



International Organization of Supreme Audit Institutions

KORNIZA E MATJES SË PERFORMANCËS SË SAI-ve

*Grupi i punës së INTOSAI-t mbi vlerën dhe dobëtë
e SAI-ve*

Miratuar në Kongresin e XXII-të të INTOSAI-t



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KORNIZA E MATJES SË PERFORMANCËS SË SAI-ve

*Grupi i punës së INTOSAI-t mbi vlerën dhe dobitë
e SAI-ve*

*****Miratuar në Kongresin e XXII-të të INTOSAI-t*****

Seria: botime KLSH-07/2017/74
ISBN 978-9928-159-59-5

Tiranë, 2017

Titulli:

“Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve”

Përgatitën botimin

Prof. Dr. Lindita Milo (Lati)

Dr. Bujar Leskaj

Përkthimi në gjuhën shqipe u realizua nga Audituesit e KLSH-së

Xhuljeta Çelaj

Ina Sokoli

Redi Ametllari

Idlir Dervishi

Lirim Beqiri

Computer Design

Benard Haka

©Copyright KLSH

Shtypur në shtypshkronjën *“CLASSIC PRINT”*

Tiranë, 2017

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Parathënie	8
1. Korniza e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit	12
1.1. Historiku dhe Qëllimi	12
1.2. Përdorimi i Kornizës së Matjes së Performancës së SAI –ve	14
1.3. Qëllimi dhe Fusha e Veprimit	15
1.4. Rreth Raportit të Performancës së SAI-t	17
1.5. Mbi Grupin e Treguesve të Performancës.....	17
1.6. Metodologjia e Vlerësimit	18
1.6.1. Fazat e Vlerësimit të KMP-së së SAI-t	18
1.6.2. Vlerësimi I Bazuar në Evidenca	23
1.6.3. Përcaktimi i Llojeve të Auditimit për Vlerësim	24
1.6.4. Ndërtimi i Kampionit të Dosjeve të Auditimit që do Vlerësohen	26
2. Përgatitja e Raportit të Performancës së SAI-t	28
2.1. Përgatitja e Raportit të Performancës së SAI-t.....	29
2.2. Përmbajtja e Raportit të Performancës së SAI-t.....	30
Parathënie.....	30
b) Deklarata për Sigurimin e Cilësisë	31
c) Vëzhgimet mbi Performancën e SAI-t dhe Ndikimin e saj	32
d) Menaxhimi i Përdorimit të Rezultateve të Vlerësimit nga SAI	38
Kapitulli 1: Hyrje.....	38
Kapitulli 2: Metodologjia	39
Kapitulli 3: Informacione për vendin dhe SAI-n.....	39
Kapitulli 4: Vlerësimi i Performancës së SAI-t.....	44
Kapitulli 5: Procesi i Zhvillimit të Kapaciteteve të SAI-t	47

<i>Aneksi 1: Përmbledhja e Treguesit të Performancës & (kur aplikohet) Trajektorja e Performancës në kohë</i>	49
<i>Aneksi 2: Burimet e Informacionit & Evidencat mbështetëse për pikëzimin e treguesit</i>	49
3. Grupi i Treguesve të Performancës së SAI-ve	50
3.1. Përmbledhje e treguesve duke përfshirë dimensionet	50
3.2. Metodologjia e Pikëzimit	54
3.2.1. <i>Pikëzimi i Dimensioneve</i>	55
3.2.2. <i>Nivelet e Pikëzimit</i>	56
3.2.3. <i>Pikëzimi i treguesve të përgjithësuar</i>	58
3.2.4. <i>Metodologjia pa pikëzim</i>	58
3.2.5. <i>Tabelat e Konvertimit për Pikëzimet e Treguesve</i>	60
3.3. Treguesit	63
Fusha A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore	63
SAI-1: Pavarësia e SAI-t	64
SAI-2: Mandati i SAI-t	71
Fusha B: Qeverisja e Brendshme dhe Etika	76
SAI-3: <i>Cikli i Planifikimit Strategjik</i>	78
SAI-4: <i>Mjedisi i Kontrollit Organizativ</i>	84
SAI-5: <i>Auditimet me Burime të Jashtme</i>	92
SAI-6: <i>Lidershipi dhe Komunikimi i Brendshëm</i>	97
SAI-7: <i>Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit</i>	101
Fusha C: Cilësia e Auditimit dhe Raportimi	105
SAI-8: <i>Mbulimi me Auditim</i>	110
Auditimi Financiar - Hyrje	118
SAI-9: <i>Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimit të Cilësisë</i>	122
SAI-10: <i>Procesi i Auditimit Financiar</i>	130

SAI-11: Rezultatet e auditimit financiar	137
Auditimi i Performancës - Hyrje	141
SAI-12: Standardet e Auditimit të Përformancës dhe Menaxhimit të Cilësisë ...	143
SAI-13: Procesi i Auditimit të Performancës	150
SAI-14: Rezultatet e Auditimit të Performancës.....	157
Auditimi i Përputhshmërisë – Hyrje	161
SAI-15: Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimit të Cilësisë	163
SAI -16: Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë	170
SAI-17: Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë	177
Treguesit për Kontrollin Gjyqësor - Hyrje	181
SAI-18: Kontrolli Gjyqësor i Standardeve dhe Menaxhimi i Cilësisë	182
SAI-19: Procesi i kontrollit gjyqësor.....	186
SAI-20: Rezultatet e kontrolleve gjyqësore	190
Fusha D: Menaxhimi Financiar i Aseteve dhe Shërbimet Mbështetëse	193
SAI-21: Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse	194
FUSHA E: Burimet Njerëzore dhe Trajnimet	199
SAI-22: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	201
SAI-23: Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi.....	206
Fusha G: Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara	212
SAI-24: Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin.....	213
SAI-25: Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.	220
Aneksi 1: Përkufizimi i termave	224
Aneksi 2: Lista e Referencave	232
Aneksi 3: Përcaktimi i KMP i SAI-t për vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit	236
Lista e Shkurtimeve	250

Hyrje

Korniza e Matjes së Performancës së institucioneve supreme të auditimit publik (SAI-ve), e miratuar ne Kongresin INCOSAI XXII të INTOSAI-t në Abu d’Habi të Emirateve të Bashkuara Arabe, në dhjetor 2016, u siguron SAI-ve një bazë për vlerësimin vullnetar të performancës së tyre kundrejt Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI-ve) dhe praktikave të tjera të mira ndërkombëtare për auditimin e jashtëm publik.

Korniza e matjes së performancës përbën një ndër dokumentet strategjike të rëndësishëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili e ka treguar qartazi se ndryshimi, zhvillimi dhe përsosja është filozofia e funksionimit të tij. Kjo filozofi nuk është vetëm një vizion apo një aspiratë, por sikurse është provuar në mënyrë të vazhdueshme, identifikimi dhe aplikimi i instrumenteve që mundësojnë zhvillimin dhe përsosjen në të gjithë dimensionet është një proces i pranishëm në mënyrë të vazhdueshme përgjatë realizimit të veprimtarisë së institucionit tonë.

Ky dokument përbën një instrument jetik, i cili nëpërmjet realizimit të procesit të vlerësimit të gjithë aspekteve të aktivitetit të institucionit më të lartë të auditimit publik, mundëson realizimin e një ekzaminimi të detajuar të nivelit të plotësisimit të standardeve të krahasuar sipas një sistemi të ndërtuar nga INTOSAI. Procesi hartimit të Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, i ndjekur nga Grupi i Punës së INTOSAI-t për “Vlerat dhe Dobitë e SAI-ve” ka qenë gjithëpërfshirës dhe është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare si dhe është testuar gjatë viteve 2013-2015 nga institucionet homologe më me eksperiencë. KLSH-ja si pjesë aktive e INTOSAI-t në mënyrë sistematike ka ndërtuar sistemet e përdorimit me efikasitet të instrumenteve të konsoliduar e të rekomanduara nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Implementimi i sistemit të treguesve dhe kritereve, që do të përdoren gjatë procesit të vlerësimit dhe vetë-vlerësimit të performancës audituese dhe organizative të institucionit, mundëson që të identifikohet, për çdo aspekt të detajuar, niveli i plotësisimit të ISSAI-ve, përcakton masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e punës audituese dhe organizative të institucionit. Vetë sistemi i zbatuar për krahasim përbën një tërësi vlerash, të cilat e bëjnë KLSH-në të vendoset sa më pranë institucioneve të vendeve më të zhvilluara dhe më me eksperiencë. Procesi i zbatimit konkret të sistemit të treguesve të matjes së performancës është një realitet i provuar për institucionin tonë. Me kurajon dhe dëshirën e përmirësimit të vazhdueshëm ky

sistem është përdorur për vlerësimin e performancës për vitet 2015 dhe 2016, gjetjet e të cilit janë publikuar në “Raporti Vjetor i Performancës, KLSH 2015” dhe “Raporti Vjetor i Performancës, KLSH 2016”.

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve është një platformë universale dhe mund të zbatohet në të gjitha llojet e SAI-ve, pavarësisht nga struktura e qeverisjes, mandati, konteksti kombëtar dhe niveli i zhvillimit. Korniza shërben, para së gjithash, për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve të SAI-t, përmes matjes së performancës dhe identifikimit të mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën e SAI-t, duke forcuar llogaridhënien.

Në përputhje me objektivat e ISSAI 12 “Vlera dhe Dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, Korniza i ofron SAI-t një bazë objektive për të demonstruar rëndësinë e tij të vazhdueshme për qytetarët dhe palët e tjera të interesit. Ajo synon të vlerësojë kontributin e SAI-t drejt një menaxhimi më të fortë financiar publik, qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies, si dhe përpjekjet për të thelluar luftën kundër korrupsionit.

Ajo shqyrton në mënyrë holistike të dy qasjet, si punën audituese ashtu dhe funksionet jo-audituese të SAI-t, në lidhje me bazën e tij ligjore dhe mjedisin ku vepron, duke identifikuar ndërvarësitë dhe shkaqet rrënjësore të performancës së SAI, duke ofruar kështu një bazë të fortë për vlerësimin tërësor të nevojave të SAI-t për planifikimin e zhvillimit të tij strategjik dhe të zhvillimit të kapaciteteve, duke mundësuar ndjekjen e progresit me kalimin e kohës.

Botimi i Kornizës së Matjes së Performancës së KLSH-së së bashku me manualët dhe udhëzuesit mundëson:

- Konsolidimin strukturor të institucionit, duke siguruar vazhdimësinë e zhvillimit të nivelit të ekspertizës së audituesve të jashtëm publik si dhe përsosjen organizative të tij;
- Rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës me publikun, partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë dhe mbi të gjitha me vet-veten;
- Komunikim të sigurtë dhe të përgjegjshëm me mbikëqyrësit tanë, parlamentin dhe qytetarët;
- Realizimin e objektivit për të qenë një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit;

- Rritjen e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit në menaxhimin e burimeve të vëna në dispozicion, duke realizuar misionin e tij si një vlerë e shtuar për qytetarët shqiptarë.

Ne si KLSH e botojmë variantin final të miratuar në Kongresin INCOSAI XXII, pasi për ne është parësore të mund të masim dhe krahasojmë punën tonë dhe rezultatet sipas kërkesave të ISSAI-ve dhe praktikave të tjera të mira ndërkombëtare.

Raportimi i performancës sonë nëpërmjet qasjes, frymës dhe treguesve të këtij instrumenti na jep siguri se jo vetëm jemi tërësisht transparentë me qytetarin, Kuvendin dhe palët e tjera të interesit, por edhe se arrijmë të japim të plotë vlerat dhe dobitë e punës së KLSH-së për ruajtjen dhe mirë-menaxhimin e parasë publike. Kjo na siguron mirëkuptimin dhe mbështetjen që kemi nevojë nga qytetari dhe Kuvendi, si dhe rrit besimin publik në dobitë e punës sonë. Për ne, si Institucion Suprem i Auditimit Publik, kjo është parësore.

Dr. Bujar LESKAJ

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit

Parathënie

Është kënaqësia ime e madhe të paraqes përpara komunitetit të INTOSAI, Kornizën e Matjes së Performancës (KMP e SAI-t). Korniza është ndërtuar përmes një procesi zhvillimi që nga viti 2010, me qëllim mbështetjen e SAI-ve në përpjekjet e tyre për të arritur objektivat e ISSAI 12, “Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve”, i cili përcakton mënyrën sesi SAI-t duhet të punojnë për të:

- forcuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin e qeverisë dhe njësive të sektorit publik;
- demonstruar rëndësinë e vazhdueshme për qytetarët, Parlamentin dhe aktorët e tjerë; dhe
- qenë një organizatë model që udhëhiqet në mënyrë shembullore.

Vlerësimi i performancës luan një rol të rëndësishëm në këto përpjekje, pasi ndihmon SAI-et të përcaktojnë në cilin nivel janë për qëllimet e zhvillimit të tyre të brendshëm, dhe gjithashtu u mundëson atyre që t’u tregojnë kredibilitetin e tyre palëve të interesit. Kjo është një pikë e fortë e KMP e SAI-t, pasi i mundëson SAI-ve të vlerësojnë performancat e tyre në mënyrë tërësore – korniza mbulon si punën audituese (dhe kontrollin gjyqësor kur është i përshtatshëm), qeverisjen e brendshme dhe etikën, marrëdhëniet me aktorët e jashtëm, si dhe pavarësinë dhe kornizën ligjore. Kjo njeh faktin që SAI-t janë institucione komplekse, dhe se performanca në aspekte të ndryshme është e ndërlydhur.

KMP e SAI-t është testuar gjerësisht që nga viti 2013, në një numër të konsiderueshëm të SAI-ve që paraqesin struktura të ndryshme administrative e nivele zhvillimi. Gjithashtu, ka pasur disa konsultime të gjera mbi draftet e mëparshme të kornizës. Kjo ka rezultuar në një kornizë që është bazuar fuqishëm në kornizën e ISSAI-ve dhe në praktika të tjera të mira të INTOSAI, është e zbatueshme për të gjithë SAI-t, dhe mund të përdoret në kontekste të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme.

Disa parime kyçe kanë udhëhequr zhvillimin e kornizës, dhe do të vazhdojnë të udhëheqin përdorimin e saj pas miratimit në XXII INCOSAI të Abu Dhabi të vitit 2016. Para së gjithash, përdorimi i KMP e SAI-t është vullnetar, dhe të gjitha vendimet kyçe që lidhen me vlerësimin, duhen të ndërmerren nga SAI. Së dyti, korniza mund të përdoret në mënyra të ndryshme; për vetë-vlerësim, për vlerësim mes kolegësh, vlerësim i jashtëm ose përzierje e tyre. Së treti, objektivi i një vlerësimi të KMP e SAI-t është i lidhur

me zhvillimin e SAI-t në fjalë – jo në krahasim me ndonjë SAI. Qëllimi përfundimtar është vlerësimi në një cilësi ëë lartë. Kjo arrihet nëpërmjet vlerësimit bazuar në evidenca të performancës aktuale, e kombinuar me mekanizma të forta për kontrollin e cilësisë dhe shqyrtimin e pavarur të projekt raporteve.

Duke qenë se puna e lidhur me zhvillimin e KMP e SAI-t ka ardhur drejt fundit për momentin, unë do të doja të shprehja mirënjohjen time më të thellë për të gjithë SAI-et dhe të tjerë të cilët kanë kontribuar për zhvillimin e procesit që nga viti 2010. Sipas mendimit tim, së bashku angazhimi aktiv dhe rezultati përfundimtar vërtetojnë moton e INTOSAI: Nga Eksperienca e Përbashkët Përfitojnë të Gjithë.

Juan M. Portal

Auditues i Përgjithshëm i Meksikës dhe

Kryetar i Grupit të Punës së INTOSAI për Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve

Fuqizimi i mbështetjes për Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) është objektivi kryesor i bashkëpunimit midis INTOSAI dhe donatorëve, i cili bashkon INTOSAI dhe partnerët e zhvillimit në një partneritet strategjik në njohjen e rolit të SAI-ve në sigurimin e përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike. Rëndësia e SAI-ve ka tërhequr vëmendjen me adoptimin e Objektivave të Qëndrueshme të Zhvillimit, ku Objektivi 16 thekson rëndësinë e institucioneve efektive dhe të përgjegjshme.

Sipas mendimit tonë, Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t (KMP e SAI-t), do të luajë një rol të rëndësishëm për SAI-et që duan të zhvillojnë kapacitetet e tyre, pasi i mundëson ata të masin performancën e tyre kundrejt standardeve të vendosura të INTOSAI dhe praktikave të mira; të vlerësojnë nevojat; të zhvillojnë i planet strategjike bazuar në evidenca dhe projektet e zhvillimit të kapaciteteve; dhe të masin progresin e tyre me kalimin e kohës.

Bashkëpunimi midis INTOSAI – Donatorë ka qenë një mbështetje e fortë që nga fillimi. Ajo ka përkrahur KMP e SAI-t dhe ka kontribuar në procesin e zhvillimit përmes këshillave strategjike, financimit të vlerësimeve pilot dhe trajnimeve. Sekretariati në INTOSAI – Donatorë në Institutin e Zhvillimit të Iniciativave (IDI) ka shërbyer si koordinator i Grupit të Punës së KMP-së së SAI-t.

Harta e përfunduar në fillim të procesit të zhvillimit të KMP e SAI-t tregoi se ka pasur një sërë mjetesh që në shkallë më të vogël apo më të madhe, kanë vlerësuar performancën dhe nevojat e SAI-ve, si në INTOSAI ashtu edhe në komunitetet e donatorëve.

Ndërsa mjete të ndryshme vazhdojnë të ekzistojnë, pasi ato përmbushin qëllime të veçanta, ne shohim vlera të mëdha tani duke patur KMP e SAI-t, si një kornizë e përdorur gjerësisht dhe që përdoret për shumë qëllime për matjen e performancës së SAI-t.

Duke patur një kornizë që njihet nga një numër i madh palësh të interesuara, duke përfshirë brenda komunitetin ndërkombëtar të donatorëve, ndihmon në uljen e kostove të transaksionit për SAI-t dhe forcon dialogun me partnerët e zhvillimit.

Sipas mendimit tonë, KMP e SAI-t mundëson cilësi të lartë, vlerësime të bazuar në evidenca të cilat do të jenë me vlerë si për SAI-t ashtu dhe për partnerët e zhvillimit.

Ne presim që KMP e SAI-t, të bëhet një sistem vlerësimi i rëndësishëm në nivel global, dhe një mjet monitorimi për mbështetjen e vazhdueshme për zhvillimin e SAI-ve në mbarë botën.

Jennifer Thomson

Drejtor/Shefi i menaxhimit financiar

Banka Botërore

Dr. Husam Al-Angari

Presidenti i Byrosë së Përgjithshme

të Auditimit, në Arabinë Saudite

Bashkëkryetarët e bashkëpunimit INTOSAI – donatorë

1. Korniza e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit


1.1. Historiku dhe Qëllimi

Korniza e Matjes së Performancës të Institucioneve Supreme të Auditimit (këtu e në vijim KMP e SAI-t), është zhvilluar nga Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Vlerën dhe Përfitimet e SAI-ve, pas një vendimi në Kongresin INTOSAI në Afrikën e Jugut në vitin 2010. Ky version, ka qenë objekt konsultimesh në Kongresin e INTOSAI në Abu Dhabi 2016, reflekton eksperiencat e Versionit Pilot (*nga korriku 2013*), i cili ishte subjekt i konsultimeve të gjera dhe u testua në më shumë se 20 vlerësime dhe në disa raunde zyrtare konsultimi me palë të shumta të interesit gjatë viteve 2013-2015.

KMP e SAI-t u mundëson institucioneve supreme të auditimit një kornizë për vlerësime vullnetare të performancës së tyre, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAIs) dhe praktikave më të mira të konsoliduara ndërkombëtare në fushën e auditimit të jashtëm publik. KMP e SAI-t është një kornizë universale shumë qëllimshme, dhe mund të zbatohet për të gjitha SAI-t, pavarësisht strukturës qeverisëse të institucionit, mandatit, kontekstit kombëtar dhe nivelit të zhvillimit. Korniza mund të përdoret për të kontribuar në përmirësimin e zhvillimit të kapaciteteve dhe planit strategjik të SAI-t duke promovuar përdorimin e matjes dhe menaxhimin e performancës, si edhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar punën e SAI-ve dhe për të rritur llogaridhënien. Kjo kornizë është e duhura (relevante) për ato SAI-te që kanë adoptuar, aspirojnë të adoptojnë, ose dëshirojnë të krahasojnë veten kundrejt ISSAI-ve dhe praktikave të tjera më të mira ndërkombëtare. Ky është një instrument që aplikohet në mënyrë vullnetare dhe nuk ka për qëllim të përdoret detyrimisht në të gjithë apo në një pjesë të komunitetit të INTOSAI-t.

Në përputhje me objektivat e ISSAI 12 "Vlera dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit - Një ndryshim në jetën e qytetarëve ", KMP e SAI-t, gjithashtu, do t'u sigurojë SAI-ve një bazë objektive për të treguar rëndësinë e tyre të vazhdueshme ndaj qytetarëve dhe palëve të tjerë të interesit. Kjo iniciativë synon të vlerësojë kontributin e SAI-ve për forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit. Kjo do tu japë SAI-ve një mundësi për t'u bërë organizata model duke udhëhequr nëpërmjet shembullit në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies përmes raportimit të besueshëm publik të performancës së tyre.

Diagrama 1: Struktura e Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-t



1.2. Përdorimi i Kornizës së Matjes së Performancës së SAI –ve

Korniza e matjes së performancës (KMP) synon të përdoret për të përcaktuar se sa mirë punon një SAI në krahasim me praktikën e mira ndërkombëtare, si dhe për të identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e tij. Vlerësimi duhet të bazohet në evidenca. Përdorimi i KMP e SAI-t është vullnetar. Vendimi për të kryer një vlerësim duke përdorur KMP e SAI-t, i takon Kryetarit të të SAI-të. Vlerësimi sipas KMP E SAI-T nuk propozon rekomandime për reformat e ardhshme, kryesisht një vlerësim i tillë, mund të pasohet nga një proces për zhvillimin e planit strategjik të SAI-t, dhe/ose identifikon, përcakton prioritetet dhe për pasojë propozon iniciativë për zhvillimin e kapaciteteve.

Qëllimet e vlerësimit të një KMP e SAI-t përfshijnë:

- **Si një hap drejt zbatimit të ISSAI-ve;** duke mësuar se ku është më e madhe nevoja për ndryshim, për zbatimin e parimeve kryesore të ISSAI-ve, dhe të marrë një kuptim më të plotë të asaj që sjellin për SAI-n praktikën më të mira.
- **Për të demonstruar progresin, vlerën dhe përfitimet për shoqërinë;** duke matur progresin gjatë periudhës dhe duke ua evidentuar këtë palëve të interesit të jashtëm, në këtë mënyrë u tregon palëve të interesuara, se si SAI kontribuon në forcimin e menaxhimit të financave publike, promovimin e qeverisjes së mirë, nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies, dhe luftimin e korrupsionit.
- **Planifikimi strategjik:** duke realizuar një vlerësim të nevojave për të gjithë organizatën, të cilin SAI mund ta përdorë për të informuar mbi zhvillimin e një plani strategjik.
- **Matja e Performancës së Brendshme/Raportimi Vjetor;** duke përmirësuar ose duke bërë të njohur përdorimin e procedurave të brendshme të matjes së performancës.
- **Të marrë mbështetje të vazhdueshme për përpjekjet për zhvillimin e kapaciteteve;** duke treguar angazhim për të ndryshuar dhe krijimin e një linje-bazë për performancën.

Një listë më gjithëpërfshirëse të qëllimeve të mundshme mund të gjendet në materialin udhëzues të KMP e SAI-t .

KMP e SAI-t përdor Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAIs), si pikë referimi kryesore sipas të cilëve matet performanca. Shumica e

treguesve janë zhvilluar në bazë të ISSAI-ve, në nivelet 1-3¹. Shumë SAI janë aktualisht në procesin e implementimit të standardeve. Për këto SAI-je, KMP e SAI-t mund të përdoret si mjet për të marrë një pamje nga lartë për të përcaktuar aspektet që kanë nevojë për ndryshim në mënyrë që të zbatohen plotësisht parimet kryesore të ISSAI-ve në nivelet 1-3. Duke pasur parasysh shtrirjen gjithëpërfshirëse, KMP e SAI-t siguron detaje të mjaftueshme për ekzaminimin ose për vlerësimin e nevojave në shumicën e aspekteve, me përjashtim të vlerësimit për: (i) mat përputhshmërinë me nivelin 4 të ISSAIs, dhe (ii) kontrollin e pritshmërive të aktorëve të tjerë ndaj SAI. Megjithatë, kriteret e KMP e SAI-t për treguesit e auditit, të cilat bazohen në parimet e nivelit 3^{të} të ISSAI, reflektojnë kërkesat kryesore të nivelit 4 të ISSAIs. Ka mjete të tjera të INTOSAI-t që janë zhvilluar për rishikimin e sigurimit të cilësisë të SAI-ve në përputhje me nivelin 4 të ISSAIs. Qëllimi i treguesve të KMP E SAI-Tjanë shpjeguar hollësisht në 1.3, dhe sipas secilës fushë respektive në Kapitullin 3.

Për më tepër, jo të gjithë SAI-t synojnë zbatimin e ISSAI-ve, për shembull, për shkak të kufizimeve në mandatin e tyre. Për këto SAI-e, PMF-ja mund të mos jetë metoda më e përshtatshme për vlerësimin e performancës, dhe publikimi i rezultateve të një vlerësimi të tillë mund të japë një pamje deformuese të performancës së SAI-t.

1.3. Qëllimi dhe Fusha e Veprimit

Korniza e matjes së performancës jep një pamje të aspekteve më të rëndësishme të performancës të SAI-të. Ky vlerësim mbulon si proceset e brendshme të SAI-t dhe produktet e saj. Gjithashtu, synon të masë performancën e SAI sipas Standardeve Ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të krijuara brenda INTOSAI, duke marrë në konsideratë mandatet specifike dhe kornizat ligjore, në të cilat funksionon SAI. Fushat e standardizuara dhe matjet objektive të performancës të SAI-të, të pasqyruara në formën e treguesve, bën të mundur krahasimin e performancës në periudha të ndryshme kohore.

Korniza e matjes së performancës së SAI-ve përbëhet nga dy komponentë:

1) Udhëzimi për Raportin e Performancës, i cili është produkti përfundimtar i vlerësimit dhe që përbëhet nga një analizë përshkrimore e gjetjeve. Kjo është paraqitur në kapitullin 2.

¹ Për informacione shtesë nëlidhje me kornizën ISSAI, shih www.issai.org. Për listën e referencave të ISSAIs dhe pikë të tjera të përdorura, ju lutem shikoni Aneksin 2.

2) Një grup prej 25 treguesish (nga dy deri në katër dimensione secili) për të matur performancën e SAI-t krahasuar me praktikat më të mira ndërkombëtare në gjashtë fusha²:

- A. Pavarësia dhe Korniza ligjore;
- B. Qeverisja e Brendshme dhe Etika;
- C. Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;
- D. Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Strukturat Mbështetëse;
- E. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi;
- F. Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesit.

Grupi i plotë treguesve është dhënë në kapitullin 3. Ndërsa fushat individuale të KMP e SAI-t sigurojnë informacione të dobishme mbi veten e tyre, të dhëna nga të gjitha fushat si dhe informacioni i përgjithshëm është i nevojshëm për kryerjen e një analize krahasuese të performancës së SAI-të.

Treguesit kryesisht matin aspekte që janë tërësisht në kontrollin e SAI-t, si psh. sistemet organizative dhe kapacitetin profesional. Përfundimisht në Fusha A, e cila mat pavarësinë e SAI-t dhe kornizën ligjore. Këto janë faktorë të vendosur, kryesisht nga organe të tjera në sistemin e qeverisjes, ndaj të cilave SAI ka ndikim të kufizuar. Megjithatë, ato janë përfshirë sepse janë shumë të rëndësishme për performancën e SAI-t, si dhe u është dhënë theks i konsiderueshëm në kornizën e Standardeve Ndërkombëtare të SAI-t. Gjithsesi duhet të pranohet që çdo dobësi në këtë fushë nuk mund të adresohet lehtë nga vetë SAI. Raporti përshkruar i Performancës, gjithashtu, vlerëson faktorët që nuk janë tërësisht në kontrollin e SAI-t, por që ndikojnë në performancën e tij, të tillë si cilësia e komponentëve të tjerë të sistemit të menaxhimit të financave publike. Kjo pjesë e vlerësimit, megjithatë, bazohet në burime dytësore të informacionit dhe jo nga treguesit e kornizës së matjes së performancës së SAI-t.

Korniza e matjes së performancës fokusohet në SAI-n e një vendi specifik dhe është hartuar për vlerësimin e të gjithë sistemit të auditimit publik, i cili s'mund të përfshijë organe të tjera përveç SAI-t. Në varësi të kuadrit kombëtar institucional (p.sh. të një shteti unitar federal, shkalla e decentralizimit), mund të ndodhë që SAI bashkëjeton

² Tre nga fushat janë të veçanta për SAIs me funksione juridiksionale dhe nuk mund të zbatohen te SAI-t e tjerë.

me organe qendrore ose organe rajonale të auditimit publik. Në raste të tilla, legjislacioni do të përcaktojë mandatet respektive të SAI-të krahasuar me organet e tjera të auditimit publik, si dhe rolin e SAI (nëse ka) në mbikëqyrjen e audituesve të tjerë publik. Është e rëndësishme për ekipin vlerësues të identifikojë qartësisht shkallën e autonomisë së organeve të tjera të auditimit publik dhe nëse ato do të mbulohen apo jo nga vlerësimi. Për të pasur një vlerësim të plotë të praktikave audituese të SAI-t, është e rekomandueshme që vlerësimi të ekzaminojë punën e SAI-t në vitin e plotë fiskal të fundit, përveç nëse specifikohet ndryshe nga treguesit. Duke pasur parasysh rëndësinë e vlerësimit, është e rekomandueshme që KMP e SAI-t të përsërisë vlerësimet çdo 3-5 vjet.

1.4. Rreth Raportit të Performancës së SAI-t

Raporti i Performancës së SAI-t është një raport përshkrimor, i cili i mundëson lexuesit një pamje të përgjithshme të performancës së SAI-t, i plotësuar me informacione për mjedisin në të cilin SAI vepron, e ndërvarësitë midis aspekteve të ndryshme të performancës së tij, dhe vlerësimin e detajuar të gjetjeve dhe nivelin e treguesve. Raporti i Performancës është produkti kryesor i vlerësimit të kornizës së matjes së performancës të SAI-të, i cili mundëson analiza përtej rezultateve të treguesve të rezultateve.

Struktura e rekomanduar e Raportit të Performancës dhe udhëzimet se si duhet shkruar ai, jepen në kapitullin 2.

1.5. Mbi Grupin e Treguesve të Performancës

Çdo tregues kërkon të masë performancën e SAI-t në një aspekt kryesor sipas një shkalle me pesë pikë nga 0 deri në 4³. Treguesit janë të dizajnuar për të mundësuar matje objektive, megjithëse kërkohet gjykim profesional të vlerësuesve. Udhëzuesi është zhvilluar bazuar në kriteret e performancës për secilin pikëzim, për secilin tregues, si dhe përfshirë vetë treguesin. Nuk ka tregues të mesatarizuar për të gjithë SAI-n, sepse të gjithë treguesit nuk janë njësoj të rëndësishëm, dhe rëndësia e tyre relative do të ndryshojë nga një SAI në tjetrin dhe nga viti në vit. Një analizë e përgjithshme e performancës së SAI-t duhet të jepet në raportin e performancës.

Udhëzime mbi pikëzimet dhe nivelet e rezultatit jepen në kapitullin 3.

³ Niveli i pikëve (0-4) nuk duhet të ngatërrohet me katër nivelet e kornizës së ISSAI. Nuk ka asnjë lidhje midis këtyre të dyja. KMP E SAI-T bazohet në nivelet 1-3 të kornizës së ISSAI.

1.6. Metodologjia e Vlerësimit

Kapitulli 3 paraqet grupin e treguesve, me dimensionet dhe kriteret respektive të tyre. Për secilin tregues, përshkruhet metoda e sugjeruar për matjen e treguesve, për të ndihmuar vlerësuesit. Gjithashtu, materiali udhëzues shtesë i kornizës së matjes së performancës së SAI-t mund të përdoret si mbështetje për planifikimin dhe kryerjen e vlerësimit.

1.6.1. Fazat e Vlerësimit të KMP-së së SAI-t

Kryerja e vlerësimit të performancës së SAI-t është një proces gjithëpërfshirës, që ka nevojë për vendime kyçe nga SAI që është përfshirë në proces. Më poshtë jepen fazat kryesore të vlerësimit sipas KMP-së së SAI-t:

1. *Vendimi për të kryer vlerësimin;*
2. *Planifikimi i vlerësimit;*
3. *Kryerja e vlerësimit;*
4. *Menaxhimi i cilësisë për të siguruar një raport të cilësisë së lartë;*
5. *Pas vlerësimit – përdorimi i rezultateve.*

Vendimi për kryerjen e vlerësimit

Kryerja e vlerësimit të kornizës së matjes së performancës të SAI-t duhet të ndërmerret me vendimmarrje nga Kryetari i SAI, për. Kjo përcaktohet nga parimi, sipas të cilit KMP e SAI-t është një mjet vullnetar vlerësimi, dhe produkti përfundimtar, Raporti i Performancës së SAI, është pronë e SAI-t. Është e rëndësishme që vendimi kyç për nisjen e një vlerësimi të shoqërohet nga këto elementë:

- *Qëllimi i vlerësimit;*
- *Kur do të kryhet vlerësimi;*
- *Si do të kryhet vlerësimi;*
- *Nëse, kur dhe si të publikohet raporti i vlerësimit.*

Këto vendime janë thelbësore për planifikimin e mëtejshëm të vlerësimit, dhe duhet komunikuar brenda SAI për të garantuar përfshirjen dhe pronësinë për vlerësimin e ardhshëm.

Planifikimi i Vlerësimit

Është e rëndësishme të vendoset theksi i duhur në planifikim, për të garantuar, që përpara së të fillojë vlerësimi, janë adresuar çështjet kryesore. Një çështje e rëndësishme, përpara fillimit, është se kush është/janë qëllimi/et e vlerësimit. Kjo do të ketë pasoja për vendimet e tjera që duhen bërë në fazën e planifikimit, të cilat përfshijnë mbledhjen e një ekipi vlerësuesish të kualifikuar, duke përcaktuar qëllimin dhe metodën e vlerësimit, përgatitjen për mbledhjen e të dhënave dhe duke vendosur një marrëveshje për të garantuar cilësi dhe afat kohor për vlerësimin.

Të gjitha këto çështje duhen dokumentuar në Termat e Referencës (ToR) të vlerësimit. ToR duhet të përgatitet nga ekipi vlerësues, me miratimin e Kryetarit të SAI. ToR duhet, gjithashtu, të krijojë një mirëkuptim të ndërsjellë midis SAI-t dhe ekipit vlerësues mbi pritshmëritë e SAI-t si dhe mbi kontributin që duhet të japi për të ndihmuar realizimin e vlerësimit. Është e rëndësishme që ToR të identifikojë personat kyç nga SAI që do të ndihmojnë ose lehtësojnë përpjekjen e ekipit, pavarësisht nëse ekipi vlerësues është i brendshëm apo i jashtëm për SAI. Gjithashtu, për të përcaktuar qëllimin dhe metodologjinë e vlerësimit, duhet një përshkrim dhe vlerësim i shkurtër i aktiviteteve kryesore të SAI-t në lidhje me temat e kornizës, duke përfshirë një marrëveshje mbi treguesit që janë të përshtatshëm për të matur aktivitetet e auditimit. Më shumë informacion mund të gjendet në vazhdim, sipas secilës fushë në kapitullin 3, dhe në dokumentin plotësues të Udhëzuesit. ToR, gjithashtu, përshkruan kualifikimet e nevojshme të ekipit vlerësues. Është e rëndësishme që të zotërohen njohuri e mjaftueshme përreth kornizës dhe metodologjisë së KMP E SAI-t nga anëtarët e ekipit. Gjithashtu, përbërja e ekipit duhet të garantojë që vlerësuesit kanë njohuri të mjaftueshme dhe eksperiencë mbi modelin e SAI-të si dhe mbi aktivitetet e auditimit dhe të kontrollit. Pra së bashku, ekipi, duhet të ketë ka njohuritë e duhura të kuptojë se si vepron SAI në kontekstin e tij.

Mënyra se si do të realizohet vlerësimi dhe nga kush, qartazi, varen nga qëllimi/et e vlerësimit. Korniza e matjes së performancës së SAI-t mund të zbatohet duke përdorur metoda të ndryshme vlerësimi, dhe korniza është dizajnuar në mënyrë të tillë që të jetë e aplikueshme njëlloj për të gjithë. Metodatat kryesore të vlerësimit janë:

- a) *Vetë-vlerësim nga SAI;*
- b) *Një vlerësim nga një organizatë tjetër SAI ose INTOSAI;*
- c) *Një vlerësim i jashtëm nga konsulentë, donatorë, auditues të jashtëm ose ekspertë të tjerë; ose*

d) Një vlerësim hibrid i kombinuar nga qasje të tjera.

Kur vendos për metodën, SAI duhet të marri parasysh aspekte të tilla si: njohuria mbi kornizën e KMP-së së SAI-t, gjuha e punës brenda SAI-t, disiplina audituese në kontekstin në të cilin SAI operon. Vlerësimi kërkon një grupe punë me burime njerëzore dhe financiare të mjaftueshme për ta kryer vlerësimin. Nëse KMP E SAI-t është vlerësuar nga homologët e tij, ISSAI 5600 *Peer Review Guide* mund të ofrojë udhëzime të dobishme se si planifikohet dhe organizohet një vlerësim të tillë.

Kryerja e Vlerësimit

Kryerja e një vlerësimi të KMP E SAI-t kërkon rishikim të dokumentit dhe intervista me drejtuesit e SAI dhe stafin. Nëse vlerësimi kryhet nga homologët ose nga vlerësues të jashtëm, normalisht gjatë periudhës 1-2 javë do të kryhen misionet në ambientet e SAI-t që është në proces vlerësimi, si dhe duhen përfshirë përgatitjet dhe ndjekja në vazhdim. Përpara fillimit të punës në terren, mund të jetë efikase shqyrtimi i disa dokumenteve mbi mjedisin e jashtëm të SAI-t, duke përfshirë kornizën ligjore, si dhe dokumente të brendshme të SAI-t. Kjo do ta pajiste ekipin vlerësues me informacionin e duhur për punën në terren, mbi personat që do të intervistohen, si dhe ku duhet kërkuar për informacionet e përshtatshme për pikëzimet e treguesve të ndryshëm. Pikëzimi i 25 treguesve përbën bazën për realizimin e vlerësimeve cilësore në Raportin e Performancës, dhe duhet të jetë përfunduar përpara shkrimit të kësaj pjese. Udhëzues sesi të vlerësohen treguesit paraqitet sipas secilit tregues respektiv në kapitullin 3.

Raporti i Performancës duhet të sigurojë informacion gjithëpërfshirës mbi performancën e SAI-t dhe të japë shpjegime për pikët e siguruara. Nëse vlerësimi është një vlerësim i përsëritur, do të ishte vlefshme të kontrollohen sesi ka ndryshuar performanca me kalimin e kohës, duke përfshirë krahasimin e treguesve të pikëzuar aty ku është e mundur.

Vlerësime të mëtejshme mbi metodologjinë janë pasqyruar më poshtë, si edhe në materialin udhëzues shtesë.

Menaxhimi Cilësor për të Siguruar një Raport të Cilësisë së Lartë

Sigurimi i një vlerësimi cilësor dhe objektiv është thelbësor për përgatitjen e Raportit të Performancës së SAI-t, i cili përshkruan në mënyrë korrekte SAI-n dhe aktivitetet e tij dhe sjellin vlerë të shtuar për përpjekje për zhvillim të SAI-t. Një vlerësim me cilësi të lartë

do të kontribuojë në vetë-pranimin dhe besimin në rezultatet e brendshme, sikurse sigurojnë kredibilitetin e rezultateve në lidhje me palët e treta të interesuara aty ku është e rëndësishme.

Për rrjedhojë, çdo vlerësim individual duhet të marrë masat që të sigurojë një produkt të cilësisë së lartë. Për të siguruar cilësinë e duhur të vlerësimit, pavarësisht metodës, kontrolli i cilësisë dhe shqyrtimi i pavarur duhet të planifikohet, kryhet dhe deklarohet.

Marrëveshjet për kontrollin e cilësisë duhet të mbulojnë shqyrtimin e letrave të punës, punën e ekipit, mbikëqyrjen dhe monitorimin eë progresit. Një zgjidhje e sugjeruar mund të jetë që udhëheqësi i ekipit të vlerësimit është përgjegjës për nivelin e parë të kontrollit të cilësisë, ndërsa niveli i dytë i kontrollit të cilësisë i projekt raportit realizohet nga menaxherët ose stafi i SAI, dhe/ose mundësisht nga një organizatë donatore, të cilët nuk kanë qenë pjesë e ekipit vlerësues. Kontrolli i cilësisë duhet të përmbajë verifikimin e fakteve të paraqitura në raport dhe të sigurojë që çështjet nuk janë keqinterpretuar. Në disa vlerësime duhet të përdoret një palë e tretë, me njohuri të mira lidhur me vendin objekt vlerësimi, për të verifikuar kontekstin e paraqitur në kapitullin përkatës.

Rekomandohet fuqimisht, që të gjitha raportet matjes së performancës së SAI-t të jenë subjekte të një vlerësimi të pavarur për zbatimin e metodologjisë së Kornizës së Matjes së performancës së SAI-t nga ekspertë të jashtëm dhe të pavarur, të certifikuar si ekspertë cilësorë. Objektivat kryesor të vlerësimit të pavarur janë për të siguruar se treguesit dhe pikëzimet janë përdorur në mënyrë korrekte, bazuar në evidenca të mjaftueshme dhe të duhura, dhe se këto elemente argumentojnë analizën duke sjellë konkluzione të vlefshme. IDI (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI) është koordinatori i Vlerësimit të Pavarur në nivel global, dhe mund të ofrojë mbështetje në identifikimin e një vlerësuesi të certifikuar nga grupi i ekspertëve të Kornizës së matjes së performancës të SAI-t. Udhëzime të mëtejshme për marrëveshjet e cilësisë mund të gjenden në materialin udhëzues shtesë të kornizës së matjes së performancës së SAI-t.


Përfundimi i Vlerësimit – Përdorimi i Rezultateve

Korniza e matjes së performancës nuk ka për qëllim që të prodhojë një listë me rekomandime për aktivitetet e ardhshme të SAI-t për zhvillimet e kapaciteteve të tyre. Përkundrazi, korniza e matjes së performancës ofron një pamje të nivelit të lartë mbi performancën e SAI-t, si dhe ofron një vlerësim të detajuar për pikat e tij të forta dhe të dobëta dhe sesi ato ndikojnë në performancën e SAI-t.

Kur raporti ka përfunduar, një seksion i shkurtër në raport është shkruar nga drejtuesit e SAI-t, në të cilën pasqyrohet sesi duhen përdorur rezultatet e vlerësimit.

Përpara se të planifikohen aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve, mbi bazën e gjetjeve në raportin e kornizës së matjes së performancës, SAI duhet të marrë parasysh prioritetet e tij të zhvillimit, bazuar në burimet që disponon, të brendshme dhe të jashtme, në mbështetje të ndryshimit, dhe për renditjen e duhur të aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve. Gjithashtu, për përcaktimin e prioriteteve të tij strategjike, SAI mundet që të shqyrtojë më tej pritshmëritë e palëve të ndryshme të interesit. Roli i kornizës së matjes së performancës së SAI-t në procesin e zhvillimit të kapaciteteve është përmbledhur në diagramën e mëposhtme:

Diagrama 2: Roli i Vlerësimit KMP të SAI-t në Zhvillimin e Kapaciteteve



Në mënyrë të ngjashme, për SAI-t që dëshirojnë të identifikojnë treguesit e performancës për menaxhim të brendshëm të performancës, duhet të realizojnë një proces për zgjedhjen e treguesve sipas prioriteteve strategjike dhe përshtatshmërisë së treguesve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm për SAI-n është publikimi apo jo i raportit. Ky vendim duhet marrë nga Kryetari i SAI-t. Përpara marrjes së vendimit, duhen marrë parasysh, me vëmendje, përfitimet e mundshme dhe risqet e publikimit. Zgjedhja gjithashtu varet dhe nga qëllimi i vlerësimit. Nëse SAI dëshiron të demonstrojë përgjegjësi ose të tregojë impaktin e punës së tij, publikimi i raportit në një audiencë të gjerë mund të jetë një zgjidhje e arsyeshme. Meqë vlerësimi i kornizës së matjes së performancës së SAI-t është një vlerësim vullnetar, dhe Raporti i Performancës është pronë e SAI-t, është gjithmonë zgjedhja e SAI-t nëse duhet publikuar apo jo, edhe nëse vlerësimi është financuar nga palë të treta. Mund të ketë arsye detyruese për SAI-n që mos ta publikojë raportin. Nëse SAI konsideron se ka risqe që lidhen me publikimin, duhet zhvilluar një plan për zvogëlimin e këtyre risqeve.

1.6.2. Vlerësimi i Bazuar në Evidenca

Vlerësimi i kornizës së matjes së performancës së SAI-t duhet mbështetur në evidenca, që do të thotë se përshkrimet dhe analizat në raport duhen mbështetur në dokumentet e evidentuara.

Metoda e rëndësishme për grumbullimin e të dhënave e përdorur në vlerësimin e kornizës së matjes së performancës së SAI-t është shqyrtimi i dokumenteve (duke përfshirë shqyrtimin e dosjeve të auditimit që janë marrë si kampion) dhe i intervistave. Shqyrtimi i dokumenteve dhe dosjeve të auditimit, zakonisht, janë burimet kryesore të evidencave, ndërsa intervistat mund të përdoren për sqarime dhe për marrje informacioni, nëse konteksti nuk paraqitet në dokumentet e shkruara. Informacioni i siguruar në intervista me drejtuesit dhe anëtarët kyç të stafit, gjithashtu ofron një kontekst të vlefshëm për të kuptuar organizatën, sistemet dhe proceset e saj, por informacioni duhet të mbështetet nga evidencat e dokumentuara. Në përfundim, vërejtjet dhe metodat e tjera mund të jenë të përshtatshme kur vlerësojnë, për shembull, Fusha F (*Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara*).

Gjatë fazës së planifikimit, vlerësuesit duhet të kuptojnë SAI-n, duke përfshirë strukturën organizative të saj dhe aktivitetet kryesore. Për të siguruar një vlerësim eficient, vlerësuesit duhet të pajisen me dokumentet më të rëndësishëm që në fillim të

procesit. Në fazën e planifikimit, ekipi vlerësues duhet marrë në konsideratë dhe të identifikojë pikat e mëposhtme:

- a) *Cilat metoda duhen përdorur për të mbledhur dhe analizuar evidenca për të vlerësuar kriteret dhe matur treguesit;*
- b) *Cilat të dhëna dhe evidenca nevojiten;*
- c) *Cilat dokumente duhet për t'u mbledhur më parë, dhe në vend;*
- d) *Si të zgjedhim llojin e auditimit për vlerësim;*
- e) *Si të ndërtojmë kampionin e dosjeve të auditimit;*
- f) *Cilat takime/mbledhje nevojiten për t'u organizuar;*
- g) *Si duhet kryer vlerësimi;*
- h) *Si duhen dokumentuar puna dhe rezultatet;*
- i) *Si duhen shpërndarë detyrat midis anëtarëve të ekipit sipas kompetencave.*

Raporti i KMP e SAI-t duhet të jetë shumë i qartë mbi burimet e tij të informacionit. Raporti duhet të paraqesë qartësisht evidencat që janë përdorur për të mbështetur pikëzimin e secilit tregues dhe faktet në pjesë të tjera të raportit. Evidenca mundet, për shembull, të listohet si shënim në fund të faqes (*footnotes*) ose në fund të raportit. Duke qenë i qartë në burimet e informacionit do të ofrohet një udhëzues i vlefshëm për kryerjen e vlerësimeve të ardhshme, dhe siguron që pikëzimi i treguesve në vlerësimet e ardhshme do të krahasohen me vlerësimet e mëparshme.

Ekipi vlerësues duhet të mbajë një dosje pune që të përmbajë dokumentet e përdorura gjatë vlerësimit. Kjo do të përfshijë evidencat e mbledhura, fletët e punës të përdorura në procesin e analizës, draft-raportin dhe komunikimet me SAI-n dhe palët e treta të interesuara.

Udhëzime të mëtejshme ofrohen në materialin udhëzues shtesë.

1.6.3. Përcaktimi i Llojeve të Auditimit për Vlerësim

Treguesit në Fushën C mbi Cilësinë e Auditimit dhe Raportimi, përbëjnë pjesën më të madhe të vlerësimit të kornizës së matjes së performancës së SAI-t. Fusha tregon një grup me 13 tregues që matin tre disiplinat e auditimit – auditimin financiar, auditimin e performancës dhe auditimin e pajtueshmërisë (ashtu siç ato identifikohen nga ISSAI) – si edhe aktiviteti kryesor i SAI-t me funksionet dhe kontrollet juridiksionale.

SAI-et zhvillohen bazuar në tradita të ndryshme administrative dhe operojnë/funksionojnë në mjedise të ndryshëm.

Prandaj, aktivitetet e auditimit mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis SAI-ve, ose vetëm në emër, dhe/ose në mënyrën se si janë organizuar aktivitetet e auditimit, si dhe çfarë përfshin auditimi. Një çështje kyçe për ekipin e vlerësimit, para nisjes së punës në terren, është, për rrjedhojë, të vendosin se çfarë lloji auditimi do të vlerësojnë dhe cilët tregues do zbatojnë⁴. Kjo është jetike, gjithashtu, për të përcaktuar kampionin e duhur që do të shqyrtohen. Me SAI-n duhet të arrihet një marrëveshje e përbashkët mbi llojin auditimit që do të shqyrtohet si pjesë e vlerësimit. Kjo duhet dokumentuar në Termat e Referencës, në mënyrë që të plotësojë pritshmëritë e vlerësuesve dhe të SAI-t.

Kur vendoset se cili lloj auditimi do vlerësohet, ekipi i vlerësimit duhet të vlerësojë kornizën ligjore të SAI-t për të përcaktuar mandatin e tij. Meqë aktivitetet e auditimit emërtohen ndryshe nga SAI të ndryshëm, ekipi duhet, gjithashtu, të marrë në konsideratë objektivat, qëllimin dhe rezultatet e aktiviteteve të auditimit që SAI realizojnë në praktikë. Për shembull, ndërsa një SAI mund të mos japi opinion, bazuar në një nivel të arsyeshëm të sigurisë, nëse informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare është pa gabime materiale (sipas përcaktimit të auditimit financiar të ISSAI-ve), përsëri mund të jetë e përshtatshme që të vlerësohet aktiviteti i auditimit sipas treguesve të auditimit financiar. Kjo duhet të realizohet nëse, objektivi i auditimit ishte që të përcaktonte nëse informacioni financiar i entitetit ishte pasqyruar në përputhje me kuadrin e zbatueshëm financiar dhe rregullator.

Shumica e SAI-ve kryejnë auditime përputhshmërie në disa forma, që nga kontrolli i thjeshtë i ligjshmërisë, deri te auditimi i sistemeve të avancuara që bazohen tek risku. Emrat dhe qëllimet ndryshojnë, por edhe njëherë, objektivi mund të ndihmojë vlerësuesit të vendosin llojin e auditimit.

⁴ Ju lutem shikoni Fushën C për më shumë informacion për llojet e ndryshme të auditimit
faqe **25** nga **250**

Kombinimet e punës audituese - Si të trajtojmë auditimet gjithëpërfshirëse.

Auditimet gjithëpërfshirëse.

Në vende të ndryshme, SAI gjatë realizimit të auditimeve kombinon lloje të ndryshme auditimesh. Nëse standardet/manualët e SAI-t kombinojnë më shumë se një lloj auditimi në një çështje të vetme, ekipi i vlerësimit mund të vendosë të vlerësojë performancën sipas treguesve të bazuar disa kampione të dosjeve të auditimit. Për shembull, një auditim që synon të realizojë, të dyja, auditimin financiar dhe atë të pajtueshmërisë, mund të përdoret si pjesë e kampionit për pikëzimin si të treguesve të auditimit financiar edhe të atij të pajtueshmërisë. Megjithatë, treguesit duhen të pikëzohen të ndarë.

Shpesh SAI-t që kryejnë auditime gjithëpërfshirëse realizojnë auditime të pajtueshmërisë me rregullimet financiare, më tepër se sa auditime financiare që bazohen tek ISSAI-të (ku objektivi i auditimit është të shpreh opinionin bazuar në një nivel të arsyeshëm të sigurisë se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiarë). Këto auditime nuk duhet të vlerësohen sipas treguesve të auditimeve financiare. Për të vlerësuar treguesit e auditimit financiar, kampioni i auditimit duhet të jetë vetëm ato, në të cilat SAI merr në shqyrtim pasqyrat financiare dhe i kërkohet që të japi opinionin nëse pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale.

Gjithashtu, disa SAI transferojnë punën e tyre për auditimet financiare tek sektorin privat ose auditues të tjerë. Në këtë rast, ekipi i vlerësimit duhet të marri në konsideratë nëse këto auditime të realizuara nga të tretët duhet të përfshihen në objektin e vlerësimit. Udhëzime të mëtejshme lidhur me këtë, ofrohen në SAI-5 *Auditimet e Jashtme*, SAI-8 (i) *Mbulimi i Auditimit Financiar*, dhe në seksionin që paraqet treguesit e auditimit financiar në Fushën C.

1.6.4. Ndërtimi i Kampionit të Dosjeve të Auditimit që do Vlerësohen

Kampionet e dosjeve të auditimit janë të nevojshme për të vlerësuar treguesit në Fushën C. Për të vlerësuar cilësinë e punës audituese të realizuar nga SAI-t, ekipi i vlerësimit duhet të shqyrtojë auditimet e kryera nga SAI gjatë periudhës në shqyrtim. Për këtë qëllim, duhet të ndërtohet kampioni i dosjeve të auditimit, duke përfshirë të gjithë dokumentacionin që lidhet me secilin lloj të auditimit/ të kontrollit juridiksional. Dokumentacioni që rishikohet përfshin dokumentet e planifikimit, Vlerësimin e riskut, letrat e punës, projekt-raportin, komunikimin me entitetet e audituara, dokumentimin e kontrollit të cilësisë, dhe raportin përfundimtar për secilin audit.

Në përputhje me vendimin se cilat lloje auditimi do shqyrtohen, duhet të ndërtohet kampioni për secilin lloj auditimi. Kampionet duhet të zgjidhen që të mbulojnë aktivitetet kryesore të auditimit që SAI ka kryer brenda afatit kohor që është objekt vlerësimi, dhe të marrin parasysh deviacionet e parashikuara të performancës. Dosjet e auditimit të kampionuara (të përfshira në grupin e vëzhgimit) duhet të zgjidhet në mënyrë rastësore dhe të pavarur nga ekipi i vlerësimit. Kampioni duhet të jetë e shtresëzuar në mënyrë që të mbulojë faktorët e ndryshëm, të cilët mund të ndikojnë në cilësinë e auditimeve, për shembull, praktikat të ndryshme nëpër departamentet e SAI-t, llojet e entiteteve të audituara, vendodhjet si zyrat qendrore kundrejt zyrave rajonale.

Madhësia e kampionit mund të ndryshojë sipas llojeve të auditimit. Zakonisht, nuk është e nevojshme të zgjedhësh një kampion i cili është përfaqësues nga pikëpamja statistikore. Meqenëse kryerja e një auditimi performance, normalisht, zgjat më shumë në kohë sesa kryerja e auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë, popullsia nga e cila do të përzgjidhet kampioni mund të jetë i vogël për periudhën objekt vlerësimi. Në këtë mënyrë, kampioni i auditimeve të performancës do të jetë, shpesh, më i vogël se kampioni i auditimeve financiare dhe i pajtueshmërisë. Në mënyrë të ngjashme, zyrat rajonale ose lokale ose departamentet me përgjegjësi të specifike mund të kenë aktivitete të kufizuara, dhe kjo mund të ndikojë te madhësinë e popullsisë, pra dhe madhësinë e kampionit.

Në rastet kur SAI kryen auditime të ndryshme të kombinuara, për shembull një auditim gjithëpërfshirës, vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë nëse do të ndërtojnë kampion të veçantë për secilin lloj ose nëse do vlerësojnë të njëjtin kampion sipas treguesve të ndryshëm. Në varësi të kontekstit të SAI-t, duhet të vendoset metoda për secilin vlerësim. Për të përcaktuar se cila është metoda e duhur, do të ishte e dobishme të merret në konsideratë specifikat e proceseve të auditimit. Është e rëndësishme të mbahet shënimi në fletët e punës dhe në raportin përfundimtar të vlerësimit se në cilat kampione janë mbështetur secili prej dimensioneve/ treguesve.

Udhëzimi i mëtejshëm është ofruar nën Fushën C në materialin udhëzues shtesë të kuadrit të matjes së performancës së SAI-t.

2. Përgatitja e Raportit të Performancës së SAI-t

Ky kapitull synon të ndihmojë në përgatitjen e Raportit të Performancës së SAI-t , i cili është produkti përfundimtar i vlerësimit të bazuar në kornizën e matjes së performancës së SAI-t. Ai përshkruan përmbajtjen e dëshiruar të RP-SAI dhe se si informacioni duhet të paraqitet në raport. Ai plotësohet nga grupi i treguesve të performancës së SAI-ve trajtuar në kapitullin 3.

Raportin e Performancës SAI-t, ka për qëllim që të sigurojë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të integruar, bazuar në evidenca, të performancës së SAI-t. Ai është hartuar në bazë të analizave të treguesve nga gjashtë fushat të performancës (A - F). Kjo evidencë dhe kuptimi i drejtë i ndërlidhjes midis fushave të performancës, janë përdorur për të vlerësuar vlerat dhe përfitimet e SAI-ve – se si kontribuon për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit dhe mënyrën se si prezanton rëndësinë e vazhdueshme. Kjo analizë duhet të paraqitet në Raportin e Performancës së SAI-t, së bashku me informacionin e duhur. Gjithashtu, Raportin e Performancës së SAI-t, duhet të trajtojë edhe në procesin e reformave të vetë SAI-t dhe perspektivat e ardhshme për reformë, si dhe përdorimin e rezultateve të SAI-t nga partnerët e zhvillimit.

Struktura e rekomanduar e Raportit të Performancës së SAI-t është si vijon:

Parathënie

a) Përmbledhje Ekzekutive

b) Deklarata e Sigurimit të Cilësisë

c) Vëzhgime mbi Performancën e SAI-t dhe Ndikimin e saj

(i) Vlerësimi i integruar i performancës së SAI-t;

(ii) Vlera dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditit- Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve;

(iii) Analiza e përpjekjeve dhe perspektivat për përmirësimin e mëtejshëm të zhvillimit të kapaciteteve të SAI-t.

(d). Përdorimi Menaxherial i Rezultateve të Vlerësimit nga SAI

1. Hyrje

2. Metodologjia

3. Informacion për Vendin dhe i Përgjithshëm për SAI-n

3.1 Përshkrimi i qeverisjes së vendit dhe mjedisi më i gjerë në të cilin operon SAI

3.2 Përshkrimi i mjedisit buxhetor të sektorit publik dhe ndikimi në

performancën e SAI-t

3.3 Përshkrimi i kornizës ligjore dhe institucionale të SAI-t, struktura organizative dhe burimet.

4. Vlerësimi i Mjedisit të SAI-t, Aftësia dhe Performanca

Vlerësimi sipas gjashtë fushave, në evidenca të bazuara te pikëzimet e treguesve

4.1 Fusha A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore;

4.2 Fusha B: Qeverisja e Brendshme dhe Etika;

4.3 Fusha C: Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;

4.4 Fusha D: Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse;

4.5 Fusha E: Burimet Njerëzore dhe Trajnimet;

4.6 Fusha F: Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara.

5. Procesi i Zhvillimit Organizativ dhe i Kapaciteteve të SAI-t

5.1 Përshkrimi i reformave të realizuara dhe në proces;

5.2 Përdorimi i rezultateve të SAI-t nga ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare.

Aneksi 1: *Përmbledhja e Treguesve të Performancës & Monitorimi i saj në Kohë (aty ku është e mundur).*

Aneksi 2: *Burimet e Informacionit & Evidencat në mbështetje të pikëzimeve të treguesve.*

2.1. Përgatitja e Raportit të Performancës së SAI-t

Raporti i Performancës së SAI-t duhet të shkruhet në bazë të analizës sipas treguesve të performancës së SAI-t brenda gjashtë fushave (A-F). Përveç kësaj, duhet të prezantohen dhe analizohen informacionet mbi kontekstin e vendit, kuadrin institucional, strukturën organizative dhe përpjekjet për zhvillimit të SAI-t. Vëzhgimet mbi performancën e SAI-t dhe ndikimi i tij duhet të jenë pjesa e fundit e raportit, pasi kjo është e bazuar në informacionin dhe analizën e paraqitur në seksionet e tjera.

Duhet të jetë e qartë në raportin e performancës se analizat dhe konkluzionet e paraqitura në seksionin (c) *Vëzhgime mbi Performancën e SAI-t dhe Ndikimin e saj*, kanë derivuar nga evidencat e paraqitura në kapitujt 2 dhe 3 të raportit. Vlerësimi i performancës në këtë seksion ofron analiza cilësore, të marra nga elementë të ndryshëm të raportit së bashku. Vlerësuesit duhet të jenë konsistent përgjatë gjithë raportit.

2.2. Përmbajtja e Raportit të Performancës së SAI-t

Pjesa tjetër e këtij seksioni jep orientim në lidhje me informacionet që raporti duhet të sigurojë dhe se si duhet t'i paraqesë ato. Raporti i performancës së SAI-t hartohet me strukturën e paraqitur më sipër.

Parathënie

Parathënia duhet të jetë një deklaratë shumë e shkurtër mbi vlerësimin. Duhet të përmend faktin që vlerësimi është përgatitur në bazë të kornizës së matjes së performancës së SAI-t, si dhe të përcaktojë periudhën e realizimit të vlerësimit.

a) Përmbledhje Ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë gjetjet kryesore të vlerësimit dhe të jetë e shkurtër (1-2 faqe). Ajo duhet të paraqesë një përshkrim të performancës së përgjithshme të SAI-t, pikat e forta, sfidat dhe perspektivat për zhvillimin e mëtejshëm. Në shkallë të madhe, përmbledhja duhet të bazohet në analizat e paraqitura në seksionin (c) të raportit të performancës së SAI-t, *Vëzhgime mbi Performancën e SAI-t dhe Ndikimin e saj*.

Përmbajtja e rekomanduar e përmbledhjes ekzekutive:

- Arsyeja për kryerjen e kornizës së matjes së performancës së SAI-t dhe cili është qëllimi i Raportit të Performancës së SAI-t
- Gjykimi i përgjithshëm i vlerësuesve për performancën e SAI-t, në lidhje me kontekstin në të cilin operon
- Vlerat dhe përfitimet kryesore të SAI-t për qytetarët
- Përmbledhje e maturisë së mjedisit të qeverisjes dhe të menaxhimit të financave publike, në të cilin SAI operon, si dhe mënyrat kryesore sesi kjo ndikon në aftësinë e SAI-t për të dhënë vlera dhe përfitime për qytetarët
- Sfidat kryesore të pavarësisë dhe burimeve me të cilat përballet SAI, dhe se si këto kufizojnë performancën e tij dhe ndikojnë në mbulueshmërinë me auditim
- Vlerësimi sesi SAI është duke performuar në lidhje me cilësinë e auditimeve të tij dhe përdorimin e raporteve; standardet e auditimit dhe metodat për sigurimin e cilësisë; procesi i auditimit; dorëzimin, publikimin dhe ndjekjen e auditimeve të tij (Fusha C); dhe përhapja e gjerë dhe komunikimi i rezultateve

të auditimit (Fusha F)

- Vlerësimi i arsyejeve kryesore të dobësive në performancën, të matur në Fushën C, dhe identifikimi i mundësive kryesore për forcimin e performancës – duke bërë dallimin midis faktorëve brenda dhe jashtë kontrollit të SAI-t
- Çfarë reformash janë planifikuar apo janë në vazhdim, dhe pikëpamja e vlerësuesve, mbi ato që janë planifikuar dhe/ose implementuar, për mënyrën që do t'i bëjë ato efektive dhe të çojnë në përmirësime të qëndrueshme të performancës.

b) Deklarata për Sigurimin e Cilësisë

Sigurimi i cilësisë dhe objektivitetit të vlerësimit është thelbësor për të prodhuar një vlerësim të performancës së SAI-t i cili të sjelli vlerë të shtuar për përpjekjet për zhvillimin e SAI-t. Një aspekt i rëndësishëm për sigurimin e një cilësie të mjaftueshme, është që vlerësimi të jetë rishikuar nga dikush i cili nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt në punën e detajuar të vlerësimit. Të qenit transparent në lidhje me natyrën dhe procesin e sigurimit të cilësisë është thelbësore për kredibilitetin e vlerësimit në sytë e të gjithë palëve të interesit.

Deklarata për Sigurimin e Cilësisë konfirmon nëse vlerësimi konsiderohet të jetë mjaftueshëm cilësor sipas kërkesave të kornizës së matjes së performancës së SAI-t.

Deklarata pohon se vlerësimi ka qenë subjekt i një menaxhimi të mjaftueshëm të cilësisë, duke përfshirë:

- Kontrollin e brendshëm të cilësisë në SAI për të verifikuar që faktet janë pasqyruar saktë;
- Rishikimin e pavarur të vlerësimit, për të vlerësuar shkallën e zbatimit në mënyrë korrekte të metodologjisë së kornizës së matjes së performancës së SAI-t, si dhe që pikëzimet dhe konkluzionet janë mbështetur në evidenca të duhura dhe të mjaftueshme.

Deklarata, gjithashtu, konfirmon nëse çështjet e ngritura gjatë procesit të menaxhimit të cilësisë janë adresuar në mënyrë të qartë për vlerësimin që të konsiderohet me cilësi të kënaqshme.

Deklarata për sigurimin e cilësisë duhet të paraqitet në fillim të raportit të performancës së SAI-t dhe duhet të tregojë:

- i. Kush e ka përgatitur vlerësimin?
- ii. Kush e ka dhënë sigurimin e cilësisë së vlerësimit?
- iii. Cilat ishin përgjegjësitë e tyre për sigurimin e cilësisë (*kontrolli i cilësisë, rishikimi i pavarur, sigurimi i procesit të menaxhimit të cilësisë e më pas vlerësimi*)?
- iv. Nëse raportin përfundimtar pasqyron në një nivel të kënaqshme çështjet e ngritura gjatë procesit?

c) Vëzhgimet mbi Performancën e SAI-t dhe Ndikimin e saj

Seksioni (c) i raportit ka për qëllim t'u ofrojë lexuesve me një tablo të integruar dhe strategjike të performancës së SAI-t, vlerat dhe përfitimet për shoqërinë, dhe perspektivat për zhvillimin në të ardhmen. Objektivi është që t'i ofrohet lexuesit të raportit një kuptim më të mirë të SAI-t si një e tërë, duke përfshirë dhe mjedisin në të cilin operon. Ky seksion duhet të sigurojë një analizë të nivelit të lartë të SAI-t, i cili integron në një kontekst, informacionin nga pjesa tjetër e vlerësimit dhe ambientin të veprimtarisë së SAI-t. Seksioni duhet të ketë vlerë të shtuar dhe të shkojë përtej, duke përmbledhur vlerësimin e mbetur. Rekomandohet që kjo pjesë të përbëhet nga tre nën-seksione, si më poshtë:

- **(i) Vlerësimi i Integruar i Performancës së SAI-t:** vlerësuesit paraqesin ato çfarë ata identifikojnë si aspektet kyçe të performancës së SAI-t nga vëzhgimet përmes vlerësimit, dhe analizojnë si faktorët e ndryshëm ndikojnë pozitivisht dhe negativisht performancën.
- **(ii) Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve:** duhet të japë një vlerësim për vlerat dhe përfitimet e SAI-t – masën që puna e tij ndikon në shoqëri. Gjithashtu, duhet përfshirë një analizë e faktorëve që mundësojnë ose vështirësojnë ndikimin e fortë të SAI-t.
- **(iii) Analiza e përpjekjeve për zhvillimin e kapaciteteve të SAI-t dhe perspektivat për përmirësim të mëtejshme:** Duhet të sigurojë një analizë të perspektivave të SAI-t për t'u zhvilluar sipas përpjekjeve të veta për zhvillimin organizativ dhe të kapaciteteve, si dhe të faktorëve ekonomiko-politik dhe institucional që mbështesin apo pengojnë zhvillimin e kapaciteteve.

Vlerësimi duhet të mbështetet në informacionin e ofruar në raportin e performancës së SAI-t, duke përfshirë vlerësimin e bazuar tek treguesit të performancës së SAI-t.

Gjithashtu, mund të jetë e nevojshme që të përdoren burime shtesë të informacionit. Udhëzime të mëtejshme sesi të plotësohet secili nën-seksion ofrohen më poshtë.

(i) Vlerësimi i Integruar i Performancës së SAI-t

Kjo pjesë duhet t'i japë përgjigje dy pyetjeve:

- Si është duke performuar/kryer punën SAI?
- ...dhe çfarë e shpjegon këtë performancë?

Analiza duhet të identifikojë performancën audituese të SAI-t (pikat e forta dhe të dobëta), e cila vëzhgohet nëpërmjet vlerësimit, dhe pastaj kërkon të shpjegojë këtë performancë. Analiza duhet të marrë si një input vlerësimet e detajuara të paraqitura në seksionet 2 dhe 3 të raportit të performancës së SAI-t dhe të analizojë dhe të evidentojë mënyrën se si pikat e forta dhe dobësitë në sistemin organizativ dhe kapacitetin profesional të SAI-t, mjedisin e tij, kapacitetin institucional, burimet financiare mbështesin apo pengojnë performancën audituese të SAI-t. Analizat duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë për të kuptuar sfidat që ballafaqohet SAI në përmbushjen e mandatit të tij, pamundësia për të audituar të gjithë entitetet e tij në përputhje me objektin e mandatit, shpeshtësinë dhe afatet kohore. Fokusi, këtu, është në analizimin e lidhjeve mes vlerësimit të fushave të ndryshme, jo thjesht duke përsëritur pikat e forta dhe dobësitë e identifikuara në trupën e vlerësimit.

Një objektivi i seksionit është të ofrojë qartësi në qëllimin e përmirësimit të performancës, duke identifikuar në çfarë shkalle performanca e SAI-t është kufizuar për shkak të:

- faktorëve që janë direkt nën kontrollin e SAI-t dhe të cilët mund të ndryshojnë nga afatshkurtër në afatmesme (p.sh. metodologjia e auditimit)
- kapaciteti institucional, te cila SAI mund të kërkojë të influencojë nga periudha afatmesme në periudhën afatgjatë (p.sh. korniza ligjore, burimet).
- çështje jashtë kontrollit të SAI-t (p.sh. sistemi politik në vend, situata ekonomike).

Metoda të sugjeruara për analizat

1. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të kornizës së matjes së performancës së SAI-t, vlerësuesit do të identifikojnë pikat më të forta dhe më të dobëta të SAI-t në lidhje me:

- Cilësinë e auditimit (Fusha C);
 - Mbulimin e auditimit (SAI-8);
 - Afatet kohore për dorëzimin dhe publikimin e rezultateve të kontrollit të auditimit/juridiksonal (SAI-11, SAI-14, SAI-17, SAI-20);
 - Ndjekje e rezultateve të auditimit (SAI-11, SAI-14, SAI-17, SAI-20).
2. Si hap i radhës, bazuar në rezultatet e kornizës së matjes së performancës së SAI-t, ekipi i vlerësimit do të identifikojë faktorët që mund të shpjegojnë secilin prej elementëve të vlerësuar të performancës së SAI-t.. Me qëllim përmirësimit e performancës, ekipi i vlerësimit duhet të fokusohet te shpjegimi i dobësive të performancës, por gjithashtu, është e vlefshme të analizohen pikat e forta për të parë se ku ka potencial për të mësuar.
 3. Kur identifikohet faktori shpjegues, ekipi duhet të kërkojë për faktorë më analitik (të thelluar), të cilët mund të shpjegojnë faktorin e veçantë. Kjo "analizë e origjinës së shkakut" duhet të vazhdojë deri sa ekipi të identifikojë faktorët themelorë për secilën aspekt të performancës. Duhet pasur parasysh që arsyet për performancën e dobët në auditim mund të gjenden shpesh në aspektet që nuk lidhen direkt me auditimin, për shembull në proceset organizative të SAI-t.
 4. Është e vlefshme të grupohen faktorët kryesorë të identifikuar sipas kategorive (faktorët e brendshëm, kapaciteti institucional, faktorët e jashtëm).
 5. Në përfundim, ekipi do të plotësojë seksionin duke shkruar rezultatet e analizave, duke u fokusuar në gjetjet më të rëndësishme të performancës dhe në faktorët shpjegues të identifikuar.

(ii) Vlera dhe Përfitimi i Institucioneve Supreme të Auditimit - Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve

Ky seksion eksploron vlerën dhe përfitimet e SAI-t duke analizuar ndikimin e punës së tij për shoqërinë në të cilën ai operon. Me fjalë të tjera, qëllimi është të tregojë pasojat e gjetjeve të vlerësimit të kornizës së matjes së performancës së SAI-t dhe shpjegon si të kuptojmë pikat e forta dhe të dobëta të SAI-t kanë rëndësi për vendin. Analiza duhet të identifikojë gjithashtu kush e mbështet dhe kush e pengon ndikimin e SAI-t.

Vlera dhe përfitimet e SAI-t mund të grupohen nën tre kategori, në përputhje me ISSAI 12 *Vlera dhe Përfitimet e SAI-ve – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve*⁵.

⁵ *Aneksi 3 paraqet sesi parimet në ISSAI 12 janë matur në SAI PMF faqe 34 nga 250*

- **Forcimi i përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe të enteve të sektorit publik** - përmes aktiviteteve të auditimit, raportimit dhe publikimit të gjetjeve.
- **Vëmendja e vazhdueshme ndaj qytetarëve, Parlamentit dhe palëve të interesuara** - duke qenë të përgjegjshëm ndaj ngjarjeve dhe shqetësimeve të vendit, duke përdorur një komunikim efektiv dhe proaktiv, si dhe duke mbështetur ndryshime në institucionet qendrore dhe publike.
- **Të qenit një organizatë model duke shërbyer si shembull** - p.sh. të performancës së SAI-t në lidhje me qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien, në ndjekje të standardeve etike, në promovimin e kulturës së cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm, në të mësuarit dhe shkëmbimin e njohurive.

Ky seksion nuk ka qëllim të ekzaminojë shkallën e arritjeve në lidhje me përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin të institucioneve qendrore dhe sektorit publik, pasi kjo është, gjithashtu, në varësi të performancës së pjesëve të tjera të mjedisit qeverisës dhe menaxhimit të financave publike. Megjithatë duhet të japë një vlerësim për madhësinë e *kontributit* që jep SAI ndaj këtyre objektivave. Gjithashtu, seksioni duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndikimit të aktivitetit të SAI-t nëse nuk përmbush mandatin e tij, të tilla si pamundësia për të audituar të gjithë klientët në përputhje me objektin e mandatit të tij, shpeshësia dhe në kohën e duhur.

Një pyetje kyçe, të cilën ekipi i vlerësimit duhet të synojë t'i përgjigjet është: *cilat ishin gjërat më të rëndësishme që SAI bëri gjatë dy viteve të fundit, dhe çfarë ndikimi kanë pasur këto?* Analiza duhet të jetë sa më e gjerë dhe të mbështetet në shembuj konkretë për mënyrat me të cilat SAI ka bërë ndryshimin në jetën e qytetarëve.

Seksioni duhet, gjithashtu, të përdoret për identifikimin e faktorëve që mundësojnë ose pengojnë vlerat dhe përfitimet e SAI-t. Sipas analizës të bërë në seksionin i), faktorë të tillë mund të jenë të brendshëm dhe nënë kontrollin e SAI-t, si komunikimi dhe përpjekja lidhur me palët e interesuara. Ato mund të jenë të jashtme, megjithatë SAI kërkon të influencojë, si kufizimi i pavarësisë së tij dhe korniza ligjore. Në fund, ato mund të jenë të jashtme dhe komplet jashtë kontrollit të SAI-t, si p.sh. sistemi qeverisës në vend dhe mjedisi i kornizës së matjes së performancës. Duke identifikuar pengesat dhe ndikimin e madh që ato kanë brenda ose jashtë kontrollit të SAI-t, na ndihmon të përcaktojmë si të përqendrojmë përpjekjet për të përmirësuar situatën.

Burime të mundshme të informacionit

Analiza e këtij seksioni bazohet në informacionin që sigurohet nga burimet e mëposhtme:

- Gjetjet dhe ndikimi i auditimeve të veçanta, të identifikuara nga raporti vjetor i SAI-t, intervista me përfaqësuesit e SAI-t dhe palët e tjera të interesuar, analiza e kampionit të raporteve të auditimit, dhe çdo lloj raporti të vendit mbi vlerën dhe përfitimet e SAI-ve;
- Analiza e vlerësuesve bazuar në seksionet e tjera të raportit të performancës së SAI-t;
- Analiza e performancës së vetë SAI-t sipas objektivave të tij strategjik, për shembull. duke përdorur indikator të performancës si përfitimet financiare dhe jo-financiare dhe përqindjen e rekomandimeve të zbatuara (nëse është e aplikueshme);
- Analiza e ndikimit të rekomandimeve të SAI-t: nëse janë në dispozicion të dhënat lidhur me zbatimin e rekomandimeve të SAI-t, përqindja e rekomandimeve të cilat pjesërisht ose plotësisht zbatohen nga institucionet e audituara do të jetë një indikator i rëndësishëm, që duhet të merret parasysh, për të vlerësuar besueshmërinë dhe legjitimitetin e SAI-t brenda mjedisit të tij institucional e më gjerë;
- Çdo vlerësim ekzistues i mjedisit të qeverisjes së vendit dhe sistemi i kuadrit të matjes së performancës (p.sh raportet e Bankës Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, donatorët bilateralë, OECD, Transparency International (Transparenca Ndërkombëtare), Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, dhe vlerësimet e PEFA).

(iii) Analiza e përpjekjeve për zhvillimin e kapaciteteve të SAI-t dhe perspektivat për përmirësimin e mëtejshëm

Ky seksion duhet të ofrojë një analizë të perspektivave të SAI-t për përmirësimin e performancës në të ardhmen, mbështetur në përmbledhjen mbi përpjekjet në proces dhe të planifikuara për zhvillimin e kapaciteteve të paraqitura në seksionin 5 të raportit të performancës së SAI-t. Duhet të bëjë një vlerësim për metodat SAI-t për planifikimin dhe implementimin e iniciativave për zhvillimin e kapaciteteve të SAI-t.

Faktorët institucionalë që janë mbështetje për zhvillimin efektiv të kapacitetit të SAI-t⁶ janë si më poshtë:

- **Udhëheqja e SAI-t dhe pronësia** e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të zhvillimit të kapaciteteve, duke vendosur SAI-n në qendër të aktiviteteve të menaxhimit të ndryshimit.
- **Harmonizimi dhe përqsja** e mbështetjes ndaj SAI-t nga dhe ndërmjet INTOSAI-t dhe bashkësisë të donatorëve, duke siguruar që të gjitha mbështetjet janë konverguar në një linjë sipas planit të drejtuar nga SAI dhe të koordinuara siç duhet midis ofruesve të ndryshëm të mbështetjes.
- **Qëndrueshmëria e aktiviteteve të zhvillimit të kapaciteteve**, duke përfshirë masën që kjo metodë krijon dhe përdor ekspertë nga brenda SAI-t dhe rajoni i INTOSAI-t, si dhe u lejon audituesve kohë të mjaftueshme për të marrë pjesë në aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve; qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e financimit të aktiviteteve për zhvillimin e kapaciteteve; metoda që përdor SAI për zhvillimin e kapaciteteve profesionale, organizative dhe institucionale në të njëjtën kohë; dhe përqendrimi i tij në ndërtimin e bashkëpunimit afatgjatë që forcon besimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis partnerëve të zhvillimit.

Raporti i performancës së SAI-t duhet të marri parasysh eksperiencat e kohëve të fundit dhe ato aktuale në lidhje me këta faktorë, si edhe faktorë të tjerë specifik të vendit. Gjithashtu, kjo duhet të ofrojë një vlerësim sesi faktorët institucionalë, politikë dhe ekonomikë të vendit, e mbështesin apo e pengojnë zhvillimin e kapaciteteve të SAI-t. Në shtesë, për vendet që përfitojnë ndihma, ky seksion duhet të analizojë mënyrën sipas së cilës praktika ekzistuese e donacioneve ndikon në performancën e SAI-t.

Ky seksion, dhe Raporti i performancës si i tërë, nuk duhet të japë rekomandime për programin e ardhshëm të zhvillimit të kapaciteteve dhe nuk duhet të përfshijë gjykimin mbi mjaftueshmërinë, përshtatshmërinë dhe fizibilitetitetin e programit të zhvillimit të kapaciteteve të SAI-t. Një konsideratë e tillë mund të ndërmerret nga SAI në një proces plotësues të veçantë.

⁶ Ju lutem referojuni “Praktikat e Mira në Mbështetje të Institucioneve Supreme të Auditimit”, OECD (2011) për informacione të mëtejshme mbi zhvillimin e kapacitetit të SAI-t.

d) Menaxhimi i Përdorimit të Rezultateve të Vlerësimit nga SAI

Ky seksion duhet të përdoret për të evidentuar se si drejtuesi dhe menaxhimi i lartë i SAI-t synojnë të përdorin rezultatet e vlerësimit. Pavarësisht nëse vlerësimi është realizuar si një vetë-vlerësim, peer review e INTOSAI-t ose vlerësim i jashtëm, ky seksion duhet të përgatitet nga SAI. Idealisht kjo duhet të jetë pjesë e raportit kryesor, por gjithashtu mund të prodhohet edhe si një dokument i veçantë. Në praktikë, kjo do të jetë pjesa e fundit që do të përgatitet, pasi menaxhimi i SAI-t duhet të japë reagimin e tij ndaj të gjithë raportit të performancës.

Kapitulli 1: Hyrje

Qëllimi i hyrjes në raportin e performancës së SAI-t është të kuptohet konteksti dhe procesi që është përgatitur dhe të nënvizohet qëllimi i vlerësimit.

Gjatësia treguese i këtij seksioni është një faqe. Ajo duhet të sigurojë informacionin e mëposhtëm:

- **Objekti i raportit të performancës së SAI-t**, duke pasqyruar se përse është ndërmarrë në këtë kohë dhe kontributin e tij në aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve të SAI-t;
- **Procesi i përgatitjes së raportit të performancës së SAI-t**, përfshin vendimin për të ndërmarrë një vlerësim, planifikimin dhe zbatimin e vlerësimit, përgatitjen e raportit të vlerësimit dhe procesit për sigurimin e cilësisë. Ky seksion duhet të shpjegojë nëse vlerësimi është kryer si një vetë-vlerësim, peer review e INTOSAI-t, vlerësim i jashtëm apo kombinim i këtyre. Gjithashtu duhet të përshkruajë rolet dhe përgjegjësitë e atyre që janë të përfshirë (p.sh. SAI, organizatat e tjera të vendit, organet globale dhe rajonale të INTOSAI-it, SAI-t homologë, donatorët, konsulentët), duke përfshirë edhe mënyrën se si është financuar vlerësimi;
- **Qëllimi i vlerësimit**, veçanërisht në vendet me rregullime komplekse institucionale për auditimin e jashtëm në sektorin publik, ky seksion duhet të qartësojë se cila është organizata, për të cilën është bërë vlerësimi, dhe nëse është e mundur, cila pjesë e organizatës. Seksioni duhet gjithashtu të theksojë auditimet e kujt viteve mbulon vlerësimi.

Gjithashtu, ky seksion duhet të vërë në dukje ndonjë kufizim apo zgjerime të fushës së vlerësimit në krahasim me këtë udhëzim. Idealisht, SAI duhet të vendosë, para se

korniza e matjes së performancës së SAI-t të zbatohet, nëse do të pikëzohen të gjithë treguesit apo jo. Arsyet për të mos pikëzuar treguesit, kryesisht, lidhen me kufizime në mandatin e SAI-t. Përgjithësisht rekomandohet përfshirja e të gjithë treguesve, pasi kjo do të ndihmojë për të krijuar një tablo më të plotë të punës së SAI-t.

Kapitulli 2: Metodologjia

Duhet të ketë një kapitull të veçantë për Metodologjinë në raportin e performancës së SAI-t. Ky kapitull duhet të shpjegojë:

- Metodatat e përdorura për mbledhjen e të dhënave;
- Burimet kryesore të informacionit që janë përdorur;
- Si dhe në çfarë shtrirje janë kryer intervistat;
- Cilat dosje të auditimit u përdorën si kampione dhe si u përzgjedhën ato;
- Si u analizuan evidencat për të pikëzuar treguesit dhe konkluzionet mbi performancës së SAI-t.

Kapitulli i metodologjisë duhet, gjithashtu, të ngrejë çështjet që lidhen me risqet e identifikuar para ose gjatë vlerësimit, dhe menaxhimin e tyre. Për shembull, kjo përfshin çështje lidhur me evidencën, dhe përdorimin e metodologjisë “Pa Pikë” për çdo tregues, kur niveli i aktivitetit të SAI-t është i ulët, ose kur informacioni i dokumentuar është i vështirë për t’u marrë.

Ky kapitull duhet të përmendë metodën e përdorur për zhvillimin e Kapitullit 3 dhe çështjet e lidhura me evidencën të tilla si mungesa e vlerësimit të vendit, që mund të përdorej si burim.

Kapitulli 3: Informacione për vendin dhe SAI-n

Objektivi i këtij seksioni është të sigurojë informacion mbi vendin e SAI-t i cili po vlerësohet, për të kuptuar mjaftueshëm të kontekstit më të gjerë të performancës së SAI-t, si edhe karakteristikat kryesore të SAI-t në atë vend. Pritet që vlerësuesit të përdorin të dhënat dytësore, duke përfshirë vlerësimet dhe analizat ekzistuese. Burimet mund të paraqitet si në tekst ashtu dhe në bibliografi.

Informacioni për këtë seksion mund të merret nga Banka Botërore, Fondi Monetar

Ndërkombëtar, nga baza e të dhënave të OECD, nga publikimet⁷, dokumentet e buxhetit të qeverisë, ose analiza të tjera ekzistuese të politikës fiskale dhe të shpenzimeve, duke përfshirë dhe vlerësimet e fundit të Shpenzimeve Publike dhe Llogaridhënien Financiare (PEFA). Kapitulli duhet të kufizojë vetveten në aspektet e nevojshme për të informuar mbi kontekstin në të cilin ushtron funksionet SAI:

3.1. Përshkrimi i marrëveshjeve të qeverisjes së vendit dhe mjedisi më i gjerë në të cilin operon SAI

Konteksti i vendit, përfshin karakteristikat ekonomike dhe zhvilluese të vendit dhe faktorët që ndikojnë mbi të, përfshirë popullsinë, nivelin e të ardhurave, varfërinë dhe nivelin e arsimit, norma e rritjes, inflacioni, sfidat kryesore të zhvillimit, konfliktet e fundit dhe të vazhdueshme dhe faktorët e tjerë të dobësisë⁸, aspekte kulturore, etj. Këto janë çështje që mund të ndikojnë se ku duhet të fokusohet SAI në auditimet e tij, ose përcaktojnë për aftësinë e SAI-t për të kryer auditime.

- **Marrëveshje për qeverisjen e vendit**, ka për qëllim të përshkruajë kontekstin e gjerë institucional në të cilin palët e interesit operojnë, duke përfshirë: sistemin politik, strukturën e qeverisjes (federale ose shtet unitar, nivelet e qeverisjes etj), marrëdhëniet midis Ekzekutivit, Legjislativit dhe Gjyqësorit, dhe natyra dhe roli i partive politike dhe konkurrencës politike; roli, aftësia dhe liria e medias dhe organizatave të shoqërisë civile; sistemet formale dhe joformale të llogaridhënies të shtetit tek qytetarët. Gjithashtu, ky seksion mund të përmbajë edhe analiza apo tregues të qeverisjes, nëse ndodhen në dispozicion, dhe të japë komente mbi aftësinë, reflektimin (ndaj qytetarëve) dhe përgjegjshmërinë e shtetit. Këto aspekte duhen marrë në konsideratë kur analizohen marrëdhëniet, iniciativat dhe rezultatet e komunikimit me palët e interesit, në seksionin (c).

3.2. Përshkrimi i mjedisit të sektorit publik buxhetor, përfshi edhe menaxhimin financiar publik dhe impakti mbi performancën e SAI-t


Qëllimi i këtij seksioni është që të ofrojë një pamje të përgjithshëm të strukturës së sektorit publik dhe detajet e buxhetit të sektorit publik, duke përfshirë burimet e të ardhurave, shpenzimeve sipas klasifikimit administrativ ose funksional dhe ekonomik, si dhe nivelet e borxhit dhe investimeve. Kjo do të ndihmojë në vlerësimin e aftësisë së

⁷ P.sh. Qeverisja në një vështrim të shkurtër, OECD

⁸ Duke përfshirë diskutime mbi të ardhurat e burimeve natyrore
faqe **40** nga **250**

SAI-t, për tu fokusuar në transaksionet më të rëndësishme të qeverisë gjatë ushtrimit të mandatit të tij. Një klasifikim i standardizuar i strukturës së sektorit publik është dhënë më poshtë për informacion. Roli i partnerëve për zhvillimin e financave publike të vendit duhet përshkruar, kur është i rëndësishëm, siç është mbështetja direkte për buxhetin. Ky seksion duhet, gjithashtu, të nënvizojë organizimet e auditimit për pjesë të ndryshme të sektorit publik, duke vënë në dukje mandatin e auditimit të organizatës që është pjesë e vlerësimit.

Diagrama 3: Struktura e Sektorit Publik⁹



Informacion i përmbledhur duhet të jepet mbi buxhetin e të gjithë sektorit publik, veçanërisht duke vënë në dukje buxhetet e përgjithshme të organizatave që përfshihen në mandatin të SAI-t dhe çdo organizate tjetër për të cilën kryhet vlerësimi.

⁹ Burimi: Manuali i statistikave Financiare të Qeverisë 2001, FMN
faqe **41** nga **250**

Informacioni në formatin si vijon mund të jetë i vlefshëm:

Të ardhurat dhe shpenzimet të buxhetuara ose aktuale sipas Klasifikimit Administrativ ose Funkcional (si përqindje ndaj buxhetit total ose qarkullimit aktual)						
	FY1		FY2		FY3	
	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime	Të ardhura	Shpenzime
Shëndetësia						
Arsimi						
Mbrojtja						
Sigurimet Shoqërore						
Të tjera						

Ky seksion duhet të japë gjithashtu një përshkrim narrativ të aspekteve kyçe të sistemit të menaxhimit të financave publike (MFP), sistem i cili është me rëndësi të veçantë për funksionimin e SAI-t. SAI është i varur nga inputet e atij sistemi, dhe nga outputet e tij që përdoren nga të tjerët në atë sistem. Në periudhën afatgjatë, SAI mund të kontribuojë në forcimin e sistemit MFP duke qenë një organizatë model dhe duke udhëhequr nëpërmjet shembullit, por nuk është përgjegjës për performancën e pjesëve të tjera të sistemit. Performanca e aspekteve kritike të sistemit MFP, duhet të përmendet, duke përfshirë mënyrën sesi ato ndikojnë në aspekte të ndryshme të performancës së SAI-t. Gjithashtu, ky seksion duhet të përmbledhë përpjekjet për reformat më të rëndësishme të realizuara së fundmi për MFP. Është me rëndësi të veçantë, për të përshkruar kuadrin e raportimit financiar të sektorit publik të vendit, pasi kjo ka implikime për pikëzimin e treguesve të auditimit financiar të kornizës së matjes së performancës së SAI-t . Aspektet e mëposhtme të sistemit MFP (dhe burimet e mundshme të informacionit) mund të përfshihen, por kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse:

- Prokurimi publik (PEFA PI-24¹⁰ dhe OECD/DAC “Metodologjia për vlerësimin e Sistemit e Prokurimit” (MAPS)) ;
- Auditimi i brendshëm (PEFA PI-26);

¹⁰ PEFA versioni i vitit 2016. Për udhëzues mbi tregues të rëndësishëm për t’u marrë në konsideratë më të vjetër se vlerësuesi PEFA 2016, ju lutem konsultoni faqen e internetit (www.pefa.org).

- Raportet vjetore financiare (PEFA PI-29);
- Auditimi i jashtëm (PEFA PI-30);
- Shqyrtimi legjislativ i raporteve të jashtme të auditimit (PEFA PI-31).

3.3. Përshkrimi i kuadrit ligjor dhe institucional të SAI-t, struktura organizative dhe burimet

Ky seksion duhet të japë informacione specifike të rëndësishme për SAI-n duke përfshirë dispozitat kushtetuese që lidhen me SAI-n dhe Kryetarin e SAI-t, si dhe kuadrin ligjor, sipas të cilit drejtohet SAI. Duhet të sqarojë nëse SAI ndjek modelin Legjislativ (Parlamentar), Juridiksional (Gjykatë), ose model tjetër (hibrid), dhe nëse qeveriset nga një Kryetar i vetëm apo nga një bord vendimmarrës (p.sh. bord, gjyqtarë).

Ky seksion duhet të përshkruajë aspekte kryesore të mandatit të SAI-t, duke përfshirë përgjegjësitë dhe qëllimin e aktiviteteve të tij, (kjo në disa raste përfshin aktivitete që dalin jashtë qëllimit të auditimit të sektorit publik siç përcaktohet nga ISSAI) dhe të shpjegojë strukturën organizative të SAI-t (duke përfshirë madhësinë dhe vendndodhjen e zyrave të degëve kryesore). Gjithashtu, duhet të përshkruhet mandati dhe marrëdhënia me organe të tjera përgjegjëse për auditimin e sektorit publik, duke përfshirë edhe mbivendosjet, mungesat (aspekte të lëna jashtë), çdo përgjegjësi të SAI-t për mbikëqyrjen dhe rregullat, dhe marrëveshjet e koordinimit.

Gjithashtu, duhet të sigurojë informacion mbi mënyrën sesi SAI i gjen burimet e veta dhe financohet (duke përfshirë numrin e personelit dhe buxhetet), dhe nëse është e mundur, informacion objektiv nëse burimet e SAI-t dhe financat janë të mjaftueshme për të mundur të realizojë mandatin e tij. Duhet të specifikojë buxhetin e nevojshëm që i duhet SAI-t për të përmbushur mandatin e tij, shumën e kërkuar nga organi që përcakton buxhetin, buxhetin e aprovuar (*origjinal dhe rishikimet për vitin*) dhe shumën e vënë aktualisht në dispozicion të SAI-t (*nëse është e ndryshme*).

Së fundi, seksioni duhet të shpjegojë kujt i raporton SAI dhe roli i Parlamentit (Legjislativit), komisionet parlamentare legjislative dhe organeve të tjera që shqyrtojnë raportet e SAI-t, si dhe roli i institucioneve të tjera të përfshira në qeverisjen e SAI-t. Duhet të vlerësohet funksionimi i Parlamentit (Legjislativit) dhe i komisioneve të tij, roli i partive politike dhe natyra e konkurrencës politike.

Kapitulli 4: Vlerësimi i Performancës së SAI-t

Objektivi i këtij kapitulli është që të sigurojë një vlerësim të elementëve kyç të performancës së SAI-t sipas matjeve nga treguesit dhe (për vlerësime të përsëritura), të raportohet mbi ndryshimet e performancës.

Ky seksion duhet të jetë 30-40 faqe. Struktura e seksionit është si më poshtë:

Vlerësimi sipas shtatë fushave të performancës së SAI-t (evidenca të bazuara në pikëzimet e indikatorëve):

- 4.1. Fusha A:** *Pavarësia dhe Kuadri Ligjor;*
- 4.2. Fusha B:** *Qeverisja e Brendshme dhe Etika;*
- 4.3. Fusha C:** *Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;*
- 4.4. Fusha D:** *Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Strukturat Mbështetëse;*
- 4.5. Fusha E:** *Burimet Njerëzore dhe Trajnimi;*
- 4.6. Fusha F:** *Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara;*

Secili prej seksioneve trajton treguesit përkatës, sipas radhës. Diskutimi duhet të bëjë dallimin ndërmjet:

- Vlerësimet të gjendjes aktuale (*analiza bazuar në tregues*);
- Raportimi mbi progresin, kur është e zbatueshme (*ndryshimet e fundit të performancës dhe të reformave që prej vlerësimit të mëparshëm*);

Raportimi i analizës bazuar në tregues

Raportimi mbi analizën bazuar në tregues mund të realizohet në këtë mënyrë:

- Teksti shpjegon pikat e forta dhe të dobëta kryesore të performancës së SAI-t siç vlerësohet nga treguesi, dhe jep rezultatin e përgjithshëm. Gjithashtu, teksti duhet të përmendë edhe aspekte të rëndësishme të vëna re të performancës, të cilat nuk janë matur nga treguesi.
- Për çdo tregues të fushës, teksti shpjegon arsyen për rezultatin specifik (0, 1, 2, 3, ose 4) dhe evidencat kryesore (duke përfshirë të dhënat sasiore) të përdorura për të mbështetur rezultatin (pikëzimin). Duhet të trajtohet çdo aspekt mbi koherencën dhe besueshmërinë e të dhënave. Nëse një dimension i treguesit nuk është vlerësuar, duhet të jepet shpjegim (dmth dimensionin nuk është i aplikueshëm).
- Duhet të paraqitet tabela përmbledhëse e pikëzimeve sipas fushave dhe në përgjithësi, së bashku me një shpjegim të shkurtër për pikëzimet. Nëse evidentohen se cilat nga kriteret janë plotësuar dhe cilat jo atëherë mundësohet ndjekja e të gjitha fushave. Për vlerësime të përsëritura, tabela mund të evidentojë rezultatin dhe shpjegimin nga vlerësimi i mëparshëm, dhe përshkruhet ndryshimi i performancës dhe faktorë të tjerë që merren parasysh kur krahasojmë rezultatet e treguesve me kalimin e kohës.

Vlerësime të përsëritura: Raportimi mbi Progresin

Për çdo tregues dhe treguesin e fushës, raporti duhet të pasqyrojë dinamikën e reformave në vend. Për vlerësimet e përsëritura, ndryshimet në pikëzimet e treguesve dhe rezultatet e fushës, si dhe shpjegimi i tyre do të bëhet i qartë nga raportimi i analizës bazuar në treguesit. Megjithatë, kjo nuk do të pasqyrojë plotësisht zhvillimin e SAI-t. Gjithashtu, raportet përshkrimore duhet të përmbajnë për secilin tregues si vijon,:

Përmirësime të vogla në punën e SAI-t që nuk janë pasqyruar te treguesit

Për shembull, një përmirësim në afatet kohore të dorëzimit të rezultateve të auditimit të përputhshmërisë të SAI-t tek autoritetet e përcaktuara nga tetë muaj pas përfundimit të vitit në shtatë muaj pas përfundimit të vitit, (kur nuk ka afat kohor ligjor të përcaktuar). SAI është ende në nivelin 2, por performanca e tij është përmirësuar.

Aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve janë zbatuar por nuk kanë ndikuar ende në punën e SAI-t

Për shembull, është ngritur një njësi e auditimit të performancës dhe është hartuar manuali i auditimit të performancës, i cili nuk është përdorur ende në këto auditime. Reforma duhet të theksohet në raportin e performancës, edhe pse kjo nuk ka ndikuar ende në punën e SAI-t.

Vini re se angazhimet për të ndërmarrë aktivitete të veçanta të zhvillimit të kapaciteteve në planet strategjike dhe të veprimit të zhvillimit të SAI-t (ose të ngjashme) nuk konsiderohen si evidencë e përmirësimeve të performancës, por janë konsideruar në kapitullin 5 të SAI-t më poshtë, si *Procesi i Zhvillimit të Kapaciteteve*.

Përdorimi i treguesve të lokalizuar të performancës

SAI-t kanë mandate të ndryshme dhe punojnë nën kushte të ndryshme, duke e bërë të vështirë zhvillimin e një kuadri global të matshmërisë që përfshin të gjitha elementet e kapaciteteve dhe performancës të përshtatshme për të gjithë SAI-et. Kuadri i matjes së performancës i SAI-t bazohet në praktikën më të mira, të cilat identifikuar midis një numri të madh SAI-sh dhe janë paraqitur në ISSAI-t dhe në udhëzues të tjerë të praktikave më të mira ndërkombëtare. Kur SAI-t kanë mandatin për të investuar burime të konsiderueshme në aktivitete, të cilat nuk përfshihen në kuadrin e matjes së performancës së SAI-t, vlerësuesi mund të konsiderojë të përshtatshme zhvillimin dhe zbatimin e një numri të vogël të treguesve të performancës të specifikuar. Në raste të tilla, praktika e mirë është të:

- Shpjegimi i logjikës për çdo tregues shtesë;
- Zhvillimi i indikatorëve të rinj që ndjekin të njëjtën strukturë si treguesit e kuadrit të matjes së performancës së SAI-t, në vend të ndryshimit të treguesve ekzistues të KMP-SË SË SAI-T;
- Dakortësimi mbi përkufizimin e treguesit dhe kriteret minimale për çdo pikëzim të dimensionit para fillimit të vlerësimit të kuadrit të matjes së performancës së SAI-t;
- Deklarimi i përkufizimit të treguesit dhe kriterëve minimale për çdo rezultat dimensionit (*p.sh. në një aneks të raportit të performancës së SAI-t*);
- Përfshirja e treguesit në fushën përkatëse në raportin e performancës;

Shumë SAI kanë zhvilluar tregues specifikë të performancës për të matur arritjen e objektivave të tyre strategjike. Tregues të tillë mund të plotësojnë kuadrin e pikave të forta dhe të dobëta individuale të SAI-t dhe ndryshimet e performancës së tij me kalimin e kohës, duke u fokusuar në performancën sipas prioriteteve strategjike të vetë SAI-t. Vlerësuesit duhet të konsiderojnë vlerat e përfshirjes së treguesve të tillë në raportin e performancës së SAI-t. Kështu, faktorët për t'u marrë në konsideratë përfshijnë: nëse është përcaktuar treguesi dhe sistemi i pikëzimit; nëse janë të vlefshme baza dhe matësit e rregullt të performancës; dhe nëse procesi i mbledhjes së të dhënave është përcaktuar dhe i sigurohet cilësia. Në varësi të natyrës së treguesve, kjo mund të përfshihet nën fushat përkatëse, ose në seksionin (c) *Observacione mbi performancën dhe ndikimin e SAI-t*.

Kapitulli 5: Procesi i Zhvillimit të Kapaciteteve të SAI-t

Ky kapitull ka për qëllim të përshkruajë progresin e bërë nga SAI për përmirësimin e performancës së tij dhe të iniciativave të ndërmarra për zhvillimin e kapaciteteve.

Shkalla e shtrirjes së këtij seksioni është tre deri në katër faqe. Ai duhet të sigurojë informacionin e mëposhtëm.

5.1. Përshkrimi i reformave të fundit dhe në proces

Ky seksion duhet të përmbledhë reformat më të rëndësishme të kohëve të fundit dhe në proces për të ofruar një pasqyrë të progresit të bërë nga SAI në zhvillimin e kapaciteteve të tij. Aty duhet të sigurohet përfshirja e formave të ndryshme të mbështetjes të siguruar dhe marrëveshjet e tyre financiare, (duke përfshirë programet globale dhe rajonale të INTOSAI-t, mbështetjen mes SAI-ve homologe dhe programet e mbështetura nga donatorët).

5.2. Përdorimi i rezultateve të SAI-t nga Ofruesit e Jashtëm të Mbështetjes Financiare

Ky seksion duhet të japë një vlerësim cilësor sesi ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare të përdorin rezultatet e auditimeve të SAI-t për të informuar, vlerësuar dhe zhvilluar programet dhe projektet e tyre, dhe nëse kjo rrit besueshmërinë, aftësinë dhe pavarësinë e SAI-t. Ky vlerësim duhet, gjithashtu, të shqyrtojë nëse dhe si ofruesit e mbështetjes e përdorin SAI-n për auditimin e projekteve dhe programeve që ata financojnë, nëse kjo merr parasysh kufizimet e kapacitetit të SAI-t, dhe nëse është bërë në një mënyrë që mbështet zhvillimin e mëtejshëm të SAI-t (të tilla si auditimet e përbashkëta).

Gjithashtu, duhet të shqyrtojë mekanizmat e përdorur për të siguruar auditimin e projekteve dhe programeve me financime të huaja dhe që kjo nuk është kryer me shpenzime të SAI-t, duke zbatuar mandatin e tij auditues.

Kur mbështetja financiare është disbursuar për sektorin qeveritar, përdoren procedurat kombëtare të auditimit kur auditimi i fondeve kryhet nën përgjegjësinë e SAI-t të vendit përfitues. *Përdorimi i plotë i sistemeve të auditimit vendas*, do të thotë që ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare mbështeten në opinionet e auditimit dhe/ose raportet e dala nga SAI (përfshirë çdo punë audituese me burime të jashtme dhe të mbikëqyrur nga SAI) mbi: pasqyrat financiare të qeverisë; përputhshmërinë me rregullat, ligjet dhe rregulloret; dhe ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e programeve të qeverisë. Ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare nuk do të bëjnë kërkesa shtesë për procedura të auditimit të SAI-t. Në alternativë, përdorimi suplementar i sistemeve të auditimit të vendit ndodh kur ofruesit e jashtëm të mbështetjes financiare përdorin SAI-n e vendit ose të realizojë auditime vetë, ose të realizojnë auditime me burime të jashtme kur kërkojnë auditime specifike, dhe/ose auditime që të kryhen në përputhje me standardet dhe procedurat që ndryshojnë nga ato normalisht të përdorura nga SAI¹¹.

Në lidhje me Asistencën Zyrtare të Zhvillimit, anketat e Deklaratës së Parisit të 2006 dhe 2011 vendosën kriteret për të përcaktuar nëse partnerët për zhvillim përdorën procedurat kombëtare të auditimit, përfshi edhe nëse marrëveshje shtesë auditimi u kërkuan nga partnerët për zhvillim. Anketa e Deklaratës së Parisit e konsideron "përdorimin e plotë" për SAI-n që kërkon që standardet e auditimit nuk janë të ndryshme nga ato të adoptuara nga SAI dhe se SAI nuk do të duhet të rishikojë ciklin e tij të auditimit për të kryer auditimin e fondeve të partnerëve për zhvillim. Përmbajtja e këtij seksioni duhet të informohet nga diskutimi mes SAI-t dhe partnerëve kryesorë të zhvillimit, si dhe nga vlerësimet ekzistuese të bashkëpunimit të zhvillimit (d.m.th. Anketa e Deklaratës së Parisit (Treguesi 5a) dhe procesi i Monitorimit Busan (Treguesi 9b), duke theksuar përdorimin e sistemeve të vendit.

¹¹ Përshtatur nga 'Practitioners Guide to Using Country Systems', faqe 66, OECD
faqe 48 nga 250

Aneksi 1: Përmbledhja e Treguesit të Performancës & (kur aplikohet) Trajektorja e Performancës në kohë

Ky aneks siguron një tabelë përmbledhëse të treguesve të performancës së SAI-t. Për secilin tregues, tabela specifikon pikëzimin e caktuar së bashku me një shpjegim të shkurtër për pikëzimin. Për vlerësimet e përsëritura, ai duhet gjithashtu të evidentojë pikëzimet dhe të japë një shpjegim të shkurtër nga vlerësimi i mëparshëm, kur krahasojmë pikëzimet e treguesve me kalimin e kohës duhet të merren parasysh shënimet mbi ndryshimin e performancës dhe faktorë të tjerë.

Treguesi	Vlerësimi Aktual (Viti)		Vlerësimi i Mëparshëm (Viti)		Ndryshimi i performancës	Faktorë të tjerë
	Pikëzimet	Shpjegimi	Pikëzimet	Shpjegimi		
SAI-1	E përgjithshme Dimensioni (i) Dimensioni (ii) Etj.	Shpjegimi për pikëzimet	E përgjithshme Dimensioni (i) Dimensioni (ii) Etj.	Shpjegimi për pikëzimet	Arsyet e ndryshimit në performancë ndërmjet dy vlerësimeve	P.sh. problemet ose mosmarrëveshjet mbi pikëzimet e mëparshme, faktorët që ndikojnë në krahasim
SAI-2						

Aneksi 2: Burimet e Informacionit & Evidencat mbështetëse për pikëzimin e treguesit

Ky aneks duhet të regjistrojë burimet specifike të informacionit dhe evidencën që përdoret për të mbështetur pikëzimin e çdo treguesi. Kjo do të sigurojë udhëzime të dobishme për kryerjen e vlerësimeve të ardhshme, dhe do të sigurojë që pikëzimi i treguesve në vlerësimet e ardhshme të jetë i krahasueshëm me vlerësimet e mëparshme.

3. Grupi i Treguesve të Performancës së SAI-ve

3.1. Përmbledhje e treguesve duke përfshirë dimensionet

Treguesi	Faqe	Fusha	Dimensionet
46 A. Pavarësia dhe Korniza Ligjore			
SAI-1	47	Pavarësia e SAI-t	(i). Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive (ii). Pavarësia/autonomia financiare (iii). Pavarësia/autonomia organizative (iv). Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe Zyrtarëve të tij
SAI-2	52	Mandati i SAI-t	(i). Mandat mjaftueshëm (ii). Aksesit në informacion (iii). E drejta dhe detyrimi për raportim
55 B. Qeverisja e Brendshme dhe Etika			
SAI-3	57	Cikli i Planifikimit i Strategjik	(i). Përbajtja e Planit Strategjik. (ii). Përbajtja e Planit Vjetor/Planit Operacional (iii). Procesi i Planifikimit Organizativ (iv). Monitorimi dhe Raportimi i Performancës
SAI-4	61	Mjedisi i Kontrollit Organizativ	(i). Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative (ii). Sistemi i Kontrollit të Brendshëm (iii). Sistemi i Kontrollit të Cilësisë (iv). Sistemi i Sigurimit të Cilësisë
SAI-5	67	Auditimet me Burimet e Jashtme	(i). Procesi i Përzgjedhjes së Audituesve me Kontratë (ii). Kontrolli i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme (iii). Sigurimi i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme
SAI-6	71	Udhëheqja dhe Komunikimi i Brendshëm	(i). Udhëheqja (ii). Komunikimi i Brendshëm

SAI-7	74	Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit	(i). Procesi i Përgjithshëm i Planifikimit të Auditimit (ii).Përmbajtja e Planit të Përgjithshëm të Auditimit
76		C. Cilësia e Auditimit dhe Raportimi	
SAI-8	79	Mbulimi i Auditimit	(i). Mbulimi i Auditimit Financiar (ii). Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivat e Auditimit të Performancës (iii). Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivat e Auditimit të Pajtueshmërisë (iv). Mbulimi i Kontrollit Juridiksional
SAI-9	87	Standardet Financiare të Auditimit dhe Menaxhimi i Cilësisë	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit Financiar (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit Financiar dhe Aftësitë (iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar
SAI-10	92	Procesi i Auditimit Financiar	(i). Planifikimi i Auditimit Financiar (ii). Zbatimit i Auditimit Financiar (iii). Vlerësimi i Evidencës së Auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi i Auditimit Financiar
SAI-11	97	Rezultatet e Auditimit Financiar	(i). Dorëzimi në kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar (ii). Publikimi në kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar (iii). Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit Financiar nga SAI
SAI-12	102	Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit të Performancës (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës dhe Aftësitë

			(iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Performancës
SAI-13	107	Procesi i Auditimit të Performancës	(i). Planifikimi i Auditimit të Performancës (ii). Zbatimi i Auditimeve të Performancës (iii). Raportimi në Auditimet e Performancës
SAI-14	112	Rezultatet e Auditimit të Performancës	(i). Dorëzimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës (ii). Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës (iii) Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit të Performancës nga SAI
SAI-15	117	Standardet e Auditimit të Pajtushmërisë dhe Menaxhimit i Cilësisë	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit të Pajtushmërisë (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Pajtushmërisë dhe Aftësitë (iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Pajtushmërisë
SAI-16	122	Procesi i Auditimit të Pajtushmërisë	(i). Planifikimi i Auditimit të Pajtushmërisë (ii). Zbatimi i Auditimit të Pajtushmërisë (iii) Vlerësimi i Evidencës së Auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi në Auditimet e Pajtushmërisë
SAI-17	126	Rezultatet e Auditimit të Pajtushmërisë	(i). Dorëzimi në kohë i Rezultateve të Auditimit të Pajtushmërisë (ii). Publikimi në kohë i Rezultateve të Auditimit të Pajtushmërisë (iii) Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit të Pajtushmërisë nga SAI


SAI-18	130	Standardet e Kontrollit Gjyqësor dhe Menaxhimi i Cilësisë (<i>për SAI-t me Funksione Gjyqësore</i>)	(i). Politikat dhe Standardet e Kontrollit Gjyqësor (ii).. Menaxhimi i Grupit të Kontrollit Gjyqësor dhe Aftësitë (iii) Kontrolli i Cilësisë në Kontrollet Gjyqësore
SAI-19	133	Procesi i Kontrollit Gjyqësor (<i>për SAI-t me Funksione Gjyqësore</i>)	(i). Planifikimi i Kontrolleve Gjyqësore (ii). Zbatimi i Kontrolleve Gjyqësore (iii) Procesi vendimmarrës gjatë Kontrolleve Gjyqësore (iv) Vendimi Përfundimtar i Kontrolleve Gjyqësore
SAI-20	136	Rezultatet e Kontrolleve Gjyqësore (<i>për SAI-t me Funksione Gjyqësore</i>)	(i). Njoftimi i Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor (ii). Publikimi i Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor (iii). Ndjekja e Zbatimit të Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor nga SAI
138 D. Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse			
SAI-21	139	Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse	(i). Menaxhimi Financiar (ii). Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës (iii) Shërbimet Administrative Mbështetëse
142 E. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi			
SAI-22	144	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	(i).Funksioni i Burimeve Njerëzore (ii). Strategjia e Burimeve Njerëzore (iii) Rekrutimi i Burimeve Njerëzore (iv) Shpërbliimi, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit
SAI-23	147	Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional	(i).Planet dhe Proceset për Zhvillimin dhe Trajnimin Profesional (ii). Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar (iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Performancës (iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Pajtueshmërisë

151		Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara	
SAI-24	152	Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin	(i).Strategjia e Komunikimeve (ii). Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Legjislativin (iii) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Ekzekutivin (iv) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Gjyqësorin, Prokurorinë dhe Agjencitë Investigative
SAI-25	156	Komunikimi me Median, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile	(i).Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Median/Shtypin (ii). Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

3.2. Metodologjia e Pikëzimit

Korniza e matjes së performancës (KMP) të SAI-t përbëhet nga 6 fusha. Secila nga këto përmban një numër treguesish, gjithsej 25 përfshirë tre tregues shtesë për SAI-t me funksion gjyqësor. Secili prej treguesve përbëhet nga dy deri në katër dimensione, të cilat mund të përmbajnë disa kritere. Një ilustrim, sesi është ndërtuar sistemi i treguesve, është paraqitur në diagramin 4 më poshtë.

Diagrama 4: Terminologjia e KMP-ja e SAI-t



3.2.1. Pikëzimi i Dimensioneve

Më poshtë jepen udhëzime për mënyrën sesi të vlerësohet çdo tregues. Pikëzimi i çdo dimensionit ndjek një komplet formulash pikëzimi, të zhvilluar sipas numrit dhe rëndësisë përkatëse të kriterëve të listuara. Pikët e secilit dimension ofrojnë bazat për pikëzimin e secilit tregues (*shiko 3.2.3*).

Leximi i Kriterëve

Në shumë raste, kriteret janë marrë direkt nga ISSAI-t ose nga praktikatat e mira ndërkombëtare dhe referenca përkatëse jepet pas kriterëve, p.sh. ISSAI 1:5 i referohet ISSAI 1, Deklarata e Limës, seksioni 5; ISSAI 10:8 i referohet ISSAI 10, parimi i Deklaratës së Meksikës 8; ISSAI 40: fq 8 i referohet ISSAI 40 për Kontrollin e Cilësisë për SAI-t, faqe 8; dhe ISSAI 100:39 i referohet ISSAI 100 Parimet Themelore të Auditimit të Sektorit Publik, seksioni 39.

Kriteret që citohen direkt tregohen me shënimin [“...”]. Disa kritere nuk janë marrë direkt nga ISSAI (për shembull, SAI-13 (i) Raportimi në kohë i auditimit). Megjithatë, këto reflektojnë konceptet në ISSAI të cilat nuk mund të përdoren direkt si kritere. Në këto raste, grupi i punës i KMP i SAI-t zhvillon kriteret, dhe shumica prej tyre testohen në Versionin Pilot të KMP-së së SAI-t. Kriteret e tilla u janë referuar si “Grupi i punës të KMP-së së SAI-t”. Në raste të tjera, kriteret nxirren nga një dokument referues, por nuk është citim i drejtpërdrejtë.

Në pjesën më të madhe të kriterëve, fjalë të veçanta janë me nënvizim. Kjo nënkupton se qëllimi i leximit është që vlerësuesit të identifikojnë fjalët kyçe, por të gjitha aspektet e kriterit duhet të jenë vlerësuar kur përcaktohet nëse secili prej tyre është plotësuar.

Si rregull, të gjithë kriteret në dimension duhen vlerësuar. Megjithatë, për disa kritere vlerësuesit mund të duhet të konsiderojnë përshtatshmërinë e kriterit në kontekstin e SAI-t në fjalë. Për të treguar këtë, ky mund të jetë rasti, ku disa kritere përmbajnë termat “kur është e përshtatshme” ose “kur është e rëndësishme”. Megjithatë, këto kritere janë me rëndësi të njëjtë me të tjerat. Për më shumë informacion për kriteret që konsiderohen si: “jo të zbatueshme”, shiko seksionin 3.2.4 Metodologjia pa Pikëzim.

3.2.2. Nivelet e Pikëzimit

Treguesit dhe dimensionet janë pikëzuar duke përdorur një shkallë numerike nga 0 në 4, ku 0 është niveli më i ulët, dhe 4 është më i lartë. Pikët i korrespondojnë nivelit të zhvillimit në fushën e matur nga treguesi në përputhje me praktikën e modeleve të aftësive të INTOSAI¹². KMP-ja e SAI-t nuk ofron pikëzim të përgjithësuar për shumën e veprimtarive të SAI-t siç bëjnë mjetet e tjera. Niveli i zhvillimit, po kështu, dhe pikëzimet mund të ndryshojnë gjerësisht ndërmjet veprimtarive të SAI-t. Nivelet e pikëzimit të indikatorit 0-4 pasqyrojnë nivelin e zhvillimit për veprimtari të ndryshme siç përshkruhet më poshtë:

Pikëzimi 0 - *tipari nuk është përcaktuar ose funksionon me vështirësi*

Nuk ka asnjë veprimtari ose funksion, ose tipari i veçantë ekziston vetëm si emër.

Pikëzimi 1 - *Niveli Bazë*

Tipari ekziston, por është në nivel shumë të ulët. Për shembull, SAI është duke kryer një auditim performance, por këto nuk kryhen rregullisht dhe në mënyrë saqë nuk është

¹² Për shembull AFROSAI-E Kuadri Institucional për Ngritjen e Kapaciteteve (ICBF)
faqe **56** nga **250**

arritur që të grumbullohet eksperiencia dhe njohuritë e duhura, dhe kjo reflektohet në cilësinë e punës.

Pikëzimi 2 - Niveli i Zhvillimit

Tipari ekziston dhe SAI ka filluar zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave përkatëse, por këto nuk janë të plota dhe nuk janë zbatuar rregullisht. Për shembull, SAI ka plane strategjike dhe të zhvillimit, një strategji të burimeve njerëzore dhe një strategji të komunikimit. Megjithatë, nëse këto janë të dobëta dhe/ose janë zbatuar pjesërisht, kjo do të reflektohet në pikëzim.

Pikëzimi 3 - Niveli i Qëndrueshëm

Tipari funksionon gjerësisht sikurse kërkohet nga ISSAI (nivelet 1-3). Nën Fushën C, kjo do të nënkuptonte që auditimet e pajtueshmërisë, financiare dhe të performancës janë kryer gjerësisht në përputhje me parimet në nivelin 3 të kornizës a të ISSAI. Një pjesë e madhe e pasqyrave financiare të marra janë subjekt i auditimit financiar. Raportet e auditimit japin një vizion mbi përdorimin e të gjitha burimeve publike dhe mbi performancën e njësisve të audituara. Shumica e raporteve të auditimit janë publikuar në një format që është i përshtatshëm për audiencën e synuar.

Pikëzimi 4 - Niveli i Menaxhuar

Tipari funksionon në përputhje me parimet e ISSAI-ve (nivelet 1-3) dhe SAI zbaton aktivitetet në mënyrë që i mundëson atij të vlerësojë dhe të përmirësojë vazhdimisht performancën e tij. Në Fushën C, auditimet e pajtueshmërisë, financiare dhe të performancës janë ndërmarrë të gjitha në përputhje me parimet në nivelin 3 të kornizës të ISSAI-ve dhe shihen si vlerë e shtuar nga klientët e auditimit. Veç kësaj, SAI ka ndërmarrë një shqyrtim të pavarur të praktikave të tij të auditimit, për shembull duke përdorur Mjetin e Vlerësimit të Pajtueshmërisë me ISSAI (iCAT), konfirmon se praktikat e auditimit të SAI-t përputhen me nivelin 4 të ISSAI-ve.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se edhe me një pikëzim të lartë, duhet të jetë e qartë se SAI është duke bërë përpjekje për të ruajtur këtë nivel të performancës. Kjo mund të përshkruhet dhe të paraqitet në analizën e performancës.

3.2.3. Pikëzimi i treguesve të përgjithshëm

Secili nga dimensionet në një tregues duhet të vlerësohet veç e veç për të prodhuar pikëzimin për treguesin si një të tërë. Pikëzimi i përgjithshëm për një tregues llogaritet duke përdorur tabelat e konvertimit, të cilat janë të paraqitura më poshtë. Për treguesit me dy, tre ose katër dimensione ka respektivisht tabela të veçanta të konvertimit. Tabelat e konvertimit bazohen në mesatarizimin e pikëzimit të dimensioneve të veçanta.¹³

Hapat për përcaktimin e pikëzimit të treguesve të përgjithshëm janë si vijon:

- 1) Identifikoni seksionin e përshtatshëm në tabelën e konvertimit, në varësi të numrit të dimensioneve të treguesit që pikëzohet;
- 2) Renditni pikëzimet e dimensionit sipas rendit zbritës (0, 1, 2, etj);
- 3) Identifikoni rreshti në tabelë që përputhet me kombinimin e pikëve që ju janë dhënë;
- 4) Merrni pikëzimin e përgjithshëm korrespondues për treguesin;

3.2.4. Metodologjia pa pikëzim

Në disa raste pikëzimi mund të jetë i pamundur për një tregues ose dimension¹⁴:

a) I pa aplikueshëm (NA)

Një tregues ose dimension mund të pikëzohet “NA”. Kjo mund të ndodhë kur SAI nuk ka mandatin për të kryer tiparin që matet me treguesin apo dimensionin në fjalë. Mandati i SAI-t matet në Fushën A, dhe nëse mandati nuk është në përputhje ne praktikën të mira do të jepet një pikëzim i ulët. Fushat B – F mund të kuotohen “NA” kur maten aktivitetet jo të mandatuara, ose aspekti që është matur nuk i takon SAI-t (për shembull realizimi i punës audituese me burime të jashtme).

Raste të tjera përfshijnë situatën kur informacioni në dispozicion është i pamjaftueshëm për të pikëzuar një tregues ose dimension, ose informacioni i kërkuar nuk është ai që pritej që SAI ta zotëronte. Një shembull i këtij rasti jepet në Fushën E për Burimet Njerëzore, ku mund të jetë e vështirë marrja e dokumentacionit mbi procese rekrutimit të veçanta e për shkak të ndjeshmërisë së informacionit.

¹³ Metoda e ngjashme me atë që kuadri PEFA quan Metoda 2 (M2).

¹⁴ Metodologjia pa pikë është përshtatur në masë të madhe nga kuadri i PEFA, kjo vlen dhe për dimensione që nuk janë të zbatueshme.

Tjetër shembull është nëse dokumentet humbasin gjatë një zjarri ose një rasti të ngjashëm. Nëse, nga ana tjetër, SAI nuk është i aftë të ofrojë informacionin që pritet që ai të ketë, kriteri duhet të konsiderohet i paplotësuar dhe jo NA. Shembuj për këto raste, janë nëse SAI nuk ka një plan strategjik, buxhetin për çdo auditim të veçantë, ose manual auditivi të përshtatshëm. Në mënyrë ideale, duhet vendosur përpara fillimit të vlerësimit se cilët tregues ose dimensione do të konsiderohen të Pa Aplikuueshëm, dhe kjo duhet të regjistrohet në Termat e Referencës.

b) Pikëzimi dhe pikët përgjithësuese në rastet "Pa Pikëzim"

Nëse një dimension është kuotuar NA, pikëzimi i përgjithshëm i treguesit duhet të llogaritet duke mos marrë në konsideratë dimensionin në fjalë, d.m.th përdoren tabelat e konvertimit të cilat përmbajnë aq dimensione sa ju keni pikëzuar. Për shembull, në qoftë se pikëzimet e dimensionit të një treguesi tre-dimensional janë 1, 3 dhe NA, duhet të përdorni tabelën e konvertimit për treguesit dy-dimensionale. Nëse më shumë se një dimension është kuotuar NA, treguesi i përgjithshëm duhet të vlerësohet NA.

Në qoftë se një kriter në një dimension është kuotuar NA, atëherë kriteri duhet të konsiderohet si i plotësuar kur numërohen kriteret e plotësuar në një listë. Për shembull, në qoftë se të gjitha kriteret janë plotësuar përveç njërit, i cili nuk mund të vlerësohet, atëherë duhet të aplikohet pikëzimi i lartë ("Të gjitha kriteret janë plotësuar"). Nëse më shumë se dy kritere janë renditur NA, si rregull, dimensionin i përgjithshëm duhet të vlerësohet NA, duke shpjeguar më poshtë rastet përjashtimore. Nëse asnjë kriter në dimension nuk është plotësuar dhe një ose më shumë kritere janë vlerësuar NA, atëherë pikëzimi i dimensionit duhet të jetë 0. Në rastet kur, ndikimi i vlerësimit NA (i pa aplikueshëm) duket se rrit në mënyrë të konsiderueshme pikëzimin e dimensionit në një nivel që duket i papërshtatshëm, vlerësuesit mund të aplikojnë gjykimin e tyre profesional dhe të rendisin treguesit si NA dhe të mos të japin atij një pikëzim keq-orientues. Gjithashtu, në rastet kur dimensionet kanë shumë kritere (për shembull, dimensionet e auditimit mund të kenë nga tetë deri në 19 kritere), vlerësuesit duhet të konsiderojnë dhënien e një rezultati për dimensionin, edhe nëse kriteret me numra të vlerësuar me NA janë më shumë se dy. Në këto raste, vlerësuesit duhet të përdorin gjykimin e tyre profesional.

3.2.5. Tabelat e Konvertimit për Pikëzimet e Treguesve

Pikëzimet për çdo dimension		Pikëzimi i Përgjithshëm	Pikëzimet për çdo dimension			Pikëzimi i Përgjithshëm
Treguesit 2-dimensional			Treguesit 3-dimensional			
0	0	0	0	0	0	0
0	1	0	0	0	1	0
0	2	1	0	0	2	1
0	3	1	0	0	3	1
0	4	2	0	0	4	1
1	1	1	0	1	1	1
1	2	1	0	1	2	1
1	3	2	0	1	3	1
1	4	2	0	1	4	2
2	2	2	0	2	2	1
2	3	2	0	2	3	2
2	4	3	0	2	4	2
3	3	3	0	3	3	2
3	4	3	0	3	4	2
4	4	4	0	4	4	2
			1	1	1	1
			1	1	2	1
			1	1	3	2
			1	1	4	2
			1	2	2	2
			1	2	3	2
			1	2	4	2
			1	3	3	2
			1	3	4	3
			1	4	4	3
			2	2	2	2
			2	2	3	2
			2	2	4	3
			2	3	3	3
			2	3	4	3
			2	4	4	3

3	3	3	3
3	3	4	3
3	4	4	4
4	4	4	4

Pikëzimet për çdo dimension				Pikëzimi i Përgjithshëm	Pikëzimet për çdo dimension				Pikëzimi i Përgjithshëm
Treguesit 4-dimensional					Treguesit 4-dimensional				
0	0	0	0	0	1	1	1	1	1
0	0	0	1	0	1	1	1	2	1
0	0	0	2	0	1	1	1	3	1
0	0	0	3	1	1	1	1	4	2
0	0	0	4	1	1	1	2	2	1
0	0	1	1	0	1	1	2	3	2
0	0	1	2	1	1	1	2	4	2
0	0	1	3	1	1	1	3	3	2
0	0	1	4	1	1	1	3	4	2
0	0	2	2	1	1	1	4	4	2
0	0	2	3	1	1	2	2	2	2
0	0	2	4	1	1	2	2	3	2
0	0	3	3	1	1	2	2	4	2
0	0	3	4	2	1	2	3	3	2
0	0	4	4	2	1	2	3	4	2

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

0	1	1	1	1	1	2	4	4	3
0	1	1	2	1	1	3	3	3	2
0	1	1	3	1	1	3	3	4	3
0	1	1	4	1	1	3	4	4	3
0	1	2	2	1	1	4	4	4	3
0	1	2	3	1	2	2	2	2	2
0	1	2	4	2	2	2	2	3	2
0	1	3	3	2	2	2	2	4	2
0	1	3	4	2	2	2	3	3	2
0	1	4	4	2	2	2	3	4	3
0	2	2	2	1	2	2	4	4	3
0	2	2	3	2	2	3	3	3	3
0	2	2	4	2	2	3	3	4	3
0	2	3	3	2	2	3	4	4	3
0	2	3	4	2	2	4	4	4	3
0	2	4	4	2	3	3	3	3	3
0	3	3	3	2	3	3	3	4	3
0	3	3	4	2	3	3	4	4	3
0	3	4	4	2	3	4	4	4	4
0	4	4	4	2	4	4	4	4	4

3.3. Treguesit

Fusha A: Pavarësia dhe Korniza Ligjore

Fusha A mbulon mandatin ligjor të SAI-t dhe pavarësinë e tij. Qëllimi i fushës është të marrë në konsideratë bazën institucionale për funksionimin e SAI-t, për të mbështetur njohjen se si SAI performon si një organizatë. Dihet se pavarësia dhe korniza ligjore e SAI-t nuk janë drejtpërdrejt nën kontrollin e vetë SAI-t. Korniza ligjore vendoset nga pushtete të tjera shtetërore. Fusha, megjithatë, është përfshirë në KMP e SAI-t sepse pavarësia dhe korniza ligjore e SAI-t kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në efektivitetin e tij. SAI-t mund të përpiqet të influencojë mbi ndonjë pengesë që buron nga kufizimi i mandatit dhe pavarësisë së tij.

ISSAI 1 (Deklarata e Limës) dhe ISSAI 10 (Deklarata e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-t) janë burimet kryesore të praktikave më të mira në këtë fushë. ISSAI 1 përshkruan rëndësinë e pavarësisë së SAI-ve, dhe ISSAI 10 ofron më shumë detaje. Ai përcakton që SAI duhet të gëzojë pavarësi financiare dhe organizative, dhe që duhet të sigurohet pavarësia e Kryetarit të SAI-t, përfshirë sigurinë fizike dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tij. Veç kësaj, SAI duhet të jetë i lirë nga ndërhyrjet që mund t'i vijnë nga Legjislativi ose Ekzekutivi në kryerjen e detyrave të tij, duke përfshirë marrjen e informacionit dhe raportimin e punës. Këto janë kushte të rëndësishme paraprake për funksionimin e SAI-t, megjithëse mekanizmat për ushtrimin e këtyre funksioneve mund të ndryshojnë sipas modelit të SAI-t dhe kontekstit të vendit. Për shembull, SAI me funksione gjyqësore janë karakterizuar nga “distanca e baraslarguar” nga Legjislativi dhe Ekzekutivi: ato janë të pavarura si nga Legjislativi ashtu edhe nga Ekzekutivi.

Treguesit e Performancës:

SAI-1: *Pavarësia e SAI-t;*

SAI-2: *Mandati i SAI-t.*

Lidhje me fusha të tjera

Rezultatet në Fushën A mund të ndikojnë rezultatet dhe aftësinë për të vlerësuar treguesit e tjerë. Mungesa e pavarësisë organizative, mund të pengojë praktikën e rekrutimit, të matura nën Fushën E. Nëse është ky rasti, kriteret ose dimensionet përkatëse mund të mos jenë të aplikueshme dhe duhet të pikëzohen sipas rastit. Në mënyrë të ngjashme, një SAI nuk duhet të penalizohet nëse vlerësimi i SAI-2 tregon që ka mandat të kufizuar për auditime. Kjo do të ketë pasoja për rezultatet e treguesve në Fushën C.

SAI-1: Pavarësia e SAI-t

Rëndësia e një Institucioni Suprem Auditimi objektiv, i cili funksionon në mënyrë efektive, qëndron në zemër të matjes së pavarësisë. Sipas ISSAI 1, kjo mundet të arrihet vetëm nëse SAI është i pavarur nga njësitë e audituara dhe është i mbrojtur nga influencat e jashtme. SAI-1 mat nivelin e pavarësisë që gëzon SAI, duke vlerësuar aspektet kyçe të pavarësisë të identifikuar nga vetë anëtarët e INTOSAI, përmes Deklaratës së Limës (ISSAI 1) dhe Deklaratës së Meksikos (ISSAI 10).

Themeli për ekzistencën e SAI-t duhet të jetë përcaktuar në kornizën ligjore të shtetit, dhe pavarësia e SAI-t duhet të garantohet madje edhe në Kushtetutë. Deklarata e Limës nënvizon se krijimi i SAI-t duhet të vendoset në ligjin suprem të vendit për të siguruar qëndrueshmëri dhe autoritet të përshtatshëm të organizatës: “Krijimi i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe pavarësia e nevojshme e tyre të jetë e përcaktuar në Kushtetutë; detajet mund të përshkruhen në legjislacion.” (ISSAI 1:5).

Korniza ligjore duhet të sigurojë që SAI të veprojë në mënyrë të pavarur, pa riskun real apo të perceptuar të të qenit të ndikuar nga Ekzekutivi ose nga njësi të tjera. Deklaratat e Limës dhe Meksikos identifikojnë pavarësinë financiare, autonomi operationale dhe një pavarësi e Kryetarit të SAI-t si një minimum për të marrë këtë nivel pavarësie. Këto aspekte duhet të pasqyrohen në kornizën ligjore po ashtu edhe në praktikën e SAI-t.

Deklarata e Limës specifikon që “pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit ofron sipas Kushtetutës dhe ligjit, garanton një autonomi në shkallë shumë të lartë, edhe atëherë kur ato veprojnë si një agjent i Parlamentit dhe kryejnë auditime sipas udhëzimeve të tyre”. Marrëdhënia midis Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamentit duhet të përcaktohet në Kushtetutë sipas kushteve dhe kërkesave të çdo vendi. Në anën tjetër, Deklarata e Limës gjithashtu, përcakton se “Institucionet Supreme të Auditimit auditojnë aktivitetet e qeverisë, autoritetet administrative dhe institucione të tjera”. Nën Modelin Gjyqësor, SAI bën pjesë në sistemin gjyqësor dhe operon i pavarur me një distancë të barabartë nga Ekzekutivi dhe Legjislativi. SAI-et me funksione gjyqësore përbëhen nga magjistratë që gjykojnë përdorimin e fondeve publike nga zyrtarët qeveritarë. Zyrtarët qeveritarë janë personalisht dhe financiarisht përgjegjës për shumat e përfshira në transaksionet e pa autorizuara ose ilegale. Kështu, SAI mund të kërkojë që paratë e shpenzuara jo në mënyrën e duhur apo që nuk janë mbledhur nga njësia publike rikuperohen sipas një procedure të quajtur gjykim i llogarive. Drejtuesit vlerësohen si përgjegjës përpara një Gjykate Disiplinore.

Qasja e Sugjeruar e Vlerësimit

Ndërsa fokusi kryesor i treguesit është ajo çfarë është shkruar në kornizën ligjore (de jure), gjithashtu, disa kritere janë të lidhura me zbatimin e kërkesave ligjore në praktikë (de facto). Të dy aspektet janë të rëndësishme kur vlerësojnë pavarësinë e SAI-t.

SAI-1 i vlerëson Kushtetutën dhe kornizën ligjore më të detajuar të SAI-t. Disa shtete kanë ligj të veçantë për SAI-n. Në vende të tjera, funksionet dhe përgjegjësitë e SAI-t janë të përfshira në ligjet e auditimit publik dhe/ose në menaxhimin financiar publik. Këto ligje mund të mbulojnë funksionet e organeve të tjera qeveritare. Në disa raste, funksionet e SAI-t mund të parashikohen në ligje të ndryshme. Kur vlerësohen dimensionet, është gjithashtu e rëndësishme të qenit në dijeni dhe marrjen në konsideratë të të gjithë komponentëve përkatës të kornizës ligjore të SAI-t.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Korniza e përshtatshme dhe Efektive Kushtetuese;*
- (ii) *Pavarësia/Autonomia Financiare;*
- (iii) *Pavarësia/Autonomia Organizative;*
- (iv) *Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe Zyrtarëve të tij.*

(i) Korniza e Përshtatshme dhe Efektive Kushtetuese: Ky dimension mat si është përshkruar SAI në Kushtetutën e një vendi. Në lidhje me këtë, është e rëndësishme të theksohet që në disa vende kushtetuta nuk është një dokument i vetëm i kodifikuar. Kur vendoset se në cilat burime ligjore do mbështetemi për vlerësimin e dimensionit kërkohet gjykimi profesional. Pika kyçe është se tiparet bazë të pavarësisë dhe mandatit të SAI-t duhen të përfshihen në kornizën ligjore, d.m.th. në ligje që kanë mbrojtje të mjaftueshme ndaj ankimit. Për shembull, nuk konsiderohet i vendosur në kornizën ligjore, nëse ligji mund të shfuqizohet nga vota e shumicës së Legjislativit.

(ii) Pavarësia/Autonomia Financiare: shqyrton pavarësinë financiare të SAI-t. SAI duhet të ketë burime të vlefshme, të nevojshme dhe të arsyeshme, dhe duhet të menaxhojë buxhetin e tij pa ndërhyrje ose kontrolle nga Ekzekutivi. Kjo pavarësi duhet të përfshijë të gjithë procesin e buxhetit, që nënkupton se Ekzekutivi nuk duhet të ndërhyjë padrejtësisht në propozimin e buxhetit të SAI-t, dhe pasi buxheti është miratuar nga Legjislativi, nuk duhet të kontrollojë shpërndarjen e tij, për shembull duke penguar shpërndarjen e burimeve.

(iii) Pavarësia/Autonomia Organizative: me qëllim përmbushjen e mandatit në mënyrë efektive, SAI ka nevojë të ketë autonomi në organizimin dhe menaxhimin e zyrave të tyre. Kjo nënkupton që ato duhet të jenë në gjendje të menaxhojnë dhe planifikimin e aktiviteteve të tyre pa ndërhyrje nga organet e ekzekutivit, duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore.

(iv) Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe Zyrtarëve të tij: Kushtet e zgjedhjes të Kryetarit të SAI-t (dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale kur është e përshtatshme) duhen specifikuar në legjislacion. Pavarësia e tyre mund të sigurohet vetëm nëse SAI-ve u caktohen Kryetarë në terma kohore fiks dhe afatgjatë dhe nëse emërtimet dhe largimet nga funksioni ndodhin përmes një procesi që siguron pavarësinë e tyre. Kjo lejon realizimin e mandatit pa frikën e presioneve. Çdo rizgjedhje, kur kjo është e zbatueshme dhe në përputhje me ligjin, duhet të bëhet në mënyrë të pavarur dhe transparente.

Termi *“Kryetari i SAI-t”* i referohet atij që është përgjegjës për vendimmarrjen e SAI-t. Se kush është në praktikë, varet nga modeli i SAI-t. Për disa institucione, siç është SAI me funksione gjyqësore, vendimet merren në mënyrë kolektive nga një numër anëtarësh. Në këtë kontekst “anëtarët janë të përcaktuar si ata persona që kanë marrë vendime për Institucionin Suprem të Auditimit dhe përgjigjen për këto vendime te palë të treta, d.m.th., anëtarët e organit kolegjial vendimmarrës ose kryetari i Institucionit Suprem të Auditimit të organizuar në mënyrë monokratike të”. (ISSAI 1;6).

SAI-1 Dimensioni & Kriteri Minimal për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioni (i) Korniza e Dukur dhe Efektive Kushtetuese	
<p>a) “Krijimi i Institucioneve Supreme të Auditimit bazohet në Kushtetutë; detaje (përfshirë rolin, fuqitë dhe detyrat e SAI-t), mund të vendoset në legjislacion”. <i>ISSAI 1:5</i>, Shiko gjithashtu <i>ISSAI 1:8</i></p> <p>b) Pavarësia e SAI-t duhet të përfshihet në Kushtetutë. <i>ISSAI 1:5</i></p> <p>c) “Pavarësia e Institucioneve të Auditimit është nën Kushtetutë dhe ligj dhe gjithashtu garanton një shkallë të lartë iniciative dhe autonomie”. <i>ISSAI 1:8</i></p> <p>d) Zgjedhja, kohëzgjatja dhe pushimi i funksioneve të Kryetarit të SAI-t (dhe anëtarëve, në rastet me organe kolegjiale) dhe pavarësia e vendimmarrjes janë të garantuara në Kushtetutë. <i>ISSAI 1:6</i>, <i>ISSAI 10:2</i></p> <p>e) Ka “një mbrojtje ligjore të mjaftueshme nga Gjykata e Lartë kundër ndërhyrjeve në pavarësinë e SAI-t”. <i>ISSAI 1:5</i></p> <p>f) SAI duhet të raportojë për çdo çështje që mund të ndikojë në aftësinë për të kryer punën e tij në përputhje me mandatin dhe / ose kuadrin ligjor”. <i>ISSAI 12.1</i></p> <p>g) SAI duhet të përpiqet të promovojë, sigurojë dhe të mbajë një kornizë kushtetuese, statutore ose ligjore të përshtatshme dhe efektive. <i>ISSAI 12:1</i></p> <p>Pikëzimi = 4; Të gjithë kriteret më lart plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3; Kriteret (a), (b) dhe të paktën tre nga kriteret e tjera më lart plotësohen</p> <p>Pikëzimi=2; Kriteret (a), (b) dhe të paktën një nga kriteret më lart plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1; Të paktën një nga kriteret më lart plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 0; Asnjë nga kriteret më lart nuk plotësohet</p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 12</p>
Dimensioni (ii) Pavarësia/Autonomia Financiare	
<p>a) Korniza ligjore në mënyrë të qartë dhe pa rezerva siguron pavarësinë financiare të SAI-t nga ekzekutivi. <i>ISSAI 1:7</i></p> <p>b) Buxheti i SAI-t është aprovuar/miruar nga “organi publik që vendos për buxhetin kombëtar”. <i>ISSAI 1:7</i></p>	<p>ISSAI 1,</p> <p>ISSAI 10,</p>

<p>c) SAI është i lirë të propozojë buxhetin e tij te organi publik që vendos për buxhetin kombëtar pa ndërhyrje nga ekzekutivi. <i>ISSAI 10:8</i></p> <p>d) SAI “është i autorizuar të përdorë fondet të alokuara për të sipas një titulli buxhetor të veçantë ashtu sikurse i përshtatet atij” (sipas kërkesës) <i>ISSAI 1:7</i></p> <p>e) Pasi buxheti i SAI-t është miratuar nga Legjislativi, Ekzekutivi (p.sh Ministria e Financave) nuk duhet të kontrollojë aksesin e saj në këto burime. <i>ISSAI 10:8</i></p> <p>f) SAI “ka të drejtë të apelojë direkt te Legjislativi nëse burimet e dhëna janë të pamjaftueshme për ta lejuar atë të përmbushë mandatin e tij”. <i>ISSAI 10:8</i></p> <p>g) Gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pasur raste të ndërhyrjeve të paligjshme nga Ekzekutivi në lidhje me buxhetin e propozuar nga SAI ose aksesin në burimet financiare. <i>ISSAI 10:8</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi =3; Kriteret (a), (f), (g) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 2; Kriteri (a) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1; Të paktën një nga kriteret më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi= 0; Asnjë nga kriteret më sipër nuk plotësohet</p>	
Dimensioni (iii) Pavarësia/Autonomia Organizative	
<p>a) Korniza ligjore siguron që SAI ka “funksione dhe pavarësi organizative që kërkohen për të përmbushur detyrat e tij”. <i>ISSAI 1:5</i></p> <p>b) Në praktikë, SAI “është i lirë nga ndërhyrjet ose orientimet e Legjislativit ose Ekzekutivit në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë së tij”. <i>ISSAI 10:3</i></p> <p>c) SAI ka pushtetin për të vendosur rregullat dhe procedurat e tij për menaxhimin e veprimtarisë dhe përmbushjen e mandatit të tij, në përputhje me rregullat përkatëse që ndikojnë në njësitë e tjera publike. <i>ISSAI 10:8, ISSAI 20:6.</i></p> <p>d) Kryetari i SAI-t është i lirë për të vendosur në mënyrë të pavarur për të gjitha çështjet e burimet njerëzore, përfshirë emërimin e stafit dhe hartimin e kushteve të tyre i kufizuar vetëm nga kornizat buxhetore dhe të punësimit të miratuara nga Legjislativi, <i>ISSAI 10:8.</i></p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p>

<p>e) Marrëdhënia midis SAI-t dhe Legjislativit, gjithashtu dhe Ekzekutivit është përcaktuar qartësisht në kornizën ligjore. <i>ISSAI 1:8, 9.</i></p> <p>f) Korniza ligjore “përshkruan përgjegjësinë dhe transparencën (duke mbuluar) mbikëqyrjen e aktiviteteve të SAI-t”. <i>ISSAI 20:1</i></p> <p>g) SAI ka të drejtë të rekrutojë dhe të paguajë ekspertë të jashtëm kur e gjykon të nevojshme. <i>ISSAI 1:14</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (b) dhe të paktën katër nga kriteret e tjera më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret më sipër plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret më sipër nuk plotësohet</p>	
Dimensioni (iv) Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe e Anëtarëve të tij	
<p>a) Legjislacioni i zbatuar specifikon kushtet për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe heqjen e Kryetarit të SAI-t, dhe (kur është e përshtatshme) anëtarëve të institucionit kolegji, nga një proces që siguron pavarësinë e tyre. <i>ISSAI 10:2</i> (për shembull, me aprovimin e Legjislativit, dhe kur është e përshtatshme, të Kryetarit të Shtetit; shkarkimi vetëm për ato shkaqe / akuza, për të cilat aplikohet mbrojtje e ngjashme me anëtarët e Gjykatës së Lartë).</p> <p>b)“(..) Kryetari i SAI-t dhe (kur është e përshtatshme) anëtarët e institucionit kolegji, emërohen [dhe ri emërohen] me afate fiks dhe që zgjasin mjaftueshëm, për t’i lejuar atyre të realizojnë mandatin e tyre pa frikë nga presionet.” <i>ISSAI 10:2</i></p> <p>c) “Kryetari i SAI-t dhe (kur është e përshtatshme) anëtarët e institucionit kolegji kanë imunitet nga hetimi për ndonjë akt që rezulton nga kryerja normale e detyrave të tyre”. <i>ISSAI 10:2</i> (për shembull SAI / Kryetari i SAI-t nuk mund të paditet për shprehjen e opinioneve audituese. Ky kriter konsiderohet i arrirë nëse legjislacioni citon që kryetari i SAI-t nuk do të jetë subjekti i drejtimit apo kontrollit të ndonjë autoriteti tjetër kur kryen funksionet e tij të përshkruara në legjislacion.</p> <p>d) Brenda 3 viteve të fundit, nuk ka patur ndonjë periudhë më të gjatë se 3 muaj gjatë të cilës, Kryetari ka qenë i emëruar me kushte në mënyrë të papërshtatshme. <i>Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p>

e) Emërimi i fundit (ose riemërimi) i Kryetarit të SAI-t është bërë nëpërmjet një procesi transparent që siguron pavarësinë e tij/saj. *ISSAI 10:2, Grupi i punës KMP së SAI-t.*

f) Gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur raste kur Kryetari i SAI-t (ose kur është e përshtatshme) anëtarët e institucionit kolegjal janë shkarkuar nëpërmjet një akti të paligjshëm ose në një mënyrë që kompromenton pavarësinë e SAI-t. *ISSAI 10:2, Grupi i punës KMP së SAI-t.*

g) Korniza ligjore siguron se “në karrierën e tyre profesionale, stafi auditues i Institucioneve Supreme të Auditimit nuk duhet të ndikohet nga njësitë e audituara dhe nuk duhet të varet nga këto njësi”. *ISSAI 1:6*

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret më sipër plotësohen

Pikëzimi = 3: Kriteret (a), (e) dhe të paktën tre nga kriteret e tjera më sipër plotësohen

Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera më sipër plotësohen

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret më sipër plotësohen

Pikëzimi = 0: asnjë nga kriteret e përmendura nuk plotësohet.

SAI-2: Mandati i SAI-t

Ky tregues synon të vlerësojë autoritetin operacional të SAI-t të përcaktuar në kornizën ligjore. Në cilësinë e institucionit suprem të auditimit të burimeve financiare qeveritare, SAI duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm sipas kornizës ligjore, në të cilën përcaktohet roli i tij dhe përshkruhen qartësisht operacionet e Financave Publike për të cilat ai ka përgjegjësinë ligjore t'i auditojë.

Sipas Deklaratës së Limës, "të gjitha operacionet financiare publike, pavarësisht nëse dhe si ato janë pasqyruar në buxhetin kombëtar, do të jenë objekt auditimi nga Institucionet Supreme të Auditimit. Përjashtimi i aspekteve të menaxhimit financiar nga buxhetin kombëtar, nuk do të thotë që do të përjashtohen nga auditimet e Institucionit Suprem të Auditimit". "ISSAI 10, gjithashtu, shtjellon kuptimin e mandatit të gjerë në mënyrë të mjaftueshme dhe diskrecionin e plotë të SAI-t. Për të mundësuar SAI-n të përmbushë mandatin ky diskrecion duhet të pasqyrohet *de jure* dhe *de facto* të drejtat e SAI-t për të marrë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për veprimtarinë e tij. Së fundi, për të qartësuar kuptimin e kompetencave të SAI-t, është e nevojshme të vlerësohen të drejtat dhe detyrimet e tij. Për të mbajtur njësitë e audituara të përgjegjshme dhe për të patur impakt, SAI duhet të ketë pushtet dhe i kërkohet të raportojë mbi aktivitetin e tij. Kuadri ligjor duhet të sigurojë ato të drejta, që i lejojnë SAI-t të përgatisë, paraqesë dhe publikojë lirisht raportet e tij të auditimit.

Për SAI-et me funksione gjyqësore, koncepti *mision* është më i përshtatshëm se koncepti mandat. Një SAI gjyqësor nuk merr një mandat, ai përmbush misionet me të cilin pajiset nga akti i tij themelues. Për SAI-et gjyqësore misioni, ashtu siç është parashikuar dhe realizuar, duhet të vlerësohen në këtë tregues.

Qasja e Sugjeruar për Vlerësimin

Vlerësimi i këtij treguesi kërkon ekzaminimin e kornizës ligjore dhe aktivitetet e SAI-t, duke përfshirë çdo dukuri apo ndërhyrje nga ekzekutivi gjatë periudhës në shqyrtim.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Mandati mjaftueshëm i gjerë;*
- (ii) *Aksesi në informacion;*
- (iii) *E drejta dhe detyrimi për të raportuar.*

(i) Mandati mjaftueshëm i gjerë: ISSAI-t parashikojnë një mandat të gjerë auditimi për SAI, duke mbuluar të gjitha (ose shumicën) e operacioneve financiare publike (ISSAI1:18). Ky dimension vlerëson të drejtat ligjore të SAI-t për të kryer auditime. Nëse kuadri ligjor nuk shprehet për elemente të caktuara, vlerësuesit duhet të shikojnë aktivitetet që SAI kryen në praktikë. Për një SAI me funksionet gjyqësore, misioni i tij siguron bazën ligjore për kontrollin gjyqësor. INTOSAI ka hartuar ISSAI për tre lloje kryesore të auditimit¹⁵ në sektorin publik. Në përmbushjen e mandateve të tyre, SAI-t duhet të jenë të pavarur në zgjedhjen e çështjeve të auditimit, në planifikimin dhe në kryerjen e tyre. Kjo nënkupton që mënyra e kryerjes së auditimit mund të ndryshojnë në praktikë dhe SAI-t mund të kombinojnë lloje të auditimit, për shembull, në auditimet gjithëpërfshirëse. Është e rëndësishme që të ketë mbikëqyrje nga një organ i pavarur (p.sh SAI) mbi të gjitha fondet publike, si dhe edhe mbi fondet jo buxhetore. SAI duhet të ketë të drejtë t'i drejtohet legjislaturës nëse ka shqetësime mbi auditimet për ato operacione financiare publike që nuk janë pjesë e mandatit të tij.

(ii) Akses në informacion: Audituesit duhet të kenë akses të lirë, në kohë dhe të pakufizuar në të gjitha dokumentet dhe informacionet që mund t'iu nevojiten për përmbushjen e siç duhet përgjegjësitë e tyre (ISSAI 10:4). Ky dimension vlerëson se deri në ç'masë SAI ka të drejta të tilla.

(iii) E drejta dhe detyrimi për të raportuar: Dimensioi vlerëson të drejtën dhe detyrimin e SAI-t për të raportuar gjetjet e auditimit. SAI-et duhet të raportojnë rezultatet e punës së tyre audituese të paktën një herë në vit (ISSAI 1:16). Ata duhet të jenë të lirë të vendosin mbi përmbajtjen e raporteve të tyre të auditimit, si dhe ti publikojnë dhe shpërndajnë ato, pasi të jenë paraqitur zyrtarisht tek subjekti ose autoriteti përkatës. SAI duhet të kushtoj kujdes të gjitha ligjeve mbi sekretin e informacionit si dhe të gjejë mënyrën e përshtatshme se si mund të komunikojë rezultatet e tij pa shkelur dispozitat e këtyre ligjeve.

¹⁵ Për informacione të mëtejshme për llojet e auditimit, ju lutem shikoni Domainin C faqe 72 nga 250

SAI - 2 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Mandati Mjaftueshëm i Gjerë	
<p>Fushëveprimi i Auditimit</p> <p>a) "Të gjitha operacionet financiare publike, pavarësisht nëse dhe si ato janë pasqyruar në buxhet, do t'i jenë subjekt i auditimit nga Institucionet Supreme të Auditimit". <i>ISSAI 01:18 (Për pikëzimin e këtij kriteri, vlerësuesve mund ti nevojitet të përkufizojnë dhe të evidentojnë interpretimin e tyre të "Buxhetit Kombëtar", në lidhje me strukturën e Qeverisë në vend).</i></p> <p>b) Kur kriteri (a) nuk plotësohet, SAI ka të drejtë t'i drejtohet legjislaturës ose komisionit përkatës legjislativ në lidhje me shqetësimet që mund të ketë mbi auditimet e cilitdo operacioni financiar publik, që nuk përfshihet në mandatin e tij. <i>ISSAI 1:18, Grupi i punës KMP e SAI-t.</i></p> <p>c) Mandati i SAI-t, në mënyrë specifike siguron që ai është përgjegjës për auditimin e të gjitha aktiviteteve të qeverisë qendrore. <i>ISSAI 10:3 (P.sh. auditimi i fondit të konsoliduar, duke përfshirë të gjitha hyrjet dhe daljet e fondeve, të gjithë të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet).</i></p> <p>d) "(...) SAI-et janë të lirë nga orientimet dhe ndërhyrjet (...), në përzgjedhjen e çështjeve të auditimit, në planifikim, (...) kryerjen e auditimit, raportimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre " <i>ISSAI 10:3.</i></p> <p>e) Gjatë 3 viteve të fundit, SAI-t nuk i është dhënë dhe nuk ka pranuar ndonjë detyrë, e cila ndikon në pavarësinë e mandatit të tij. <i>ISSAI 10:3, Grupi i punës KMP e SAI-t</i></p> <p>f) Nuk ka pasur raste ndërhyrjeje në përzgjedhjen e klientëve të auditimit ose subjekteve brenda tre viteve të fundit, në mënyrë të tillë që mund të kompromentojnë pavarësinë e SAI-të. <i>ISSAI 10:3, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>Minimalisht, "SAI duhet të autorizohet për të audituar (...)": <i>ISSAI 10:3</i></p> <p>g) "ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e llogarive të qeverisë apo të njëjësive publike". <i>ISSAI 10: 3</i></p> <p>h) "cilësinë e menaxhimit financiar dhe raportimit". <i>ISSAI 10: 3</i></p> <p>i) "ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit të operacioneve të qeverisë ose njëjësive publike". <i>ISSAI 10: 3</i></p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p>

<p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (c) dhe të paktën gjashtë nga kriteret e tjerë plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (c) dhe të paktën tre nga kriteret e tjerë plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kritere plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Aksesit në Informacion</p>	
<p>a) Ligji i jep SAI-t të drejtë të pakufizuar në evidenca, dokumenta dhe informacion. <i>ISSAI 1:10</i></p> <p>b) SAI ka të drejtë të vendosë se çfarë informacioni i nevojitet për auditimet e tij. <i>ISSAI 1:10</i></p> <p>c) Në rast se aksesit në informacionin e kërkuar për auditimin është i kufizuar ose mohohet, ekziston një proces i përshtatshëm për zgjidhjen e këtyre çështjeve, p.sh. mundësia për të adresuar tek legjislativi ose në një prej komisioneve të tij, për të çuar çështjen në gjykatë, ose të drejtën direkte për të sanksionuar subjektet që pengojnë aksesin në informacion. <i>ISSAI 10: 4, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>d) Për kontrollet jogjyqësore, në rastet kur aksesit në informacionin e nevojshëm fshihet, SAI ka autoritet të veçantë për të sanksionuar përgjegjësit e këtyre fshehjeve. (p.sh. gjoba për mos dhënie të informacionit, gjoba për fshehje të informacionit, etj). <i>Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>e) Stafi i SAI ka të drejtën e aksesit në ambientet e subjekteve të audituara me qëllim që të kryejnë punën e nevojshme në terren. <i>ISSAI 1:10</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera më lart plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p>

Dimensioni (iii) E drejta dhe detyrimi për të raportuar	
<p>a) "Institucioni Suprem i Auditimit duhet të ketë autoritetin e kërkuar nga Kushtetuta dhe për të raportuar gjetjet e tij çdo vit dhe në mënyrë të pavarur në parlament. " <i>ISSAI 1:16 (d.m.th organi i përfaqësuesve të popullit)</i></p> <p>b) SAI ka të drejtë të publikojë raportet e veta vjetore të auditimit. <i>ISSAI 1:16</i></p> <p>c) "SAI gjithashtu duhet të ketë autoritetin për të raportuar veçanërisht mbi gjetjet më të rëndësishme të vitit." <i>ISSAI 1:16</i></p> <p>d) "SAI-t janë të lirë të përcaktojnë përmbajtjen e raporteve të tyre të auditimit" <i>ISSAI 10: 6</i></p> <p>e) "SAI-t janë të lirë të vendosin kohën e publikimit të raporteve të tyre, përveç kur në ligj janë përcaktuar kërkesat specifike " <i>ISSAI 10: 6.</i></p> <p>f) Gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pasur ndërhyrje në vendimet e SAI-t mbi përmbajtjen e raporteve të auditimit të tij. <i>ISSAI 10: 6</i></p> <p>g) Gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pasur ndërhyrje në përpjekjet e SAI-t për të publikuar raportet e tij të auditimit. <i>ISSAI 10: 6</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a) dhe të paktën katër prej kriterëve të tjera më lart plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 10</p>

Fusha B: Qeverisja e Brendshme dhe Etika

Një nga objektivat e ISSAI 12 është që SAI-et duhet të drejtojnë duke dhënë shembullin e mirë dhe të jenë organizata model. SAI-et duhet të promovojnë transparencën dhe llogaridhënien përmes mirëqeverisjes dhe sjelljes etike, në mënyrë që të përmbushin mandatet e tyre.

SAI mund të ndërmarrë disa hapa për të siguruar një qeverisje të mirë. Ai duhet të adoptojë dhe të veprojë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes, në të gjitha aspektet e punës së tij. Sikundër shprehet ISSAI 20 në pjesën hyrëse të tij: "SAI-et janë (...) përgjegjës për planifikimin dhe realizimin e fushëveprimit të tyre duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për t'u siguruar që, ata vetë promovojnë llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike në përmbushje të mandatit të tyre ligjor edhe përgjegjësitë në mënyrë të plotë dhe objektive". Është e rëndësishme që kjo përgjegjësi është pranuar në mënyrë të qartë në nivel të lartë të menaxhimit dhe është reflektuar në qeverisjen e SAI-t dhe që është ndjekur në të gjithë organizatën.

Kjo fushë mat performancën e përgjithshme të SAI-t në fushën e qeverisjes së brendshme dhe etikës. Ajo kërkon që të jap një kuptim tërësor përpjekjeve, përpjesive dhe dobësive të SAI-t në nivel organizativ. Treguesit që maten në Fushën B pasqyrojnë themelet e SAI-t për kryerjen e aktiviteteve të tij.

Planifikimi afatgjatë dhe afatshkurtër është baza e aktivitetit të një SAI. Përmbajtja e planit strategjik, procesi i zhvillimit të tij, si dhe raportimi mbi performancën e SAI-t përfshihen në SAI-3. Planifikimi i përgjithshëm i aktiviteteve të auditimit trajtohet në SAI-7. Plani i përgjithshëm i auditimit për SAI-n përshkruan auditimet që SAI do të kryejë në një periudhë të caktuar kohe. Ai duhet të jenë në përputhje me mandatin e SAI-t. Plani i përgjithshëm i auditimit mund të jetë i përvitshëm ose një plan auditimi i shtrirë në shumë vite.

ISSAI 20, Parimi 4 thotë se SAI-et duhet të zbatojnë standarde të larta integriteti dhe etike për stafin në të gjithë nivelet. Kontrolli i brendshëm është një parim kryesor për të gjitha operacionet e SAI-t, dhe për këtë arsye, është qendror në shumicën e fushave në KMP të SAI-t. SAI-4 mat elementet thelbësore për sistemin e kontrollit të brendshëm. ISSAI 20, Parimi 5 thekson se SAI-et duhet të sigurohen që këto parime llogaridhënieje dhe transparence nuk kompromentohen kur SAI-et kryejnë auditime me burime të jashtme. Sistemi i SAI-t për respektimin e këtyre parimeve matet përmes SAI-5. Për të siguruar një praktikë me integritet të lartë, organizata duhet t'i komunikojë në mënyrë

të qartë se çfarë pritet nga stafi, si edhe të krijojë një mjedis të karakterizuar nga sisteme të kontrollit të brendshëm funksionale dhe sjellje etike të personelit. Menaxhimi i lartë duhet të promovojë këto standardet duke demonstruar shembullin e duhur nga lidershipi dhe të ndërmarrë iniciativa për të inkurajuar punën cilësore dhe një kulturë të fortë të kontrollit të brendshëm. Këto aspekte janë të mbuluara si në SAI-4 ashtu edhe në SAI-6.

Treguesit e performancës:

SAI - 3: *Cikli i Planifikimit Strategjik;*

SAI - 4: *Mjedisi i Kontrollit Organizativ;*

SAI - 5: *Auditimet me Burime të Jashtme;*

SAI - 6: *Lidershipi dhe Komunikimi i Brendshëm;*

SAI - 7: *Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit.*

Lidhja me fushat e tjera

Meqenëse Fusha B mat kryesisht procedurat dhe praktikat në nivel organizativ (me përjashtim të SAI-5), është e rëndësishme, gjithashtu, që vlerësuesi të verifikojë nëse praktikat aktuale në SAI korrespondojnë me sistemin qendror. Kjo gjë mund të ndihmojë në identifikimin e praktikave më të mira të cilat duhet zbatohen në të gjithë organizatën.

SAI-3: Cikli i Planifikimit Strategjik

Plani strategjik është i rëndësishëm për të siguruar orientimin organizativ, dhe publikimi i tij komunikon synimet e SAI-t për palët e interesit të brendshëm dhe të jashtëm. Planifikimi strategjik duhet të marrë në konsideratë pritshmëritë e palëve të interesit dhe rreziqet, si dhe mjedisin institucional në të cilin vepron SAI, dhe kur është e përshtatshme, masat për të forcuar këtë mjedis. Objektivat e përcaktuara në planin strategjik duhet të përcaktohen në një plan vjetor/operativ për SAI-n.

SAI duhet të vendos sisteme efice dhe efektive, të cilat mundësojnë planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër. Ai, gjithashtu duhet të monitorojë dhe të raportojë për performancën e tij. Në përputhje me terminologjinë e INTOSAI, planifikimi afatgjatë do të referohet si "planifikim strategjik", edhe pse disa SAI mund ta quajnë ndryshe. Planifikimi afatshkurtër i referohet "planifikimit vjetor / planifikimit operacional". Planifikimi operacional i veprimtarisë së SAI-t natyrisht do të përkojë me planin e përgjithshëm të auditimit. Megjithatë, planifikimi i përgjithshëm i auditimit matet me SAI-7. Burimet e të dhënave për matjen e SAI-3 (iii) dhe SAI-7 mund të jenë të njëjta në disa SAI. Analiza e përmbajtjes së planit përkatës është, pra objektivi kryesor në vlerësimin e planeve sipas kriterëve (pavarësisht nëse janë mbledhur ose jo, të gjitha aspektet në një dokument).

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Përmbajtja e Planit Strategjik;*
- (ii) *Përmbajtja e Planit Vjetor/Planit Operacional;*
- (iii) *Procesi i Planifikimit Organizativ;*
- (iv) *Monitorimi dhe Raportimi i Performancës.*

(i) **Përmbajtja e Planit Strategjik:** Procesi i planifikimit strategjik duhet të identifikojë pritshmëritë e së ardhmes që SAI synon të arrijë, të vlerësojë situatën aktuale, të njohë rreziqet, dhe të identifikojë nevojat e zhvillimit të organizatës në bazë të tij. Në bazë të kësaj, ai duhet të përcaktojë se si do të arrihen pritshmëritë e së ardhmes, duke identifikuar një deklaratë misioni afatgjatë dhe objektivat strategjikë, duke marrë parasysh kulturën dhe vlerat e SAI-t. Në mënyrë që SAI të raportojë, zbatojë, monitorojë dhe vlerësojë planin e tij strategjik është e rëndësishme që të ketë vendosur një sistem të matjes së performancës. Për të krijuar një urë lidhëse midis planit strategjik dhe planit vjetor duhet të hartohet një matricë zbatimi ose një dokument i ngjashëm me të.

(ii) Përmbajtja e Planit Vjetor: Për të lehtësuar zbatimin e planit të tij strategjik, SAI duhet të detajojë në nivel operacional objektivat e tij afatgjatë. Plani operacional / plani vjetor përcaktohet si një mjet i përdorur nga organizata për të zbatuar planin e tij strategjik dhe për të ndihmuar në menaxhimin e aktiviteteve të përditshme. Në bazë vjetore, SAI duhet të sigurojë një plan të detajuar për vitin e ardhshëm duke elaboruar mbi projektet, aktivitetet, afatet kohore të planifikuara, si dhe burimet e nevojshme, buxhetin e përafërt, rezultatet, përgjegjësinë për projektet dhe rreziqet e përfshira. Treguesit e performancës duhet të masin rezultatet në vend të aktiviteteve, me fjalë të tjera (p.sh. pasja e 20 audituesve të certifikuar financiarë në SAI) në vend të aktiviteteve që do të zhvillohen (p.sh. kryerja e 2 kurseve të trajnimit mbi certifikimin e auditimit financiar për personelin). SAI duhet të planifikojnë si aktivitetet e lidhura me auditimin, ashtu edhe ato që nuk lidhen me të. Plani mund të marrë një trajtë shumë vjeçare, të tillë si një plan tre-vjeçar, ku viti i parë është planifikuar në mënyrë të detajuar dhe dy vitet e tjera janë planifikuar në mënyrë të përgjithshme. Plani duhet të komunikohet brenda institucionit.

(iii) Procesi i planifikimit: Procesi i planifikimit duhet të ndjekë parimet e qeverisjes së mirë, duke përcaktuar në mënyrë të qartë afatet, hapat, rolet dhe përgjegjësitë. Pronësia nga niveli i lartë menaxherial i SAI-t është thelbësore, por niveli i duhur i pjesëmarrjes nga gjithë organizata çon në një pronësi më të fortë dhe siguron që janë dëgjuar të gjithë palët. Përveç kësaj, konsultimi me palët e interesuara mund të jetë i dobishëm për të siguruar që rëndësia e SAI-t në shoqëri konsiderohet si pjesë e procesit. Në dobi të llogaridhënies, SAI duhet të vendosë planin e vet strategjik në dispozicion të publikut, dhe plani operacional duhet minimalisht të njihet brenda organizatës.

(iv) Monitorimi dhe Raportimi i Performancës: SAI duhet të raportojë publikisht për veprimtarinë dhe performancën e vetë, për të treguar se ka përmbushur mandatin e saj. Raportimi duhet të tregojë performancën e SAI-t kundrejt objektivave të brendshme, vlerën e auditimeve të tij për palët e treta të interesit, dhe ndikimin që puna e tij ka në shoqëri.

SAI - 3 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Përmbajtja e Planit Strategjik	
<p>a) Plani strategjik aktual bazohet në vlerësimin e nevojave që mbulojnë aspekte kryesore të organizimit dhe identifikimin e mangësive ose fushave që kanë nevojë për përmirësime të performancës. <i>Manuali i Planifikimit Strategjik IDI</i></p> <p>b) Plani strategjik përfshin një kornizë rezultatesh, kornizën logjike ose diçka të ngjashme, e cila ka një hierarki logjike të qëllimeve (p.sh. Misioni – Vizioni – qëllimet - objektivat; ose inputet – aktivitetet –outputet – rezultati - ndikimi). <i>Manuali i Planifikimit Strategjik IDI</i></p> <p>c) Plani strategjik përmban një numër të menaxhueshëm të treguesve që masin arritjen e objektivave strategjike të SAI-t (d.m.t.,h. lidhur me produktet e jashtme (raportet), aftësitë e brendshme, komunikimi me grupet e interesit dhe korniza ligjore). <i>Manuali i Planifikimit Strategjik IDI</i></p> <p>d) Plani strategjik plotësohet me matricë të implementimit ose dokument të ngjashëm, i cili identifikon dhe i jep prioritet projekteve që duhet të ndërmerren për të arritur qëllimet dhe objektivat e planit strategjik, dhe që identifikon rreziqet për arritjen e tij. <i>Manuali i Planifikimit Strategjik IDI</i></p> <p>e) "Pritshmëritë e palëve të interesit dhe rreziqet e reja janë përcaktuar në planet strategjike, sipas rastit". <i>ISSAI 12:5</i></p> <p>f) Plani strategjik aktual bazohet në vlerësimin e kuadrit institucional (d.m.th., praktikat formale dhe joformale që qeverisin veprimtarinë e SAI-t, si dhe sistemet kombëtare të qeverisjes, politikat ekonomike dhe menaxhimit financiar publik) në të cilin SAI vepron, dhe kapacitetin aktual të palëve kryesore të interesit për të përdorur raportet e SAI-t. <i>Manuali i Planifikimit Strategjik IDI</i></p> <p>g) Kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, plani strategjik përfshin masa për forcimin e mjedisit institucional të SAI-t.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p style="text-align: center;">ISSAI 12</p> <p style="text-align: center;">Udhëzimi i IDI-t për planifikimin strategjik për SAI.</p>

<p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Përmbajtja e planit Vjetor/Planit Operacional</p>	
<p>Një plan vjetor efektiv duhet të përmbajë:</p> <p>a) Aktivitete të përcaktuar qartë, afatet, dhe përgjegjësitë.</p> <p>b) Mbulimi i të gjitha shërbimeve kryesore mbështetëse të SAI-t, si menaxhimi financiar, BNJ dhe trajnimet, IT dhe infrastruktura, etj.</p> <p>c) Lidhje të qartë me planin strategjik.</p> <p>d) Plani vjetor përmban ose është i lidhur me një buxhet, dhe ka prova se janë marrë në konsideratë burimet e nevojshme për të përfunduar aktivitetet e planifikuara.</p> <p>e) Një vlerësim i riskut të lidhur me arritjen e objektivave të planit.</p> <p>f) Tregues të matshëm në nivel produkti dhe rezultati.</p> <p>g) Nivelet bazë të matjes së performancës aktuale dhe piketat për treguesit kryesorë.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>IDI Manual për Planifikimin Strategjik për Institucionet Supreme të Auditimit</p>
<p>Dimensioni (iii) Procesi i Planifikimit Organizativ (Zhvillimi i Planit Strategjik dhe Planit vjetor/funksional)</p>	
<p>Një proces efektiv i planifikimit organizativ kërkon:</p> <p>a) Zotërimi i procesit nga niveli i lartë: Drejtuesi i SAI-t dhe niveli menaxherial janë të përfshirë në vetë procesin.</p>	<p>ISSAI 20</p>

<p>b) Pjesëmarrja: mundësia e të gjithë personave brenda organizatës për të dhënë input në planifikimin organizativ.</p> <p>c) Një numër i përshtatshëm i palëve të treta të interesit konsultohen si pjesë e procesit.</p> <p>d) Komunikimi: ka komunikim efektiv të planeve organizative për çdo individ brenda organizatës.</p> <p>e) Plani strategjik është vendosur në dispozicion të publikut. <i>ISSAI 20:2</i></p> <p>f) Ekziston një proces për monitorimin vjetor të progresit kundrejt Planit strategjik dhe planit vjetor/operacional.</p> <p>g) Planifikimi i planit: janë përcaktuar qartë përgjegjësitë, veprimet dhe afatet për zhvillimin e planeve organizative.</p> <p>h) Vazhdimësia: plani i fundit strategjik ishte në fuqi deri në momentin që periudha e mëparshme e planifikimit strategjik kishte përfunduar.</p> <p>i) Procesi i planifikimit organizativ është vlerësuar për të siguruar të dhëna për procesin e ardhshëm të planifikimit.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën shtatë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p>IDI Manual për Planifikimin Strategjik për Institucionet Supreme të Auditimit</p>
<p>Dimensioni (iv) Monitorimi dhe Raportimi i Performancës</p>	
<p>Lidhur me matjen dhe raportimin mbi performancën e SAI-t:</p> <p>a) "SAI vlerëson dhe raporton mbi aktivitetet dhe performancën e tij në të gjitha fushat (...)." <i>ISSAI 20:6 (përfshirë një rishikim përmbledhës të performancës së SAI kundrejt strategjisë dhe objektivave vjetore të tij).</i></p>	<p>ISSAI 12</p> <p>ISSAI 20</p>

<p>b) SAI-et përdorin treguesit e performancës për të matur arritjen e objektivave të brendshme. <i>Manuali IDI për Planifikimin Strategjik, kapitulli 9.</i></p> <p>c) "SAI-t mund të përdorin treguesit e performancës për të vlerësuar vlerën e punës audituese për Parlamentin, qytetarët dhe palët e tjera të interesit" <i>ISSAI 20:6 (d.m.th., përcaktimi i treguesve të përshtatshme për palët specifike të interesit, apo matja e kënaqësisë së palëve të interesuara).</i></p> <p>d) "SAI ndjek shikueshmërinë e vetë publike, rezultatet dhe ndikimin përmes reagimeve të jashtme" <i>ISSAI 20:6.</i></p> <p>e) Kur është e përshtatshme, "SAI ... boton statistikatat e matjes së ndikimit të auditimeve të veta, të tilla si kursimet dhe përfitimet efikase të programeve të qeverisë." <i>INTOSAI Udhëzuesi mbi Komunikimin dhe Promovimin e vlerës dhe përfitimeve të SAI-ve, fq. 8</i></p> <p>Përveç raportimit vjetor të performancës së SAI-t:</p> <p>f) "SAI raporton publikisht rezultatet e rishikimeve nga kolegët dhe vlerësimet e jashtme të pavarura" <i>ISSAI 20:9.</i></p> <p>g) SAI-t bëjnë publike standardet e auditimit dhe metodologjinë kryesore të auditimit që zbatohen. <i>ISSAI 12: 8.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>IDI Manual për Planifikimin Strategjik për Institucionet Supreme të Auditimit</p> <p>INTOSAI Udhëzuesi mbi Komunikimin dhe Promovimin e vlerës dhe përfitimeve të SAI-ve</p>
---	---

SAI-4: Mjedisi i Kontrollit Organizativ

SAI duhet të vendosë sistemin e kontrollit të brendshëm i cili të ofrojë siguri të arsyeshme që SAI menaxhon veprimtarinë e tij me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret (INTOSAI GOV 9100). Më tej, SAI duhet të vendosë sistemin e kontrollit të cilësisë që të sigurojë cilësinë në të gjithë punën e tij (ISSAI 40). Megjithatë, ky sistem nuk duhet të kufizojë pavarësinë e magjistratëve në SAI-t gjyqësore, ose audituesve në SAI-t e tjera gjatë auditimeve të tyre.

Kontrolli i brendshëm përcaktohet me planet e organizatës, duke përfshirë qasjen e menaxhimit, metodat, procedurat dhe masat e tjera që merren me qëllim zbatimin e parimeve të tij. Gjithkush në një organizatë mban përgjegjësi deri në një farë mase për kontrollin e brendshëm. Sistemi i kontrollit të brendshëm përcaktohet dhe përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur: 1) mjedisi i kontrollit, 2) vlerësimi i riskut, 3) aktivitetet e kontrollit, 4) informimi dhe komunikimi, 5) monitorimi. *Mjedisi i kontrollit* është themeli për sistemin e kontrollit të brendshëm dhe siguron disiplinën, strukturën dhe kulturën që ndikojnë në përgjithësi në cilësinë e kontrollit të brendshëm. Me vendosjen e një mjedisi efektiv kontrolli, *vlerësimi i risqeve*, me të cilat përballet organizata gjatë veprimtarisë për përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj, siguron bazat për zhvillimin e një përgjigjeje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Strategjia kryesore për zvogëlimin e risqeve realizohet nëpërmjet *aktiviteteve të kontrollit*, që mund të jenë parandaluese dhe/ose zbuluese. Për njësinë ekonomike për të drejtuar dhe kontrolluar operacionet e saj, *informacioni dhe komunikimi* efektiv janë jetike. Së fundmi, është i nevojshëm *monitorimi* i sistemit i kontrollit të brendshëm për t'u siguruar që ky sistem i qëndron ndryshimit të objektivave, mjedisit, burimeve dhe risqeve (INTOSAI GOV 9100).

Cilësia e punës së kryer nga SAI-et ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre, e në fund të fundit, në mënyrën se si ata përmbushin mandatin e tyre. Si një objektiv kryesor, çdo SAI duhet të marrë në konsideratë risqet lidhur me cilësinë e punës, duke krijuar një sistem të kontrollit të cilësisë, i cili hartohet për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme atyre. Mbajtja e një sistemi të kontrollit të cilësisë kërkon monitorim dhe një angazhim në vijimësi për përmirësim të vazhdueshëm (ISSAI 40, fq. 4). Dimensioni (iii) mbulon aspektet organizative të cilësisë së auditimit që funksionojnë në të gjithë SAI-n. Kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer shpjegohet në Fushën C përmes treguesve përkatës për secilin lloj auditimi. Sigurimi i cilësisë së auditimit shpjegohet në

dimensionin (iv). Dallimi në mes të kontrollit të cilësisë dhe sigurimin e cilësisë shpjegohet në dimensionin (iii) dhe (iv). ISSAI 40 Kontrolli i cilësisë për SAI-et përdoret si referencë për këtë tregues.

Dimensione për t'u vlerësuar:

(i) Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm - Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative;

(ii) Sistemi i Kontrollit të Brendshëm;

(iii) Sistemi i Kontrollit të Cilësisë;

(iv) Sistemi i Sigurimit të Cilësisë.

(i) Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm: - Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative: Kodi i Etikës është një deklaratë e plotë e vlerave dhe parimeve të cilat e udhëheqin punën e përditshme të audituesve për të siguruar që sjellja e tyre është e paqortueshme në të gjitha kohët dhe në të gjitha rrethanat (ISSAI 30). Ai duhet të qartësojë kriteret etike për audituesit. Gjithashtu, ky kod nuk duhet të jetë një dokument i vetëm, por duhet të ekzistojë në një formë e cila siguron që personeli, si dhe palët e jashtme, kanë njohuri të mjaftueshme për përmbajtjen e tij. Kodi i Etikës i INTOSAI-t (ISSAI 30) synon të përbëjë bazën për çdo Kod tjetër etike të hartuar nga çdo SAI. Konceptet kryesore në ISSAI 30 janë integriteti, pavarësia dhe objektiviteti, kompetenca, sjellja profesionale, konfidencialiteti dhe transparenca.

(ii) Sistemi i kontrollit të brendshëm: Sistemet e kontrollit të brendshëm janë të rëndësishme për të gjitha operacionet e SAI-eve prandaj edhe përbëjnë thelbin në shumicën e fushave të KMP të SAI-t. Ai është e pamundur të matet me një tregues të një fushe të vetme. Fusha (i) i SAI-4 përfshin disa pjesë të rëndësishme të një mjedisi të kontrollit që duhet të ekzistojë në mënyrë që SAI të ketë kontroll të brendshëm efektiv; kodi i etikës dhe integritetit, struktura organizative dhe qartësi mbi përgjegjësinë dhe linjat e raportimit. Fusha (ii) i SAI-4 nënvizon elementet thelbësore të nivelit të lartë të sistemit të SAI- t për menaxhimin e riskut dhe kontrollit.

(iii) Kontrolli i cilësisë së procesit të auditimit përshkruan tërësinë e masave të marra për të siguruar cilësi të lartë të çdo produkti të auditimit. Kontrolli i cilësisë kryhet si pjesë e integruar e procesit të auditimit. Që sistemi i kontrollit të cilësisë të jetë efektiv ai duhet të jetë pjesë e strategjisë, kulturës, politikave dhe procedurave të një SAI. Në këtë mënyrë, cilësia duhet të ngulitet në punën e një SAI dhe në prodhimin e raporteve të tij.

Në pjesën më të madhe të SAI-eve me funksione gjyqësore, të cilat shpesh veprojnë sipas një procedure kolegjiale, kanë një numër mekanizmash të integruar në nivelet operacionale të SAI-t dhe në kornizën normative të cilat kontribuojnë në cilësi. Zyra e prokurorit publik që vepron së bashku me SAI luan një rol të rëndësishëm në kontrollin e cilësisë. Zakonisht, mbikëqyrja nga një prokuror publik ose Kryeprokurori, ka si rol kryesor të sigurojë që ligji zbatohet siç duhet, duke filluar nga zbatimi i tij nga vetë SAI: Kjo siguron që auditimet/kontrollet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat në fuqi.

Për më tepër, kur autorizohet nga dispozitat që qeverisin SAI-n, emërimi i një personi të ngarkuar me kontrollin e cilësisë, për shembull, një gjyqtar "i lartë" i cili shqyrton cilësinë e auditimit/ kontrollit dhe rezultatet e tij përpara publikimit të tij shërben si një tjetër element i kontrollit të cilësisë të integruar, ose emërimi i një zyrtari "i lartë" (zakonisht në nivel drejtori) si mbikëqyrës për çdo punë audituese/ kontrolli dhe i ngarkuar me kontrollin e procedurat kryesore të kontrollit të cilësisë. Së fundi, ekzaminimi kolegjial i raportit të kontrollit dhe më pas miratimi i tij, ofron garancinë e një shqyrtimi të përbashkët, nga anëtarë me eksperiencë, të procesit të auditimit dhe përmbajtjes së raportit përfundimtar.

(iv) Sigurimi i cilësisë është një vlerësim periodik i procesit të auditimit. Ai është një proces monitorimi i hartuar për t'i ofruar SAI-t siguri të arsyeshme që politikat dhe procedurat lidhur me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të rëndësishme, të përshtatshme dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Sigurimi i cilësisë duhet të kryhet nga individët të pavarur (d.m.th. nuk kanë marrë pjesë në procesin e auditimit që po rishikojnë). Procesi i sigurimit të cilësisë duhet të përfshijë një rishikim të një kampioni të përzgjedhur nga auditimet e përfunduara të SAI-t.

Sigurimi i cilësisë mund të bëhet përmes mekanizmave të ndryshëm procedurale, si pjesë e ***një qasjeje të integruar të menaxhimit të cilësisë***, siç përcaktohet më sipër. Në SAI-et me funksione gjyqësore, zyra e prokurorit publik luan një rol të rëndësishëm në procesin e sigurimit të cilësisë. Zyra nuk merr pjesë në asnjë nga procedurat e auditimit dhe të kontrollit. Shumica e punës së kryer nga SAI i paraqitet prokurorit publik. Zyra e prokurorit publik paraqet një opinion mbi respektimin e procedurave, normat (kohën, transparencën, arsyetimin) dhe mbi përmbajtjen e rezultateve të hetimit. Në SAI-et gjyqësore, autorët e raporteve të auditimit/kontrollit mbeten "mjeshtrat" e propozimeve të shprehura në raportet e tyre, ndërsa SAI (organi vendimmarrës) ka "fjalën e fundit" në përmbajtjen e raporteve të auditimit/kontrollit dhe natyrën e çdo veprimi tjetër që do të ndërmerret si pasojë e tyre.

SAI - 4 Dimensione & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Mjedis i Kontrollit të Brendshëm - Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative	
<p>Për të nxitur sjellje etike dhe një mjedis të fortë kontrolli, SAI duhet:</p> <p>a) Të ketë një kod etike. (<i>ISSAI 10:3, ISSAI 30.</i>)</p> <p>b) Kodi i etikës përcakton "rregullat apo kodet etike, politikat dhe praktikat që janë në përputhje me ISSAI 30." <i>ISSAI 20:4.</i> Si minimum ai duhet të përmbajë kriteret të cilat adresojnë "integritetin, pavarësinë dhe objektivitetin, kompetencat, sjelljen profesionale, konfidencialitetin dhe transparencën" e audituesve. <i>ISSAI 30; fq. 5.</i></p> <p>c) Të rishikojë kodin e etikës së paku çdo dhjetë vjet për të siguruar përputhshmërinë me ISSAI 30.</p> <p>d) Ti "kërkojë të gjithë stafit që gjithmonë të ketë sjellje në përputhje me vlerat dhe parimet e shprehura në kodin e etikës, dhe [...] të ofrojë udhëzime dhe mbështetje për të lehtësuar kuptimin e tyre." <i>ISSAI 30:12</i></p> <p>e) Ti "kërkojë çdo personi fizik/juridik që kontraktin për të kryer punën në emër të tij të pranojë dhe të zbatojë kërkesat e kodit etik." <i>ISSAI 30:12</i></p> <p>f) Të vendosë në dispozicion të publikut kodin etik. <i>ISSAI 30:12</i></p> <p>g) Të "zbatojë një sistem të kontrollit të etikës për të identifikuar dhe analizuar risqet etike, për t'i minimizuar ato, për të mbështetur sjelljen etike, dhe për të trajtuar çdo shkelje të vlerave etike, duke përfshirë edhe mbrojtjen e atyre që raportojnë veprime të gabuara të dyshuara." <i>ISSAI 30:12</i></p> <p>h) Të ketë një strukturë organizative të miratuar dhe të zbatuar; dhe "të sigurojë që përgjegjësia është caktuar në mënyrë të qartë për të gjithë punën e kryer nga SAI" <i>ISSAI 40: fq. 10</i></p> <p>i) Të ketë përshkrime të qarta të punës që mbulojnë përgjegjësitë kryesore të gjithë organizatës. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>j) Të sigurohet që stafi i ka të qarta detyrat dhe linjat e raportimit. <i>INTOSAI GOV 9100: fq. 19-20</i></p> <p>k) Të ketë vlerësuar cenueshmërinë dhe elasticitetin e tij ndaj shkeljeve të integritetit, përmes përdorimit të mjeteve si IntoSAINT ose të tjera të ngjashme, gjatë pesë viteve të fundit. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t.</i></p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p> <p>ISSAI 30</p> <p>INTOSAI GOV 9100</p> <p>IntoSAINT</p>

<p>l) Të "zbatojë standarde të larta të integritetit (...) për personelin në të gjitha nivelet", duke miratuar politika integriteti bazuar në një vlerësim duke përdorur IntoSAINT ose një mjet tjetër të ngjashëm. <i>ISSAI 20:4</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a), (b), (c), (d), (g) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (a), (d), (g) dhe të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Kriteri (a), (d), (g) plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Kriteri (a), (d), (g) nuk plotësohen.</p>	
<p>Dimensionii (ii) Sistemi i Kontrollit të Brendshëm</p>	
<p>Për të promovuar kontrollin e brendshëm efektiv brenda tij, SAI duhet:</p> <p>a) Të ketë një sistem funksional e të përcaktuar qartë për të identifikuar, minimizuar dhe monitoruar risqet operacionale kryesore. <i>INTOSAI GOV 9100.</i></p> <p>b) Të sigurojë që politikat dhe procedurat e kontrollit të brendshëm dokumentohen dhe zbatohen në mënyrë të qartë. <i>INTOSAI GOV 9100: Kap. 2.3-2.5</i></p> <p>c) Të mbajë një proces vjetor për drejtuesit e të gjitha departamenteve/njësive të SAI-t që të ofrojë siguri që ata kanë përmbushur detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e riskut. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t.</i></p> <p>d) Të sigurojë që drejtuesi i SAI-t nënshkruan deklaratën e kontrollit të brendshëm, e cila publikohet si pjesë e raportit vjetor të SAI-t. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>e) Të ketë ndërmarrë një rishikim të sistemit të kontrollit të brendshëm brenda pesë viteve të fundit dhe të raportojë mbi të. <i>INTOSAI GOV 9100: Kap. 2.5</i></p> <p>f) Të caktojë qartësisht përgjegjësinë për auditimin e brendshëm dhe të sigurohet që personeli i ngarkuar me këtë përgjegjësi të ketë mandatin e duhur, aftësitë, përvojën dhe burimet e nevojshme për këtë punë. <i>ISSAI 40: fq. 9; INTOSAI GOV: fq. 18, 41.</i></p>	<p style="text-align: center;">ISSAI 40</p> <p>INTOSAI GOV 9100, e bazuar në kornizën e integruar COSO për kontrollin e brendshëm</p>

<p>g) Të sigurojë se audituesit e brendshëm janë të pavarur nga menaxhimi dhe raportojnë direkt në nivelin më të lartë të autoritetit në organizatë (p.sh një Komitet Auditimi, një komitet me një funksion të ngjashëm, apo drejtuesit të SAI-t.) <i>INTOSAI GOV: fq. 45 (Për SAI-n me funksione gjyqësore: kur pikëzohet ky kriter, për shkak të pavarësisë së gjyqtarit, duhet të merren parasysh aspektit të kufizuar të hierarkisë dhe integritit të sistemit të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë,).</i></p> <p>h) Të ketë një sistem për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i brendshëm dhe Komiteti i Auditimit (ose komiteti me funksion të ngjashëm, apo drejtuesi i SAI-t). <i>INTOSAI GOV 9100: Kap. 2.5.</i></p> <p>i) Të ketë një procedurë njoftimi për punonjësit për të raportuar shkeljet e dyshuara ("sinjalizuesit").</p> <p>j) Të hartojë dhe të zbatojë një politikë për qarkullimin në pozicionet e punës për të menaxhuar sa më mirë të jetë e mundur konfliktin e interesit. <i>INTOSAI GOV 9100: fq. 2</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a), (c), (e) dhe të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (iii) Sistemi i Kontrollit të Cilësisë</p>	
<p>SAI ka vendosur një sistem të kontrollit të cilësisë për të gjithë punën e tij (veprimtari audituese dhe jo-audituese, për shembull procedurat e prokurimit), të cilat kanë karakteristikat e mëposhtme:</p> <p>a) "Një SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për të promovuar (...) cilësinë, si thelbësore në kryerjen e të gjithë punës së tij." <i>ISSAI 40: fq. 5.</i></p> <p>b) Politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë janë hartuar në mënyrë të qartë dhe "(...) Kryetari i SAI-t (...) mban përgjegjësi të plotë për sistemin e kontrollit të cilësisë." <i>ISSAI 40: fq. 5.</i></p>	<p>ISSAI 40, e cila është e bazuar në Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë (ISQC)</p>

<p>c) "Kryetari i SAI-t mund të delegojë autoritetin për menaxhimin e sistemit të kontrollit të cilësisë së SAI-t tek një person apo disa persona [individualisht ose kolektivisht] me përvojën e mjaftueshme dhe të duhur për të kryer atë funksion." <i>ISSAI 40: fq. 5 (d.m.th., personat përgjegjës për kontrollin e cilësisë kanë aftësitë e duhura).</i></p> <p>d) SAI ka "(...) krijuar sisteme që marrin në konsideratë risqet për cilësinë që lindin nga kryerja e punës " <i>ISSAI 40: fq. 8</i></p> <p>e) "SAI-t duhet të marrë në konsideratë programin e tyre të punës dhe nëse ata kanë burime të mjaftueshme për të ofruar punë audituese në nivelin e dëshiruar të cilësisë. Për të arritur këtë, SAI-t duhet të kenë një sistem për të përcaktuar përparësitë e punës në një mënyrë që merr parasysh nevojën për të ruajtur cilësinë." <i>ISSAI 40: fq. 8.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (iv) Sistemi i Sigurimit të Cilësisë</p>	
<p>Sistemi i Sigurimit të Cilësisë së SAI-t/monitorimi i sistemit të tij të kontrollit të cilësisë duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:</p> <p>a) Të "Përfshijë një shqyrtim dhe vlerësim të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të cilësisë së SAI - t, duke përfshirë një rishikim të një kampioni të punës së përfunduar nga tërësia e auditimeve të kryera nga SAI" <i>ISSAI 40: fq. 13. (d.m.th., shqyrtimi i një kampioni sipas të gjitha llojeve të auditimeve/kontrolleve të kryera nga SAI)</i></p> <p>b) Kanë procedura të shkruajtura dhe/ose planet për sigurimin e cilësisë të cilat specifikojnë frekuencën me të cilën duhet të bëhen rishikimet e sigurimit të cilësisë dhe sigurimet e cilësisë janë kryer në përputhje me frekuencat e përcaktuara në këtë plan. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t.</i></p> <p>c) "(...) Përgjegjësia për procesin e monitorimit të sigurimit të cilësisë i caktohet një individ ose individëve me përvojë të</p>	<p>ISSAI 40</p>

<p>mjaftueshme, të përshtatshme dhe me autoritetin e duhur në SAI për të përmbushur këtë përgjegjësi" ISSAI 40: fq. 13</p> <p>d) Rishikimet e sigurimit të cilësisë rezultojnë në konkluzione të qarta dhe, kur është e përshtatshme, në rekomandime të duhura për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese për mangësitë e evidentuara. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>e) Ka evidenca se Kryetari i SAI-t ka analizuar rekomandimet që rezultojnë nga rishikimi të sigurimit të cilësisë së auditimeve dhe ka nxjerrë konkluzionet e duhura. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>f) "(...) ata që kryejnë sigurimin e cilësisë janë të pavarur (d.m.th., ata nuk kanë marrë pjesë në punë ose në ndonjë rishikim të kontrollit të cilësisë së punës)" ISSAI 40: fq. 13. <i>(Pavarësia shtrihet edhe në përzgjedhjen e auditimeve që do të jenë objekt i shqyrtimit. Për SAI-et gjyqësore: merren në konsideratë specifikat e modelit gjyqësor të SAI-t, dhe në veçanti Zyra e Prokurorit Publik,)</i></p> <p>g) "(...) rezultatet e monitorimit të sistemit të kontrollit të cilësisë raportohen te drejtuesi i SAI-t në kohën e duhur." ISSAI 40: fq. 13 <i>(d.m.th. brenda një muaji nga momenti i përfundimit të rishikimit).</i></p> <p>h) "(...) SAI-et mund të konsiderojnë angazhimin e një SAI tjetër, ose organ tjetër të përshtatshëm, për të kryer një shqyrtim të pavarur të sistemit të përgjithshëm të kontrollit të cilësisë (si një peer review – rishikim nga kolegët)" ISSAI 40: fq. 13 <i>(duke përfshirë edhe aktivitete jo-audituese).</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a) dhe së paku pesë prej kriterëve të tjera plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Sigurimi i Sistemit të Cilësisë SAI-t/monitorimi i sistemit të kontrollit të cilësisë mbulon pjesët më të rëndësishme, (sipas gjykimit profesional të vlerësuesit), të punës audituese të SAI-t, dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Sigurimi i Sistemit të Cilësisë së SAI/ monitorimi i sistemit të kontrollit të cilësisë mbulon një kampion të punës së kryer të auditimit, dhe të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
--	--

SAI-5: Auditimet me Burime të Jashtme

Korniza ligjore e SAI-t mund të lejojë kontraktimin e audituesve të jashtëm. Për të mundësuar që SAI-et me kapacitete të kufizuara të përfundojnë auditimet e tyre në kohën e duhur, kryerja e disa auditimeve me burime të jashtme mund të jetë një alternativë për të përmbushur mandatin e tyre. Megjithatë, SAI mbetet institucioni përgjegjës për auditimet dhe për rezultatet e punës së kontraktuar. Prandaj, siç përcaktohet edhe në ISSAI 40, SAI i cili kontraktin punën audituese duhet të marrë në konsideratë risqet që lidhen me cilësinë e punës së tyre. Ky tregues në mënyrë të veçantë vlerëson procedurat dhe praktikat të vendosura brenda SAI-t, i cili kontraktin disa aspekte të punës së tij me burime të jashtme, me qëllim garantimin e cilësisë së këtyre auditimeve. Treguesi përfshin auditimet që kryen plotësisht me burime të jashtme. Auditimet pjesërisht me burime të jashtme përfshihen në (d.m.th., analiza specifike që kërkojnë ekspertizë të jashtme), janë të Fushën C.

SAI duhet të vendosë një sistem për të siguruar që puna e kryer nga palët e kontraktuara është e cilësisë së kërkuar. Është thelbësore që SAI të ketë procedura të përshtatshme si për përzgjedhjen burimeve kontraktore, ashtu edhe për kontrollin e cilësisë së punës së auditimit të kryer nga ana e tyre në emër të SAI-t. Për më tepër, puna e auditimit e kryer me burime të jashtme duhet të përfshihet në sistemin e SAI-t për rishikimin e sigurimit të cilësisë për të siguruar se cilësia dhe procedurat e kontrollit janë zbatuar.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) Procesi për Përzgjedhjen e Audituesve të Kontraktuar;***
- (ii) Kontrolli i Cilësisë së Auditimeve me Burime të Jashtme;***
- (iii) Sigurimi i Cilësisë së Auditimeve me Burime të Jashtme.***

(i) Procesi për përzgjedhjen e audituesve të kontraktuar është një proces prokurimi me risk të lartë. Për këtë arsye kërkon politika dhe procedura të shëndosha që sigurojnë që audituesit e kontraktuar zbatojnë kërkesat etike të SAI-t, janë kompetent dhe nuk kanë ndonjë konflikt interesi me subjektet e audituara. Procesi i përzgjedhjes duhet të përfshijë një vlerësim të sistemit të kontrollit të cilësisë së organizatës së audituesit të kontraktuar.

(ii) Kontrolli i cilësisë së auditimeve me burime të jashtme duhet të jetë i një rëndësie të barabartë me atë të auditimeve me burime të vetë SAI-t, si dhe pjesë e integruar e sistemit të SAI-t për kontrollin e cilësisë. SAI duhet të identifikojë risqet e mundshme të

cilësisë së auditimeve me burime të jashtme, të marrë të gjitha dokumentet relevante të punës që janë pjesë e punës së auditimit, dhe të sigurohet që audituesi i kontraktuar zbaton procedurat e kontrollit të cilësisë të nevojshme, në përputhje me standardet e zbatueshme. SAI gjithashtu duhet të ketë procedura mbi publikimin e raporteve të hartuara nga audituesit e kontraktuar.

(iii) Sigurimi i cilësisë së auditimeve me burime të jashtme: duke qenë se kontraktimi i punës së auditimit paraqet risk për cilësinë e rezultateve, është e rëndësishme që ekzistojë një sistem për sigurimin e cilësisë që vlerëson sistemin e kontrollit të cilësisë për auditimet me burime të jashtme. Duhet të ekzistojnë procedura që lejojnë vlerësimin e rregullt dhe monitorimin me përgjegjësi të përcaktuara qartë. Sigurimi i cilësisë duhet të kryhet nga persona të pavarur dhe rezultatet duhet të orientojnë drejt rekomandimeve të përshtatshme që duhet të ndiqen nga menaxhimi i SAI-t, përfshirë këtu edhe ndryshime në procedura apo kontrata, nëse këto janë rekomanduar.

Qasja e sugjeruar për vlerësimin

Ekipi vlerësues duhet të marrë në konsideratë parimet e përcaktuara për përzgjedhjen e audituesve të kontraktuar. Gjithashtu duhet të përcaktojë nëse këto janë zbatuar në praktikë, duke rishikuar një kampion të proceseve për zgjedhjen e audituesve të kontraktuar.

Për të vlerësuar sistemin e SAI-t për kontrollin e cilësisë së auditimeve me burime të jashtme, grupi i vlerësimit duhet të shqyrtojë parimet dhe standardet e zbatueshme, si dhe një kampion të dosjeve të auditimeve me burime të jashtme për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre me standardet dhe parimet.

Për të rishikuar sistemin e SAI-t për sigurimin e cilësisë së auditimeve me burime të jashtme, grupi duhet të rishikojë parimet dhe standardet e zbatueshme për sigurimin e cilësisë së tyre, si dhe se si këto zbatohen në praktikë. Përveç kësaj, ekipi duhet të shqyrtojë aftësitë dhe përvojën e rishikuesve të sigurimit të cilësisë (SC), si edhe rezultatet e shqyrtimeve të tyre (d.m.th., raportet ose prezantimet). Letra, minutat e takimeve, ndryshimet në standardet e zbatueshme gjatë auditimit përkatës pas shqyrtimeve të rishikuesit të sigurimit të cilësisë mund të konsiderohen si evidenca se audituesi i kontraktuar ka marrë në konsideratë dhe/ose vepruar sipas rekomandimeve të rishikuesit të sigurimit të cilësisë së SAI-t.

SAI -5 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Procesi për Përzgjedhjen e Audituesve të Kontraktuar	
<p>SAI duhet të hartojë politika dhe procedura për përzgjedhjen e audituesve të kontraktuar. Sistemi siguron që:</p> <p>a) SAI ka siguri të arsyeshme që çdo palë e kontraktuar për të kryer punë për SAI-n ka kompetencën dhe aftësitë e nevojshme për "(...) të kryer punën e saj në përputhje me standardet përkatëse dhe të zbatueshme ligjore e rregullatore; për të mundur SAI-n të nxjerrë raporte që janë të përshtatshme sipas rrethanave". <i>ISSAI 40: fq. 9.</i></p> <p>b) SAI ka "(...) siguri të arsyeshme që (...) çdo palë e kontraktuar kryen punë audituese për SAI-n në përputhje me kërkesat etike përkatëse" <i>ISSAI 40: fq. 6. (dmth integriteti, pavarësia, sekretit profesional, kompetenca dhe transparencja).</i></p> <p>c) "(...) Çdo palë e kontraktuar për të kryer punë për SAI-n ka njohuri të përshtatshme për mjedisin e sektorit publik në të cilin vepron SAI, dhe një kuptim të mirë të punës që atyre u kërkohet të kryejnë për llogari të SAI-t" <i>ISSAI 40: fq 10.</i></p> <p>d) "(...) Çdo palë e kontraktuar për të kryer punë për SAI-n i nënshtrohet marrëveshjeve të konfidencialitetit" <i>ISSAI 40: fq 7 (d.m.th., duke përfshirë këtu edhe kërkesa të nënshkruara).</i></p> <p>e) "SAI-et duhet të kenë politika dhe procedura që përforcojnë rëndësinë e qarkullimit të personelit kyç të auditimit, aty ku duhet, për të zvogëluar riskun e familjarizimit të tepërt me organizatën që auditohet. SAI mund të marrë në konsideratë masa të tjera për të zvogëluar riskun e familjaritetit" <i>ISSAI 40: fq 7 (d.m.th., duke vendosur një kufi maksimal të viteve që një auditues i jashtëm mund të auditojë të njëjtin subjekt, duke përfshirë kërkesat e pavarësisë në kontratat e shkruara).</i></p> <p>f) standardet e auditimit të SAI-t, si dhe "(...) politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë komunikohen në mënyrë të qartë tek (...) çdo pale të kontraktuar për të kryer punën për SAI-n" <i>ISSAI 40: fq 6; ISSAI 40: fq 11.</i></p> <p>g) "(...) SAI-t duhet të kërkojnë konfirmim se firmat e kontraktuara kanë ngritur sisteme për kontrollin e cilësisë" <i>ISSAI 40: fq. 13. (d.m.th. vlerëson sistemin</i></p>	<p>ISSAI 40</p> <p>ISQC 1</p>

<p><i>e kontrollit të cilësisë së audituesit të kontraktuar. Rrjedh nga ISQC1: 32 dhe 33.)</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a), (b) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Kontrolli i Cilësisë së Auditimeve me Burime të Jashtme</p>	
<p>SAI ka një sistem për kontrollin e cilësisë së auditimeve me burime të jashtme.</p> <p>a) Sistemi i SAI-t për kontrollin e cilësisë për auditimet me burime të jashtme përfshin të gjithë punën audituese të kryer në këtë mënyrë, si dhe siguron se firma e kontraktuar zbaton procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë auditimit me qëllim sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërinë me standardet e zbatueshme. <i>Rrjedh nga ISSAI 40: fq. 11, Grupi i Punës KMP e SAI-t.</i></p> <p>b) Sistemi i kontrollit të cilësisë për auditimet me burime të jashtme bazohet në vlerësimin e riskut të cilësisë së punës audituese që kryhet me burime të jashtme duke iu përgjigjur këtyre risqeve në mënyrë të përshtatshme. <i>ISSAI 40: fq. 8.</i></p> <p>c) "SAI duhet të sigurojë që i gjithë dokumentacioni (si letrat e punës së auditimit) është pronë e SAI-t, pavarësisht nëse puna është kryer nga SAI apo personeli i kontraktuar" <i>ISSAI 40: fq. 12 (d.m.th. duke përfshirë këto kërkesa në kontratat me shkrim).</i></p> <p>d) "(...) Ka procedura për autorizimin e raporteve që do të hartohen." <i>ISSAI 40: fq. 11, 12 (d.m.th. të kryhet kontrolli i cilësisë së projektraportit.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (d) dhe të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (d) dhe të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p>	<p>ISSAI 40</p>

<p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (iii) Sigurimi i Cilësisë së Auditimeve me Burime të Jashtme</p>	
<p>SAI duhet të ketë një sistem për monitorimin e sistemit të kontrollit të cilësisë për auditimet me burime të jashtme (<i>sigurimi i cilësisë</i>). ISSAI 40: fq. 12.</p> <p>a) Ka procedura dhe/ose plane të shkruara për sigurimin e cilësisë së auditimeve me burime të jashtme. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i>.</p> <p>b) Procesi i sigurimit të cilësisë "përfshin vlerësime të vazhdueshme të sistemit të kontrollit të cilësisë së SAI-t, si edhe një rishikim të një kampioni të punës së përfunduar nga e gjithë puna e kryer nga SAI" ISSAI 40: fq. 13 (d.m.th, <i>procesi i sigurimit të cilësisë përfshin shqyrtimin e një kampioni të auditimeve me burime të jashtme</i>).</p> <p>c) "(...) përgjegjësia për procesin e monitorimit të sigurimit të cilësisë i caktohet një individ apo individëve me përvojë dhe autoritet të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm në SAI për të marrë përsipër këtë përgjegjësi" ISSAI 40: fq. 13.</p> <p>d) rishikuesit e sigurimit të cilësisë janë të pavarur, d.m.th. nuk kanë qenë të përfshirë në kontrollin e cilësisë së auditimeve të kontraktuara. ISSAI 40: fq. 13.</p> <p>e) rishikimet e sigurimit të cilësisë rezultojnë në konkluzione të qarta dhe, ku është e nevojshme, në rekomandime për përmirësime. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i>.</p> <p>f) "(...) rezultatet e monitorimit të sistemit të kontrollit të cilësisë raportohen te Kryetari i SAI-t në kohën e duhur (...)" ISSAI 40: fq. 13.</p> <p>g) Ka të dhëna se menaxhimi i lartë i audituesit të kontraktuar ka marrë në konsideratë dhe ka marrë vendim mbi rekomandimet e ofruara nga sigurimi i cilësisë. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i>.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =3: Kriteri (b), (d) dhe të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (d) dhe të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>ISSAI 40</p>

SAI-6: Lidershipi dhe Komunikimi i Brendshëm

Sipas ISSAI 20, SAI duhet të veprojë mbi themelet e transparencës dhe llogaridhënies. Gjithashtu, ISSAI 12 thekson për SAI-t parimin e udhëheqjes nëpërmjet shembullit. Praktikisht, Kryetari i SAI-t dhe menaxhimi i lartë janë përgjegjës për dhënien e shembullit të mirë, për të promovuar integritetin, por gjithashtu për të mundësuar përmbushjen efektive të mandatit të organizatës duke zhvilluar një kulturë organizative e cila promovon efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri. Në mënyrë që SAI të arrijë objektivat e tij, është i nevojshëm një lidership i fortë dhe komunikim i mirë me stafin.

Qasja e vlerësimit të sugjeruar

Vlerësimi i performancës së lidershipit dhe komunikimit kërkon një qasje holistike. Disa kritere mund të vlerësohen duke parë ekzistencën e disa praktikave në një fushë të caktuar, për disa kritere të tjera duhet që vlerësuesi të shikojë organizatën në tërësinë e saj. Për lidershipin, vlerësuesi duhet të përdorë gjykimin profesional për të vlerësuar nëse iniciativa të veçanta, të para bashkërisht në tërësi, janë të mjaftueshme për të përmbushur kriteret. Praktikave të komunikimit të brendshëm duhet të jenë më të formalizuara në organizatat e mëdha, në mënyrë që të merren parasysh konteksti, struktura organizative dhe stafi.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Lidershipi;*
- (ii) *Komunikimi i brendshëm.*

(i) **Lidershipi** është një element kryesor i të gjitha operacioneve të SAI-t dhe për këtë arsye është thelbësor për shumicën e fushave në KMP të SAI-t. Është e pamundur matja e një treguesi ose fushe të vetëm. Megjithatë SAI-6 dimensionin (i) mat disa nga praktika që konsiderohen si kërkesa minimale për një lidership efektiv. Lidershipi është i vështirë për tu matur, kështu në pjesën përshkruese të raportit të performancës duhet të analizohet ndikimi i lidershipit dhe i kulturës organizative.

(ii) **Komunikimi i brendshëm:** Komunikimi i brendshëm është një nga aspektet kryesore për ta mbajtur stafin e SAI-t të informuar, të motivuar dhe në të njëjtin drejtim me objektivat e SAI-t. Ai është një mjet i fuqishëm për të stimuluar rritjen e angazhimit të stafit. Përveç kësaj, stafi luan një rol të rëndësishëm në komunikimin e rëndësishëm të SAI-t për qytetarët. Prandaj, i gjithë personeli duhet të jetë i informuar për punën dhe prioritetet strategjike të SAI-t. Komunikimi i brendshëm është

gjithashtu një mjet i rëndësishëm për shkëmbimin e njohurive, duke lejuar njerëzit të dinë se iniciativat e ndërmarra në të gjithë SAI-n, rritjen e inovacionit dhe gjenerimin e ideve të reja.

SAI – 6 Dimensionet & Kriteret minimale për pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Liderhipi	
<p>Karakteristikat e lidershit efektiv të SAI - t:</p> <p>a) Liderhipi mban takime vendimmarrjeje periodike. <i>Rrjedhin nga CAF: fq. 19, Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>b) Vendimet kryesore të lidershit të SAI-t dokumentohen dhe i komunikohen stafit. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>c) Liderhipi identifikon dhe shpërndan vlerat e SAI-t dhe i promovon ato në aktivitete publike, dokumentet kryesore dhe në komunikimin e përditshëm. <i>CAF: fq. 18, Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>d) Liderhipi i SAI-t zbaton me sukses një sistem ku autoriteti delegohet dhe ku drejtuesit mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. <i>Rrjedh nga ISSAI 20 fq 4, ISSAI 40: fq. 5 (d.m.th., në rast të kontrollit të pamjaftueshëm të cilësisë së auditimeve)</i></p> <p>e) Liderhipi harton strategji (brenda kompetencave të tij) për të stimuluar performancën e mirë dhe i zbaton ato. <i>Rrjedhin nga INTOSAI GOV 9100: fq.30</i></p> <p>f) Liderhipi ndërmerr iniciativa për të dhënë shembullin e mirë me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe forcimin e kulturës së kontrollit të brendshëm. <i>INTOSAI GOV 9100, ISSAI 30: fq. 6</i></p> <p>g) Liderhipi ndërmerr iniciativa për ndërtimin e një kulturë etike në organizatë duke identifikuar etikën si një prioritet i qartë; duke udhëhequr me shembullin e mirë; promovuar standarde të larta profesionale, përgjegjshmërinë dhe transparencën në vendimmarrje; duke inkurajuar një mjedis të të mësuarit të hapur dhe të përbashkët ku pyetjet më të vështira dhe të ndjeshme mund të ngrihen dhe të diskutohen; dhe duke njohur sjelljen e mirë etike e duke trajtuar ato jo etike. <i>ISSAI 30: fq. 6 - 8</i></p>	<p>INTOSAI GOV 9100</p> <p>Kuadri i Përbashkët i Vlerësimit (CAF)</p>

<p>h) Lidershipi ndërmerr iniciativa për të krijuar "një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është thelbësore në kryerjen e të gjithë punës së SAI-t." <i>ISSAI 40: fq. 5</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Komunikimi i Brendshëm</p>	
<p>Sa i përket komunikimit të brendshëm, këto kriteret duhet të plotësohen nga SAI për periudhën në shqyrtim:</p> <p>a) SAI ka vendosur parime për komunikim të brendshëm dhe monitoron zbatimin e tyre.</p> <p>b) Lidershipi i komunikon stafit mandatin, vizionin, vlerat thelbësore dhe strategjitë e SAI-t. <i>AFROSAI - E Udhëzuesi për komunikimin për SAI – t, CAF: fq. 18</i></p> <p>c) Lidershipi informon dhe këshillon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore të lidhura me organizatën. <i>Rrjedhin nga CAF: fq. 9</i></p> <p>d) SAI përdor mjetet e duhura për të nxitur komunikimin e brendshëm efektiv, të tilla si: newsletter/revista, adresat e-mail për të gjithë stafin, intranetin etj. <i>AFROSAI - E Udhëzuesi për komunikimin për SAI-t</i></p> <p>e) Ka ndërveprime të rregullta dhe të hapura midis menaxhimit dhe punonjësve, të tilla si: takime informuese organizative, takime të rregullta të grupeve të ndryshme. <i>AFROSAI - E Udhëzuesi për komunikimin për SAI-t</i></p> <p>f) SAI ka një sistem komunikimi elektronik që i lejon të gjithë punonjësve të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informacione. <i>AFROSAI - E Udhëzuesi për komunikimin për SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p style="text-align: center;">AFROSAI - E Udhëzuesi për komunikimin për SAI - t</p> <p style="text-align: center;">Kudri i Përbashkët i Vlerësimit (CAF)</p>

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.	
Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.	

SAI-7: Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit

ISSAI 1 thekson se SAI duhet të auditojë në përputhje me një program të vetë-përcaktuar. Gjithashtu, SAI-7 trajton procesin e zhvillimit të planit të përgjithshëm të auditimit/program kontrolli si dhe përmbajtjen e tij.

Plani i përgjithshëm i auditimit/programi i kontrollit përcakton auditimet/kontrollet që SAI planifikon të kryejë në një periudhë kohe të caktuar. Ky mund të jetë një plan vjetor apo shumëvjeçar. Plani i përgjithshëm i auditimit/programi i kontrollit mbështet SAI-n në përmbushjen e mandatit dhe arritjen e objektivave të tij në mënyrë efikase dhe efektive. Është e rëndësishme që plani i përgjithshëm i auditimit/programi i kontrollit të jetë i mirë studiuar, të pasqyrojë buxhetin i SAI-t dhe ngarkesën e punës së punonjësve.

ISSAI 40. Kontrolli i cilësisë përcakton se SAI-et duhet të marrin në konsideratë planin e përgjithshëm të auditimit/programi i kontrollit dhe nëse ata kanë burimet për të realizuar sasinë e punës audituese me nivelin e kërkuar të cilësisë. Për të arritur këtë objektiv, SAI duhet të ketë ndërtuar një sistem që përcakton përparësitë e punës duke patur parësore nevojën për të ruajtur cilësinë. Gjithashtu është i rëndësishëm dokumentimi i procesit për zhvillimin e planit i përgjithshëm i auditimit/programi i kontrollit .

Qasja e sugjeruar për vlerësimin

Vlerësuesit duhet të kryejë një vlerësim të gjithëpërfshirës të procesit të planifikimit të përgjithshëm të auditimit/ i kontrollit, duke e plotësuar këtë me informacione nga vlerësimi i treguesve të auditimit/kontrollit në fushën C, për të përcaktuar nëse ekziston një sistem në SAI i cili siguron një qasje të qëndrueshme. Për më tepër, vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë nëse sistemi i ofron lidhshpirt informacione të mjaftueshme për të parë nëse mandati është përmbushur në mënyrë efektive.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i)Procesi i Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/kontrollit;*
- (ii) Përmbajtja e Planit të Përgjithshëm të Auditimit/Programit të Kontrollit.*

(i) Procesi i Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/kontrollit përshkruan auditimet që SAI do të kryejë. Ai duhet të pasqyrojë mandatin e SAI-t. ISSAI 1 thekson se objektivat e auditimit/kontrollit të SAI-t - ligjshmëria, rregullshmëria, ekonomikiteti, efienca dhe efektiviteti i menaxhimit financiar - kanë të gjithë rëndësi të barabartë (ISSAI 1:4).

Megjithatë, i takon SAI-t të përcaktojë prioritetet e tij rast pas rasti. Për të arritur këtë, SAI duhet të ketë një sistem për të përcaktuar përparësitë e punës duke marrë parasysh nevojën për të ruajtur cilësinë, duke zbatuar një metodologji të bazuar në risk për të përcaktuar auditimet/kontrollet që do të kryej. Burimet të nevojshme për të realizuar planin janë marrë në konsideratë dhe janë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për zbatimin e tij.

(ii) Përmbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/kontrollit për një SAI duhet të mbulojë elemente si vlerësimin e pengesave, vlerësimin e riskut për përcaktimin e prioritetëve të auditimeve, buxhetin dhe burimet njerëzore në dispozicion. Mbulimi me auditim i mandatit të SAI-t vlerësohet nga SAI-8.

SAI - 7 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Procesi i Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/Kontrollit	
<p>Për planifikimin e përgjithshëm efektiv të auditimit/kontrollit:</p> <p>a) SAI dokumenton procesin e ndjekur për zhvillimin dhe miratimin e planit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit për SAI-n. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedhin nga ISSAI 100: 42</i></p> <p>b) Procesi për zhvillimin e planit të përgjithshëm të auditimit/kontrollit të SAI-t identifikon përgjegjësitë e auditimit/kontrollit nga mandati i tij. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>c) Procesi i planifikimit të auditimit/kontrollit ndjek një metodologji të bazuar në risk. <i>(d.m.th., vlerësim i riskut sistematik si bazë për përzgjedhjen e subjekteve të auditimit dhe qasjes). Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedh nga ISSAI 40: Elementi 3</i></p> <p>d) Ka përgjegjësi të përcaktuara qartë për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të auditimit/kontrollit. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedh nga ISSAI 40: Element 4</i></p> <p>e) Ka të dhëna që SAI monitoron zbatimin e planit të auditimeve/kontrolleve të tij. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>f) Procesi i planifikimit të auditimit/kontrollit për SAI-n merr parasysh buxhetin e pritshëm dhe burime për periudhën me të cilën plani do të realizohet. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedh nga ISSAI 40: Element 3</i></p> <p>g) SAI "duhet të sigurojë që pritshmëritë e palëve të interesuara dhe risqet e reja janë faktorë të përfshirë në (...) planet e auditimit (programet e kontrollit) sipas rastit" <i>ISSAI 12: 5</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (a), (b), (c) dhe të paktën dy prej kriterëve të tjera më sipër plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteret (a), (b) dhe të paktën një prej kriterëve të tjera më sipër plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p>	<p>ISSAI 12</p> <p>ISSAI 40</p> <p>ISSAI 100</p>

<p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Përbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/Kontrollit</p>	
<p>Përbajtja e Planifikimit të Përgjithshëm të Auditimit/kontrollit ose dokumente të tjera të ngjashme:</p> <p>a) Përcakton objektivat e auditimit/kontrollit në nivel të lartë, si dhe përgjegjësitë për çdo auditim/kontroll që do të kryhet. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedh nga ISSAI 40: Element 4</i></p> <p>b) Përfshin një kalendar për zbatimin e të gjitha auditimeve/kontrolleve. <i>Rrjedhin nga ISSAI 100: 48</i></p> <p>c) Tregon se SAI e zbaton mandatin e tij të auditimit/kontrollit sipas një kalendari siç ishte planifikuar në planin tij; ose, nëse nuk është kështu, përfshin një përmbledhje dhe shpjegimin e ndonjë difference midis mandatit të SAI t dhe planit të auditimit/kontrollit të tij. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>d) Përcakton burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për të kryer auditimet/kontrollet e planifikuar. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t, rrjedh nga ISSAI 100: 48</i></p> <p>e) Përmban një vlerësim të risqeve dhe pengesave për zbatimin e planit ose programit. <i>Grupi i Punës KMP e SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (a), (b) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera më sipër plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën kriteret (a) dhe (b) plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>ISSAI 100</p> <p>ISSAI 40</p>

Fusha C: Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

Auditimit në sektorit publik ka zbatime të ndryshme dhe të shumëllojshme. Mandati i SAI-t përcakton përgjegjësitë për auditim dhe çdo funksion tjetër që ai mund të ketë. ISSAI 100 përcakton parimet themelore të auditimit të sektorit publik, të cilat zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha llojet e auditimeve dhe që SAI-t duhet të ndjekin bazuar në mandatin dhe strategjitë e tyre. Përveç kësaj, ISSAI-t sigurojnë standarde dhe udhëzime për llojet e mëposhtme të auditimit të sektorit publik:

- **Auditimi Financiar** përcakton nëse informacioni financiar i një njësie ekonomike është paraqitur në përputhje me raportimin financiare dhe kornizat rregullative në fuqi. Kjo arrihet përmes përfitimit të evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të mundësuar që audituesi të mund të ofrojë një opinion të bazuar në siguri të arsyeshme që informacioni financiar është pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. *ISSAI 200 e shtjellon këtë më tej.*
- **Auditimi i performancës** vlerëson nëse ndërhyrjet, programet dhe institucionet veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim. Kjo arrihet duke ekzaminuar performancën kundrejt kriterëve të përshtatshme dhe duke analizuar shkakun e devijimeve nga kriteret apo problemet. Qëllimi është ti jepet përgjigje pyetjeve kyçe të auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim. *ISSAI 300 e shtjellon këtë më tej.*
- **Auditimi i Përputhshmërisë** përcakton nëse një çështje e veçantë është në përputhje me kornizën ligjore të zbatueshme të identifikuar si kriterë. Auditimi i përputhshmërisë kryhet duke vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje kornizën ligjore që qeverisin subjektin e audituar. *ISSAI 400 e shtjellon këtë më tej.*

Kontrolli gjyqësor: Disa SAI kanë funksione gjyqësore. Objektivi i kontrollit gjyqësor është hartojë rregulla në formën e vendimeve të veçanta, urdhrave, vendimeve ose dekreteve, veçanërisht për përgjegjësinë personale dhe financiare të kontabilistëve publik. Në disa raste, qëllimi i kontrollit gjyqësor, gjithashtu, mund të jetë vendosja e një detyrimi të veçantë mbi menaxherët publik nëpërmjet vendimeve kolegjiale potencialisht për të sanksionuar çdo parregullsi. Ushtrimi i kontrollit gjyqësor nënkupton pajtueshmërinë me standardet e zbatueshme, si dhe zbatimin e një procedure ballafaqese, kryesisht të shkruar, të përcaktuar në ligj dhe aktet nënligjore. Kontrolli gjyqësor i lejon SAI-t të kontrollojë nëse menaxheri publik, nën një regjim

specifik përgjegjësie të përcaktuar nga ligji dhe aktet nënligjore, ka përmbushur detyrat e përcaktuara. Nëse këto nuk janë përmbushur, menaxherët publike mbajnë përgjegjësi. Kjo përgjegjësi i referohet në mënyrë rigorozë përputhshmërisë me detyrat në fjalë. Parimet specifike të kontrollit gjyqësor që SAI-et me funksione gjyqësor nuk përshkruhen në kuadrin e ISSAI-ve, kështu që kriteret janë hartuar duke u bazuar në praktikat më të mira që kanë të bëjnë me këtë proces.

Kjo fushë synon vlerësimin e cilësisë, si dhe rezultatet e punës së auditimit/kontrollit që është aktiviteti kryesor i SAI-t. Ai përfshin një tregues që mat mbulimin me auditim të SAI-t për çdo lloj auditimi, duke përfshirë edhe kontrollin gjyqësor.

Fusha mbulon tre llojet e auditimit të përcaktuara në ISSAI, si dhe kontrollin gjyqësor për SAI-t me funksione gjyqësor. Ajo ndjek një strukturë ku performanca e SAI-t për secilin lloj auditimi matet me anë të tre treguesve. E njëjta strukturë vlen edhe për treguesit për kontrollin gjyqësor. Struktura është si vijon:

- 1. Parimet** - Treguesit SAI-9, SAI-12 dhe SAI-15 vlerësojnë standardet, udhëzimet e auditimit, kompetencat, dhe menaxhimin e cilësisë që përbëjnë bazën për punën audituese të kryer nga SAI. SAI-18 mat të njëjtat fenomene për kontrollin gjyqësor;
- 2. Procesi** - Treguesit SAI-10, SAI-13 dhe SAI-16 vlerësojnë cilësinë e praktikave për të gjitha procedurat e auditimit gjatë periudhës në shqyrtim, nga planifikimi, zbatimi i auditimeve, vlerësimi i evidencave dhe në fund raportimi. SAI-19 mat të njëjtat fenomene për kontrollin gjyqësor;
- 3. Rezultatet** - Treguesit SAI-11, SAI-14 dhe SAI-17 fotografojnë rezultatet e punës audituese dhe si këto rezultate raportohen dhe ndiqen. SAI-20 mat të njëjtat fenomene për kontrollin gjyqësor.

Qasja e sugjeruar për vlerësimin e treguesve në Fushën C

Të gjitha auditimet fillojnë me objektiva, të cilat përcaktojnë llojin ose llojet e auditimeve që do të kryhen dhe standardet e zbatueshme. Është e nevojshme identifikimi i llojeve të auditimeve që kryen SAI dhe i treguesve që aplikohen. Kapitulli 1.6 ofron disa udhëzime për këto çështje. Udhëzime të mëtejshme jepen në treguesit përkatës më poshtë. Kur planifikon vlerësimin, grupi i vlerësimit duhet të shqyrtojë këto udhëzime dhe t'i diskutojë ato me SAI-n.

Gjatë vlerësimit të treguesve të kësaj fushe, duhet filluar me shqyrtimin e manualeve, udhëzime dhe standardeve të auditimit të SAI-t, duke përfshirë edhe politikat që udhëheqin zbatimin e auditimeve dhe përshkruajnë procedurat për menaxhimin e

cilësisë. Nëse SAI, së fundmi, ka miratar standarde apo manuale auditimi të reja, është e rëndësishme që grupi i vlerësimit të përcaktojë versionet e përshtatshme për shqyrtim. Burim i evidencave duhet të jenë standardet dhe manualët e përdorura nga grupet e auditimit. Kur vërehen dobësi në punën e auditimit, këto nganjëherë mund edhe të shpjegohen nga dobësitë në materialin udhëzues.

Kur vlerësuesi verifikon që sistemet e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë janë të shëndosha, vlerësuesi mund të vendosë një nivel sigurie mbi raportet e sigurimit të cilësisë të brendshme dhe të jashtme të SAI-t si evidencë për të bazuar pikëzimin e treguesve mbi procesin e auditimit financiar, të pajtueshmërisë dhe auditimit të performancës.

Evidenca të mëtejshme të përshtatshme duhet të merren nga një rishikim i një kampioni i auditimeve (kampion rastësor dhe i shtresëzuar me qëllim përfaqësimin e ndarjeve të ndryshme, llojeve të subjekteve, etj.).¹⁶ Nëse nuk specifikohet ndryshe, një kriter konsiderohet i plotësuar në përgjithësi kur ai plotësohet në të gjitha auditimet e përfshira në kampion, edhe pse vlerësuesi mund të hasë raste mosrespektimi në një auditim të vetëm brenda kampionit, kur është i bindur se ky ishte një rast i veçantë dhe ka evidenca të mjaftueshme për të thënë se kriteri plotësohet në përgjithësi në shumicën e popullatës së auditimeve. Kur treguesit kërkojnë shqyrtimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së evidencave të auditimit, vlerësuesi duhet të rishikojë të paktën dy procedura të planifikuara të auditimit nga secili prej auditimeve të zgjedhura dhe të formojë një opinion të bazuar mbi gjykimin e tij profesional. Treguesit mbi procedurat e auditimit (SAI-10, SAI-13 dhe SAI-16) kërkojnë për një pikëzim të barabartë me 4 që SAI të ketë ndërmarrë kohët e fundit një vlerësim të përputhshmërisë me ISSAI në nivelin 4, i cili konfirmon përputhshmërinë me të gjitha kërkesat e nivelit 4 të ISSAI-ve të lidhura me dimensionin në fjalë. Nëse SAI ka kryer një vlerësim të tillë të detajuar, për shembull, nëpërmjet procesit të sigurimit të cilësisë dhe/ose duke përdorur iCATs, vlerësuesi duhet të shqyrtojë nëse mund të mbështetet në këtë vlerësim. Në këtë kontekst janë thelbësore cilësia e vlerësimit dhe pavarësia e shqyrtimit. Nëse vlerësuesit mendon se mund të mbështetet tek vlerësimi, ata mund të përdorin rezultatet e atij vlerësimi për justifikuar pikëzimin e kriterëve në treguesit e procesit të auditimit.

¹⁶ Për udhëzime të mëtejshme mbi kampionimin shih seksionin 1. 6. 4
faqe 107 nga 250

Informacioni për të pikëzuar treguesit në auditime/rezultate të kontrollit gjyqësor (SAI-11, SAI-14, SAI-17, SAI-20) duhet të merren nga sistemi informatik i menaxhimit të SAI-t, ose nga shqyrtimi i një kampioni të dosjeve të auditimit/kontrollit.

Treguesit e performancës:

SAI - 8: *Mbulimi me Auditim;*

SAI - 9: *Standardet e Auditimit Financiar Dhe Menaxhimi i Cilësisë;*

SAI - 10: *Procesi i Auditimit Financiar;*

SAI - 11: *Rezultatet e Auditimit Financiar;*

SAI - 12: *Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë;*

SAI - 13: *Procesi i Auditimit të Performancës;*

SAI - 14: *Rezultatet e Auditimit të Performancës;*

SAI - 15: *Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimi i Cilësisë;*

SAI - 16: *Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë;*

SAI - 17: *Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë;*

SAI - 18: *Standardet e Kontrollit Gjyqësor dhe Menaxhimi i Cilësisë (për SAI-et me funksione gjyqësor);*

SAI - 19: *Procesi i Kontrollit Gjyqësor (për SAI-et me funksione gjyqësor);*

SAI - 20: *Rezultatet e Kontrolleve Gjyqësor (për SAI-et me funksione gjyqësor).*

Lidhja me treguesit në fushat A dhe B

Korniza e matjes së performancës së SAI-ve siguron vlerësime të ndryshme të auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe të performancës së një SAI-, si dhe të kontrollit gjyqësor aty ku është i përshtatshëm. Përpara pikëzimit të treguesve nën këtë fushë, vlerësuesi duhet të marrë parasysh kuadrin ligjor të SAI-t për të përcaktuar nëse mandati i tij për të kryer lloje të ndryshme të auditimit është i kufizuar. Nëse mandati e lejon atë të kryejë vetëm lloje të caktuara auditimi, atëherë treguesit e tjerë në fushën C duhet të shënohen si të pa zbatueshëm.¹⁷

¹⁷ *Shih seksionin 3. 2. 4 për detaje mbi metodologjinë e pikëzimit të treguesve*
faqe 108 nga 250

SAI-9, SAI-12, SAI-15 dhe SAI-18 vlerësojnë qasjen e SAI-t ndaj auditimit/kontrollit gjyqësor në drejtim të standardeve dhe udhëzimeve, si dhe se si çështjet e menaxhimit të grupit të auditimit, aftësitë, dhe kontrolli i cilësisë zbatohen në nivel auditimesh/kontrollesh të veçanta. Cilësia e këtyre funksioneve në nivel organizativ vlerësohet në kuadrin: kontrollit të cilësisë në SAI-4 dhe zhvillimi profesional dhe trajnimi në SAI-23.

SAI-8: Mbulimi me Auditim

Treguesi mat mbulimin me auditim në secilin nga tre llojet e auditimit: financiar, performancë dhe përputhshmëri, dhe kur është e përshtatshme edhe për kontrollet e gjyqësore. Ai ofron informacion deri në ç' masë SAI është i aftë të auditojë njësitë brenda mandatit të tij. Vlerësimi i këtij treguesi mund të bazohet në informacionin nga sistemi i menaxhimit të informacionit të SAI-t, rishikime të përfunduara të sigurimit të cilësisë dhe/ose shqyrtime të një kampioni auditimi.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) Mbulimi me auditim financiar;*
- (ii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të performancës;*
- (iii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të përputhshmërisë;*
- (iv) Mbulimi i kontrollit gjyqësor.*

(i) Mbulimi me auditim financiar: Mandati i SAI për auditimin e pasqyrave financiare mund të jetë i përcaktuar në legjislacion (shih Fushën A Pavarësia dhe Korniza Ligjore). Kjo mund të përfshijë legjislacionin për auditimin (i cili zakonisht identifikon përgjegjësitë e auditimit financiar në lidhje me llogaritë publike ose fondin e konsoliduar) si dhe aktet dhe instrumentet e tjera ligjore të krijimit të njërive qeverisjes qendrore dhe lokale, dhe forma të ndryshme të korporatave publike. Në disa raste legjislacioni mund të përcaktojë subjektet që do të auditoohen, por mund të mos jetë i qartë mbi detyrimet për të kryer auditime financiare, të përputhshmërisë dhe performancës. Në këto raste, vlerësuesit duhet të marrin parasysh praktikën e krijuar, dhe pritshmëritë për të përcaktuar nëse auditimi financiar është një pjesë e mandatit të SAI-t dhe nëse treguesit e auditimit financiar janë të zbatueshëm. Legjislacioni ndonjëherë parashikon që auditimi financiar të kryhet me burime të jashtme. Në këtë rast, vlerësuesi duhet të përcaktojë nëse SAI mban përgjegjësi për cilësinë e auditimeve: nëse po, atëherë ky dimension është i zbatueshëm. Në rast se SAI është përgjegjës për cilësinë e auditimeve me burime të jashtme, por nuk ka akses të një pjesë ose të gjitha dosjet e këtij auditimi, atëherë të gjitha kriteret që nuk mund të pikëzohen për këtë arsye, duhet të pikëzohen si të pa plotësuar nga SAI.

Pavarësisht se kush e merr përsipër auditimin, SAI duhet të sigurohet, që të gjitha pasqyrat financiare që i paraqiten për auditim brenda mandatit të tij, (d.m.th, përjashtuar kërkesat për auditime shtesë jashtë mandatit të SAI-t, por duke përfshirë çdo auditim ku SAI ka pranuar rolin e audituesit të emëruar) auditoohen brenda afateve

kohore përkatëse ligjore (apo brenda gjashtë muajve nga marrja e pasqyrave financiare, nëse nuk ka afat kohor ligjor). Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është zakonisht jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të SAI-t. Në rast se pasqyrat financiare brenda mandatit të SAI-t nuk i janë paraqitur atij nga personat përgjegjës, SAI nuk mund të nisë auditimin financiar, por minimalisht duhet të raportojë te personat përgjegjës dhe te publiku për mos-dorëzimin e pasqyrave financiare.

Në disa vende, mandati i SAI-t për auditime financiar mund të jetë vetëm auditim i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë. Pikëzimi, pra, do të jetë ose 4 (nëse këto janë audituar) ose 0 (në qoftë se nuk janë audituar). Nëse këto pasqyra financiare të konsoliduara nuk janë dorëzuar, dhe për këtë arsye nuk mund të auditohen, dimensionit i duhet dhënë pikëzimi 0 nëse SAI nuk raporton publikisht mbi mosdorëzimin e pasqyrave financiare; konsiderohet si i pazbatueshëm nëse ai raporton publikisht.

(ii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të performancës: duke qenë se mandati ligjor i SAI-t për auditimin e performancës është i gjerë dhe fushëveprimi i auditimit të performancës është fleksibël, është e vështirë matja e mbulimit me auditim për auditimin e performancës. SAI-et duhet të përcaktojnë rast pas rasti se si vendosin përparësitë midis llojeve të ndryshme të auditimit (ISSAI 1: 4). Prandaj, dimensionit i mbulimit me auditim për auditimin e performancës fokusohet në vlerësimin nëse, proceset e SAI-t për përzgjedhjen e temave të auditimit i mundësojnë atij zgjedhjen e auditimeve që mbulojnë çështje të rëndësishme dhe kanë një impakt të lartë. Impakti i lartë i referohet mundësisë që auditimet të përmirësojnë ndjeshëm sjelljen, operacionet dhe programet e qeverisë, p.sh. duke ulur kostot dhe thjeshtësuar administrimin, duke rritur cilësinë dhe vëllimin e shërbimeve, apo përmirësimin e efektivitetit, ndikimin apo përfitimin për shoqërinë (ISSAI 300: 40). Në zgjedhjen e çështjeve që do të auditohen, audituesit mund të përdorin teknika formale si analiza e riskut ose vlerësimi i problemit, por edhe gjykimin profesional.

(iii) Mbulimi, përzgjedhja dhe objektivi i auditimit të përputhshmërisë: matja e mbulimit me auditim në rastin e auditimit të përputhshmërisë mund të jetë e vështirë, pasi mandati i SAI-t për të mund mos të ketë përcaktuar qartë natyrën e aktiviteteve të detyrueshme të auditimit; si dhe qëllimi i auditimeve të përputhshmërisë mund të ndryshojnë ndjeshëm. Përveç kësaj, shumë SAI-eve iu mungojnë burimet dhe kapacitetet e brendshme për të kryer auditime të përputhshmërisë të çdo subjekti të

audituar çdo vit, brenda mandati i tij. Për këtë arsye duhet të ekzistojë një mekanizëm i cili siguron se përzgjedhja e subjekteve të audituara në një vit të caktuar është e bazuar në qasje të qartë dhe të dokumentuar të përzgjedhjes së kampionit, që merr në konsideratë risqet dhe materialitetin e subjektit, si dhe burimet në dispozicion të SAI-t. Procesi duhet të sigurojë që të gjitha subjektet brenda mandatit të SAI-t janë audituar brenda një periudhe të arsyeshme kohore, për të siguruar një bazë për llogaridhënien dhe për të ruajtur pritshmëritë e mbikëqyrjes.

Prandaj ky dimension mat se si SAI zgjedh subjektet që do të jenë objekt i auditimeve të përputhshmërisë në një vit të caktuar dhe pastaj deri në çfarë shkalle SAI ka mundur të kryejë këto aktivitete të planifikuara. Përveç kësaj, mat edhe përqindjen e subjekteve të qeverisë qendrore që janë objekt i një auditimi të përputhshmërisë në vitin në shqyrtim, si dhe nëse auditimet e SAI-t kanë mbuluar tema të rëndësishme, si prokurimi, pagat dhe të ardhurat.

Fushëveprimi i auditimeve individuale të përputhshmërisë përcaktohet nga mandati i SAI-t, çështja që do të auditohet, legjislacioni i zbatueshëm, niveli i sigurisë që do të ofrohet, materialiteti dhe risku. Kjo është vlerësuar në SAI-16 Procesit i Auditimit Të Përputhshmërisë.

(iv) Mbulimi i kontrollit gjyqësor: Misionet e SAI-t për të kryer kontroll gjyqësor janë përgjithësisht të përcaktuara në ligj. Ligji përcakton kompetencën e SAI-t: subjektet, menaxherët publike (duke përfshirë kontabilistët), parregullsitë dhe pasojat e tyre. Ligji përcakton procesin për ndjekjen e parregullsive.

Brenda këtij kuadri ligjor, SAI përcakton rregullat e veta të programimit të kontrollit gjyqësor. Qëllimi i këtyre rregullave është që të sigurojë se:

- Kontrolli gjyqësor i të gjitha llogarive nën autoritetin e SAI-t kryhet brenda një periudhe të arsyeshme kohe;
- Gjykimi i të gjitha llogarive dhe çdo akuzë e ngritur nga SAI ndodh brenda një periudhe të arsyeshme kohe;
- Inventari i llogarive që presin gjykimin nga SAI ka mbetur i pandryshuar ose është pakësuar;
- Stabiliteti i shumës financiare të këtyre llogarive që presin gjykimin nga SAI. Ky element duhet të marrë parasysh inflacionin aktual;
- Respektohen periudhat për parashkrimin e gjykimit, duke përfshirë edhe verifikimin e kontabilistëve, nëse ka të tilla.

SAI mund të mos ketë burime dhe kapacitetet e brendshme për të kryer një kontroll gjyqësor të çdo subjekti nën autoritetin e tij gjatë një viti. Në raste të tilla, SAI duhet të planifikojë dhe programojë kontrollin gjyqësor, në mënyrë të tillë, që shumica e këtyre subjekteve të mund t'i nënshtrohen kontrollit gjyqësor brenda një periudhë të caktuar kohore. Subjektet e mbetura kampionohen, bazuar në nivelin e riskut që ato përfaqësojnë.

Vendimi për të kryer një kontroll gjyqësor dhe fushëveprimi i hetimit janë të përcaktuara nga misioni i SAI-t, rezultatet e kontrollit të mëparshëm dhe vlerësimi i riskut. Ky aspekt vlerësohet në SAI-19 Procesi i Kontrollit Gjyqësor. Çdo kontroll gjyqësor mund të përqendrohet në një temë të caktuar ose të merret me tërësinë e operacioneve të njësisë ekonomike të kontrolluar.

SAI - 8 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimension (i) Mbulimi me Auditim Financiar	
<p>Pikëzimi = 4: Në vitin në shqyrtim, 100% e pasqyrave financiare të marra (të detyrueshme për t'u audituar bazuar në mandatin e SAI-t) janë audituar; dhe SAI raporton publikisht për çdo mos-dorëzim të pasqyrave financiare. <i>ISSAI 1:18, Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p> <p>Pikëzimi = 3: Në vitin në shqyrtim, të paktën 75% e pasqyrave financiare të marra (të detyrueshme për t'u audituar bazuar në mandatin e SAI-t) janë audituar, përfshirë fondin e konsoliduar/llogaritë publike (ose ku nuk ka fond të konsoliduar, tre Ministritë më të mëdha); dhe SAI raporton publikisht për çdo mos-dorëzimin të pasqyrat financiare. Përzgjedhja e pasqyrave financiare për auditim është e bazuar në risk, materialitet, mandatin, kompetencat dhe burimet e SAI-t. <i>ISSAI 1:18, ISSAI 40: fq. 8, Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p> <p>Pikëzimi = 2: Në vitin në shqyrtim, të paktën 50% e pasqyrave financiare të marra (të detyrueshme për t'u audituar bazuar në mandatin e SAI-t) janë audituar, përfshirë fondin e konsoliduar llogaritë publike (ose ku nuk ka fond të konsoliduar, tre Ministritë më të mëdha); dhe SAI raporton përgjegjësit e çdo mos dorëzimi të pasqyrave financiare. Përzgjedhja e pasqyrave financiare për auditim bazohet në marrjen në konsideratë të riskut, materialitetit, mandatit, kompetencat dhe burimet e SAI-t. <i>ISSAI 1:18, ISSAI 40: fq. 8, Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p> <p>Pikëzimi = 1: Në vitin në shqyrtim, të paktën 25% e pasqyrave financiare të marra (të detyrueshme për t'u audituar bazuar në mandatin e SAI-t) janë audituar. <i>ISSAI 1:18, Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p> <p>Pikëzimi = 0: Në vitin në shqyrtim, më pak se 25% e pasqyrave financiare të marra (të detyrueshme për t'u audituar bazuar në mandatin e SAI-t) janë audituar. <i>ISSAI 1:18, Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 40</p>
Dimension (ii) Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivi i Auditimit të Performancës	
<p>a) SAI ka përcaktuar prioritetet për auditimin e performancës të bazuar në idenë se ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti janë objektivat e auditimit të një rëndësie të barabartë me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e menaxhimit financiar dhe të kontabilitetit. <i>ISSAI 1: 4</i></p>	<p>ISSAI 1</p> <p>ISSAI 12</p>

<p>b) "Auditimi i performancës shqyrton nëse ndërhyrjet, programet dhe institucionet po veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim." <i>ISSAI 100: 22</i></p> <p>c) Çështjet e auditimit janë përzgjedhur "përmes procesit të planifikimit strategjik [dhe/ose operacional] të SAI-t duke analizuar çështjet e mundshme dhe kryer studime për të identifikuar risqet dhe problemet" <i>ISSAI 300: 36. Shih gjithashtu ISSAI 3000: 89.</i></p> <p>d) "SAI-et duhet të sigurojnë që pritshmëritë e palëve të interesuara dhe risqet e reja janë faktorë në (...) planet e auditimeve, sipas rasteve" <i>ISSAI 12: 5</i></p> <p>e) "Në [planifikimin e procesit], audituesit [dhe SAI-et] duhet të marrin parasysh se çështjet e auditimit duhet të jenë mjaftueshëm të rëndësishme (...)" <i>ISSAI 300: 36. Shih gjithashtu ISSAI 3000: 90.</i></p> <p>f) "Në [planifikimin e procesit], audituesit [dhe SAI-t] duhet të marrin parasysh se çështjet e auditimit duhet të jenë (...) të auditueshme dhe në përputhje me mandatin e SAI - t." <i>ISSAI 300: 36. Shih gjithashtu ISSAI 3000: 90.</i></p> <p>g) "Procesi i përzgjedhjes së çështjes duhet të synojë maksimizimin e ndikimit të pritur të auditimit duke marrë parasysh kapacitetet e auditimit (d.m.th., burimet njerëzore dhe aftësitë profesionale)" <i>ISSAI 300:36. Shih gjithashtu ISSAI 3000: 91.</i></p> <p>h) Gjatë pesë viteve të fundit, SAI ka publikuar raporte që mbulojnë të paktën gjashtë nga sektorët/çështjet e mëposhtëm: <i>Grupi i punës KMP i SAI-t. Shih gjithashtu ISSAI 12: 5, ISSAI 300: 36.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi Ekonomik Kombëtar - Mbrojtja - Mbledhja e të Ardhurave - Arsimi - Mjedisi - Programet e Reformës së Sektorit Publik - Shëndetësia - Financat Publike dhe Administrata Publike - Infrastruktura - Sigurimet Shoqërore dhe Tregu i Punës <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p>ISSAI 100</p> <p>ISSAI 300</p>
---	-----------------------------------

Dimension (iii) Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivi i Auditimit të Përputhshmërisë	
<p>a) Plani i auditimit për vitin në shqyrtim identifikon subjektet brenda mandatit të SAI - t që do të jenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë në një vit të caktuar.</p> <p>b) Përzgjedhja e subjekteve të audituara bazohet në një vlerësim sistematik dhe të dokumentuar të riskut dhe materialitetit, duke marrë parasysh burimet në dispozicion të SAI - t. <i>Rrjedhin nga ISSAI 40: fq. 8, ISSAI 100: 41</i></p> <p>c) Procesi i përzgjedhjes së subjekteve siguron që të gjitha subjektet brenda mandatit të SAI-t auditohen gjatë një periudhe të arsyeshme kohore. <i>ISSAI 1:18</i></p> <p>d) Gjatë tre viteve të fundit çështjet e trajtuara nëpërmjet auditimeve kanë përfshirë të paktën një nga të mëposhtmet: <i>ISSAI 12: 5</i></p> <p style="margin-left: 20px;">I. Prokurimi</p> <p style="margin-left: 20px;">II. Pagat</p> <p style="margin-left: 20px;">III. Mbledhja e të Ardhurave</p>	<p>ISSAI 1</p>
<p>Pikëzimi 4 = Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen, duke përfshirë të gjitha nën-kriteret nën (d). Gjatë vitit në shqyrtim, të gjitha subjektet e identifikuar në planin për atë vit dhe të paktën 75% e subjekteve të pushtetit qendror kanë qenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p>	<p>ISSAI 12</p>
<p>Pikëzimi 3 = Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen. Gjatë vitit në shqyrtim, 75% e subjekteve të identifikuara në planin për atë vit dhe të paktën 50% e subjekteve të pushtetit qendror kanë qenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 40</p>
<p>Pikëzimi 2 = Kriteret (a) dhe (b) më sipër plotësohen. Gjatë vitit në shqyrtim, 50% e subjekteve në plan për atë vit dhe të paktën 50% e subjekteve të pushtetit qendror kanë qenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 100</p>
<p>Pikëzimi 1 = Kriteri (a) më sipër plotësohet. Gjatë vitit në shqyrtim, të paktën 25% e subjekteve të pushtetit qendror kanë qenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t</i></p>	
<p>Pikëzimi 0 = Gjatë vitit në shqyrtim, më pak se 25% e subjekteve të qeverisë qendrore kanë qenë subjekt i auditimit të përputhshmërisë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t.</i></p>	

Dimension (iv) Mbulimi i Kontrollit Gjyqësor

Shënim: Kriteret (e) dhe (f) zbatohen vetëm për SAI-et, në të cilën Zyra e Prokurorit Publik është pjesë e SAI-t. Në të kundërt, vendosja e pikëve vetëm do të përfshijë kriteret nga (a) deri në (d).

- a) Raporti mesatar i stokut të llogarive më 31/12 ndaj stokut të llogarive në vitin e mëparshëm është i barabartë me ose më i vogël se një.
- b) Raporti mesatar i vlerës financiare të stokut të llogarive më 31/12 ndaj vlerës financiare të stokut të llogarive në vitin e mëparshëm është i barabartë me ose më i vogël se një.
- c) Përqindja e llogarive të gjykuar ndaj numrit të përgjithshëm të llogarive të planifikuar për gjykim.
- d) Përqindja e vlerës financiare të llogarive të gjykuara ndaj vlerës financiare të llogarive të caktuara për gjykim.
- e) Raporti i stokut të referimeve të Prokurorit Publik të pa proceduara ende më 31/12, ndaj stokut të aplikimeve të prokurorit publik të pa proceduara në vitin e mëparshëm, është i barabartë me ose më i vogël se një.
- f) Raporti i stokut të çështjeve në pritje të një vendimi më 31/12 ndaj stokut të çështjeve në pritje të një vendimi në vitin e mëparshëm është i barabartë me ose më i vogël se 1.

Pikëzimi = 4: Kriteret (a), (b), (e) dhe (f) plotësohen. Përqindja mesatare e kriterëve (c) dhe (d) është 80% ose më e lartë.

Pikëzimi = 3: Kriteret (a) dhe (b) plotësohen. Pikëzimi mesatar si për (c) ose (d) është 80% ose më i lartë, ndërsa pikëzimi mesatar i (c) ose (d) është rreth 70%, dhe ose (e) ose (f) janë plotësuar.

Pikëzimi = 2: Kriteret (a) dhe (b) plotësohen. Përqindja mesatare e kriterëve (c), dhe (d) është 60% ose më e lartë, dhe kriteret (e) dhe (f) janë plotësuar.

Pikëzimi = 1: Kriteret (a) ose (b) plotësohen. Ose (c) ose (d) është më i lartë se 60%, ndërsa tjetri është 50% ose më i madh.

Pikëzimi = 0: Kriteret (a) dhe (b) nuk plotësohen. [Praktikisht pikëzimi i kriterëve të tjera është i paaplikueshëm.]

Auditimi Financiar - Hyrje

Qëllimi dhe Objektivi i Auditimit Financiar

"Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së një opinioni nga audituesi nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar" (ISSAI 200:16)."

Në kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare, objektivat e përgjithshme të audituesit janë:

- (a) Të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësinë e tyre nuk kanë anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, duke lejuar që audituesi të shpreh një opinion nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; dhe
- (b) Të raportojë mbi pasqyrat financiare dhe të komunikojë rezultatet e auditimit, në përputhje me gjetjet e auditimit" (ISSAI 200: 17).

Angazhimet me Siguri të Arsyeshme

Auditimet e kryera në përputhje me ISSAI 200 janë angazhime me siguri të arsyeshme, dhe jo me siguri të kufizuar. Auditimi i pasqyrave financiare në përputhje me ISSAI është një angazhim me siguri të arsyeshme. Auditimet me siguri të arsyeshme janë hartuar në mënyrë të tillë që të rezultojnë në një përfundim të shprehur në formë pozitive, të tilla si: "Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë)". (ISSAI 200: 38)

"Angazhimet me siguri të kufizuar, si angazhime shqyrtimi, aktualisht nuk mbulohen nga ISSAI – t për auditimet financiare. Angazhime të tilla japin një nivel më të ulët sigurie se sa siguria e arsyeshme dhe janë hartuar në mënyrë të tillë që të rezultojnë në një përfundim të shprehur në formë negative, të tillë si: "Nuk është venë re asgjë që do të na bëjë të besojmë se pasqyrat financiare nuk janë paraqitur në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale." (ISSAI 200: 39).

Parakushtet për auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me ISSAI

"Një auditim financiar i kryer në përputhje me ISSAI bazohet në kushtet e mëposhtme:

- Korniza e raportimit financiar që përdoret për përgatitjen e pasqyrave financiare konsiderohet të jetë e pranueshme nga audituesi;

- Menaxhimi i subjektit pranon dhe kupton përgjegjësinë e tij "[për përgatitjen e pasqyrave financiare, duke mbajtur kontrolle të brendshme të përshtatshme dhe duke i ofruar audituesit qasje të pakufizuar në të gjitha informacionet e rëndësishme]. (ISSAI 200: 19).

Pa një kornizë të pranueshme të raportimit financiar, audituesi nuk ka kritere të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare. ISSAI 1210, shtojca 2, ofron ndihmë për audituesin në përcaktimin nëse kornizën e raportimit financiar është e pranueshme. Korniza e raportimit financiar e pranueshme përmban informacion mbi pasqyrat financiare, i cili është i rëndësishëm, i plotë, i besueshëm, i paanshëm dhe i kuptueshëm për përdoruesit. Kur audituesi përcakton se korniza e raportimit financiar nuk është e pranueshme, atëherë ai mund ta pranojë gjithsesi atë, në qoftë se:

- "Menaxhimi pranon të japë informacione shpjeguese të nevojshme mbi pasqyrat financiare për të shmangur keqkuptimet dhe;
- Raporti i audituesit për pasqyrat financiare përfshin paragrafin e Theksimit të Çështjes, duke tërhequr vëmendjen e përdoruesve të dhënira e informacioneve shpjeguese.

Nëse kushtet e mësipërme nuk plotësohen, audituesi duhet të vlerësojë efektin e natyrës së keqpasqyrimeve të pasqyrave financiare në raportin dhe opinionin e audituesit dhe të marrë në konsideratë nevojën për të informuar legjislativin në lidhje me këtë çështje."(ISSAI 200: 23).

Si përcaktohet nëse aktiviteti i auditimit është auditim financiar

Vlerësuesi duhet të konsiderojë nëse lloji i punës së auditimit të kryer nga SAI është auditim financiar. Karakteristikë kryesore e auditimit financiar, siç përcaktohet në ISSAI 100, është përcaktimi nëse informacioni financiar i një njësie ekonomike është paraqitur në përputhje me kornizën të raportimit financiar rregullatore të zbatueshme. Auditimet ku fokusi kryesor i auditimit është përputhshmëria me kornizën ligjore të zbatueshme¹⁸ duhet të mbulohet sipas treguesve mbi auditimin e përputhshmërisë. Auditimet financiare që ndërmerren kur SAI konsideron kornizën e raportimit financiar të jetë e papranueshme, mund të mbuloohen me këtë tregues, por janë subjekt i kritereve shtesë që SAI nuk i referohen ISSAI-t për auditimin financiar në raportin apo opinionin e Tij.

¹⁸ Rregullat, ligjet dhe rregulloret, rezolutat buxhetore, politikat, kodet e vendosura, kushtet e miratuara ose parimet e përgjithshme të menaxhimit financiar të shëndoshë të sektorit publik dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

ISSAI 200 (paragrafi 25) parashikon parimet themelore të rëndësishme për një auditim të plotë të pasqyrave financiare. ISSAI 200, gjithashtu, mund të zbatohet për auditimet e tjera financiare, duke përfshirë auditimin e një pasqyre të vetme financiare, pasqyrat financiare të përgatitura bazuar në kontabilitetin cash, elementët e një pasqyre financiare, dhe pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me kornizat e raportimit financiar për qëllime të veçanta (duke përfshirë raportet e ekzekutimit të buxhetit). Për auditime të tilla, udhëzimi në ISSAI 1800, 1805 dhe 1810, si dhe parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë dhe performancës, mund të jenë të përshtatshme.

Auditimi Financiar i Raporteve të Ekzekutimit të Buxhetit.

ISSAI 200 paragrafi 25 thotë se:

"Në disa mjedise të auditimit të sektorit publik, auditimet financiare referohen si auditime të ekzekutimit të buxhetit, të cilat shpesh përfshijnë ekzaminimin e transaksioneve kundrejt buxhetit për çështje përputhshmërie dhe rregullshmërie (...). Në mjedise të tilla auditimi shpesh mungon një kornizë e pranueshme e raportimit financiar. Rezultati i transaksioneve financiare mund të paraqiten në formatin e shpenzimeve në krahasim me shifrat e buxhetuara. Në mjedise ku janë ndërmarrë auditime të tilla e, dhe ku nuk ka pasqyra financiare të paraqitura në përputhje me kornizën e pranueshme të raportimit financiar, audituesi mund të arrijë në konkluzionin që parakushtet themelore të një auditimi në përputhje me ISSAI mbi auditimin financiar nuk plotësohen. Audituesit në mjedise të tilla mund të marrin në konsideratë zhvillimin e standardeve duke përdorur parimet themelore mbi auditimin financiar, si udhëzim për të përshtatur nevojat e tyre specifike."

Aty ku fokusi i auditimit është në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme, *ISSAI 400 Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*, mund të jetë një burim i rëndësishëm i informacionit për zhvillimin e standardeve të duhura të auditimit. Kur audituesi duhet të përcaktojë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e një kuadri të pranueshëm me qëllim të veçantë raportimin financiar, duhet të zbatohen *ISSAI 1210 Shtojca 2, si dhe ISSAI 1800, 1805 dhe 1810*.

ISSAI 200 Parimet Themelore të Auditimit Financiar siguron SAI-et me një bazë për miratimin ose zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve për auditimin financiar. Ato mund të përdoren në tre mënyra (*ISSAI 200: 10*):

- Për të formuar bazën mbi të cilën zhvillohen standardet;

- Për të formuar bazën mbi të cilën miratohen standardet kombëtare;
- Për të formuar bazën për miratimin e Udhëzimeve të auditimit financiar (ISSAI 1000-1810) si standarde të detyrueshme.

"Referenca të ISSAI 200 në raportet e auditimit apo raportin e audituesit duhet të bëhet vetëm nëse standardet e auditimit janë zhvilluar ose miratuar plotësisht në përputhje me të gjitha parimet përkatëse të ISSAI 200".(ISSAI 200: 11).

SAI-9: Standardet e Auditimit Financiar dhe Menaxhimit të Cilësisë

Ky tregues është specifik për parimet themelore të auditimit financiar. SAI-9 vlerëson qasjen e SAI-t për auditimin financiar në drejtim të standardeve të tij të përgjithshme dhe udhëzimet për auditimin financiar, si edhe se si çështjet e menaxhimit të grupit të auditimit, aftësitë dhe kontrolli i cilësisë zbatohen në nivel angazhimi të auditimit. Cilësia e këtyre funksioneve në nivel organizativ vlerësohet në treguesit në kontrollin e cilësisë në SAI-4, si dhe zhvillimin profesional dhe trajnimit në SAI-23.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Standardet e auditimit financiar dhe politikak;*
- (ii) *Menaxhimi i grupit të auditimit financiar dhe aftësitë;*
- (iii) *Kontrolli i cilësisë në auditimin financiar.*

(i) Standardet e auditimit financiar dhe politikak: Ky dimension shqyrton nëse SAI ka miratuar standarde auditimi në përputhje me parimet themelore të auditimit financiar, siç pasqyrohet në ISSAI 200. Ai analizon më tej nëse SAI ka vendosur politika dhe procedura për audituesit e tij të cilat interpretojnë standardet në kontekstin e SAI-t. Politikak dhe Procedurat mund të gjenden në dokumente të ndryshme, të tilla si manuallet e auditimit. Ato duhet të dokumentohen me shkrim.

(ii) Menaxhimi i grupit të auditimit financiar dhe aftësitë: Dimensioi shqyrton nëse SAI ka krijuar një sistem për të siguruar që anëtarët e grupit të auditimit kolektivisht së bashku zotërojnë kompetenca profesionale dhe aftësitë e nevojshme për të kryer auditimin në fjalë siç e kërkon ISSAI 200. Ajo, gjithashtu, shqyrton se çfarë mbështetje SAI ofron për audituesit e tij në procesin e auditimit. Për të pikëzuar dimensionin, vlerësuesit mund të shqyrtojnë politikak dhe procedurat të SAI-t për krijimin e grupeve të auditimit, si dhe material udhëzues dhe mbështetje të tjera që u jepen audituesve. Për të verifikuar se sistemi i krijimit të grupit të auditimit është zbatuar në praktikë, vlerësuesit mund të shqyrtojnë dokumentacionin e planifikimit për auditimet që merren si kampion.

(iii) Kontrolli i cilësisë në auditimin financiar: Ky dimension shqyrton se si zbatohet në praktikë kontrolli i cilësisë për auditimin financiar, siç dëshmohet nëpërmjet rishikimit të dosjeve të auditimit. Kontrolli i cilësisë i procesit të auditimit përshkruan shumë e masave të marra për të siguruar cilësi të lartë të çdo produkti të auditimit, dhe kryhet si pjesë e integruar e procesit të auditimit. Procedurat e kontrollit të cilësisë në nivel angazhimi duhet të ofrojnë siguri të arsyeshme se auditimi përputhet me standardet

profesionale, kërkesat ligjore dhe rregullative të zbatueshme dhe se raporti i audituesit është në përputhje me rrethanat. (ISSAI 200:42). Individë të ndryshëm mund të përfshihen në kontrollin e cilësisë dhe në disa faza të procesit të auditimit. Menaxherët e linjës dhe përgjegjësit e grupeve të auditimit shpesh kanë një rol kyç, pasi ata shqyrtojnë draft planet, punën e auditimit dhe draft raportet para se auditimi të përfundojë. Sistemi i kontrollit të cilësisë të SAI-t në nivel organizativ matet në (SAI-4, dimensionimi (iii)).

SAI-9 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Standardet e Auditimit Financiar dhe Politikat	
<p>SAI duhet të adoptojë Udhëzimet e Auditimit Financiar (ISSAI 1000 - 1810) si standardet e tij, ose të zhvillojë ose të miratojë standardet kombëtare të auditimit në bazë të, ose në përputhje me ISSAI 200 Parimet Themelore të Auditimit Financiar. <i>ISSAI 200:10</i>. Adoptimi i standardeve në përputhje me ISSAI 200 mund të konsiderohet për të përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) "Audituesi duhet të vlerësojë nëse parakushtet për një auditim të pasqyrave financiare janë plotësuar" <i>ISSAI 200:18 (d.m.th., korniza e pranueshme e raportimit financiar dhe menaxhimi i pranon përgjegjësitë e veta). ISSAI 200:19</i></p> <p>b) "Audituesi duhet të zvogëlojë riskun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm në rrethanat e angazhimit për të marrë siguri të arsyeshme si bazë për një formë pozitive të shprehjes së opinionit të audituesit" <i>ISSAI 200:49</i></p> <p>c) "Audituesi duhet të zbatojë konceptin e materialitetit në mënyrë të përshtatshme, kur planifikon dhe kryen auditimin" <i>ISSAI 200:58</i></p> <p>d) "Audituesi duhet të përgatisë dokumentacionin e auditimit që është e mjaftueshme për të mundësuar një auditues me përvojë, dhe që nuk ka lidhje të mëparshme me auditimin, të kuptojë natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera (...), rezultatet (...) dhe evidencat e grumbulluara të auditimit" <i>ISSAI 200:70</i>.</p> <p>e) "Audituesi duhet, pas përcaktimit të personit/ave të duhur brenda strukturës së subjektit të audituar (...) të komunikojë me ta lidhur me qëllimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit." <i>ISSAI 200: 64</i></p> <p>f) "Audituesi duhet të dakordësojë (...) kushtet e angazhimit të auditimit me . menaxhimin apo me personat e ngarkuar me qeverisje, sipas rastit" <i>ISSAI 200: 74</i></p> <p>g) "Audituesi duhet të hartojë një strategji të përgjithshme të auditimit që përfshin fushëveprimin, kohën dhe drejtimin e auditimit, dhe një plan të auditimit i cili e drejton atë. " <i>ISSAI 200: 80</i></p>	ISSAI 200

- h) "Audituesi duhet të planifikojë siç duhet auditimin për të siguruar se ai është kryer në një mënyrë efektive dhe eficiente" *ISSAI 200:82*
- i) "Audituesi duhet të ketë kuptuar natyrën e subjektit të audituar dhe mjedisit në të cilin ai vepron, duke përfshirë edhe procedurat e kontrollit të brendshëm të rëndësishme për auditimin" *ISSAI 200: 85*
- j) "Audituesi duhet të vlerësojë risqet e anomalive materiale në nivel të pasqyrave dhe në nivel pohimi për llojet e transaksioneve, llogarive, gjendjet e llogarive dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për të siguruar një bazë për kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit." *ISSAI 200: 92.*
- k) "Audituesi duhet të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme për të adresuar risqet e vlerësuara të anomalive materiale në pasqyrat financiare" *ISSAI 200:97 (d.m.th., të hartojë teste auditimi si testet e kontrolleve dhe procedurave thelbësore, duke përfshirë testet e detajeve dhe procedurat analitike thelbësore, duke pasur parasysh risqet e qenësishme të vlerësuara të kontrollit të lidhura me anomali materiale në nivel pohimi) ISSAI 200:98*
- l) "Audituesi duhet të hartojë dhe të kryejë procedurat thelbësore për secilin llojë të transaksioneve, gjendjeve të llogarive dhe informacioniet speguese që janë materiale pavarësisht nga risqet e vlerësuara të anomalive materiale" *ISSAI 200: 102.*
- m) "Audituesi duhet të identifikojë dhe të vlerësojë risqet (...) e mashtrimit dhe të marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi lidhur me këto risqe, dhe të përgjigjet në mënyrën e duhur mashtrimit apo mashtrim të dyshuar të identifikuar gjatë auditimit" *ISSAI 200:104*
- n) "Audituesi duhet të identifikojë risqet (...) e mospërputhjes të drejtpërdrejtë dhe materiale me ligjet dhe rregulloret [dhe] të marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për përputhshmërinë me këto ligje dhe rregullore" *ISSAI 200:118*
- o) "Audituesi duhet të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë, që të mund të marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme , dhe të jetë i aftë për të nxjerrë konkluzionet mbi të cilat të bazojë opinionin e audituesit" *ISSAI 200:126*
- p) "Audituesi duhet të grumbullojë anomalitë e identifikuar gjatë auditimit, dhe komunikojë me menaxhimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen në kohën e duhur për të gjitha anomalitë e akumuluar gjatë auditimit" *ISSAI 200: 139 (d.m.th., audituesi duhet të përcaktojë nëse anomalitë e*

pakorrigjuara janë materiale individualisht apo të përgjithësuara). ISSAI 200: 142

q) "Audituesi duhet të formojë një opinion të bazuar në një vlerësim të konkluzioneve, bazuar në evidencat e marra të auditimit, nëse pasqyrat financiare në tërësinë e tyre janë përgatitur në përputhje me kornizën e pranueshme të raportimit financiar. Opinioni duhet të shprehet në mënyrë të qartë përmes një raporti me shkrim që po ashtu përshkruan bazën për këtë opinion" *ISSAI 200: 143*

r) Kur është e nevojshme: "Audituesi i angazhuar për të audituar pasqyrat financiare në grup duhet të marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi në lidhje me informacionin financiar të komponentëve dhe të procesit të konsolidimit për të shprehur një opinion nëse pasqyrat financiare të qeverisë në tërësi janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi" *ISSAI 200: 182*

SAI ka miratuar politika dhe procedura për mënyrën se si ka zgjedhur të zbatojë standardet e tij të auditimit, të cilat duhet të mbulojnë aspektet në vijim:

s) Si të "(...) përcaktojë materialitetin për pasqyrat financiare në tërësi (...), nivelin e materialitetit ose nivelet që do të zbatohen për (...) lloje të veçanta të transaksioneve, gjendjet e llogarive apo dhënien e informacioneve shpjeguese" *ISSAI 200:59* "Audituesi duhet të përcaktojë materialitetin e performancës" *ISSAI 200:60 (duke përfshirë vlerësimin e materialitetit sipas vlerës, natyrës dhe përmbajtjes) ISSAI 100:41*

t) "Kërkesat për audituesin në lidhje me dokumentacionin në fushat në vijim: përgatitjen në kohë të dokumentacionit të auditimit; forma, përmbajtja dhe shtrirja e dokumentacionit të auditimit; (...) inventari përfundimtar i dosjes së auditimit" *ISSAI 200: 72*

u) "Natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të auditimit (...), bazuar në dhe (...) në përgjigje ndaj risqeve të vlerësuara të anomalive materiale në nivel pohimi" *ISSAI 200:99 (Nëse është e nevojshme, përdorimi i një qasje për të llogaritur madhësinë minimale të kampionit të planifikuar në përgjigje të materialitetit dhe riskut të vlerësuar, bazuar në një model të auditimit).*

v) "Kur miraton ose zhvillon standarde auditimi, SAI merr në konsideratë domosdoshmërinë e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit në lidhje me:

<p>I. Përdorimin e konfirmimeve nga burimet e jashtme si evidencë e auditimit</p> <p>II. Evidencat e auditimit kur përdoren procedurat analitike dhe teknikat të ndryshme të marrjes së evidencave të auditimit</p> <p>III. Evidencat e auditimit kur përdoret puna e auditimit të brendshëm (...)</p> <p>IV. Evidencat e auditimit kur përdoren ekspertë të jashtëm." ISSAI 200: 132</p> <p>Pikëzimi = 4: Kriteret (b), (c), (p), (q) dhe të paktën gjashtëmbëdhjetë nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (b), (c), (q) dhe të paktën dymbëdhjetë nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteret (b), (c) dhe të paktën tetë nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Kriteret (b) dhe të paktën katër nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Menaxhimi i Grupit të Auditimit Financiar dhe Aftësitë</p>	
<p>SAI ka krijuar një sistem për të siguruar që "grupi i auditimit (...) si një i tërë ka kompetencën dhe aftësitë e duhura", duke përfshirë: ISSAI 200: 46</p> <p>a) "Njohjen dhe përvojë në praktikë në auditime të një natyre dhe kompleksiteti të ngjashëm përmes trajnimit të duhur dhe përvojës " ISSAI 200: 47</p> <p>b) "Të kuptuarit e standardeve profesionale dhe ligjore të zbatueshme dhe kërkesat rregullatore" ISSAI 200:47.</p> <p>c) "Ekspertizën teknike, duke përfshirë ekspertizën IT dhe fushat e specializuara të kontabilitetit ose auditimit" ISSAI 200:47</p> <p>d) "Njohja e industrive përkatëse [sektorëve] në të cilën organizata e audituar vepron" ISSAI 200: 47</p> <p>e) "Kuptimi i politikave dhe procedurave të SAI-t të kontrollit të cilësisë" ISSAI 200:47</p> <p>f) "(...) Të kuptuarit e marrëveshjeve të zbatueshme të raportimit" ISSAI 200:47</p>	<p>ISSAI 200</p>

g) Sistemi siguron që janë identifikuar njohuritë, aftësitë dhe ekspertiza e kërkuar për kryerjen e auditimit financiar. *Grupi i punës KMP i SAI-t*

h) Sistemi siguron se ka linja të qarta raportimi dhe të alokimit të përgjegjësiave brenda grupit. *Grupi i punës KMP i SAI-t*

SAI, gjithashtu, siguron mbështetje për grupet e auditimit në çështjet në vijim: *(të tilla si: në formën e manualeve të auditimit dhe materiale të tjera udhëzuese, trajnimit dhe zhvillimit profesional, ekspertë dhe/ose informacion nga burime të jashtme.)*

i) Zhvillimi i strategjisë së përgjithshme të auditimit *ISSAI 200: 81* dhe planit të auditimit, duke përfshirë "natyrën, kohën dhe procedurat e planifikuara të vlerësimit të riskut; [dhe] natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të planifikuara të auditimit në nivel pohimi" *ISSAI 200: 83*

j) Si të vlerësojë mjedisin e përgjithshëm të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë për shembull, "marrjen në konsideratë të komunikimit dhe zbatimit të integritetit dhe vlerave etike, angazhimin për kompetencë, pjesëmarrjen nga e personave të ngarkuar me qeverisje, filozofinë e menaxhimit dhe stilin operativ, strukturën organizative, ekzistencën dhe nivelin e aktivitetit të auditimit të brendshëm, caktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe politikat e praktikave të burimeve njerëzore" *ISSAI 200: 87*.

k) Si të arrijë një "njohje të kontrollit të brendshëm në lidhje me raportimin financiar (...)" *ISSAI 200: 90*

l) "(...) Vlerësimi i risqeve të anomalive materiale (...) në nivel pasqyre financiare dhe në nivel pohimi" *ISSAI 200:92*, "duke përfshirë edhe anomalitë "për shkak të mashtrimit" *ISSAI 200:104* dhe ato "për shkak të (...) mos përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret" *ISSAI 200: 118*

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen

Pikëzimi = 3: Kriteret (a), (i) dhe të paktën shtatë prej kriterëve të tjera më lart plotësohen.

Pikëzimi =2: Kriteri (a) dhe së paku pesë prej kriterëve të tjera më lart plotësohen..

Pikëzimi = 1: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Dimensioni (iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar

- a) "E gjithë puna e kryer duhet të jetë subjekt i rishqyrtimit si një mjet për të kontribuar në cilësisë dhe nxitjen e të mësuarit dhe zhvillimit të personelit" *ISSAI 40: fq 11 (d.m.th., duke përfshirë rishikimin e planit të auditimit, letrave të punës dhe punën e grupit, si dhe monitorimin e rregullt të ecurisë të auditimit nga nivelet e përshtatshme të menaxhimit. Shqyrtimi duhet të ndihmojë për të siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme dhe se raporti i audituesit është i përshtatshëm me rrethanat) ISSAI 200:42, Grupi i punës KMP i SAI-t*
- b) "Kur të lindin çështje të vështira ose të diskutueshme, SAI duhet të sigurojë që janë përdorur burimet e duhura (si ekspertë teknik) për t'u marrë me çështje të tilla" *ISSAI 40: fq 11*
- c) "(...) çdo ndryshim i opinionit brenda SAI-t duhet të dokumentohet në mënyrë të qartë dhe të zgjidhet para publikimit të raportit (...)" *ISSAI 40: fq 12*
- d) "SAI duhet të njohë rëndësinë e rishikimit të kontrollit të cilësisë së auditimit për punën e tij dhe çështjet e ngritura nga ai duhet të zgjidhen para publikimit të raportit në mënyrë të kënaqshme" *ISSAI 40: fq 12 (d.m.th. SAI duhet të ketë një politikë nëse dhe kur duhen kryer rishikime të të gjithë auditimit nga ekspertë të papërfshirë në auditim, para publikimit të raportit - Kjo është pjesë e kontrollit të cilësisë dhe jo sigurimit të cilësisë)*
- e) "(...) Ka procedura për autorizimin e raporteve që do të publikohen." *ISSAI 40: fq 12 (D.m.th. kryhet rishikimi i kontrollit të cilësisë të projekt raporteve, normalisht duke përfshirë rishikimin nga nivele të ndryshme të menaxhimit dhe ndoshta diskutime me stafin dhe/ose ekspertë të jashtëm).*

ISSAI 40

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohen.

SAI-10: Procesi i Auditimit Financiar

Treguesi përshkruan se si auditimet financiare kryhen në praktikë. Ai ekzaminon fazën e planifikimit, fazën e zhvillimit dhe fazën e raportimit. Përzgjedhja e nivelit të treguesi duhet të bëhet në bazat e një rishikimi të një kampioni të dosjeve nga auditimet financiare për periudhën nën rishikim. Evidenca mund të merret, gjithashtu, nga raportet e brendshme të sigurimit të cilësisë së SAI-t, ku vlerësuesi përcakton se mund të mbështetet mbi to. Gjithashtu, mund të jetë tepër ndihmuese intervistimi i grupeve të auditimit që kanë ndërmarrë auditimet e kampionuara. Si rregull, çështjet që mbulojnë kriteret duhet të dokumentohen në mënyrë që kriteri të cilësohet i përmbushur, për shembull, në planin e auditimit, në letrat e punës, ose në raportin e auditimit.

Referohuni në Aneksin 1 për përcaktimet dhe shpjegimet e termave kyç.

Lidhja në vlerësimin e përputhshmërinë e SAI-ve me ISSAI-t e nivelit të katërt.

Është një praktikë e mirë për SAI që të ndërmarrin rishikime të detajuara të sigurimit të cilësisë të punës së tyre audituese. Nëse SAI-t raportojnë se kanë kryer auditimet e tyre financiare në përputhje me ISSAI-t 1000-1810 (ose në përputhje me ISA-t), ato duhet të kenë një sistem që të sigurojë që janë në përputhje me ISSAI-t e nivelit të katërt. Për të inkurajuar këto rishikime dhe përshtatur rastet ku SAI-t kanë ndërmarrë një vlerësim të përputhshmërisë me ISSAI-t e nivelit të katërt, pikëzimi me katër i treguesve të procesit të auditimit në KMP e SAI-t (SAI-9, SAI-12 dhe SAI-15) kërkon që SAI të ketë bërë një rishikim të tillë dhe se rishikimi konfirmoi se SAI është në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse të nivelit 4. Vlerësuesi i takonë të përcaktojë nëse çështjet e mospërputhshmërisë të lindura gjatë vlerësimit lidhen me planifikimin, zhvillimin apo dimensionet e raportimit në KMP të SAI-t. Kjo do ta bëjë më të lehtë për SAI-n që ti referohen rezultateve të ndonjë vlerësimi të mëparshëm kur pikëzojnë treguesit në KMP e SAI-t.

Nëse SAI nuk ka ndërmarrë auditimet e tij në përputhje me ISSAI-t e nivelit të katërt, por duke u bazuar në standarde konsistente me parimet bazë të auditimit financiar ISSAI-t e (nivelit e 3: ISSAI 200), kriteret e detajuara më poshtë mund të përdoren për të vlerësuar dhe pikëzuar procesin e auditimit financiar të SAI-t.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) Planifikimi i auditimeve financiare;
- (ii) Zhvillimi i auditimeve financiare;
- (iii) Vlerësimi i evidencave të auditimit, konkludimi dhe raportimi në auditimet financiare.

Çdo dimension vendos kriteret për planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin, konkludimin dhe raportimin respektivisht siç janë vendosur në ISSAI 200. baza për vlerësimin e kriterit në dimension kampioni i marrë nga dosjet e auditimit, lutemi shikoni hyrjen në Fushën C

SAI-10 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Planifikimi i Auditimit Financiar	
<p>a) <i>Ku është e përshtatshme:</i> Për mjedise që nuk kanë organizata që vendosin standarde apo kornizat e raportimit financiar të njohura apo të autorizuara, të përshkruara nga ligji apo rregulloret, audituesi përcakton nëse ky kuadër i raportimit financiar është i aplikueshëm. <i>(Nëpërmjet aplikimit të ISSAI 1210, aneksi 2) ISSAI 200:24</i></p> <p>b) "Audituesi duhet të përcaktojë materialitetin për pasqyrat financiare si një e tërë (...), nivelet e materialitetit ose nivelet që duhet të aplikohen në (..) lloje të veçanta transaksionesh, tepricat e llogarive ose shënimet shpjeguese" <i>ISSAI 200:61 (duke përfshirë materialitetin sasior, sipas natyrës dhe përmbajtjes) ISSAI 100:41</i></p> <p>c) "Audituesi duhet të identifikojë personin e duhur të kontaktit në subjektin që do auditohet sipas strukturës qeverisëse të entitetit dhe të komunikojë me të sipas qëllimit të planifikuar dhe kohështrirjes së auditimit (...)" <i>ISSAI 200:64</i> dhe "(...) duhet të dakortësojë (...) termat e angazhimit me menaxhimin ose personat e ngarkuar me qeverisjen e organizatës." <i>ISSAI 200:74</i></p> <p>d) "Audituesi duhet të zhvillojë një strategji të përgjithshme auditimi që përfshin qëllimin, kohështrirjen dhe drejtimin e auditimit (...)" <i>ISSAI 200:80</i>, "natyra, kohështrirja dhe zgjatja e burimeve të nevojshme që të ndërmerë angazhimin" <i>ISSAI 200:81</i> dhe "të planifikojë auditimin në mënyrën e duhur për të siguruar që është ndërmerë në një mënyrë efektive dhe efciente" <i>ISSAI 200:82</i> duke përfshirë "natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të</p>	<p>ISSAI 200</p> <p>ISSAI 30</p>

<p>vlerësimit të riskut; [dhe] natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të planifikuara në nivelin e pohimeve të auditimit.” ISSAI 200:83</p> <p>e) “Audituesi duhet të ketë një njohje të entitetit që po auditohet dhe të mjedisit në të cilin operon (...)” ISSAI 200:85</p> <p>f) Audituesi duhet të vlerësojë mjedisin e përgjithshëm të kontrollit të brendshëm. ISSAI 200:87</p> <p>g) Audituesi duhet të arrijë një (..) njohje të kontrolleve të brendshme lidhur me raportimin financiar (...)” ISSAI 200:90</p> <p>h) “Audituesi duhet të vlerësojë riskun e anomalive materiale në nivel të pasqyrave financiare (...)” ISSAI 200:92</p> <p>i) “Audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare si pasojë e mashtrimit (...)” ISSAI 200:104</p> <p>j) “Audituesi duhet të identifikojë risqet e anomalive materiale si pasojë e (...) mospërputhjes materiale me ligjet dhe rregullat. ISSAI200:118</p> <p>k) SAI ka ngritur një sistem që siguron se në nivel angazhimi të llojit auditim, audituesit e tij {dhe çdo ekspert i jashtëm} përputhet me kërkesat etike vijuese: integriteti, pavarësia dhe objektiviteti, kompetenca, sjellja profesionale, konfidencialiteti dhe transparencja. ISSAI 30 (të tilla si: duke shmangur anagazhimet afatgjata me të njejtin subjekt të audituar,dhe duke kërkuar deklaratimet e duhura nga stafi në lidhje me etikën dhe pavarësinë).</p> <p>Pikëzimi= 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh rishikime të sigurimit të cilësisë, rishikim ndërmjet kolegësh ose rishikim i pavarur, iCAT subjekt i sigurisë së cilësisë së pavarur, të ndërmarra në tre vitet e fundit) të praktikës së auditimit financiar të SAI-t ka konfirmuar që SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit të katërt lidhur me këtë dimension (<i>përfshirë të gjithë kriteret e mësipërm</i>).</p> <p>Pikëzimi =3: Kriteri (b), (h) dhe të paktën gjashtë nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (h) dhe të paktën katër nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen</p>	
Dimensioni (ii) Implementimi i Auditimit Financiar	
<p>a) Audituesi i “përgjigjet riskut të vlerësuar nëpërmjet planifikimit të procedurave të auditimit (..) si procedurave thelbësore ose testeve të kontrolleve.” ISSAI 200:98 “Natyra, koha dhe shtrirja e procedurave të</p>	

<p>auditimit bazohen dhe i përgjigjet riskut të vlerësuar(..) duke përfshirë riskun e qenësishëm (..) dhe riskun e kontrollit” ISSAI 200:99 Kur SAI ka adoptuar politika dhe procedura lidhur me një qasje për llogaritjen e minimumit të madhësisë së kampionit në përgjigje të materialitetit dhe vlerësimit të riskut, këto procedura ndiqen në praktikë.</p> <p>b) Audituesi duhet të (..) marrë evidencë të mjaftueshme auditimi duke pasur parasysh riskun e vlerësuar të anomalive materiale si pasojë e mashtrimit ose mashtrimit të dyshuar gjatë auditimit.” ISSAI 200:104</p> <p>c) Audituesi duhet të marrë evidencë të mjaftueshme duke ju referuar përputhshmërisë me ligjet dhe rregullat që njihen përgjithësisht se kanë një efekt direkt dhe material në përcaktimin e shumave materiale dhe shënimeve shpjeguesve në pasqyrat financiare.” ISSAI 200:118</p> <p>d) Kur është e nevojshme: Gjatë auditimit të tyre, SAI-t “marrin evidencë të nevojshme dhe të duhur në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimin e konfirmimeve nga burimet e jashtme si evidencë auditimi; • Evidencë auditimi nga procedurat analitike dhe teknika të ndryshme audituese të kampionimit (..); • Evidencë auditimi nëpërmjet përdorimit të punës së funksionit të auditimit të brendshëm; • Evidencë auditimi nga ekspertët e jashtëm (...).” ISSAI 200:132 <p>e) Kur është e përshtatshme:”Audituesit e angazhuar në auditim {pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë} duhet të marrin evidencë të mjaftueshme dhe të duhur auditimi duke ju referuar informacionit financiar të të gjithë komponentëve dhe procesit të konsolidimit të tyre për të shprehur një opinion. (...).” ISSAI 200:182</p> <p>f) “(...) Procedurat e auditimit {Kur përdoren} në mënyrë që të fitohet evidencë e duhur dhe të mjaftueshme të auditimit në mënyrë që të nxirren konkluzione për të mbështetur opinionin e audituesit”. ISSAI 200:126</p> <p>g) Janë ndërmarrë të gjitha procedurat e auditimit të planifikuara, ose kur nuk janë ndërmarrë të gjitha procedurat e planifikuara, duhet të jetë në dosjet e auditimit një shpjegim se pse nuk u kryen, i cili duhet të jetë i aprovuar nga personat përgjegjës për auditimin. Grupi punës KMP e SA-t</p> <p>Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (i tillë si rishikime të sigurimit të cilësisë, rishikim ndërmjet kolegësh ose rishikim i pavarur, iCAT subjekt i sigurisë së cilësisë së pavarur, të ndërmarrë në tre vitet e fundit) të praktikës së auditimit financiar të SAI-t ka konfirmuar që SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-</p>	<p>ISSAI 200</p>
--	------------------

<p>ve të nivelit të katërt të lidhura me këtë dimension (përfshirë të gjithë kriteret e mësipërm).</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a), (f) dhe të paktën tre nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe të paktën dy nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet</p>	
<p>Dimensionimi (iii) Vlerësimi i evidencës së auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi në Auditimin Financiar</p>	
<p>a) "Audituesi duhet të përgatisë dokumentimin e auditimit që është i mjaftueshëm për t'i mundësuar një audituesi me përvojë, pa njohuri paraprake të auditimit, të kuptojë natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera, (...) rezultatet (...) dhe evidencat të marra të auditimit (...)." <i>ISSAI 200:70</i></p> <p>b) Janë ndjekur procedurat e dokumentacionit të SAI në lidhje me: "përgatitja e dokumentacionit të auditimit në kohën e duhur; formën, përmbajtjen dhe shtrirjen e dokumentimit; (...) përmbledhja e tyre në dosjen përfundimtare të auditimit." <i>ISSAI 200:72</i></p> <p>c) "Audituesi duhet të identifikojë personin(at) e duhur të kontaktit gjatë auditimit në strukturën qeverisëse të njësisë dhe të komunikojë me ta lidhur me (...) çdo gjetje të rëndësishme" <i>ISSAI 200:64</i> dhe "të gjitha anomali të e regjistruara gjatë kryerjes së auditimit." <i>ISSAI 200:139</i></p> <p>d) "Gjetjet e auditimit të SAI janë subjekt i procedurave për komente dhe rekomandime [ose observacione] për t'u diskutuar dhe për t'u përgjigjur nga subjekti i audituar." <i>ISSAI 20:3</i></p> <p>e) Anomali të e pakorrigjuara duhet të vlerësohen për materialitetin, individualisht ose së bashku (..) " <i>ISSAI 200:140</i></p> <p>f) "Audituesi duhet të formojë një opinion bazuar në një vlerësim të konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e auditimit të fituara, nëse pasqyrat financiare në tërësi janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar të zbatueshëm". <i>ISSAI 200:143</i> Forma e dhënies së opinionit të auditimit është e duhura duke marrë parasysh udhëzimet në ISSAI 200, si më poshtë:</p>	<p>ISSAI 200</p> <p>ISSAI 100</p> <p>ISSAI 20</p>

- I. "(...) Opinioni i pamodifikuar nëse konstatohet se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin financiar të zbatueshëm ". *ISSAI 200:147* (duke përfshirë përdorimin e Paragrafëve për Theksimin e Çështjes)
- II. Në të kundërt një opinion i modifikuar që mund të jetë në tre format:
- III. "(...) Një opinion i kualifikuar nëse: (1) (...) audituesi konkludon se gabimet [janë] materiale, por jo të përhapura, për deklaratat financiare; ose (2) audituesi nuk ishte në gjendje të merrte evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme mbi të cilat bazohet një opinion, por (...) efekti i mundshëm (...) mund të jetë material, por jo i përhapur. " *ISSAI 200:153*
- IV. "(...) Një opinion i kundërt nëse (...) audituesi konkludon se anomalitë (...) janë edhe materiale dhe të përhapura (...)." *ISSAI 200:154*
- V. "(...) Refuzim për të dhënë një opinion nëse nuk ka qenë në gjendje të marrë evidencë të auditimit të mjaftueshme të përshtatshme mbi të cilat bazohet opinioni, audituesi konkludon se efektet (...) mund të jenë të dyja materiale dhe të përhapura." *ISSAI 200: 155*

g) Raporti i audituesit duhet të jetë në një formë të shkruar dhe të përmbajë elementët e mëposhtëm:" *ISSAI 200:149*

- I. Titullin (..)
- II. Kujt i drejtohet sipas kushteve të angazhimit
- III. Një paragraf hyrës që identifikon se pasqyrat financiare të kujt janë audituar
- IV. Një paragraf me adresimin e përgjegjësisë së menaxhimit për pasqyrat financiare
- V. Një paragraf me fillimin e përgjegjësisë së audituesit duke shprehur se përgjegjësia e audituesit është të japë një opinion bazuar në auditimin e pasqyrave financiare (..)
- VI. Një paragraf me hyrjen "Opinion" (..)
- VII. Firmën e audituesit
- VIII. Datën në të cilën audituesi mori evidencë të mjaftueshme dhe të duhur në të cilën u bazua opinioni i audituesit në pasqyrat financiare
- IX. Vendndodhja në juridiksionin ku audituesi ushtron aktivitetin." *ISSAI 200:149*

h) "Raportet duhet të jenë të lehta për t'u kuptuar, të mos përmbajnë shprehje me dy kuptime dhe të paqarta si dhe të plota. Ato duhet të jenë objektive dhe të drejta, duke përfshirë vetëm informacion të mbështetur në evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të duhur dhe që sigurojnë që gjetjet janë

vendosur në perspektivën dhe kontekstin e duhur.” ISSAI 100:51 (d.m.th., në rastin e raporteve të gjata formale siç janë letrat e menaxhimit)

- i) Çdo observacion dhe rekomandim i auditimit është shkruar qartë dhe në mënyrë koncize dhe i është drejtuar atyre që janë përgjegjës për sigurimin e implementimit të tyre.
- j) Aty ku është e arsyeshme: “Nëse kushtet{për pranimin e kornizës së raportimit financiar} nuk plotësohen, audituesi duhet të vlerësojë efektin e kësaj natyre të keqpasqyrimin të pasqyrave financiare në raportin e auditimit dhe opinionin e tij, dhe të ketë në konsideratë lajmërimin e legjislativit për këtë çështje” ISSAI 200:23
- k) Kur është e rëndësishme: “Raporti i audituesit në pasqyrat financiare për qëllime të veçanta {të tilla si raportet e ekzekutimit të buxhetit}, raporti duhet të përshkruajë qëllimin për të cilin janë përgatitur pasqyrat financiare” ISSAI 200:173 dhe “audituesi duhet të përfshijë një paragraf të theksimit të çështjes duke lajmëruar përdoruesit për faktin që pasqyrat financiare janë përgatitur me një kornizë raportimi për qëllime të veçanta (...)”. ISSAI 200:174

Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (d.m.th., rishikime të sigurimit të cilësisë, rishikim ndërmjet kolegësh ose rishikim i pavarur, iCAT subjekt i sigurisë së cilësisë së pavarur, të ndërmarra në tre vitet e fundit) të praktikës së auditimit financiar të SAI-t ka konfirmuar që SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit të katërt të lidhur me këtë dimension (përfshirë të gjithë kriteret e mësipërm).

Pikëzimi = 3: Kriteri (e), (f) dhe të paktën gjashtë nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Kriteri (f) dhe të paktën katër nga kriteret e tjera të mësipërme plotësohen

Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

SAI-11: Rezultatet e auditimit financiar

Ky tregues vlerëson produktet e funksionit të auditimit financiar të SAI-t, dorëzimin në kohë dhe publikimin e raporteve të auditimit financiar, si dhe ndjekjen e rekomandimeve.

(i) dhe (ii) Dorëzimi në kohë dhe publikimi i rezultateve të auditimit financiar: Rezultatet e një auditimi financiar mund të jenë: a) opinioni i auditimit mbi informacionin financiar të një njësie ekonomike (nganjëherë të shoqëruar nga një raport i SAI-t/Kryetarit të SAI); b) një raport për menaxhimin ose ata që janë ngarkuar me qeverisjen. Të gjitha rezultatet duhet të jenë paraqitur tek autoriteti përkatës në kohën e duhur (dimensioni ii). Dorëzimi nënkupton dërgimin/dhënien formalisht të raportit përfundimtar të auditimit tek autoriteti që do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e raportit dhe marrjen e masave të duhura. Pikëzimi në dimensionin (iii) duhet të fokusohet nëse raportet e auditimit dhe/ose opinionet publikohen sipas legjislationit, dhe jo nëse janë publikuar raportet e tjera, duke përfshirë letrat e menaxhimit, dhe gjetjet e punës të auditimit financiar. Legjislationi kombëtar shpesh përshkruan fazën në procesin kur SAI lejohet të publikojë raportin e auditimit dhe / ose opinionin. Raporti i auditimit konsiderohet i përfunduar kur vendimmarrësit(at) e SAI (p.sh. Kryetari i SAI) e ka miratur atë.

(iii) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga SAI: SAI duhet të ketë një sistem për të ndjekur nëse subjektet e audituara ndërmarrin veprimet e duhura në bazë të rekomandimeve të bëra nga SAI, dhe nga të tjerët të ngarkuar me qeverisjen. Kjo duhet të përfshijë mundësinë që subjekti i audituar t'i përgjigjet këtyre rekomandimeve, si dhe raportimit të SAI-t drejt autoriteteve përkatëse dhe publikut për gjetjet auditiveve të ndjekjes së rekomandimeve.

Qasja e rekomanduar për pikëzim

Informacioni për të pikëzuar këtë tregues mund të merret nga sistemi i menaxhimit të informacionit të SAI-t, ose nga rishikimi i një kampioni të auditimeve të pasqyrave financiare të ndërmarra gjatë periudhës nën shqyrtim.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i)** *Dorëzimi në kohë i rezultateve të auditimit financiar;*
- (ii)** *Publikimi në kohë i rezultateve të auditimit financiar;*
- (iii)** *Ndjekja nga SAI i zbatimit e rekomandimeve të auditimeve financiare.*

SAI-11 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Dorëzimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar	
<p>Pikëzimi = 4: Për të paktën 80% të auditimeve financiare, opinioni i auditimit dhe/ose raporti i janë dërguar autoritetit të duhur brenda kohës ligjore apo të dakortësuar (ose nëse nuk ka limit kohor të përcaktuar, brenda 6 muajve nga marrja e pasqyrave financiare nga SAI) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP / SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 3: Për të paktën 60% të auditimeve financiare, opinioni i auditimit dhe/ose raporti i janë dërguar autoritetit të duhur brenda kohës ligjore apo të dakortësuar (ose nëse nuk ka limit kohor të përcaktuar, brenda 9 muajve nga marrja e pasqyrave financiare nga SAI) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP / SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 2: Për të paktën 40% të auditimeve financiare, opinioni i auditimit dhe/ose raporti janë dërguar autoritetit të duhur brenda kohës ligjore apo të dakortësuar (ose nëse nuk ka limit kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga marrja e pasqyrave financiare nga SAI) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP / SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 1: Për të paktën 20% të auditimeve financiare, opinioni i auditimit dhe/ose raporti janë dërguar autoritetit të duhur brenda kohës ligjore apo të dakortësuar (ose nëse nuk ka limit kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga marrja e pasqyrave financiare nga SAI) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP / SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 0: Për më pak se 20% të auditimeve financiare, opinioni i auditimit dhe/ose raporti janë dërguar autoritetit të duhur brenda kohës ligjore apo të dakortësuar (ose nëse nuk ka limit kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga marrja e pasqyrave financiare nga SAI) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP / SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 10 ISSAI 20</p>
Dimensioni (ii) Publikimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar	
<p>Pikëzimi = 4: Për të gjithë raportet dhe/ose opinionet ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin që të publikojë, raporti dhe/ose opinionet është i disponueshëm për</p>	<p>ISSAI 1 ISSAI 10</p>

<p>publikun në rrethana të duhura brenda 15 ditëve pasi SAI është i lejuar që ta publikojë. <i>ISSAI 1:16, ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP I SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 3 Për të gjithë raportet dhe/ose opinionet ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin që të publikojë, raporti dhe /ose opinionin është i disponueshëm për publikun në rrethana të duhura brenda 30 ditëve pasi SAI është i lejuar që ta publikojë. <i>ISSAI 1:16, ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP I SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 2 Për të paktën 75% të raporteve dhe/ose opinioneve ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin që të publikojë, raporti dhe /ose opinionin është i disponueshëm për publikun në rrethana të duhura brenda 60 ditëve pasi SAI është i lejuar që ta publikojë. <i>ISSAI 1:16, ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP I SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 1 Për të paktën 50% të raporteve dhe/ose opinioneve ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin që të publikojë, raporti dhe/ose opinionin është i disponueshëm për publikun në rrethana të duhura brenda 60 ditëve pasi SAI është i lejuar që ta publikojë. <i>ISSAI 1:16, ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP I SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 0 Për më pak se 50% e raporteve dhe/ose opinioneve ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin që të publikojë, raporti dhe/ose opinionin është i disponueshëm për publikun në rrethana të duhura brenda 60 ditëve pasi SAI është i lejuar që ta publikojë. <i>ISSAI 1:16, ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP I SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 20</p>
<p>Dimensioni (iii) Ndjekja nga SAI i Zbatimit të Rekomandimeve të Auditimeve Financiare</p>	
<p>a) SAI-t kanë sistemin e tyre të brendshëm të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për të siguruar që subjekti i audituar trajton në mënyrën e duhur rekomandimet e tyre po ashtu dhe ato të bëra nga Legjislativi ose prej një nga komisioneve të tij, ose bordi drejtues i të audituarit sipas rastit.” <i>ISSAI 10:7</i></p> <p>b) Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve fokusohet në atë nëse subjekti i audituar ka adresuar siç duhet çështjet e ngritura {në auditimet e mëparshme}.” <i>ISSAI 100:51</i></p> <p>c) SAI ka ngritur një praktikë për vlersimin material për të përcaktuar nëse ndjekja e zbatimit të rekomandimeve kërkon investigim/auditim shtesë. <i>Grupi i punës KMP i SAI-t, ISSAI 100:41</i></p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p> <p>ISSAI 100</p>

- d) Procedurat e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të SAI-t duhet të lejojnë subjektin e audituar të japë informacion për veprimet korrigjuese të ndërmarra ose pse nuk janë ndërmarrë veprime korrigjuese. *ISSAI 20:3*
- e) SAI-t e dërgojnë raportin e tyre të ndjekjes së rekomandimeve tek Legjislativi, një prej komisioneve të tij, ose bordit drejtues të subjektit të audituar sipas rastit, për konsideratë dhe veprim edhe kur SAI ka fuqinë kushtetuese për ndjekjen dhe sanksione." *ISSAI 10:7*
- f) SAI-t raportojnë publikisht mbi rezultatet e auditimeve të tyre {duke përfshirë} raportimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve për punën e tyre rekomanduese. *ISSAI 20:7*

Pikëzimi = 4: Të gjithë kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Një nga kriteret e mësipërme plotësohet.

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.

Auditimi i Performancës - Hyrje

Auditimi i performancës fokusohet mbi faktin nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat qeveritare janë duke performuar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ka hapësirë për përmirësime. (ISSAI 300:9). Kjo arrihet duke shqyrtuar performancën aktuale nën dritën e kriterëve të përshtatshme dhe duke analizuar problemet apo shkaqet e shmangieve nga kriteret. Qëllimi i auditimit të performancës është që t'i përgjigjet pyetjeve kryesore të auditimit dhe të rekomandojë përmirësime (ISSAI 100:22). Rekomandimet, së bashku me raportin e auditimit, kanë si qëllim të përmirësojnë ndjeshëm operacionet dhe programet qeveritare, duke çuar në ndryshime si: ulja e kostove, thjeshtëzim i administrimit, përmirësim të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve, ose përmirësim të efektivitetit, impaktit dhe përfitimeve të shoqërisë. (ISSAI 300:40).

Fokusi i auditimeve të performancës është më i gjerë sesa thjesht menaxhimi financiar qeveritar. Ai mund të mbulojë efektivitetin e lëvrimit të shërbimeve publike (si shëndetësia dhe arsimi), ose përgjithësisht administratën publike. Fusha e auditimeve specifike të performancës mund të variojë nga shqyrtimet e kufizuara të një mjedisi të caktuar në një entitet të vetëm, deri në ekzaminime shumëdimensionale të iniciativave të gjera qeveritare. Zakonisht, një SAI nuk kryen auditim performace për të njëjtin subjekt çdo vit, por përzgjedh tema dhe subjekte audituese mbështetur në vlerësimin e riskut dhe materialitetit. Duke pasur parasysh larmishmërinë e madhe të çështjeve potenciale audituese, është kritike që audituesit e performancës të akumulojnë njohuri për fushën përkatëse në fazën e planifikimit, në mënyrë që auditimi të dizajnohet i fokusuar realisht në çështjen në fjalë dhe të ketë ndikim tek palët e interesit. Ndonëse auditimet e performancës mund ta trajtojnë përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret, ato dallojnë nga auditimet e përputhshmërisë, sepse përgjithësisht adresojnë një fushë më të gjerë audituese. Për shembull, auditimet e performancës mund të shqyrtojnë ndikimin e mospërputhjes së objektivave të një programi qeveritar me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe/ose të kërkojnë shkaqet themelore të performancës jo të kënaqshme.

ISSAI 300 parashtron Parimet Themelore të Auditimit të Performancës. ISSAI 3000 ofron një Standard më të detajuar të Auditimit të Performancës, ndërsa ISSAI 3100 dhe 3200 japin respektivisht Udhëzime për konceptet themelore të auditimit të performancës dhe procesin e auditimit të performancës. Duke reflektuar natyrën e auditimit të performancës, ISSAI-t për auditimin e performancës theksojnë nevojën për fleksibilitet

në dizenjimin e një auditimi specifik, nevojën që audituesi të jetë i hapur dhe krijues në mbarëvajtjen e auditimit, sikurse nevojën për të ushtruar gjykim profesional gjatë gjithë auditimit (ISSAI 300:5). Metodatat e përdorura në auditimin e performancës janë shpesh të ngjashme me ato të përdorura në shkencat shoqërore dhe në shumë vende, audituesit e performancës janë të formuar në disiplina të tilla.

Si përcaktohet nëse aktiviteti i SAI-t përfshin auditimin e performancës

Përpara aplikimit të treguesve, vlerësuesi duhet të shqyrtojë nëse SAI ka mandat për të kryer auditimin e performancës dhe nëse lloji i auditimit të kryer nga SAI klasifikohet si auditim performance, sikurse përkufizohet nga ISSAI-t. Auditimi i performancës realizohet më së shumti si një angazhim i veçantë auditues, që finalizohet me një raport auditimi performance për Legjislativin. Gjithashtu, elementë të auditimit të performancës mund të jenë pjesë e një auditimi më të gjerë, që gjithashtu përfshinë auditimin e përputhshmërisë dhe/ose financiar. Për të identifikuar nëse performanca është objektivi primar i auditimit, duhet theksuar se auditimi i performancës përqendrohet tek aktiviteti dhe rezultati, përkundër raporteve ose llogarive dhe se objektivi kryesor është promovimi i performancës efektive, ekonomike dhe eficiente, përkundër raportimit mbi pajtueshmërinë. (ISSAI 300: 14)

Shumica e kritereve në treguesit e performancës janë marrë nga ISSAI 300: Parimet Themelore të Auditimit të Performancës. Në ato raste kur parimet në ISSAI 300 janë të njëjta ose të ngjashme me kërkesat e ISSAI 3000, janë përfshirë referenca të dyfishta. Disa kritere nuk janë marrë drejtpërdrejt nga ISSAI-t (si për shembull SAI-13 (i) mbi momentin e duhur të publikimit të raportit auditues), sepse këto kritere reflektojnë koncepte të ISSAI-ve, të cilat vetë nga ana e tyre nuk mund të përdoren direkt si kritere. Në raste të tilla, Grupi i Punës së KMP i SAI-t sugjeroi kritere specifike të cilat u testuan në versionin Pilot të KMP së SAI-t. Kritere të tilla referohen apo identifikohen si “Grupi i Punës së KMP i SAI-t”.

Referojuni Shtojcës 1 për përkufizimet dhe shpjegimet e termave kyç

SAI-12: Standardet e Auditimit të Përformancës dhe Menaxhimit të Cilësisë

Ky tregues është specifik për parimet themelore të auditimit të performancës. SAI-12 adreson themelet e praktikës së auditimit të performancës, duke përfshirë standardet e auditimit dhe materiale udhëzuese, sikurse dhe proceset e SAI-t për të garantuar cilësinë e auditimeve të performancës. Sistemet e përgjithshme të SAI për garantimin e cilësisë së punës audituese janë vlerësuar në treguesit mbi kontrollin e cilësisë në SAI-4 dhe stafi i rekrutimit dhe trajnimit në disiplinat përkatëse të auditimit në SAI-11 dhe SAI-23.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Standardet dhe Politikat e Auditimit të Performancës;*
- (ii) *Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës;*
- (iii) *Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Performancës.*

(i) Standardet dhe Politikat e Auditimit të Performancës: Ky dimension shqyrton nëse standardet e auditimit të një SAI janë në përputhje me parimet themelore të auditimit të performancës në ISSAI 300. Dimensioi merr gjithashtu parasysh nëse SAI ka implementuar politika dhe procedura për audituesit e saj, të cilat interpretojnë standardet në kontekstin e SAI-t individual. Të tilla politika dhe procedura mund të gjenden në dokumente të ndryshme, p.sh. në manualët e auditimit. Ato duhet të dokumentohen me shkrim.

(ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës: Ky dimension shqyrton nëse SAI ka krijuar një sistem për të garantuar se anëtarët e grupit të auditimit të performancës zotërojnë si një e tërë kompetencat profesionale, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për të kryer auditimin në fjalë. Dimensioi shqyrton gjithashtu mbështetjen që SAI ofron për audituesit e tij të performancës. Për të pikëzuar dimensionin, vlerësuesit mund shqyrtojnë politikat dhe procedurat e SAI-t për të formuar grupe audituese, si edhe ofrimin e materialeve apo formave të tjera të mbështetjes. Për të verifikuar nëse grupet e auditimit janë krijuar në përputhje me politikat dhe procedurat e SAI-t, vlerësuesit mund të shqyrtojnë dokumentacionin e planifikimit të auditimit për kampionin e auditimeve të marra nën shqyrtim.

(iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Performancës: shqyrton se si masat e kontrollit të cilësisë për auditimin e performancës janë zbatuar në praktikë, siç dëshmohet nëpërmjet rishikimit të dosjeve të auditimit. Kontrolli i cilësisë përshkruan shumë e masave të marra për të garantuar cilësi të lartë të çdo produkt auditimi dhe kryhet si

pjesë përbërëse e procesit të auditimit. Në kontrollin e cilësisë mund të përfshihen disa persona dhe në faza të ndryshme të procesit të auditimit. Menaxherët e linjës dhe përgjegjësit e grupeve luajnë shpesh një rol kyç, duke qenë se ata shqyrtojnë projektplanet, punën audituese dhe projekt raportin përpara se auditimi të finalizohet. Procedurat për vigjilimin e cilësisë duhet të garantojnë se janë përmbushur kërkesat e aplikueshme dhe të vendosin theksin në raportet e duhura, të balancuara dhe objektiviteti që shtojnë vlerë dhe i përgjigjen pyetjeve të auditimit (ISSAI 300: 32). Duhet mbajtur në vëmendje se sistemi i kontrollit të cilësisë në nivel organizativ për SAI-t matet diku tjetër në kornizën e SAI-PMF (SAI-4 (iii)).

SAI-12 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioni (i) Standardet dhe Politikat e Auditimit të Performancës	
<p>SAI ka përpunuar standardet kombëtare të auditimit në përputhje me ISSAI 300 ose ka miratuar Udhëzimet e Auditimit të Performancës INTOSAI-t (ISSAI 3000-3999) si standarde qeverisëse të tij. <i>ISSAI 300:4, 7.</i></p> <p>Adoptimi i standardeve në përputhje me ISSAI 300 mund të konsiderohet që përmbush të gjitha kriteret/nevojat e mëposhtme:</p> <p>a) Janë identifikuar elementët e secilit auditim performance (audituesit, pala përgjegjëse, përdoruesit e synuar, çështja e auditimit dhe kriteret). <i>ISSAI 300:15</i></p> <p>b) Është vendosur një objektiv i mirë-përkufizuar auditues që lidhet me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit. <i>ISSAI 300:25</i></p> <p>c) Është përzgjedhur një qasje audituese, që lehtëson logjikën e dizenjimit të auditimit. <i>ISSAI 300:26 (Qasje audituese përcakton natyrën e ekzaminimit. Auditimi i performancës në përgjithësi ndjek një nga tre qasjet: qasje të orientuar nga sistemi; qasje të orientuar drejt rezultateve; ose qasje të orientuar drejt problemeve. ISSAI 300:26).</i></p> <p>d) Janë identifikuar kriteret të përshtatshme [auditimi] të cilat korrespondojnë me pyetjet e auditimit dhe janë të lidhura me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit. <i>ISSAI 300:27</i></p> <p>e) Është menaxhuar aktivisht risku i auditimit, i cili është risku i nxjerrjes së konkluzioneve të pasakta ose jo të plota, duke ofruar për rrjedhojë</p>	ISSAI 300

informacion të pabalancuar ose duke dështuar në shtimin e vlerës tek përdoruesit. *ISSAI 300:28*

- f) Është ruajtur komunikimi efektiv dhe i duhur me subjektin e audituar dhe palët e interesuara në procesin e auditimit, duke përkufizuar përmbajtjen, procesin dhe marrësit e informacionit për secilin auditim. *ISSAI 300:29*
- g) Grupi i auditimi ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin. *ISSAI 300:30*
- h) Është aplikuar skepticismi dhe gjykimi profesional. *ISSAI 300:31*
- i) Audituesit kanë zbatuar procedurat për vigjilimin e cilësisë, duke garantuar se kërkesat e aplikueshme janë plotësuar (...). *ISSAI 300:32*
- j) Është konsideruar materialiteti në të gjitha fazat e procesit të auditimit. *ISSAI 300:33*
- k) Është dokumentuar auditimi (...) në mënyrë të tillë që “informacioni [është] mjaftueshëm i plotë dhe i detajuar, për t’i mundësuar një audituesi me përvojë dhe pa asnjë lidhje paraprake me auditimin, që të përcaktojë se çfarë është punuar për të arritur në gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet”. *ISSAI 300:34*
- l) Është planifikuar auditimi në mënyrë të tillë që të kontribuojë në rritjen e cilësisë dhe duke u kryer në mënyrë ekonomike, efektive, eficiente, në kohë dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të duhur të projektit. *ISSAI 300:37*
- m) Është grumbulluar evidencë e mjaftueshme dhe relevante audituese për të formuluar gjetjet, filtruar konkluzionet në përgjigje të pyetjeve dhe objektivave të auditimit, si edhe lëshuar rekomandimet përkatëse. *ISSAI 300:38.*
- n) Audituesit janë përpjekur të ofrojnë raporte auditimi të kuptueshme, të plota, bindëse, koherente, të lexueshme dhe të balancuara. *ISSAI 300:39*
- o) SAI-t janë përpjekur t’i aksesojnë gjerësisht raportet e tyre tek publiku, në përputhje me mandatin e SAI-t. *ISSAI 300:41*
- p) SAI-t janë përpjekur të gjenerojnë rekomandime konstruktive, atje ku është e mundur dhe në përputhje me mandatin e tyre. *ISSAI 300:40*
- q) Janë ndjekur gjetjet dhe rekomandimet e mëparshme audituese, kurdoherë që ka qenë e përshtatshme. *ISSAI 300:42*

<p>SAI ka adoptuar politika dhe procedura për mënyrën sesi do t'i implementojë standartet e veta audituese. <i>ISSAI 20:3; 40:fq. 11</i>. Këto duhet të mbulojnë fushat në vijim:</p> <p>r) Planifikimi i auditimit, përfshirë zgjedhjen e temave të auditimit. Politikat dhe procedurat duhet të jenë të dizenuara për të garantuar se audituesit analizojnë dhe hulumtojnë tema potenciale audituese, duke marrë parasysh rëndësinë, auditueshmërinë dhe impaktin e auditimeve të planifikuara. Gjatë planifikimit, audituesit duhet të lënë vend për fleksibilitet në të ardhmen. <i>ISSAI 300:36, 37. Shih gjithashtu ISSAI 3000:89-90</i>.</p> <p>s) Proceset analitike që i mundësojnë audituesve të përftojnë evidencë të mjaftueshme dhe të duhur audituese, për të identifikuar gjetjet dhe arritur në konkluzione, në përgjigje të objektivave dhe pyetjeve audituese. <i>ISSAI 300:38</i></p> <p>t) Format i raportit të auditimit, i cili duhet të përmbajë informacion në lidhje me objektivat e auditimit, kriteret, metodologjinë, burimet e të dhënave dhe gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet. <i>ISSAI 300:39</i></p> <p>u) Dokumentimi i auditimit. Politikat dhe procedurat duhet të jenë të dizenuara për të garantuar se “Informacioni [është] mjaftueshëmrisht i plotë dhe i detajuar për t'i mundësuar një audituesi me përvojë dhe që nuk ka lidhje të mëparshme me auditimin, që të përcaktojë më pas çfarë pune është bërë për të arritur në gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet.” <i>ISSAI 300:34</i>.</p> <p>Pikëzimi = 4: Kriteret (b), (d), (m), (s) dhe të paktën pesëmbëdhjetë prej kriterëve të tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (b), (m) dhe të paktën dymbëdhjetë prej kriterëve të tjera të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dhjetë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën pesë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se pesë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës</p>	
<p>SAI ka krijuar një sistem për të garantuar se” Grupi i auditimit [kolektivisht dhe duke përfshirë edhe ekspertët të jashtëm, kur kërkohen] ka kompetencën</p>	<p>ISSAI 40</p>

<p>profesionale të nevojshme për të kryer auditimin” , përfshirë: <i>ISSAI 300:30. Shih gjithashtu ISSAI 40: fq. 10.</i></p> <p>a) njohuri të mira të auditimit [të performancës], duke përfshirë edhe kuptimin e standarteve të aplikueshme të auditimit. <i>ISSAI 300:30</i></p> <p>b) njohuri të mira të (...) projektimit kërkimor, metodave të shkencave sociale dhe teknikave të vlerësimit ose investigimit. <i>ISSAI 300:30</i></p> <p>c) njohuri të mira mbi organizatat qeveritare, programet dhe funksionet. <i>ISSAI 300:30</i></p> <p>d) aftësi personale të tilla si: analitike, të shkruara dhe komunikimi <i>ISSAI 300:30</i></p> <p>e) aftësi dhe përvojë për të ushtruar gjykim profesional. <i>ISSAI 300:31</i></p> <p>f) Sistemi garanton se njohuritë, aftësitë dhe ekspertiza e nevojshme për kryerjen e auditimit të performancës janë identifikuar. <i>Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>g) Sistemi garanton se ka linja të qarta të raportimit dhe alokimi të përgjegjësive brenda ekipit. <i>Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>SAI ofron gjithashtu mbështetje për audituesit e tij, siç kërkohet për të zbatuar standardet e miratuara të auditimit dhe zhvilluar aftësitë e tyre profesionale: <i>ISSAI 1:13, ISSAI 40: fq 10-11, ISSAI 300:30 (p.sh. në formën e manualeve të auditimit dhe materialeve të tjera udhëzuese, trajnimeve në vendin e punës dhe promovimin e zhvillimit profesional, akses në ekspertë dhe/ose informacion nga burimet e jashtme.)</i></p> <p>h) Si të përpunohen objektivat audituese dhe pyetjet audituese që lidhen me parimet e ekonomicitetit, eficiencës, dhe/ose efektivitetit. <i>ISSAI 300:25</i></p> <p>i) Si të vendosen kritere të përshtatshme audituese të cilat korrespondojnë me pyetjet e auditimit dhe janë të lidhura me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit. <i>ISSAI 300:27</i></p> <p>j) Si të dizajnohen procedurat audituese që do të përdoren për mbledhjen e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit. <i>ISSAI 300:37</i></p> <p>k) Si të aplikohen metoda të ndryshme për grumbullimin e të dhënave. <i>ISSAI 300:38 (P.sh., analiza statistikore, anketat, intervistat, etj.)</i></p>	<p>ISSAI 300</p>
---	------------------

<p>l) Si të vlerësohen evidencat audituese nën dritën e objektivave të auditimit. <i>ISSAI 300:38</i></p> <p>m) Si të shkruhen raporte audituese të cilat janë të plota, bindëse, të lexueshme dhe të paanshme. <i>ISSAI 300:39</i></p> <p>n) Si të formulohen rekomandimet të bazuara dhe vlerë-shtuese. <i>ISSAI 300:40</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri (a), (h), (i) dhe të paktën shtatë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe së paku pesë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Performancës</p>	
<p>a) E gjithë puna e kryer duhet të jetë subjekt i rishqyrtimit si një mjet për të kontribuar në cilësi dhe nxitjen e të mësuarit e zhvillimit të personelit” , dhe procesi i rishqyrtimit duhet dokumentuar. <i>ISSAI 40: fq. 11-12 (dmth duke përfshirë rishikimin e planit të auditimit, letrat e punës dhe punën e ekipit; dhe monitorimin e rregullt të progresit nga nivelet e duhura të menaxhimit. Rishikimi duhet të sigurojë që kërkesat e aplikueshme janë përmbushur dhe është vendosur theksi në raporte të drejta, të përshatshme, të balancuara, vlerë-shtuese dhe që adresojnë pyetjet e auditimit. Parametrat e kontrollit të përgjithshëm të cilësisë duhet të plotësohen me parametra specifike auditues. <i>ISSAI 300:32; 37, Grupi i Punës i KMP i SAI-t).</i></i></p> <p>b) “Audituesit duhet të zbatojnë procedurat për vigjilimin e cilësisë, duke garantuar se kërkesat e aplikueshme janë plotësuar (...).” <i>ISSAI 300:32</i></p> <p>c) “Kur lindin çështje të vështira ose të debatueshme, SAI duhet të garantojë se burimet e përshtatshme (të tilla si ekspertët teknikë) janë angazhuar për të trajtuar çështje të tilla”. <i>ISSAI 40: fq 11</i></p> <p>d) “(...) çdo mospërputhje qëndrimesh brenda SAI-t është dokumentuar dhe zgjidhur në mënyrë të qartë përpara emetimit të raportit”. <i>ISSAI 40: fq 12</i></p> <p>e) “SAI-t duhet të njohin rëndësinë e angazhimit në rishqyrtimet e fokusuara mbi kontrollin e cilësisë për punën e tyre dhe [atëherë kur këto rishqyrtime kryhen] çështjet e ngritura duhet të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme</p>	<p>ISSAI 40</p> <p>ISSAI 300</p>

përpara se të emetohet raporti”. *ISSAI 40:fq 12* (dmth SAI duhet të ketë një politikë se nëse dhe kur kryhen shqyrtimet e gjithë procesit auditues nga punonjësit me përvojë që nuk janë të përfshirë në auditim, përpara se të emetohet raporti - theksojmë se kjo është pjesë e kontrollit të cilësisë dhe jo e garantimit të cilësisë. *Grupi i Punës i KMP i SAI-t*)

- f) “Janë dizenuar procedura për autorizimin e raporteve që do të emetohen”. *ISSAI 40:fq 12* (dmth: kryerja e kontrollit të cilësisë për projekt-raportet; zakonisht duke përfshirë rishikimin nga ana e niveleve të ndryshme të menaxhimit dhe mundësisht diskutime me grupin auditues dhe/ose ekspertë të jashtëm.

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Të paktën pesë kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.

SAI-13: Procesi i Auditimit të Performancës

Ky tregues vlerëson se si auditimet e performancës kryhen në praktikë. Ai fokusohet specifikisht mbi fazën e planifikimit, faza e zbatimit dhe fazën e raportimit. Vlerësimi i këtij treguesi duhet të bëhet kryesisht duke shqyrtuar një kampion dosjesh auditimi të performancës që i përkasin vitit nën vlerësim. Mund të jetë i dobishëm edhe intervistimi i grupeve të punës që ka kryer këto auditime. Si rregull, që secili kriter të konsiderohet i plotësuar, kërkesat për të (kriterin) duhen dokumentuar në mënyrë që të konsiderohet i plotësuar (për shembull në planin e auditimit, në letrat e punës, në raportin e auditimit).

Gjithashtu, referojuni Aneksit 1 për përkufizimet dhe shpjegime të termave kryesore.

Lidhje për vlerësimin e pajtueshmërisë së SAI-t me ISSAI-t e nivelit 4

Është praktikë e mirë që SAI-t të kryejnë vlerësime të garantimit të cilësisë për punën e tyre audituese. Nëse SAI-t raportojnë që kanë kryer auditime performance në përputhje me ISSAI 3000-3999, ata duhet të kenë një sistem të ngritur për të garantuar se janë në përputhje me ISSAI e nivelit 4 (shih *ISSAI 100:7-12*). Për të inkurajuar vlerësime të tilla dhe trajtuar rastet kur SAI e ka kryer një vlerësim të pajtueshmërisë së tij me ISSAI-t e nivelit të katërt, vlerësimi me katër (4) i indikatorëve të procesit të auditimit në SAI-PMF (SAI-9, SAI-12, SAI-15) kërkon që SAI ta ketë kryer një shqyrtim të tillë dhe që shqyrtimi ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat përkatëse të nivelit 4. Është në dorë të vlerësuesit për të përcaktuar nëse ndonjë çështje e mospërputhjes së vërejtur në vlerësime të tilla ka të bëjë kryesisht me dimensionet e planifikimit, zbatimit ose raportimit në KMP e SAI-t . Kjo do ta lehtësonte mbështetjen e SAI-t në rezultatet e vlerësimeve të tilla, përgjatë vlerësimit të treguesve në KMP e SAI-t .

Nëse SAI nuk i ka kryer auditimet e tij në përputhje me ISSAI-t e nivelit 4, por i ka mbështetur më tepër ato në në standarde konsistente me parimet themelore të auditimit të performancës (niveli 3 ISSAI-ve: ISSAI 300) kriteret e mëposhtme mund të përdoren për të vlerësuar dhe pikëzuar proceset e auditimit të performancës së SAI-t.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Planifikimi i Auditimeve të Performancës;*
- (ii) *Implementimi i Auditimeve të Performancës;*
- (iii) *Raportimi i Auditimeve të Performancës.*

Këto dimensione përcaktojnë kriteret e auditimit të performancës për planifikimin, zbatimin, konkludimin dhe raportimin, siç është përcaktuar në ISSAI 300. Kampionimi i dosjeve të auditimit është baza për vlerësimin e kriterëve në dimensionin,. Shihni gjithashtu hyrjen në Fushën C.

SAI-13 Dimensioani & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioani (i): Planifikimi i Auditimeve të Performancës	
<p>a) "(...) Njohuritë specifike për auditimin në fjalë, substanciale [të lidhura me subjektin që trajtohet] dhe metodologjike janë përfutur përpara se auditimi të njoftohet zyrtarisht [faza studimore e tij]". ISSAI 300:37. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000:98</i></p> <p>b) "Audituesit duhet të (...) analizojnë çështje potenciale audituese dhe të identifikojnë risqet dhe problemet". ISSAI 300:36.</p> <p>c) "Audituesit duhet konsiderojnë materialitetin në të gjitha fazat e procesit auditues. Vëmendje duhet t'i kushtohet jo vetëm aspektit financiar, por edhe aspekteve sociale dhe politike të çështjes objekt-auditimi, me qëllim gjenerimin e një vlere të shtuar maksimale." ISSAI 300:33. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000:83</i></p> <p>d) "Audituesit duhet vendosin një objektiv auditues të mirë-përkufizuar që lidhet me parimet e ekonomisë, eficiencës dhe efektivitetit". ISSAI 300:25. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000:35.</i></p> <p>e) "Objektivat e auditimit mund paraqiten si një pyetje audituese gjithëpërfshirëse, e cila mund të detajohet në nën-pyetje më të fokusuara". ISSAI 300:25. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000:36-37.</i></p> <p>f) "Audituesit duhet të zgjedhin një qasje të orientuar kah rezultati, problemi, sistemi, ose një kombinim të tyre, për të lehtësuar fokusimin e dizajnit të auditimit". ISSAI 300:26. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000: 40. (Qasja e auditimit përcakton natyrën e ekzaminimit. Auditimi i performancës në përgjithësi ndjek një nga tre qasjet: qasje të orientuar nga sistemi, qasje të orientuar nga rezultati ose qasje të orientuar nga problemi. ISSAI 300:26).</i></p> <p>g) "Audituesit duhet të konsolidojnë kriteret të përshtatshme, në përputhje me pyetjet e auditimit dhe të lidhura me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit". ISSAI 300:27. <i>Shih gjithashtu ISSAI 3000:45.</i></p>	<p>ISSAI 300</p> <p>ISSAI 30</p>

- h) “Kriteret duhet të diskutohen me subjektet e audituara, por përgjegjësia finale e përzgjedhjes së kriterëve të përshtatshme i mbetet audituesit.” *ISSAI 300:27. Shih gjithashtu ISSAI 3000:49.*
- i) “Gjatë planifikimit të auditimit, audituesi duhet të përcaktojë procedurat audituese për mbledhjen e evidencës së mjaftueshme dhe të duhur”. *ISSAI 300:37. Shih gjithashtu ISSAI 3000:101.*
- j) “Kur planifikojnë auditimin, audituesit duhet të vlerësojnë riskun e mashtrimit”. *ISSAI 300:37. Shiko gjithashtu ISSAI 3000:73.*
- k) Audituesit duhet ta planifikojnë auditimin në një mënyrë të tillë që të kontribuojë në cilësi të lartë audituese dhe duke u kryer në mënyrë ekonomike, eficiente, efektive, në kohën e duhur si dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë të projektit.” *ISSAI 300:37. Shih gjithashtu ISSAI 3000:96 (dmth duke mbajtur në konsideratë koston preventive të auditimit dhe afatet kyçe të e projektit e “gurët kilometrikë”. ISSAI 300:37).*
- l) “Audituesit duhet të vlerësojnë nëse dhe në cilat fusha është e nevojshme ekspertiza e jashtme, duke ndërmarrë modifikimet e nevojshme”. *ISSAI 300:30. Shih gjithashtu ISSAI 3000:65.*
- m) SAI ka krijuar një sistem për të garantuar se, në nivelin e angazhimit të auditimit, audituesit e saj [dhe çdo person i kontraktuar] përputhet me kërkesat e mëposhtme etike: integritetin, pavarësinë dhe objektivitetin, kompetencën, sjelljen profesionale, konfidencialitetin dhe transparencën. *ISSAI 30 (p.sh. duke shmangur marrëdhëniet afatgjata me të njëjtin subjekt të audituar dhe kërkuar deklaratat e duhura nga stafi në lidhje me etikën dhe pavarësinë)*

Pikëzimi =4: Një vlerësim i pavarur (p.sh: shqyrtim i sigurimit të cilësisë, shqyrtim i pavarur ose ndërmjet kolegësh, iCAT subjekt i garantimit të pavarur të cilësisë, i kryer brenda tre vitet e fundit) i praktikës së auditimit të performancës së SAI ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit katër përkatëse për këtë dimension (Përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme).

Pikëzimi =3: Të paktën dhjetë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi =2: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen

Pikëzimi = 1: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Dimensioni (ii): Implementimi i Auditimeve të Performancës

- a) "Audituesit duhet të sigurojnë evidencën e duhur dhe të mjaftueshme audituese për të identifikuar gjetjet, filtruar konkluzionet në përgjigje të objektivave dhe pyetjeve të auditimit dhe [kur e përshtatshme] gjeneruar rekomandimet." *ISSAI 300:23, 38. Shih gjithashtu ISSAI 3000:106.*
- b) "Audituesi duhet të vlerësojë evidencat me qëllim identifikimin e gjetjeve të auditimit". *ISSAI 300:38.*
- c) "Audituesit duhet të kombinojnë dhe krahasojnë të dhënat nga burime të ndryshme (...)." *ISSAI 300:38.*
- d) "Bazuar në gjetjet, audituesi duhet të ushtrojë gjykim profesional për të arritur në një konkluzion [që] ofron përgjigje për pyetjet e auditimit". *ISSAI 300:38.*
- e) Evidenca e auditimit "(...) duhet të vendoset në kontekst dhe të gjithë argumentet përkatëse, avantazhet dhe disavantazhet e perspektivave të ndryshme duhet të merren në konsideratë përpara se të nxirren konkluzionet, duke riformuluar objektivin dhe pyetjet audituese sipas nevojës." *ISSAI 300:38-39. Shih gjithashtu ISSAI 3000:112.*
- f) "Auditimi i performancës përfshin një seri procesesh analitike që evoluojnë gradualisht përmes ndërveprimit të ndërsjellë (...)." *ISSAI 300:38.*
- g) "Duhet të ruhet dhe shfaqet një standard i lartë i sjelljes profesionale përgjatë gjithë procesit të auditimit (...)." *ISSAI 300:31. Shih gjithashtu ISSAI 3000:75 (p.sh. audituesit duhet të punojnë në mënyrë sistematike, me kujdesin dhe objektivitetin e duhur. ISSAI 300:31).*
- h) "Audituesit duhet të menaxhojnë aktivisht riskun e auditimit, i cili është rreziku i filtrimit të konkluzioneve të pasakta ose të paplota, duke ofruar informacion të pabalancuar ose duke dështuar në shtimin e vlerës për përdoruesit". *ISSAI 300:28. Shih gjithashtu ISSAI 3000:52. (dmth të identifikojnë në dokumentet planifikues risqe të tilla, si dhe masat parandaluese përkatëse, duke i ndjekur aktivisht ato gjatë implementimit të auditimit. ISSAI 300:28.*
- i) "Audituesit duhet konsiderojnë materialitetin në të gjitha fazat e procesit auditues. Vëmendje duhet t'i kushtohet jo vetëm aspektit financiar, por edhe aspekteve sociale dhe politike të çështjes objekt-auditimi, me qëllim gjenerimin e një vlere të shtuar maksimale." *ISSAI 300:33. Shih gjithashtu ISSAI 3000:83*
- j) "Audituesit duhet të vendosin ura efektive dhe të duhura komunikimi me subjektet e audituara dhe palët e interesuara gjatë procesit të auditimit

ISSAI 300

<p>(...)” ISSAI 300:29. <i>Shih gjithashtu 3000:55 (përfshirë njoftimin e subjektit të audituar për aspektet kryesore të auditimit, si edhe objektivin e auditimit, pyetjet e auditimit dhe çështjet e auditimit ISSAI 300:29)</i></p> <p>k) “Audituesit duhet të dokumentojnë auditimin (...). Informacioni duhet të jetë mjaftueshmërisht i plotë dhe i detajuar për t’i mundësuar një audituesi me përvojë dhe që nuk ka asnjë lidhje paraprake me auditimin për të përcaktuar se çfarë është punuar për të arritur në gjetjet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet”. <i>ISSAI 300:34. Shih gjithashtu ISSAI 3000:86.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh: shqyrtim i sigurimit të cilësisë, shqyrtim i pavarur ose ndërmjet kolegësh, iCAT subjekt i garantimit të pavarur të cilësisë, i kryer brenda tre vitet e fundit) i praktikës së auditimit të performancës së SAI ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit katër relevante për këtë dimension (Përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme).</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën tetë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (iii): Raportimi i Auditimeve të Performancës</p>	
<p>a) “Në një auditim performance, audituesit raportojnë gjetjet e tyre për ekonomikitetin, eficiencën [e përdorimit të burimeve] dhe efektivitetin me të cilin objektivat përmbushen”. <i>ISSAI 300:39. (Duhet të theksohet se raportet mund të ndryshojnë sipas fushëveprimit dhe natyrës. Ata për shembull mund të vlerësojnë nëse burimet janë alokuar në mënyrën e duhur, dhe/ose komentojnë mbi ndikimin e politikave dhe programeve. ISSAI 300:39)</i></p> <p>b) “Audituesit duhet të përpiqen që të gjenerojnë raporte auditimi të kuptueshme (...)”. <i>ISSAI 300:39. Shih gjithashtu ISSAI 3000:116-117. (dmth përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të adresuar objektivin dhe pyetjet e auditimit, duke qenë njëkohësisht mjaftueshëm i detajuar për të ofruar një kuptueshmëri të çështjes objekt-auditimi, si dhe gjetjeve e konkluzioneve mbi të. ISSAI 300:39)</i></p>	<p>ISSAI 300</p>

- c) "Audituesit duhet të përpiqen që të gjenerojnë raporte auditimi bindëse (...)." ISSAI 300:39. Shih gjithashtu ISSAI 3000:116, 118. (dmth që janë të strukturuar logjikshëm dhe paraqesin një lidhje të qartë mes objektivit të auditimit, kriterëve, gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve). ISSAI 300:38
- d) "Audituesit duhet të përpiqen që të gjenerojnë raporte auditimi të lexueshme (...)." ISSAI 300:38. Shih gjithashtu ISSAI 3000:116, 120 (dmth janë aq të qarta dhe koncize sa lejon çështja objekt-auditimi dhe formuluar në gjuhë të qartë) ISSAI 300:38.
- e) "Audituesit duhet të përpiqem që të gjenerojnë raporte auditimi (...) të balancuara". ISSAI 300:38. Shih gjithashtu ISSAI 3000:126, 131 (dmth balancuar në përmbajtje dhe ton. E gjithë evidenca duhet paraqitur paanësisht). ISSAI 3000:131
- f) "Audituesit duhet të marrin parasysh materialitetin në të gjitha fazat e procesit të auditimit." ISSAI 300:33. Shih gjithashtu ISSAI 3000:83. (dmth menaxhimin e riskut të gjenerimit të gjetjeve apo raporteve të papërshtatshme apo me ndikim të ulët. ISSAI 300:33)
- g) "Raporti duhet të përfshijë informacion në lidhje me (...) kriteret e [auditimit] [dhe burimet e tyre]". ISSAI 300:39. Shih gjithashtu ISSAI 3000:122
- h) Raporti duhet të përfshijë konkluzione në përgjigje të objektivit të auditimit dhe pyetjeve," (...) t'i përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjeve të auditimit apo të shpjegojë pse kjo nuk ishte e mundshme" ISSAI 300:38-39. Shih gjithashtu ISSAI 3000:124.
- i) "Nëse është relevante dhe e lejuar nga mandati i SAI-t, audituesit duhet të synojnë gjenerimin e rekomandimeve konstruktive që potencialisht kontribuojnë ndjeshëm në adresimin e dobësive apo problemeve të identifikuar nga auditimi". ISSAI 300:40. Shih gjithashtu ISSAI 300:39, ISSAI 3000:126
- j) "SAI-t duhet të deklarojnë cilat standarte aplikojnë kur kryejnë auditime, dhe kjo deklaratë duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve të raportit të SAI-t". ISSAI 100:8. (Referenca për standardet e auditimit mund të përfshihet në raportin e auditimit ose mund të komunikohet nga SAI në një formë më të përgjithshme, duke mbuluar një diapazon të përcaktuar angazhimesh. ISSAI 300:7)

- k) “Subjekteve të audituara duhet t'i jepet mundësia për të komentuar mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit përpara se SAI tyë publikojë raportin e auditimit.” *ISSAI 300:29. Shih gjithashtu ISSAI 3000:129*
- l) “Çdo mosmarrëveshje [me entitetin e audituar] duhet të analizohet dhe gabimet faktike të korrigojen. Shqyrtimi i observacioneve duhet të regjistrohet në letrat e punës në mënyrë që ndryshimet në projekt-raportin e auditimit apo arsyet për të mos bërë ndryshime, të jenë të dokumentuara. *ISSAI 300:29. Shih gjithashtu ISSAI 3000:130*

Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh: shqyrtim i sigurimit të cilësisë, shqyrtim i pavarur ose ndërmjet kolegësh, iCAT subjekt i garantimit të pavarur të cilësisë, i kryer brenda tre vitet e fundit) i praktikës së auditimit të performancës së SAI ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit katër përkatëse për këtë dimension (Përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme).

Pikëzimi = 3: Të paktën nëntë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen. Pikëzimi = 1: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

SAI-14: Rezultatet e Auditimit të Performancës

Treguesi lidhet me *output*-et e auditimit të performancës, paraqitjen dhe publikimin në kohë të raporteve të auditimit të performancës dhe ndjekjen e rezultateve të auditimit.

(i) Dorëzimi në Kohë i Auditimit të Rezultateve të Performancës: Raportet e auditimit të performancës duhet t'i paraqiten autoritetit përkatës në një mënyrë të përshtatshme. Paraqitja përfshin dërgimin/dhënien e raportit final autoritetit që është përgjegjës për shqyrtimin e raportit, si dhe për marrjen e masave respektive. Në disa vende, raportet e performancës i paraqiten Legjislativit, si marrësi formal, ndërsa kopje të tjera ndahen me palë të tjera të interesit për informacion. Raporti i auditimit është përfundimtar kur vendimmarrësi në SAI (p.sh. Kryetari i SAI-t ta ketë miruar).

(ii) Publikimi në Kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës: SAI-et duhet të kërkojnë që raportet e tyre të jenë të gjerësisht aksesueshme, përfshirë publikun (*ISSAI 300:41*). SAI-et mund të publikojnë raportet e auditimit në faqet elektronike dhe/ose në formë të shtypur. Legjislacioni vendos përshkruan fazën e procesit kur SAI-t i lejohet të publikojë raportin e auditimit (p.sh. vetëm pasi raporti të jetë dorëzuar në Parlament).

(iii) Ndjekja e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës dhe Gjetjeve: Ndjekja i referohet asaj çka SAI ndërmerr për të gjurmuar observacionet dhe rekomandimet dhe asaj se ç'kanë bërë subjektet e audituara për zbatimin e tyre (*ISSAI 300:42*). Ky dimension shqyrtton ndjekjen e gjetjeve të auditimit të performancës. Në disa vende, Parlamenti (një komision i përhershëm si Komisioni i Financave Publike ose një seancë plenare e Parlamentit) nxjerr rekomandime shtesë për qeverinë dhe subjektet e audituara mbi bazën e auditimeve të SAI-t. Në këtë kontekst, SAI mund të fokusojë aktivitetin e ndjekjes për rekomandimet e Parlamentit.

Qasja e sugjeruar për vlerësim

Vlerësimi i këtij treguesi mund të bazohet mbi informacionin nga sistemi i menaxhimit të informacionit të SAI-t. Nga ana tjetër, mund të përdoren informacione nga shqyrtimet e garantimit të cilësisë dhe/ose nga shqyrtimi i një kampioni të auditimeve të performancës.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

(i) Paraqitja në Kohë e Rezultateve të Auditimit Performancës;

(ii) Publikimi në Kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës;

(iii) Ndjekja e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës dhe Gjetjeve.

SAI-14 Dimensioni & Kriteret minimale për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioni (i) Dorëzimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Performancës	
<p>Pikëzimi = 4: Të gjitha raportet e auditimit të performancës i dorëzohen autoritetit përkatës (Legjislativit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 15 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda periudhës së përcaktuar ligjërisht) <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 3: Të gjitha raportet e auditimit të performancës i dorëzohen autoritetit përkatës (Legjislativit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 30 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda periudhës së përcaktuar ligjërisht) <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 2: Për të paktën 75% të auditimeve të performancës, raporti i dorëzohet autoritetit përkatës (Parlamentit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 45 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda periudhës së përcaktuar ligjërisht) <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 1: Për të paktën 50% të auditimeve të performancës, raporti i dorëzohet autoritetit përkatës (Parlamentit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 60 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda periudhës së përcaktuar ligjërisht) <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 0: Për më pak se 50% të auditimeve të performancës, raporti i dorëzohet autoritetit përkatës (Parlamentit, subjektit të audituar dhe/ose ministrisë përkatëse) brenda 60 ditëve nga përfundimi i auditimit (ose brenda periudhës së përcaktuar ligjërisht) <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p>	ISSAI 20
Dimensioni (ii) Publikimi në Kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës	
<p>Pikëzimi = 4: Përveçse kur pengohet nga legjislacioni, SAI i publikon të gjitha raportet e auditimit të performancës brenda 15 ditëve pasi i lejohet t'i publikojë. <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 3: Përveçse kur pengohet nga legjislacioni, SAI i publikon të gjitha raportet e auditimit të performancës brenda 30 ditëve pasi i lejohet t'i publikojë. <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p>	ISSAI 20

<p>Pikëzimi = 2: Përveçse kur pengohet nga legjislacioni, SAI publikon të paktën 75% të raporteve të auditimit të performancës brenda 60 ditëve pasi i lejohet t'i publikojë. <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 1: Përveçse kur pengohet nga legjislacioni, SAI publikon të paktën 50% të raporteve të auditimit të performancës brenda 60 ditëve pasi i lejohet t'i publikojë. <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 0: SAI publikon më pak se 50% të raporteve të auditimit të performancës brenda 60 ditëve pasi i lejohet t'i publikojë. <i>ISSAI 20:8, Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p>	
<p>Dimensioni (iii) Ndjekja e Rekomandimeve të Auditimit të Performancës dhe Gjetjeve</p>	
<p>a) "Audituesit duhet të ndjekin gjetjet dhe rekomandimet e mëparshme audituese, kudo ku është e përshtatshme". <i>ISSAI 300:42. Shih edhe ISSAI 3000:136</i></p> <p>b) "Ndjekja nuk kufizohet vetëm me implementimin e rekomandimeve, por konsiston nëse subjekti i audituar ka adresuar siç duhet problemet dhe ka rregulluar situatën e konstatuar pas një periudhe kohore të arsyeshme." <i>ISSAI 300:42. Shih edhe ISSAI 3000:136</i></p> <p>c) Nëse është e mundur, raporti i ndjekjes së rekomandimeve përfshin "(...) konkluzionet dhe impaktin e të gjitha veprimeve korrigjuese." <i>ISSAI 300:42. Shih edhe ISSAI 3000:136</i></p> <p>d) "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të SAI i mundësojnë subjektit të audituar që të ofrojë informacion mbi ndërmarrjen ose jo të masave korrigjuese". <i>ISSAI 20:3</i></p> <p>e) "Ndjekja e rekomandimeve duhet të raportohet në mënyrë të përshtatshme për të ofruar <i>feedback</i> për Legjislativin." <i>ISSAI 300:42. Shih edhe ISSAI 10:7 dhe ISSAI 3000:136</i></p> <p>f) Rezultatet e ndjekjes së rekomandimeve mund të raportohen individualisht ose në një raport të konsoliduar, i cili mund të përfshijë një analizë të auditimeve të ndryshme, mundësisht duke theksuar të tendencat dhe tematikat për disa fusha raportimi. <i>ISSAI 300:42</i></p> <p>g) SAI ka krijuar një praktikë për vlerësimin e materialitetit dhe rëndësinë e problemeve të konstatuara, për të përcaktuar nëse ndjekja e rekomandimeve kërkon një auditim të ri shtesë. <i>Grupi i Punës i KMP i SAI-t, ISSAI 100:41, ISSAI 300:33. Shih gjithashtu ISSAI 3200:152-153</i></p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p> <p>ISSAI 100</p> <p>ISSAI 300</p>

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 3: Pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 2: Tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 1: Një nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.	

Auditimi i Përputhshmërisë – Hyrje

“Objektivi i auditimit të përputhshmërisë është të mundësojë SAI-n që të vlerësojë nëse aktivitetet e njësive të sektorit publik janë në përputhje me kornizën rregullatore . (ISSAI 400:13).

Auditimi i përputhshmërisë është vlerësimi i pavarur nëse një çështje e caktuar e shqyrtuar është në përputhje me kornizën rregullatore të zbatueshëm, e cila është identifikuar si kritere. Auditimet e përputhshmërisë realizohen për të vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën rregullatore , i cili qeverisë njësinë e audituar”. (ISSAI 400:12).

“Auditimi i përputhshmërisë mund të përfshijë vlerësimin e të dyjave, si të përputhshmërisë me kriteret formale të rregullshmërisë dhe/ose me parimet e përgjithshme të menaxhimit të shëndoshë financiar publik, si dhe sjelljen e zyrtarëve publikë siç duhet të jetë. Ndërsa *rregullshmëria* është fokusi kryesor i auditimit të përputhshmërisë, por përshtatshmëria mund të jetë e aplikueshme për shkak të kontekstit të sektorit publik, ku gjithashtu ka pritshmëri në lidhje me menaxhimin financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publikë” (ISSAI 400:13).

Kriteret e zbatueshme “përfshijnë rregullat, ligjet dhe rregulloret, rezolutat buxhetore, politikat, kodet e pranuar, termat e dakodësuara ose parimet e përgjithshme të një menaxhimi të shëndoshë financiar publik dhe sjelljet e zyrtarëve publikë”.(ISSAI 400:29).

“ISSAI 400, *Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë*, i siguronë SAI-ve bazën për adoptimin ose zhvillimin e standardeve dhe udhëzuesve për kryerjen e auditimeve të përputhshmërisë. Parimet në ISSAI 400 mund të përdoren në tre mënyra”:

- Për të formuar bazën mbi të cilën zhvillohen standardet;
- Për të formuar bazën mbi të cilën adoptohen pëmbajtja e standardeve kombëtare;
- Për të formuar bazën për adoptimin e Udhëzuesve të Auditimit të Përputhshmërisë si standarde të detyrueshme.” (ISSAI 400 :5)

Si përcaktohet nëse një aktivitet auditimi është auditim përputhshmërie

Vlerësuesi duhet të marri në konsideratë nëse ndonjë nga auditimet e kryera nga SAI është auditim përputhshmërie. Karakteristika kyçe e auditimit të përputhshmërisë, siç përkufizohet nga ISSAI 400, është vlerësimi nëse çështja në shqyrtim është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kornizën ligjore dhe rregullatore që qeverisë subjektin e audituar. Shpesh herë auditimi i përputhshmërisë kryhet si aktivitet i veçantë auditimi, gjithashtu, ndodh shpesh që një auditim përputhshmërie të kryhet së bashku me auditimin financiar, kjo qasje cilësohet si auditim rregullshmërie, si dhe ndodh që të përfshihen elemente të auditimit të përputhshmërisë në auditimet e performancës. Në planifikimin e vlerësimit KMP të SAI-t, vlerësuesit duhet të marrin parasysh burimet më të përshtatshme të informacionit për të pikëzuar këta tregues të auditimit të përputhshmërisë. Kjo mund të përfshijë kombinimin e evidencave nga lloje të ndryshme auditimesh të cilat përmbajnë elemente të auditimit të përputhshmërisë.

Në shumë vende, SAI-et publikojnë një "raport mbi zbatimin e buxhetit/ligjit të buxhetit", të dallueshëm nga auditimi financiar bazuar në kërkesat e ISSAI 200. Vlerësuesit duhet të përcaktojnë nëse treguesit e auditimit financiar të SAI-9, SAI-10 dhe SAI-11 janë zbatuar ose nëse raporti i SAI-t mbi zbatimin e buxhetit duhet të vlerësohet në bazë të aspekteve të auditimit të përputhshmërisë. Ju lutemi, referohuni tek prezantimi i auditimit financiar për më tepër sqarim.

Në disa vende, Legjislativi mund të miratojë buxhetin e qeverisë bazuar në raportin mbi zbatimin e buxhetit. Ky miratim është elementi politik i kontrollit të jashtëm për implementimin e buxhetit. Në rast të parregullsive apo mospërputhjeve materiale, kuadri ligjor ofron shtyrjen e miratimit të buxhetit dhe ekzekutivi (ose një organi specifik i lidhur me procesin) i jepet një periudhe kohore e caktuar që të japë informacion mbi procedurat përkatëse. Pas kësaj periudhe, ose kur është e zbatueshme drejtëpërsëdrejti, në rast të parregullsive të tilla, mund të ndërmerren veprime të mëtejshme nga organi legjislativ për të detyruar përputhshmërinë me ligjet buxhetore dhe të tjera rregullime.

SAI-15: Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimit të Cilësisë

Ky indikator është specifik për parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë. SAI-15 shqyrton bazën për praktikën e auditimit të përputhshmërisë, duke përfshirë standardet e auditimit dhe materialin udhëzues, si dhe procesin për të garantuar cilësinë e auditimeve të përputhshmërisë nga SAI. Sistemi i përgjithshëm i SAI-t për të siguruar cilësi në punën audituese është vlerësuar nëpërmjet indikatorit mbi kontrollin e cilësisë në SAI-4, rekrutimet dhe trajnimet e stafit në disiplinat përkatëse audituese në SAI-22 dhe SAI-23.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Politikat dhe Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;*
- (ii) *Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Përputhshmërisë;*
- (iii) *Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Përputhshmërisë.*

(i) Politikat dhe Standardet e Auditimit të përputhshmërisë: Ky dimension shqyrton nëse standardet e adoptuara nga SAI janë në përputhje me parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë, të përcaktuara në ISSAI 400. Ai, gjithashtu, merr në konsideratë nëse SAI ka politika dhe procedura për interpretimin e standardeve në kontekstin e vetë SAI-t. Këto politika dhe procedura mund të gjenden në dokumente të ndryshme, p.sh. manuale. Ato duhet të dokumentohen në formë të shkruar.

(ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Përputhshmërisë: Ky dimension shqyrton nëse SAI ka vendosur një sistem që garanton se grupi i auditimit, si një i tërë, zotëron aftësitë dhe përvojën e nevojshme. Ai gjithashtu, shqyrton se çfarë mbështetjeje SAI i ofron audituesve të vetë gjatë procesit të auditimit të përputhshmërisë. Për pikëzimin e këtij dimension, vlerësuesit mund të shqyrtojnë politikat dhe procedurat e SAI-t për organizimin e grupeve të auditimit si dhe materiale udhëzuese dhe mbështetjet e tjera që ofrohen. Për të verifikuar nëse grupi i auditimit janë organizuar në përputhje me procedurat dhe politikat e SAI-t, vlerësuesit mund të shqyrtojnë dokumentacionin e planifikimit në auditivet e kampionuara.

(iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Përputhshmërisë: Shqyrton sesi masat e kontrollit të cilësisë janë zbatuar në praktikë, fakt që evidentohet përmes rishikimit të dosjeve të auditimit. Kontrolli i cilësisë përshkruan numrin e masave të ndërmarra për të siguruar një cilësi të lartë për çdo produkt auditimi dhe realizohet i integruar me procesin e auditimit. Këto masa duhet të garantojnë që auditimi është realizuar në përputhje me standardet e zbatueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzioni ose opinioni është i

duhuri për situatën përjetëse ISSAI 400:44. Disa individë mund të përfshihen në kontrollin e cilësisë në faza të ndryshme të procesit të auditimit. Menaxherët dhe përgjegjësit e grupit shpesh kanë një rol kyç, pëderisa ata rishikojnë dprojekt-planet, punën audituese dhe projekt-raportin para se auditimi të përfundojë. Vëreni se sistemi i kontrollit të cilësisë së SAI-t në nivel organizativ matet gjetkë në kornizë [(SAI-4(iii))

SAI-15 Dimensionet dhe Kriteret Minimale për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioni (i) Politikat dhe Standardet Auditimit të Përputhshmërisë	
<p>SAI ka zhvilluar standarde kombëtare auditimi në përputhje me ISSAI 400 ose ka adoptuar Udhëzuesit e Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI 4100 ose 4200) si standarde të detyrueshme. <i>ISSAI 400:5</i>. Miratimi i standardeve mund të konsiderohet në përputhje me ISAI 400 kur plotësohen kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) “Elementet përkatëse për auditimin e përputhshmërisë ... duhet të identifikohen nga audituesi përpara kryerjes së auditimit.” <i>ISSAI 400:27 (dmth, identifikimi i kuadrit ligjor i zbatueshëm që mbulojnë rregullshmërinë dhe, nëse është e nevojshme, korrektësinë, kërkesat, çështjen, përdoruesit e synuar të raportit dhe nivelin e sigurisë që do të ofrohet, qoftë ky i arsyeshëm apo i kufizuar) ISSAI 400:28-41.</i></p> <p>b) “Audituesit duhet të marrin parasysh riskun e auditimit gjatë procesit të auditimit” <i>ISSAI 400:46. (dmth, audituesi duhet të marrë parasysh tre dimensionet të ndryshme të riskut të auditimit: riskun e qenësishëm, riskun e kontrollit dhe riskun e zbulimit) ISSAI 400:46</i></p> <p>c) “Audituesi duhet të marrë parasysh materialitetin gjatë procesit të auditimit” <i>ISSAI 400:47 (dmth, duke përfshirë shqyrtimin e materialitetit sipas vlerës, natyrës dhe kontekstit) ISSAI 400:94-99.</i></p> <p>d) “Audituesit duhet të përgatisin dokumentacion të mjaftueshëm për auditivin”. <i>ISSAI 400:48.</i></p> <p>e) Audituesit duhet të vendosin komunikim efektiv gjatë procesit të auditimit.” <i>ISSAI 400:49.</i></p> <p>f) “Audituesit duhet të identifikojnë kriteret e përshtatshme dhe çështjen.” <i>ISSAI 400:51.</i></p> <p>g) “Audituesit duhet të përcaktojnë fushëveprimin e auditimit.” <i>ISSAI 400:50.</i></p>	ISSAI 400

- h) "Audituesit duhet të kuptojnë subjektin e audituar nën këndvështrimin e kuadrit rregullator." ISSAI 400:52.
- i) "Audituesit duhet të kuptojnë mjedisin e kontrollit dhe kontrollet e brendshme përkatëse". ISSAI 400:53
- j) "Audituesit duhet të kryejnë vlerësimin e riskut" ISSAI 400:54 (dmth, të përcaktojnë natyrën, kohën dhe zgjatjen e procedurave të auditimit).shif ISSAI 4000-120
- k) "Audituesit duhet të marrin në konsideratë riskun e mashtrimit." ISSAI 400:55.
- l) "Audituesit duhet (të planifikojnë auditimin duke) krijuar një strategji të auditimit dhe një plan të auditimit." ISSAI 400:56.
- m) "Audituesit duhet të mbledhin evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të mbuluar qëllimin e auditimit." ISSAI 400:57.
- n) "Audituesit duhet të vlerësojnë nëse është marrë evidencë e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse formon konkluzione të duhura." ISSAI 400:58.
- o) "Audituesit duhet të përgatisin një raport të shkruar, bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, kohës dhe në procesin e ballafaqimit" ISSAI 400:59.
- SAI ka miratuar politika dhe procedura për mënyrën se si ka zgjedhur të zbatojë standardet e tij të auditimit, të cilat duhet të mbulojnë si më poshtë:
- p) "Përcaktimin e materialitetit [nëpërmjet] gjykitimit profesional ... bazuar në interpretimin e audituesit mbi nevojat e përdoruesve ... në drejtim të vlerës ... karakteristikave të qenësishme [natyrës] të një çështjeje ... [dhe] kontekstit në të cilin ajo ndodh" ISSAI 400:47.
- q) Kërkesat e SAI-t për dokumentimin e auditimit, për të siguruar se "audituesi duhet të përgatisë dokumentacionin përkatës të auditimit para se të dërgohet raporti ië auditimit ose para publikimit të Raportit të Audituesit, dhe dokumentacioni duhet të ruhet për një periudhë të përshtatshme kohore". ISSAI 400:48.
- r) Përcaktimi i natyrës, kohës dhe shtrirja e procedurave të auditimit që do të kryhet:

<ul style="list-style-type: none"> • Në këndvështrimin e kriterëve dhe të fushëveprimit të auditimit, karakteristikat e subjektit të audituar dhe rezultatet e vlerësimit të riskut <i>ISSAI 400:54</i> • për qëllimin e marrjes së evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit <i>ISSAI 400:57</i>, • si dhe të vlerësojë nëse evidencat e marra janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme në mënyrë që të zvogëlojnë riskun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm ... duke përfshirë konsideratat e materialitetit ... dhe nivelin e sigurisë së auditimit. <i>ISSAI 400:58 (Nëse është e nevojshme, duke përfshirë një qasje për të përlllogaritur madhësinë minimale të planifikuar të kampionit si përgjigje ndaj materialitetit, vlerësimit të riskut, dhe nivelit të sigurisë, në bazë të një modeli specifik të auditimit).</i> <p>Pikëzimi=4: Kriteret (b), (c), (n) dhe (o) dhe të paktën 12 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =3: Kriteret (b), (c), (n) dhe (o) dhe të paktën 8 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteret (b) dhe (c) dhe të paktën 6 nga kriteret e më sipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Kriteri (b) dhe të paktën 3 nga kriteret e tjera plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se 4 kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensionii (ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Përputhshmërisë</p>	
<p>SAi ka vendosur një sistem që garanton se "Individët në grupin e auditimit duhet që si një e tërë të zotërojnë njohuri, aftësi dhe ekspertizën e nevojshme për të përfunduar me sukses auditimin e përputhshmërisë". Kjo përfshin <i>ISSAI 400:45</i></p> <p>a) Njohjen si edhe përvojën praktike të llojit të auditimit që po kryhet.</p> <p>b) Njohjen e standardeve të zbatueshme dhe kornizën ligjore dhe rregullative.</p> <p>c) Njohjen e operacioneve të njësisë të audituar.</p> <p>d) Aftësinë dhe përvojën për të ushtruar gjykimin profesional"</p>	<p>ISSAI 400</p> <p>ISSAI 40</p>

Sistemi garanton se:

e) Njohuritë, aftësitë dhe ekspertiza e kërkuar për realizimin e punës audituese janë identifikuar. *Grupi i punës KMP së SAI-t*

f) Në rast se janë përdorur ekspertët e jashtëm, vlerësohet nëse kanë kompetencat, aftësinë dhe objektivitetin. *Grupi i punës KMP së SAI-t*

g) Ka linja të qarta raportimi dhe shpërndarje të përgjegjësi brenda grupit të auditimit. *Grupi i punës KMP së SAI-t*

SAI ofron mbështetje të nevojshme për audituesit (*p.sh. Në formën e manualeve të auditimit ose manualeve udhëzuese, në trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin profesional, akses tek ekspertët dhe/ose informacione nga burimet e jashtme*).

h) Identifikimin e kuadrit rregullator të zbatueshme bazuar në kritere formale, si legjislacioni, rregulla, marrëveshje dhe ligje të tjera, përfshirë ligjet buxhetore dhe në rastet “kur kriteret formale mungojnë ose kur ka boshllëqe në legjislacion, bazuar në parimet e përgjithshme të menaxhimit financiar dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik (që duhet të jetë i përshatshëm). *ISSAI 400:32*

i) Identifikimi i kriterëve të përshtatshme si bazë për vlerësimin e evidencës së auditimit për të nxjerre gjetet dhe konkluzionet. *ISSAI 400:51*

j) Përcaktimin e elementëve përkatës për nivelin e sigurisë që ofrohet (siguri e arsyeshme apo e kufizuar) *ISSAI 400:41*

k) Marrjen në konsideratë “të tre dimensioneve të riskut të auditimit: të qenësishëm, të kontrollit dhe të zbulimit”. *ISSAI 400:46*

l) Njohjen “ të mjedisit të kontrollit dhe kontrolleve të brendshme përkatëse” dhe vlerësimin “e riskut nëse kontrollet e brendshme mund të mos parandalojnë dhe zbulojnë mospërputhjet materiale”. *ISSAI 400:53*

m) Përfshirjen e faktorit të riskut të mashtrimit në vlerësimin e riskut dhe ushtrimin e kujdesit profesional në rastet kur hasen mospërputhje materiale që mund të tregojnë mashtrim. *ISSAI 400:55*

n) Përcaktimin e natyrës, kohëzgjatjen dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që do të kryhen” *ISSAI 400:54* “identifikiminën këndvështrimin e kriterëve, fushëveprimin dhe karakteristikave të njësisë së audituar” *ISSAI 400:54*

<p>dhe" idnetimifikimin e risqeve dhe impaktit të tyre në procedurat e auditimit" ISSAI 400:54.</p> <p>o) Zhvillimin e strategjisë dhe planit të auditimit" ISSAI 400:56</p> <p>p) Mbledhjen e evidencave audituese të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazën e një konkluzioni ose opinionit që mbulon masën e evidencës, rëndësinë dhe besueshmërinë e tij dhe sesi besueshmëria e evidencës ndikohet nga burimi e natyra e vet evidencës, nëse varet nga rrethanat individuale nga ku është marrë dhe nëse ekziston nevoja për të mbledhur evidencë, si në cilësi ashtu edhe në sasi" ISSAI 400:57.</p> <p>q) Përgatitja e raportit të shkruar në një formë të përshtatshme në mënyrë që raporti të jetë i plotë, i saktë, objektiv, bindës, i qartë dhe konciz për atë që lejon çështja në shqyrtim" ISSIA 400:59</p> <p>Pikëzimi = 4: Kriteret (a), (e), (o) dhe të paktën 13 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (a), (e), (o) dhe të paktën 9 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteret (a), (e) dhe të paktën 6 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën 4 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se 4 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
Dimensioni(iii) Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Përputhshmërisë	
<p>a) "E gjithë puna e kryer duhet të jetë objekt i rishikimit si një mjet për të kontribuar në cilësinë dhe promovimin e të mësuarit dhe zhvillimin e personelit" ISSAI 40:11 (dmth, duke përfshirë rishikimin e planit të auditimit, letrat e punës dhe punën e grupit, dhe monitorimin e rregullt të progresit të auditimit nga ana e niveleve të duhura të menaxhimit. Ky rishikim duhet të synojë të sigurojë që auditimi është në përputhje me standardet e zbatueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzioni ose opinionit është i duhur për situatën e dhënë ISSAI 400:44 dhe Grupi i Punës KMP së SAI-t).</p> <p>b) "Audituesi ... duhet të zbatojë procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë auditimit ... duke syënuar të sigurojë se auditimi është në përputhje me standardet e zbatueshme". ISSAI 400: 44</p>	<p>ISSAI 40 ISSAI 400</p>

- c) "Aty ku linden çështje të vështira ose të diskutueshme, SAI duhet të sigurojë që janë përdorur burimet e duhura (si ekspertët teknikë) për shqyrtimin e këtyre çështjeve" *ISSAI 40: fq 11*
- d) "Çdo ndryshim opinionesh brenda SAI-t duhet të dokumentohet në mënyrë të qartë dhe të zgjidhet para publikimit të raportit. *ISSAI 40: fq.12*
- e) "SAI-et duhet të njohin rëndësinë angazhimeve të rishikimeve të kontrollit të cilësisë për punën e tyre dhe [aty ku ato kryhen] çështjet e ngritura duhet të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme përpara se të publikohet raporti". *ISSAI 40: fq.12 (dmth, rishikim nga ekspertë që nuk janë të përfshirë në auditim).*
- f) "Procedurat për autorizimin e raporteve të publikuara respektohen" *ISSAI 40:12 (dmth, kryerja e rishikimit të kontrollit të cilësisë të projekt raporteve, normalisht duke përfshirë rishikimin nga ana e niveleve të ndryshme të menaxhmentit dhe ndoshta diskutimet me stafin në njësi dhe/ose ekspertë të jashtëm).*

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Së paku pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.

SAI -16: Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë

Ky indikator vlerëson mënyrën sesi realizohen në praktikë auditimet e përputhshmërisë. Në veçanti, shqyrton fazën e planifikimit, fazën e zbatimit dhe fazën e raportimit. Pikëzimi i këtij indikator duhet të realizohet bazuar në shqyrtimin e dosjeve të përputhshmërisë për vitin në shqyrtim. Gjithashtu, mund të mblidhen evidenca nga raportet e sigurimit të cilësisë së SAI-t, aty ku vlerësuesi vendos se mund të mbështet mbi këto. Mund të jetë e dobishme edhe intervistat me grupet e auditimit që kanë kryer auditimet e përzgjedhura. Si rregull, çështjet e mbuluara nga kriteret duhet të dokumentohen për të vlerësuar nëse janë plotësuar kriteret për shembull, në planin e auditimit, në letrat e punës dhe në raportin e auditimit.

Referohuni Aneksit 1 për përkufizime dhe sqarime të termave kyçe.

Lidhja me vlerësimet e përputhshmërisë së SAI-t me nivelin 4 të ISSAI-ve

Është praktikë e mirë për SAI-et që të bëjnë rishikime të detajuara të cilësisë mbi punën audituese. Nëse SAI-et raportojnë se i kanë realizuar auditimet në përputhje me ISSAI-et 4000-4999, ato duhet të kenë ngritur një sistem për të siguruar se përputhen me ISSAI-it, e nivelit 4. Për të inkurajuar rishikime të tilla dhe trajtuar raste kur SAI ka ndërmarrë një vlerësim të përputhshmërisë së tij me ISSAI-it e nivelit 4, pikëzimi 4 për treguesit e procesit të auditimit në KMP e SAI-t (SAI-9, SAI-12 dhe SAI-15) kërkon që SAI të ketë kryer një rishikim të tillë dhe se ky rishikim ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e nivelit 4. I takon vlerësuesit të përcaktojë nëse ndonjë çështje e vërejtur mospërputhshmërie lidhet kryesisht me dimensionet e planifikimit, implementimit ose raportimit në KMP së SAI-t. Kjo do ta bënte të lehtë për SAI-it të mbështeten në rezultatet e vlerësimeve të mëparshme gjatë pikëzimit të treguesve në KMP e SAI-t.

Nëse SAI nuk i ka kryer auditime në përputhje me nivelin 4 të ISSA-ve, por i ka bazuar auditime në standarde që janë në përputhje me parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë (niveli 3 ISSAI:ISSAI 400), kriteret e mëposhtme mund të përdoren për të vlerësuar procesit e auditimit të përputhshmërisë së SAI-ve.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Planifikimi i Auditimit të Përputhshmërisë;*
- (ii) *Zbatimi i Auditimit të Përputhshmërisë;*
- (iii) *Vlerësimi i Evidencave të Auditimit, Përfundimet dhe Raportimi në Auditimet e Përputhshmërisë.*

Dimensionet vendosin kriteret për planifikimin, zbatimin, vlerësimin, nxjerrjen e konkluzioneve dhe raportimin ashtu sikurse janë pëcaktuar në ISSAI 400. Kampionimi i dosjeve të auditimit është baza për vlerësimin e kriterit në dimension, gjithashtu, referohu hyrjes në Fushën C.

SAI-16 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pkëzim	Referenca Kyçe
Dimension (i) Planifikimi i Auditimit të Përputhshmërisë	
<p>a) "Elementet e duhur për auditimin e përputhshmërisë ... duhet të identifikohen nga audituesi përpara kryerjes së një auditimi përputhshmërie." ISSAI 400:27 (D.m.th duhet të identifikohet kuadri rregullator i zbatueshëm që mbulon rregullshmërinë dhe, nëse është e nevojshme, kërkesat e përputhshmërisë; palët e interesit si edhe nivelin e sigurisë që do të ofrohen, qoftë e arsyeshme ose e kufizuar) ISSAI 400:28-41</p> <p>b) "Audituesit duhet të marrin në konsideratë riskun e auditimit gjatë procesit të auditimit." ISSAI 400:46 (dmth, audituesi duhet të marrë parasysh tre dimensione të riskut të auditimit: riskun e qenësishëm, riskun e kontrollit dhe riskun e zbulimit) dhe "Audituesit duhet të kryejnë vlerësimin të riskut për të identifikuar risqet e mospërputhshmërisë" ISSAI 400:54 (dmth, për të përcaktuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit)</p> <p>c) "Audituesit duhet të konsiderojnë materialitetin gjatë procesit të auditimit." ISSAI 400:47 shih edhe ISSAI 4000:94 (dmth, duke përfshirë shqyrtimin e materialitetit sipas vlerës, natyrës dhe kontekstit)</p> <p>d) "Audituesit duhet të vendosin një komunikim efektiv gjatë procesit të auditimit" dhe "Audituesi duhet të informjë palët pëgjegjëse për kriteret e auditimit" ISSAI 400: 49</p> <p>e) "Audituesit duhet të identifikojnë çështjen dhe kriteret e përshtatshme" të bazuar në kuadrin rregullator të zbatueshëm, si bazë për vlerësimin e evidencave të auditimit. ISSAI 400:51</p> <p>f) "Audituesit duhet të përcaktojnë fushëveprimin e auditimit ... [si] një deklaratë të qartë të fokusit, shtrirjes dhe kufizimeve lidhur me përputhshmërinë e çështjes me kriteret". ISSAI 400: 50.</p>	<p>ISSAI 400</p> <p>ISSAI 30</p>

<p>g) "Audituesit duhet të kuptojnë subjektin e audituar në sipas rregullave përkatëse që e qeverisin atë." <i>ISSAI 400: 52</i></p> <p>h) "Audituesit duhet të kuptojnë mjedisin e kontrollit dhe kontrollet e brendshme të përkatëse." <i>ISSAI 400: 52</i></p> <p>i) "Audituesit duhet të marrin në konsideratë riskun e mashtrimit", duke përfshirë faktorët e riskut të mashtrimit në vlerësimet e tyre të riskut. <i>ISSAI 400: 55.</i></p> <p>j) "Audituesit duhet të planifikojnë auditimin duke zhvilluar një strategji të auditimit dhe një plan të auditimit ... si strategjia e auditimit dhe plani i auditimit duhet të dokumentohet me shkrim" <i>ISSAI 400: 56</i></p> <p>k) SAI ka vendosur një sistem që garanton se, në nivel auditimi, audituesit [dhe çdo i kontraktuar] përputhet me kërkesat etike: integriteti, pavarësia, objektiviteti, sjellja profesionale, konfidencialiteti dhe transparenca. <i>ISSAI 30 (p.sh. duke shmangur marrëdhëniet afatgjata me subjektet e audituara dhe duke kërkuara deklarata nga stafi mbi etikën dhe pavarësinë)</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh. rishikimi i sigurimit të cilësisë, një peer review i pavarur, vlerësim iCAT të sigurisë së cilësisë, të realizuar brenda 3 viteve të fundit) për praktikën e auditimit të përputhshmërisë ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI të nivelit 4, në lidhje me këtë dimension(përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme).</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteret (b), (h), dhe të paktën gjashtë prej kriterëve të mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Kriteri (h) dhe të paktën 4 nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Së paku dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Zbatimi i Auditimit të Përputhshmërisë</p>	
<p>a) Audituesi ka "të përcaktuar natyrën, kohë dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që do të kryhet" sipas kriterëve dhe fushëveprimin e auditimit, karakteristikave të subjektit të audituar dhe rezultatet e vlerësimit të riskut <i>ISSAI 400:54</i> "për qëllime të marrjes së evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme" <i>ISSAI 400:57</i> (nëse është e përshtatshme, zbatohet qasja e</p>	<p>ISSAI 400</p>

SAI-t për të llogaritur madhësinë minimale të kampionëve të planifikuar në përgjigje të materialitetit, vlerësimit të riskut, dhe nivelit të sigurisë.)

- b) "Nëse audituesi ndeshet me raste mospërputhshmërie, të cilat mund të jenë indikator të mashtrimit, ai/ajo duhet të ushtrojë kujdesin e duhur profesional në mënyrë që të mos ndërhyjë në procedurat ose hetime juridike që mund të kryhen në të ardhmen" *ISSAI 400:55* dhe duhet të ndjekë procedurat e SAI-t për trajtimin e indiceve të mashtrimit.
- c) Atëherë kur përdoren ekspertë të jashtëm, "audituesit duhet të vlerësojnë nëse eksperti ka kompetencën e nevojshme, aftësinë dhe objektivitetin, si dhe duhet të përcaktojë nëse puna e ekspertit është e përshtatshme me qëllimin e auditimit." *ISSAI 400: 45*
- d) "Audituesi duhet të mbledhë evidenca auditimit të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të sigurojë bazën për përfundimet apo opinionin ... [duke përfshirë] një shumëllojshmëri procedurash për grumbullimin e evidencave si sasiore dhe cilësore ... [dhe] audituesi shpesh ka nevojë të kombinojë dhe të krahasojë evidenca nga burime të ndryshme " *ISSAI 400: 57*
- e) Të gjitha procedurat e planifikuara të auditimit janë kryer, ose kur disa procedura të planifikuara të auditimit nuk janë kryer, ka një shpjegim të përshtatshëm i cili ruhet në dosjen e auditimit dhe është aprovuar nga personat përgjegjës për auditimin.

Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh. një rishikim i sigurisë së cilësisë, një peer review i pavarur, vlerësim iCAT të sigurisë së cilësisë, të realizuar brenda 3 viteve të fundit) për praktikën e auditimit të përputhshmërisë ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat ISSAI-ve të nivelit 4, në lidhje me këtë dimension (përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme)

Pikëzimi = 3: Kriteri (a) dhe (d) dhe të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Kriteri (a) dhe të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.

Dimensioni (iii) Vlerësimi i Evidencave të Auditimit, Përfundimet dhe Raportimi në Auditimet e Përputhshmërisë	
<p>a) "Dokumentimi duhet të ketë detaje të mjaftueshme për të mundësuar që një auditues me përvojë, që nuk ka lidhje të mëparshme me auditimin, të kuptojë nga dokumentimi i auditimit sa vijon: marrëdhëniet e çështjes, kriteret, fushëveprimin e auditimit, vlerësimin e riskut, strategjinë e auditimit, planin e auditimit dhe natyrën, kohën dhe shtrirjen e rezultateve të procedurave të kryera; evidencat e auditimit që merren për të mbështetur përfundimin, opinionin e audituesit apo raportin; mbajtjen e evidencave të arsytimit për të gjitha çështjet e rëndësishme ku kërkohet ushtrimi i gjykitit profesional dhe konkluzionet e lidhura me të" <i>ISSAI 400:48</i></p> <p>b) Kërkesat e SAI-t për dokumentimin e auditimit janë zbatuar, për të siguruar që "audituesi të përgatisë dokumentacionin përkatës të auditimit para se raporti i auditimit ose raporti i audituesit të publikohet dhe dokumentacioni të ruhet për një periudhë të përshtatshme kohore" <i>ISSAI 400: 48</i> shih <i>ISSAI 4000:64</i></p> <p>c) "Audituesit duhet të vlerësojnë nëse janë marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për auditimin dhe nëse ato formojnë konkluzionet përkatëse ... në mënyrë që të zvogëlojnë riskun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm ... vlerësimi më tej përfshin konsideratat e materialitetit ... [dhe] nivelin e sigurisë së auditimit". <i>ISSAI 400: 58</i></p> <p>d) "Audituesit duhet të vendosin komunikim të efektiv gjatë procesit të auditimit", dhe gjatë auditimit "raste materiale mospërputhshmërie duhet t'i komunikohen nivelit të duhur të menaxhimit apo atyre që janë të ngarkuar me qeverisje." <i>ISSAI 400: 49</i></p> <p>e) "Gjetjet e SAI-t i nënshtrohen procedurave të marrjes së komenteve, rekomandimeve [ose] vërejtjeve për diskutime dhe observacione nga subjekti i audituar." <i>ISSAI 20: 3</i></p> <p>f) "Audituesit duhet të përgatisin një raport të bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afateve kohore dhe ballafaqimit". <i>ISSAI 400: 59</i></p> <p>g) Raporti i auditimit të përputhshmërisë në vetvete përfshin elementet e mëposhtme:</p> <p>I. Titullin</p>	ISSAI 400

II. Të adresuarin

III. Fushëveprimin e auditimit, përfshirë periudhën kohore të mbuluar

IV. Identifikimin ose përshkrimin e çështjes

V. Kriteret e identifikuar

VI. Identifikimin e standardeve të auditimit të zbatuar

VII. Një përmbledhje të punës së kryer

VIII. Gjetjet

IX. Një konkluzion/Opinion

X. Përgjigjet nga subjekti i audituar (sipas rastit)

XI. Rekomandimet (sipas rastit)

XII. Datën e Raportit

XIII. Nënshkrimin" ISSAI 400: 59

h) "Raporti duhet të jetë; lehtësisht i kuptueshëm dhe nuk duhet të ketë paqartësi dhe dykuptimësi; të jetë i plotë; të përfshijë vetëm informacion i cili është mbështetur mbi evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit; të sigurojë që gjetjet janë evidentuar sipas perspektivës dhe kontekstit; dhe të jetë objektiv dhe i drejtë ". ISSAI 100: 51 (siç është rasti i raporteve të gjata në formën e letrave të menaxhimit).

i) Të gjitha observacionet dhe rekomandimet e auditimit janë të shkruara në mënyrë të qartë dhe koncize, dhe u drejtohen personave përgjegjës për zbatimin e tyre.

j) "Kur jepet një opinion, audituesi duhet deklarojë nëse është i pamodifikuar ose modifikuar në bazë të një vlerësimi të materialitetit dhe përhapjes së gabimeve". ISSAI 400: 59. *Shih edhe ISSAI 4000:151*

Pikëzimi = 4: Një vlerësim i pavarur (p.sh. një rishikim i sigurisë së cilësisë, një peer review i pavarur, vlerësim iCAT të sigurisë së cilësisë, të realizuar brenda 3 viteve të fundit) për praktikën e auditimit të përputhshmërisë ka konfirmuar se SAI përputhet me të gjitha kërkesat e ISSAI-ve të nivelit 4, në lidhje me këtë dimension (përfshirë të gjitha kriteret e mësipërme)

Pikëzimi = 3: Kriteri (e) dhe (f) dhe të paktën 6 nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

Pikëzimi = 2: Kriteri (e) dhe të paktën 4 nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.	

SAI-17: Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë

Ky indikator vlerëson rezultatet e funksionit të auditimit të përputhshmërisë së SAI-t, paraqitjen dhe publikimin në kohë të raporteve të auditimit dhe ndjekjen e rekomandimeve dhe gjetjeve .

Dimensioni (i) dhe (ii) Dorëzimi dhe Publikimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë: të gjitha rezultatet duhet të paraqiten tek autoriteti përkatës në një afat kohor të përcaktuar (dimensioni (i)). Dorëzimi nëkupton dërgimin/dhënie të zyrta të raportit të auditimit tek autoriteti që do të jetë përgjegjës për të marrë në konsideratë raportin dhe të ndërmarrë veprimet e përshtatshme. Dimensioni (ii) merr në konsideratë nëse raportet e auditimit të përputhshmërisë (ose pëmbledhjet e tyre kur raportet janë shumë të gjata dhe të detajuara) dhe/ose opinionet janë publikuar siç e lejon legjislacioni. Legjislacioni kombëtar shpesh i përshkruan, fazën në proces se kur SAI-t i lejohet të publikojë raportin dhe/ose opinionet e auditimit. Raporti i auditimit është i plotë kur vendimmarrësit në SAI (p.sh. Kryetari i SAI-t) e ka miratuar atë.

Dimensioni (iii) Ndjekja e Zbatimit të Rekomandimeve dhe Gjetjeve: SAI duhet të ketë një sistem të përshtatshëm për të siguruar që subjektet e audituara të ndërmarrin veprimet e duhura ndaj observacioneve dhe rekomandime të SAI-t dhe mundësisht nga të tjerët të ngarkuar me qeverisjen e subjektit të audituar. Kjo duhet të përfshijë mundësinë për subjektet e audituara që të mund t'i përgjigjen rekomandimeve, po ashtu SAI duhet të ndërmarrë veprime për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe të raportoj mbi gjetjet e ndjekes së rekomandimeve në mënyrën e duhur dhe kur është e nevojshme të raportojë publikisht këto gjetje.

Qasja e sugjeruar për vlerësim

Informacioni për të pikëzuar këtë tregues mund të merret nga sistemi i menaxhimit të informacionit të SAI-t ose nga rishikimi i kampionit të auditimeve të përpurhshmërisë të kryera gjatë periudhës në shqyrtim.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i)** *Dorëzimi në kohë i rezultateve të auditimit të përputhshmërisë;*
- (ii)** *Publikimi në kohë e rezultateve të auditimit të përputhshmërisë;*
- (iii)** *Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe Gjetjeve.*

SAI-17 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referencat Kyçe
Dimensioni (i) Dorëzimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë	
<p>Pikëzimi =4: Për të paktën 80% të auditimeve të përputhshmërisë, opinioni dhe/ose raporti i auditimit është paraqitur tek autoritetet përkatëse brenda afateve të përcaktuara në ligj ose brenda kohës së rënë dakord (kur s’ka afat kohor të përcaktuar, brenda 6 muajve nga koha e përfundimit të raporteve të auditimit). <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i PUnës KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =3: Për të paktën 60% të auditimeve të përputhshmërisë, opinioni dhe/ose raporti është paraqitur tek autoritetet përkatëse brenda afateve të parashikuara në ligj (kur s’ka afat kohor të përcaktuar, brenda 9 muajve nga koha e përfundimit të raporteve të auditimit.) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i PUnës KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =2: Për të paktën 40% të auditimeve të përputhshmërisë, opinioni dhe/ose raporti është paraqitur tek autoritetet përkatëse brenda afateve të përcaktuara në ligj (kur s’ka afat kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga koha e përfundimit të raportit të auditimit.) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i PUnës KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =1: Për të paktën 20% të auditimeve të përputhshmërisë, opinioni dhe/ose raporti është paraqitur tek autoritetet përkatëse brenda afateve të përcaktuara në ligj (kur s’ka afat kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga koha e përfundimit të raportit të auditimit) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:8, Grupi i PUnës KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =0: Për më pak se 20% të auditimeve të përputhshmërisë, opinioni dhe/ose raporti është paraqitur tek autoritetet përkatëse duhet të jetë brenda afateve të përcaktuara në ligj (kur s’ka afat kohor të përcaktuar, brenda 12 muajve nga koha e përfundimit të raportit të auditimit.) <i>ISSAI 10:5, ISSAI 20:08, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p>
Dimensioni (ii) Publikimi në Kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë	
<p>Pikëzimi =4: Për të gjitha raportet dhe/ose opinionet e audituara ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin t’i publikojë, raporti dhe/ose opinion bëhet i disponueshëm për publikun përmes mënyrave të përshtatshme brenda 15 ditëve pasi SAI-t i është lejuar publikimi. <i>ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =3: Për të gjitha raportet dhe/ose opinionet e audituara ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin t’i publikojë, raporti dhe /ose opinion bëhet i disponueshëm për</p>	

<p>publikun përmes mënyrave të përshtatshme brenda 30 ditëve pasi SAI-t i është lejuar publikimi. <i>ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =2: Për të paktën 75% të raporteve dhe/ose opinioneve të audituara ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin t'i publikojë, raporti dhe /ose opinion i bëhet i disponueshëm për publikun përmes mënyrave të përshtatshme brenda 60 ditëve pasi SAI-t i është lejuar publikimi. <i>ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =1: Për të paktën 50% të raporteve dhe/ose opinioneve të audituara, ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin ti publikojë, raporti dhe /ose opinion bëhet i disponueshëm për publikun përmes mënyrave të përshtatshme brenda 60 ditëve pasi SAI-t i është lejuar publikimi. <i>ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi =0: Për më pak se 50% të raporteve dhe/ose opinioneve e audituara ku SAI ka të drejtën dhe detyrimin ti publikojë, raporti dhe /ose opinion bëhet i disponueshëm për publikun përmes mënyrave të përshtatshme brenda 60 ditëve pasi SAI-t i është lejuar publikimi. <i>ISSAI 10:6, ISSAI 20:8, Grupi i punës KMP së SAI-t</i></p>	
<p>Dimensioni (iii) Ndjekja e Zbatimit të Rekomandimeve dhe Gjetjeve</p>	
<p>a) "SAI-t kanë sistemin e tyre të brendshëm të ndjekjes për t'u siguruar se entet e audituara i adresojnë në mënyrën e duhur gjetjet dhe rekomandimet, si dhe ato të bëra nga Legjislativi, nga komisionet përkatëse, ose nga bordi drejtues i subjektit të audituar, sipas rastit. <i>ISSAI 10:7</i></p> <p>b) "Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve fokusohet nëse subjekti i audituar i ka adresuar në mënyrë menjëhershme çështjet e konstatuara [në auditimet e paraardhëse]". <i>ISSAI 100:51</i></p> <p>c) Proceduar e ndjekjes së rekomandimeve të SAI lejojnë subjektin e audituar të ofrojë informacion mbi masat e marra ose mbi arsyet se pse nuk janë marrë masa". <i>ISSAI 20:3</i></p> <p>d) "SAI-t i paraqesin raportet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve tek Legjislativi, ose në një nga komisionet përkatëse, ose në bordin drejtues të subjektit të audituar, sipas rastit, për shqyrtim dhe marrjen e masave edhe kur SAI kanë kompetenca statutorë për të dhënë sanksione". <i>ISSAI 10:7</i></p> <p>e) "SAI raporton publikisht mbi rezultatet e auditimeve të tyre...[përfshirë] masat e marra në lidhje me rekomandimet e tyre". <i>ISSAI 20:7</i></p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 20</p> <p>ISSAI 100</p>

f) SAI ka krijuar një praktikë për vlerësimin e materialitetit me qëllimin përcaktimin se kur një procedure e ndjekjes së rekomandimeve kërkon një auditim shtesë.
Grupi i punës KMP së SAI-t, ISSAI 100:41.

Pikëzimi =4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi =3: Të paktën 5 nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi =2: Të paktën 3 nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi =1: Të paktën 1 nga kriteret e mësipërme plotësohet.

Pikëzimi =0: Asnjë nga kriteret e përmendura nuk plotësohet.

Treguesit për Kontrollin Gjyqësor - Hyrje

Objektivi i kontrollit gjyqësor është të marrë vendikte në formën e vendimeve specifike: urdhra, vendime ose urdhëresa mbi detyrimin personal dhe financiar të kontabilistëve publikë. Në disa raste, kontrolli gjyqësor rezulton në një verdikt mbi detyrimin ligjor të menaxherëve publikë nëpërmjet vendimeve kolegjiale dhe , mundësisht per ti sanksionuar ata për cdo parregullsi. Kontrolli gjyqësor nënkupton verifikimin e përputhshmërisë me standartet e aplikueshme po ashtu implementimin e procedurës ballafaqese dhe kryesisht të shkruar, të përcaktuara në ligj dhe rregullore.

Çdo gjyqësori në sektorin publik i duhet një grup të plotë rregullash dhe standardesh të një niveli të caktuar (ligj, rregullore) për të krijuar një regjim detyrimi për menaxherët e tij publikë (përfshirë kontabilistët), duke përfshirë kërkesat për zbatimin e tij që aplikohen në procesin gjyqësor. Kontrolli gjyqësor lejon SAI-n të kontrollojë nëse menaxherët publikë , sipas një rregjimi specific detyrimi të vendosur nga ligji dhe rregulloret, përmbushin detyrat që u janë caktuar nga ligji dhe rregulloret. Nëse nuk përmbushin detyrat e tyre, menaxherët publikë janë përgjegjës. Është ngushtësisht e kufizuar me përputhshmërinë e detyrave në fjalë.

Parimet specifike për kontrollin gjyqësor për SAI-t me funksione gjyqësore nuk janë përshkruar në kornizën e ISSAI-ve , kështu kriteret janë zhvilluar mbi bazën e praktikave të mira që i përkasin këtij procesi, nga një grup reference të SAI-ve me funksion gjyqësor bazuar në një marrëveshje të përbashkët midis këtyre që treguesit te pasqyrojnë praktika të ndryshme për SAI-t gjyqësore në mënyrë globale.

Si të përcaktohet që një kontroll është kontroll gjyqësor

Kontrolli gjyqësor është një kompetencë e dhënë nga ligji. Korniza e tij ligjore vendos qëllimin, përmbajtjen dhe procesin e tij. Vlerësuesit duhet të jenë të sigurtë që kontrolllet e prezantuara si gjyqësore janë në përputhje me kerkesat e kësaj kornize ligjore.

Megjithse kontrolli gjyqësor në disa raste mund të kryhet si një lloj i vecantë kontrolli, ai mund të kryhet gjithashtu sëbashku me lloje të tjera kontrolli. Në planifikimin e vlerësimit të KMP të SAI-t, vlerësuesit duhet të marrin në konsideratë burimet më të përshtatshme informacionit për të pikëzuar këto tregues. Kjo mund të përfshijë kombinimin e evidencës nga lloje të ndryshme kontrollesh të cilat përmbajnë element gjyqësor, por në të gjitha rastet duhet të jetë e qartë se në cilin kampion janë mbështetur rezultatet.

SAI-18: Kontrolli Gjyqësor i Standardeve dhe Menaxhimi i Cilësisë

Ky tregues është specifik për parimet themelore të kontrollit gjyqësor. SAI-18 përfshin kontrollin gjyqësor të standardeve, udhëzuesve si dhe procesitet e SAI-t për sigurimin e cilësisë së kontrolleve gjyqësore. Sistemet e përgjithshëm të SAI-t për sigurimin e cilësisë së punës audituese/kontrolluese vlerësohen në treguesit e kontrollit të cilësisë në SAI-4 dhe rekrutimin dhe trajnimet e stafit në disiplinat përkatëse të auditimit në SAI-22 dhe SAI-23.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Politikat dhe Standardet e Kontrollit Gjyqësor;*
- (ii) *Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit në Kontrollin Gjyqësori;*
- (iii) *Kontrolli i Cilësisë së Kontrolleve Gjyqësore.*

(i) Politikat dhe Standardet e Kontrollit Gjyqësor: Kushtetuta dhe ligjet përcaktojnë parimet dhe standardet, të detyrueshme për t'u zbatuar nga menaxherët publikë dhe kontabilistët, si dhe përgjegjësinë në rastet e mospërputhshmërisë. Në disa vende, korniza ligjore i jep autoritetin SAI-t të nxjerrë rregullime specifike mbi mënyrën sesi procesi i kontrolleve gjyqësore do të implementohet.

(ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit në Kontrollin Gjyqësor: Dimensioi shqyrton nëse SAI ka vendosur një sistem që garanton se anëtarët e grupit të kontrollit gjyqësore zotëron kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për të kryer kontrollin përkatës. Po ashtu, shqyrton se çfarë mbështetje ofron SAI për audituesit gjatë procesit të kontrollit gjyqësorë. Për të vlerësuar dimensionin, vlerësuesit mund të bazohet tek politikat dhe procedurat për ngritjen e grupeve të kontrollit, hartimin e udhëzuesve si dhe mbështetjet e tjera që u ofron audituesve. Për të verifikuar qëe sistemi për organizimin e grupit të kontrollit zbatohet në praktikë, vlerësuesit mund të shqyrtojnë dokumentimin e planikimit për kontrollet që janë marrë si kampion.

(iii) Kontrolli i Cilësisë së Kontrolleve Gjyqësore: Shqyrton sesi janë zbatuar në praktikë masat për kontrollin e cilësisë të kontrolleve gjyqësore, të evidentuara përmes rishikimit të dosjeve të kontrollive gjyqësore. Kontrolli i cilësisës procesit të kontrollit gjyqësorë përshkruan tërësinë e masave të marra për të siguruar cilësi të lartë për secilin produkt të kontrollit dhe realizohet si pjesë integrale e procesit të kontrollit. Dy institucione kanë një rol kryesor në kontrollin e cilësisë së kontrollit gjyqësorë: Prokurori dhe Sekretari i gjykatës.

Vreni që sistemi i SAI mbi kontrollin e cilësisë në nivel organizate matet gjetkë në kornizë (SAI-4 (iii)).

SAI-18 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
<p>Dimensioni (i) Politikat dhe Standardet e Kontrollit Gjyqësor</p>	
<p>a) Ekziston një kornizë ligjore që përcakton proceset e kontrolleve gjyqësore, rolet kyçe dhe përgjegjësitë (<i>të tilla si, kush mban përgjegjësin, si dhe kur fillon dhe përfundon një proces i kontrollit gjyqësore, cilët janë palët e përfshira dhe rolet e tyre</i>)</p> <p>b) SAI ka vendosur standarde mbi kontrollin gjyqësorë që: (i) janë të pajtueshme me legjislacionin e nivelit të lartë dhe (ii) nëse zbatohen, përshkruajnë qartë se me cilat parime dhe politikat duhet të jenë në përputhje menaxherët/kontabilistët ose cilido tjetër që është përgjegjës për asetet publike.</p> <p>c) Sipas rastit, SAI i ka komunikuar këtë standarde tek ata që janë nën juridiksionin e tij.</p> <p>d) Ligji ose rregulloret e brendshme të SAI përshkruajnë qartazi dhe i komunikojnë atyre që duhet të kenë llogaridhënie karshi SAI-t, mbi dokumentet, raportet dhe informacionet që duhet t'i dërgohen SAI-t.</p> <p>e) Ka një proces të përcaktuar në ligj ose rregullore që përshkruan sesi SAI duhet të veprojë në rast mos-përputhshmërie nga ata që duhet të kenë llogaridhënie ndaj SAI-t.</p> <p>f) Ka sanksione të përcaktuara në legjislacion, të zbatueshme në rast mos-përputhshmërie nga ata që duhet të kenë llogaridhënie ndaj SAI-t</p> <p>g) SAI ka një procedure ndjekjeje për ato subjekte që nuk japin llogari ose nuk e kanë dhënë në kohë dhe/ose në përputhje me procedurat e vendosura.</p> <p>Pikëzimi =4: Të gjitha kriteret plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =3: Kriteri (a) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =2 Kriteri (a) dhe të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =1 Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>

<p>Pikëzimi =0 Më pak se tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Aftësitë dhe Menaxhimi i Grupit në Kontrollin Gjyqësor</p>	
<p>SAI ka vendosur një sistem që garanton se individët në grupin e kontrollit zotërojnë si një e tërë aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për të përfunduar me sukses një kontroll gjyqësor. Kjo përfshin:</p> <p>a) Njohuri të mira dhe eksperiencë praktike në lidhje me kontrollin gjyqësorë.</p> <p>b) Njohuri mbi standardet e aplikuara, ligjet dhe rregullore</p> <p>c) Njohuri të mjaftueshme për karakteristikat e subjektit që po kontrollohet.</p> <p>d) Aftësitë dhe eksperiencën e nevojshme për të formësuar një gjykim profesional.</p> <p>Sistemi garanton që:</p> <p>e) Njohuritë, aftësitë dhe ekspertiza e kërkuar për kryerjen e kontrollit janë identifikuar.</p> <p>f) Nëse përdoren ekspertë të jashtëm, vlerësohet nëse ata i zotërojnë aftësitë, kapacitetet dhe objektivitetin e nevojshëm.</p> <p>g) SAI ofron të personelit kontrollues shërbime mbështetëse për t'i ndihmuar ata që të implementojnë standardet e kontrollit dhe rregullat etike, me qëllim përmirësimin profesional. <i>(të tilla si, përmes udhëzuesve, mundësi për të përmirësuar aftësitë, për t'u konsultuar me ekspertë etj).</i></p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>
<p>Pikëzimi =4: Të gjithë kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Pikëzimi =3 Kriteret (a), (b), (e) dhe (f) plotësohen.</p>	
<p>Pikëzimi =2. Kriteri (a), (b), (d) dhe (e) plotësohen.</p>	
<p>Pikëzimi =1 Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Pikëzimi =0 Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	

Dimensioni (iii) Kontrolli i Cilësisë së Kontrolleve Gjqësore	
<p>a) E gjithë puna e kryer duhet të rishikohet me qëllimin promovimin e cilësisë, dijes dhe zhvillimit profesional (përfshirë ekzaminimin e planit të kontrollit, dokumenteve dhe punës së grupit, dhe rastet e mbikëqyrjes dhe rishikimit)</p> <p>b) SAI implementon procedura të kontrollit të cilësisë në çdo fazë të kontrollit gjyqësorë.</p> <p>c) SAI mund të përdorë burime të përshtatshme (si ekspertë teknikë) nëse nevojiten.</p> <p>d) Vendimet gjyqësore nga SAI i nënshtrohen ankimit.</p> <p>e) Numri i ankimeve që ka sjellë një ndryshim të vendimeve të kontrollit gjyqësorë është relativisht i ulët.</p> <p>Pikëzimi =4: Të gjithë kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =3 Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =2. Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi =1 Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi =0 Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>

SAI-19: Procesi i kontrollit gjyqësor

Treguesi evidenton se si kontrolli gjyqësor kryhet në praktikë. Ky dukshëm shqyrton fazën e planifikimit, fazën e zbatimit dhe fazën vendimit. Pikëzimi i këtij treguesi duhet të bëhet në bazë të rishikimit të një kampioni të dosjeve të kontrollit gjyqësor të periudhës nën shqyrtim. Ai, gjithashtu, mund të jetë i dobishme për të intervistuar grupet që kanë kryer kontrollet gjyqësore.

Qasja e sygjeruar për vlerësim

Pikëzimi i këtij treguesi duhet të bëhet në bazë të rishikimit të një kampioni të dosjeve të kontrollit gjyqësore për periudhën nën shqyrtim. Ai gjithashtu mund të jetë i dobishëm për të intervistuar grupet e kontrollit që kanë kryer kontrollet gjyqësore. Rishikimi i dokumenteve duhet të përfshijë dokumente të punës, fletët e punës, raportet e përkohshme dhe dokumentimin e procesit dhe vendimet në lidhje me gjykimin. Për Dimensionin (iii) vlerësuesi gjithashtu duhet të vlerësojë bazën dhe praktikën për vendimmarrje, duke e mbështetur këtë me gjetjet nga kampionet, ndërsa Dimensionin (iv) kërkon shqyrtimin e dokumentacionit nga vendimi përfundimtar.

Si rregull, çështjet e mbuluara nga kriteret duhet të dokumentohen për kriteret që duhet të konsiderohen të plotësuar, për shembull, në planin e kontrollit. Vlerësimi i këtij treguesi nuk duhet të shkelë as fshehtësinë e kontrollit të hetimit as konfidencialitetin e reflektimit.

Dimensione për t'u vlerësuar:

- (i) *Planifikimi i kontrolleve gjyqësore;*
- (ii) *Implementimi i kontrolleve gjyqësore;*
- (iii) *Procesi i vendimmarrjes gjatë kontrolleve gjyqësore;*
- (iv) *Vendimi përfundimtar i kontrolleve gjyqësore.*

(i) Planifikimi i kontrolleve gjyqësore: Menaxhimi i duhur i kontrollit, i përcaktuar siç duhet nga SAI, kërkon që kontrollori të mbledh njohuri mbi subjektin e kontrollit, dhe se qëllimet e kontrollit dhe mjetet për të arritur ato (për shembull, aftësitë apo kalendari i punës) janë përcaktuar në mënyrë të qartë.

(ii) Implementimi i kontrolleve gjyqësore: Kur gjykimi ka një vendim të përkohshëm dhe një përfundimtar, ky dimension do të përfshijë aktivitetet e kontrollit të lidhura me të dyja.

(iii) Procesi i vendimmarrjes gjatë kontrolleve gjyqësore: Vendimi që rezulton nga një kontroll gjyqësor, qëndron në prezantimin e rezultateve të hetimit, nga gjyqtari i ngarkuar me kontrollin, opinioni i Zyrës së Prokurorit Publik dhe shqyrtimit të një ose disa magjistratëve . Nuk mund të ketë raste me dispozitë ligjore për vendimet monokratik. Nëse dëgjimi është publike apo jo, procesi i vendim-marrjes juridike duhet të jetë gjithmonë kundërshtuese. Menaxherët publike (duke përfshirë kontabilistët) me akuza të supozuara duhet të kenë një mundësi për të paraqitur vërejtjet e tyre apo argumente.

(iv) Vendimi përfundimtar i kontrolleve gjyqësore: Vendimi i SAI-t gjyqësor është një vendim ligjor dhe zyrtarë që i drejtohet atyre që janë përgjegjës për objektin e kontrolluar (për shembull, të veprorë ose të rregjistrojë). Prandaj, ai duhet të dorëzohet në përputhje me ligjet dhe rregulloret. Vendimi përfundimtar duhet të jetë i lehtë për tu kuptuar, i qartë dhe gjithëpërfshirës. Ai duhet të paraqesi argumentet e të gjitha palëve, dhe klauzolat operative duhet të shprehen qartë dhe në përputhje me arsyet e vendimit.

SAI -19 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (I) Planifikimi i Kontrolleve Gjyqësore	
<p>Kur planifikohen kontrolle gjyqësore, përgjegjësit për kontrollin duhet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Fitojnë njohuri të mjaftueshme para kontrollit, në mënyrë që të sigurojnë se plani i kontrollit është hartuar mirë. b) Aplikojnë një strategji të bazuar në risk fokusuar në sistemin, duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të palës së kontrolluar. c) Në rastin e kontrollit gjyqësor të llogarive, formulohet objektivi i kontrollit. d) Përfshijnë një afat kohor dhe kalendarin e zbatimit. e) Të gjitha kontrollet e planifikuara janë të përfshira në programin vjetor të punës të SAI. f) SAI ka krijuar një sistem për të siguruar që, në nivel të çdo kontrolli, ata që janë përgjegjës për kontrollin përmbushin kërkesat e mëposhtme etike: integriteti, pavarësia dhe objektiviteti, kompetenca, sjellja profesionale, 	<p style="text-align: center;">Grupi i punës i KMP i SAI-t</p> <p style="text-align: center;">ISSAI 30</p>

<p>konfidencialiteti dhe transparenca. ISSAI 30. (dmth, duke shmangur marrëdhënie afat-gjatë me të njëjtin entitet të kontrolluar dhe të kërkojnë deklaratat e duhura nga stafi i SAI-t në lidhje me etikën dhe pavarësinë).</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (II) Implementimi i Kontrolleve Gjyqësore</p>	
<p>Kur zbatohet kontrolli, përgjegjësit për kontrollin duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Të informojnë palën e kontrolluar që kontrolli ka filluar. b) Të vendosi komunikim të mirë me palën e kontrolluar. c) Të punojë në mënyrë sistematike, me kujdes dhe objektivitetin e duhur. d) Krijojnë, përpilojnë dhe arkivojnë dokumentacion mjaftueshëm të plotë dhe të detajuar nga fillimi duke përfshirë edhe vendimin përfundimtar në përputhje me rregulloret brendshme të zbatueshme. e) Të aplikojë metoda të mira për manaxhimin e proceseve të kontrollit. f) Të njoftojë personin përgjegjës për parregullësitë e vërejtura. <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>
<p>Dimensioni (III) Procesi i vendimmarrjes gjatë kontrolleve gjyqësore</p>	
<p>a) Mbahet një seancë publik ose jo publike, në përputhje me rregulloret vëndase.</p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>

<p>b) Ka komunikim me/ose pjesëmarrjen e prokurorit publik në procesin e kontrollit gjyqësor</p> <p>c) Përbërja dhe nën ndarja e gjykatës që gjykon çështjet dokumentohet në tekstet ligjore ose rregulloret e brëndshme</p> <p>d) Përfshirja e raportuesit në procesin e vendimmarrjes është në përputhje me rregulloren vendase</p> <p>e) Vendimi që merr një drejtues publik i përgjegjshëm është kolegjal.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (iv) Vendimi përfundimtar i kontrolleve gjyqësore</p>	
<p>a) Vendimi përfundimtar i referohet dokumentacionit ligjor të aplikueshme për rastin.</p> <p>b) Vendimi përfundimtar pasqyron argumentet e të gjitha palëve.</p> <p>c) Vendimi përfundimtar është i justifikuar.</p> <p>d) Forma e vendimit është në përputhje me ligjet dhe rregulloret.</p> <p>e) Vendimi përfundimtar është i lehtë për t'u kuptuar, i qartë dhe gjithëpërfshirës.</p> <p>f) Klauzolat operative të përfshira në vendime janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe janë në përputhje me arsyet e vendimit.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	<p>Grupi i punës i KMP i SAI-t</p>

SAI-20: Rezultatet e kontrolleve gjyqësore

Rezultatet e kontrolleve gjyqësore janë vendime, të tilla si gjykime, urdhra dhe urdhëresa ligjore kundër menaxherëve publikë (përfshirë kontabilistët). Edhe pse zbatimi i këtyre vendimeve është jashtë kompetencave të SAI-t, ky tregues vlerëson se si SAI gjyqësor menaxhon vendimin, me anë të njoftimit, publikimit dhe me ndjekjen e informatave të marra në lidhje me implemtimin.

Qasja e sugjeruar për vlerësim

Informacioni i nevojshëm për të vlerësuar këtë tregues mund të gjendet në sistemin menaxhimit të informacionit të SAI-t, dhe me anë të shqyrtimit të një kampioni të dosjeve të kontrolleve gjyqësore në periudhën në shqyrtim.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Njoftimi i vendimeve nga kontrollin gjyqësor;*
- (ii) *Publikimi i vendimeve që lidhen me kontrollin gjyqësor;*
- (iii) *Ndjekja nga SAI i zbatimit të vendimeve që lidhen me kontrollin gjyqësor.*

(i) Njoftimi i vendimeve nga kontrolli gjyqësor: Pas marrjes së një vendimi përfundimtar, pala e kontrolluar duhet të njoftohet. Ky dimension vlerëson praktikën e njoftimit gjyqësor të SAI-t, duke matur përqindjen e vendimeve përfundimtare që pasojnë kontrollet gjyqësor të cilat u njoftohen palëve brenda një periudhe të dakordësuar më parë.

(ii) Publikimi i vendimeve që lidhen me kontrollin gjyqësor: Në përgjithësi, vendimet gjyqësore nga SAI-t mund të publikohen dhe komunikohen; Megjithatë, publikimi nuk është automatik dhe është një çështje zgjedhje për SAI-n. Ky dimension vlerëson praktikën e publikimit gjyqësor të SAI-t, duke matur përqindjen e vendimeve të njoftuara të botuara brenda vitit kur është bërë njoftimi.

(iii) Ndjekjen nga SAI i zbatimit të vendimeve që lidhen me kontrollin gjyqësor: Zbatimi i vendimeve që lidhen me kontrollet gjyqësore mund të jenë jashtë fushëveprimit të SAI-t. Megjithatë, SAI ende mund të monitorojë këto vendime, dhe të verifikojë zbatimin e tyre (për shembull, Ministria e Financave i dërgon një listë të detyrimeve të mbartura, vlerave për t'u arkëtuar, etj). Kur një vendim është zbatuar, në shumë raste, SAI duhet të rivendosë statusin e përgjegjësit për llogaritë në fjalë.

SAI – 20: Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Njoftimi i Vendimeve nga Kontrolli Gjyqësor	
<p>Pikëzimi = 4: Më shumë se 90 % e vendimeve të marra në 3 vitet e fundit janë njoftuar brënda 2 muajve nga vendimi përfundimtar</p> <p>Pikëzimi = 3: Më shumë se 80 % e vendimeve të marra në 3 vitet e fundit janë njoftuar brënda 3 muajve nga vendimi përfundimtar</p> <p>Pikëzimi = 2: Më shumë se 70 % e vendimeve të marra në 3 vitet e fundit janë njoftuar brënda 4 muajve nga vendimi përfundimtar</p> <p>Pikëzimi = 1: Më shumë se 50 % e vendimeve të marra në 3 vitet e fundit janë njoftuar brënda 6 muajve nga vendimi përfundimtar</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se 50 % e vendimeve të marra në 3 vitet e fundit janë njoftuar brënda 6 muajve nga vendimi përfundimtar</p>	
Dimensioni (ii) Publikimi i Vendimeve që Lidhen me Kontrollin Gjyqësor	
<p>Pikëzimi = 4: Më shumë se 90 % e vendimeve të njoftuara në 3 vitet e fundit janë botuar brënda 4 muajve nga njoftimi.</p> <p>Pikëzimi = 3: Më shumë se 75 % e vendimeve të njoftuara në 3 vitet e fundit janë botuar brënda 5 muajve nga njoftimi.</p> <p>Pikëzimi = 2: Më shumë se 60 % e vendimeve të njoftuara në 3 vitet e fundit janë botuar brënda 6 muajve nga njoftimi.</p> <p>Pikëzimi = 1: Më shumë se 50 % e vendimeve të njoftuara në 3 vitet e fundit janë botuar brënda 12 muajve nga njoftimi.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se 50 % e vendimeve të njoftuara në 3 vitet e fundit janë botuar brënda 12 muajve nga njoftimi.</p>	
Dimensioni (iii) Ndjekjen nga SAI i Zbatimit të Vendimeve që Lidhen me Kontrollin Gjyqësor	
<p>a) SAI ka një system për monitorimin dhe zbatimin e vendimeve të tij, në mënyrë direkte ose me ndihmën e administratës publike</p>	

<p>b) Kur një vendim nuk implementohet, SAI ndërmerr veprime pas një periudhe të caktuar.</p> <p>c) Kur SAI merr njoftime se vendimi është zbatuar, ai rivendos statusin e pergjegjësve për llogarinë në kohën e duhur.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjithë kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi=1: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet, por sistemi i ndjekjes së zbatimit është në proces zhvillimi.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret nuk plotësohet, dhe nuk ka sistem për ndjekjen e zbatimit në proces.</p>	
---	--

Fusha D: Menaxhimi Financiar i Aseteve dhe Shërbimet Mbështetëse

SAI duhet të menaxhojë operacionet e tij me ekonomicitet, efikasitet, dhe efektivitet dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret (ISSAI 20:6).

SAI duhet të aplikojë parime menxhimi të mira në mënyrë që të sigurojë përdorim më të mirë të burimeve të veta. Kjo zbatohet si në mbikëqyrjen e përdotëshme të stafit, gjithashtu edhe në kontrollet e brendshme të duhura mbi menaxhimin financiar dhe operacionet e tij.

Kjo nënkupton që SAI duhet të ketë menaxhim organizativ të përshtatshëm dhe struktura mbështetëse që sigurojnë një qeverisje të mirë, dhe që mbështesin kontrollin e brendshëm dhe praktikën e menaxhimit (ISSAI 12, Parimi 9). Kjo aplikohet në mënyrë të njëjtë në menxhimin e aseteve dhe shërbimeve mbështetëse të SAI-it.

Fusha D konsiston në një tregues që mbulon nivelet kryesore dhe kriteret e nevojshme për një SAI që të tregojë llogaridhënie për mënyrën se si ai menaxhon financat, asetet dhe shërbimet mbështetëse për të arritur objektivat e tij.

Indikatorët e performancës

SAI-21: *Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse.*

SAI-21: Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse

SAI ka nevojë për burime të mjaftueshme financiare, asete dhe mirëmenaxhim të shërbimeve mbështetëse për një funksionim efektiv. Menaxhimi i burimeve financiare duhet të ndjekë një sistem i cili karakterizohet nga transparenca dhe llogaridhënia, duke përfshirë kontrollet e brendshme dhe dokumentimin e kostove. SAI, gjithashtu, duhet të tregojë planifikim dhe përdorim efektiv të aseteve, duke përfshirë zyrat dhe qendrat e trajnimit, automjetet, pajisjet e zyrës, software-et dhe hardware-et e teknologjisë së informacionit (TI). Për të siguruar përdorimin më të mirë të infrastrukturës dhe të pajisjeve, SAI ka nevojë për mirë funksionim të shërbimeve mbështetëse, për shembull TI, financa, arkivat dhe asetet.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Manaxhimi Financiar;*
- (ii) *Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës;*
- (iii) *Shërbimet Mbështetëse Administrative.*

(i) Manaxhimi Financiar: SAI-t "duhet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, materiale, dhe monetare të nevojshme dhe të arsyeshme" dhe SAI-t duhet të "menaxhojnë buxhetin e tyre dhe të detajojnë atë në mënyrë të përshtatshme" (ISSAI 10: 8). Mjedisi i kontrollit të brendshëm duhet të ofrojë sigurinë se burimet e SAI-it janë të mbrojtura kundër humbjes për shkak të keqpërdorimit, abuzimi, keqmenaxhimit, gabimeve, mashtrimit apo parregullsi të tjera. Ajo gjithashtu duhet të ofrojë siguri se SAI u përmbahet ligjeve, rregulloreve dhe direktivave të menaxhimit, dhe se SAI zhvillon dhe mban të dhëna të besueshme financiare.

(ii) Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës: Asetet e SAI-it normalisht përfshijnë ndërtesën, qendrën e trajnimit dhe arkivimit, automjetet, rrjete TI, hardware dhe software. Për tu siguruar se këto pasuri janë menaxhuar mirë, SAI-t duhet: zhvillojë plane afatshkurtra dhe afatgjata të menaxhimit të aseteve bazuar në nevojat aktuale dhe të ardhshme; të shqyrtojë rregullisht përdorimin e aseteve për të siguruar që asetet janë përdorur në mënyrë efektive; dhe të raportojë te Legjislativi, ku ajo i konsideron asetet dhe infrastrukturën aktuale si të pamjaftueshme.

(iii) Shërbimet Mbështetëse Administrative: Funksionet administrative, mbështetja e TI dhe arkivimi janë pjesë vitale e njohurive dhe menaxhimit të informacionit, dhe ato i mundësojnë SAI-t të mbajë nën mbikëqyrje, të monitorojë progresin e punës dhe të

ndjek gjurmët e auditimit, si dhe menaxhimin e dokumentacionit në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe të rruajtjes.

SAI-21 Dimensioni & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Menaxhimi Financiar	
<p>Për të siguruar manaxhimin efektiv të burimeve financiare, SAI duhet:</p> <p>a) Të caktojë në mënyrë të qartë përgjegjësitë për menaxhimin financiar të aktiviteteve. <i>INTOSAI GOV 9100.fq.29</i></p> <p>b) Të ketë një sistem delegimi të autoritetit për kryerjen dhe aprovimin e shpenzimeve për SAI-in. <i>INTOSAI GOV 9100.fq.29</i></p> <p>c) Të ketë manuale financiare dhe/ose rregullore, të cilat të jenë të disponueshme për të gjithë stafin e tij. <i>ISSAI 20:1, INTOSAI GOV 9100.fq.10,36-38;</i></p> <p>d) Të sigurojë që stafi i ngarkuar me buxhetimin dhe kontabilitetin të kenë aftësitë, eksperiencën dhe burimet e duhura për të kryer punën. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6, INTOSAI GOV 9100.fq.18;</i></p> <p>e) Të ketë afate të qarta dhe procedura qeverisje për procesin e buxhetimit. <i>Rrjedh nga ISSAI 20:6</i></p> <p>f) Të ketë një sistem menaxhimi informacioni funksional, i cili përfshin informacionin financiar dhe të performancës. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6; INTOSAI GOV 9100.fq.10</i></p> <p>g) Të ketë një sistem funksional të evidentimit të kostove të stafit. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6; INTOSAI GOV 9100.fq.10</i></p> <p>h) Të menaxhon shpenzimet aktuale, në mënyrë që jo më shumë se një vit nga tre vitet e fundit, shpenzimet aktuale të SAI-t, të jenë 10% më të larta se shpenzimet e aprovuar në buxhetin e fundit. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:8; ISSAI 20:6;</i></p> <p>i) SAI përgatit çdo vit pasqyrat /raportet financiare duke ndjekur kuadërën rregullator të përshtatshëm. <i>ISSAI 20:6;</i></p> <p>j) Pasqyrat financiare të SAI-t bëhen publike dhe janë subjekt i auditimeve të jashtme të pavarura ose rishikimit parlamentar. <i>ISSAI 20:6;</i></p>	<p>ISSAI 12</p> <p>ISSAI 20</p> <p>INTOSAI GOV 9100</p>

<p>k) Kur kërkohet me ligj ose rregullore e aplikueshme SAI ka marr një opinion auditimi të pamodifikuar ose të pakualifikuar në auditimin/rishikimin e fundit të pasqyrave financiare dhe ka dhënë përgjigjen e duhur ndaj raportit të auditimit/rishikimit dhe/ose letrës drejtuar menaxhimit dhe rekomandimeve të kryera. <i>Rrjedh nga ISSAI 20:6;</i></p> <p><i>(kur aktivitetet e SAI-t janë raportuar si pjesë e llogarive të përgjithshme publike, ato duhet të shpalosen si një shënim i veçantë në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar dhe nuk duhet të ketë kualifikim në lidhje me shënimin mbi aktivitetet e SAI-t)</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën tetë nga kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 2: Së paku pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës</p>	
<p>a) SAI ka zhvilluar një strategji afatgjatë ose plan për nevojat e tij fizike të infrastrukturës, dhe një plan afat shkurtër për nevojat në fushën e TI, bazuar në nivelet aktuale dhe të parashikuara të personelit në të ardhmen. <i>CBC Udhëzues për krijimin e kapaciteteve në SAI:fq.45,49</i></p> <p>b) Kur është e përshtatshme, SAI ka rishikuar madhësinë, personelin dhe vendet e akomodimit të tij në lidhje me vendndodhjen e klientëve të saj të auditimit gjatë 5 viteve të fundit, dhe ka marrë në konsideratë çdo propozim për përmirësim. <i>Rrjedh nga ISSAI 20:6; Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>c) SAI ka rishikuar përshtatshmërinë e infrastrukturës së TI-së (Kompjuterat, Programe dhe rrjeti TI) gjatë 3 viteve të fundit dhe ka marrë në konsideratë çdo propozim për përmirësim. <i>CBC Udhëzues për krijimin e kapaciteteve në SAI:fq.48-50; Grupi i Punës i KMP i SAI-t (psh. Duke përdorur metodologjinë e EUROSAIT për vetëvlerësimin e TI-së(ITSA))</i></p>	<p>ISSAI 12</p> <p>ISSAI 20</p> <p>INTOSAI GOV 9100</p> <p>CBC Udhëzues për krijimin e kapaciteteve në SAI</p>

<p>d) Kur është e nevojshme, në raportin e tij vjetor ose raporte të ngjashëm, SAI raporton çdo mospërputhje në lidhje me asetet dhe infrastrukturën e tij. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:1</i></p> <p>e) SAI ka siguruar akses në objektet e duhura të arkivimit të cilat mundësojnë që gjitha të dhënat relevante të ruhen në mënyrë të sigurt për shumë vite dhe të aksesueshme kur është e nevojshme. <i>INTOSAI GOV 9100.fq.11</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet .</p>	
Dimensioni (iii) Shërbimet Mbështetëse Administrative	
<p>SAI duhet të ketë mbështetjen e duhur administrative për të funksionuar dhe për të ruajtur asetet dhe infrastrukturën e tij në mënyrë efektive:</p> <p>a) Përgjegjësia për mbështetjen e TI-së është caktuar në mënyrë të qartë dhe stafi i ngarkuar me këtë detyrë ka aftësitë e duhura, për të kryer punën. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6; INTOSAI GOV 9100.fq.18</i></p> <p>b) Përgjegjësia për menaxhimin dhe arkivimin e dosjeve është caktuar në mënyrë të qartë dhe stafi i ngarkuar me këtë detyrë ka aftësitë e duhura, për të kryer punën. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6; INTOSAI GOV 9100.fq.18</i></p> <p>c) Përgjegjësia për menaxhimin e të gjitha kategorive kryesore të aktiveve dhe të infrastrukturës është caktuar në mënyrë të qartë dhe stafi i ngarkuar me këtë detyrë ka aftësitë e duhura, për të kryer punën. <i>Rrjedh nga ISSAI 12:9; ISSAI 20:6; INTOSAI GOV 9100.fq.18</i></p> <p>d) Të gjitha funksionet mbështetëse administrative janë rishikuar gjatë 5 viteve të fundit dhe ka marrë në konsideratë çdo propozim për përmirësim. <i>Rrjedh nga ISSAI 20:6; CBC Udhëzues për krijimin e kapaciteteve në SAI: fq.46; Grupi i Punës i KMP i SAI-t</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p>	

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

Pikëzimi = 3: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.	
Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.	

FUSHA E: Burimet Njerëzore dhe Trajnimet

Deklarata e Limës (ISSAI 1) njeh se një SAI efektiv varet nga aftësia e tij për të rekrutuar, mbajtur, dhe nga shpërndarja efektive e aftësive më të larta, puna intensive dhe motivimi i stafit. Është përgjegjësi e menaxhmentit të SAI-it për të siguruar që SAI ka stafin e duhur në kohën e duhur dhe se ajo mund ta shpërndajë ata në mënyrë efektive.

ISSAI 40 identifikon kontributin e menaxhimit të burimeve njerëzore për të ndihmuar që të ofrohet punë audituese me cilësi të lartë. ISSAI 40 thekson se SAI duhet të krijojë politika dhe procedura të burimeve njerëzore, të cilat i ofrojnë atij siguri të arsyeshme që ka personelin e mjaftueshëm me kompetencën e kërkuar, aftësitë dhe të përgjegjshëm për të vepruar në përputhje me principet etike. ISSAI 100 thekson, për të gjitha auditimet “nevojën e rekrutimit të personelit me kualifikimin e duhur, ofrimi i zhvillimit të personelit dhe trajnimi [dhe që] audituesi duhet të mbajnë aftësitë e tyre profesionale nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional.” (ISSAI 100:39)

Për të siguruar që stafi është përherë i kualifikuar mjaftueshëm, të ketë zhvillim profesional dhe përditësim mbi standardet dhe metodat e auditimit, SAI duhet të ketë qasje të zhvillimit profesional në mënyrë strategjike. Fusha E tregon performancën e SAI-t në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Disa SAI mund të mbështeten në një agjensi rekrutimi nga sektori publik për të realizuar funksionet e rekrutimit, pagave, trajnimit të stafit etj. Megjithatë, shumë SAI konsolidojnë funksionet e burimeve njerëzore si rezultat i rritjes së autonomisë së saj organizative, ose në përputhje me objektivat e tyre për zhvillimin organizativ. Këto kanë edhe përgjegjësi “tradicionale” për personelin, dhe një rolë strategjik për të ndihmuar drejtuesit të identifikojnë dhe plotësuar kërkesat për staf për periudha afatgjatë strategjike. *CBC Udhëzues për krijimin e kapaciteteve në SAI: fq.5*

Lidhja me Treguesit e Fushës A (Pavarësia dhe Korniza ligjore)

Aty ku ekzekutivi është i përfshirë ngushtë në menaxhimin e burimeve njerëzore të SAI-t, vlerësuesit duhet të jenë të kujdesshëm me qëllim që të sigurohen se Fusha E mat performancën e faktorëve brenda kontrollit të SAI-t. Treguesit e Fushave dhe kriteret që kanë të bëjnë me politikat dhe proceset e përcaktuara jashtë SAI-t duhet të konsiderohen të pazbatueshme dhe duhet të zbatohet metodologjia pa-pikëzimit për këto raste (shih seksionin 3.2.4). Çdo mungesë e pavarësisë në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të theksohet në pjesën shpjeguese të raportit të performancës. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore e cili është

kryer jashtë SAI-t mund të përfshihet edhe në pjesën shpjeguese të raportit të performancës, por nuk duhet të pasqyrohet në pikëzimin e treguesve. Një përfshirje e tillë e ekzekutivit në menaxhimin e burimeve njerëzore do të reflektohet përmes rezultateve më të ulëta në SAI-6, Dimensionin (iii) Pavarësia Organizative/Autonomia.

Kur vendimet për rekrutimin, shpërblimin dhe promovimin janë marrë nga Ekzekutivi, SAI duhet të sigurojë që ka sistemet e përshtatshme për të mbrojtur pavarësinë e stafit të SAI-t gjatë auditimit. Këta faktorë duhet të merren parasysh nga vlerësuesi dhe duhet të përmenden në pjesën shpjeguese të raportit të performancës. Vlerësuesi duhet të konsiderojë nëse sistemet janë të përshtatshme për të mbrojtur pavarësinë e SAI-t.

Në SAI-et me funksione gjyqësore, zakonisht ka dy lloje stafi: personeli i kontrollit, duke përfshirë magjistratët, dhe personeli administrativ apo mbështetës. Personeli i kontrollit (Magjistratët ose Gjyqtarët, Raportuesit, Audituesit dhe Asistentët) dhe sekretarët e gjykatave janë nëpunës civilë, rekrutimi, shpërblimi dhe promovimi i të cilëve është i parashikuar në ligj, rregulloret dhe praktikatat që rregullojnë shërbimin civil. Magjistratëve (ose Gjyqtarëve) duhet tu jepet pavarësi në punën e tyre sipas ligjit kombëtar. Kjo do të thotë se kuadri ligjor duhet të japë sigurinë që gjyqtarët janë të mbrojtur nga lëvizja në pozicionet ku janë emëruar. Kriteret për promovim jo gjithmonë janë të përcaktuara qartë.

Burime të praktikës së mirë për këtë fushë janë ISSAI 40, Udhëzuesi i Komitetit të Ndërtimit të Kapaciteteve të INTOSAI mbi Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (CBC MBNJ Guide), Kuadri Institucional i Ndërtimit të Kapaciteteve AFROSAI-E (AFROSAI-E ICBF).

Treguesit e performancës:

SAI - 22: *Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;*

SAI - 23: *Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi.*

SAI-22: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Ky tregues vlerëson elementët e menaxhimit të burimeve njerëzore të SAI-t. Sipas ISSAI 40, politikat dhe procedurat e burimeve njerëzore të SAI-t [midis gjërave të tjera] duhet të përfshijnë: rekrutimin, zhvillimi profesional, vlerësimi i performancës dhe promovimi.(ISSAI 40.fq.10)

Në disa vende stafi i SAI-t është pjesë e grupit të punonjësve publik, dhe nuk përzgjidhen direkt nga SAI. Ky mund të jetë një avantazh por mund edhe të ndikojë në pavarësinë e tij. Kjo duhet të reflektohet tek SAI-1.

Qasja e sygjeruar për vlerësim

Vlerësuesit në vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore të SAI-t, duhet të përcaktojnë cilat funksione janë nën kontrollin e vetë SAI-t. Fushat dhe kriteret që kanë të bëjnë me funksionet dhe proceset e përcaktuara jashtë SAI duhet të konsiderohet jo të aplikueshme, dhe duhet të zbatohet metodologjia e “pa pikëzim” (shih seksionin 3.2.4). Megjithatë, funksionet e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe proceset duhet të shpjegohet në pjesën shpjeguese të treguesit.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) Funksioni i Burimeve Njerëzore;*
- (ii) Strategjia e Burimeve Njerëzore;*
- (iii) Rekrutimi i Burimeve Njerëzore;*
- (iv) Shpërblimet, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit.*

(i) Funksioni i Burimeve Njerëzore: Stafi i menaxhimi të burimeve njerëzore ka nevojë për një kuadër të gjërë në të kompetencave duke përfshirë aftësitë dhe njohuritë në menaxhimin e ndryshimit, menaxhimin e palëve të interesit dhe ndikimin e tyre.

(ii) Strategjia e Burimeve Njerëzore: Një strategji e burimeve njerëzore përputh burimeve njerëzore me drejtimin e synuar të organizatës. Strategjia mbështetet nga vlerat, kultura, parimet etj. Kjo mund të jetë një dokument më vete, ose i integruar në dokumente të tjera, si plani strategjik i SAI-t. Aspektet e mëposhtme të burimeve njerëzore duhet të theksohet në strategjinë e saj: rekrutimin, menaxhimin e performancës, trajnimin dhe zhvillimin, mbajtja dhe mirëqenien e stafit.

(iii) Funksioni dhe Rekrutimi i Burimeve Njerëzore: SAI duhet të ketë një proces transparent rekrutimi, i cili duhet të përmbushi nevojat e tij.

(iv) Shpërblimet, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit: Me qëllim që të ketë një staf të motivuar, SAI-t i duhet të vlerësojë performancën individuale dhe të përdori këtë bazë për vendimet mbi promovimin dhe shpërblimin. Njësoj, SAI-t i duhet të krijojë dhe mbajë një mjedis të sigurt pune ku stafi është i lirë të shprehur shqetësimet e tij.

SAI – 22 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni(i) Funksioni i Burimeve Njerëzore	
<p>SAI duhet t'i ngarkojë përgjegjësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore një individi ose departamenti:</p> <p>a) Që duhet të ketë aftësitë, eksperiencën dhe burimet e duhura për ta bërë këtë detyrë. <i>ISSAI 40. fq 10</i></p> <p>Funksioni i burimeve njerëzore ka përgjegjësinë për:</p> <p>b) Zhvillimi dhe mirëmbajtja e strategjisë dhe politikave të burimeve njerëzore.</p> <p>c) Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një kuadri të kompetencave.</p> <p>d) Ofrimi i udhëzimeve dhe këshillimeve mbi çështjet e burimeve njerëzore.</p> <p>e) Mirëmbajtja e sistemit të vlerësimit të performancës.</p> <p>f) Hartimi i plani konkret mundësish për zhvillimin profesional të përshtatshëm.</p> <p>g) Mirëmbajtja e dokumentave të personelit (për shembull kodi i etikës i firmosur dhe raportet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional).</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Së paku pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohen.</p>	<p>ISSAI 40</p> <p>Udhëzuesi CBC MBNJ</p>
Dimensioni (ii) Strategjia e Burimeve Njerëzore	
<p>SAI duhet të ketë një strategji të burimeve njerëzore që:</p>	

<p>a) Është në përputhje me planin/objektivat strategjike të tij. <i>AFROSAI – EICBF fq.12</i></p> <p>b) Mbulon rekrutimin, shpërblimin, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional. <i>Udhëzuesi CBC MBNJ, fq.10-11; Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>c) Përmban informacion në lidhje me numrin dhe llojin e personelit që kërkohet për periudhën e planifikimit. <i>Udhëzuesi CBC MBNJ, fq.10-11</i></p> <p>d) Ka tregues, sistem vlerësimi dhe objektiva (p.sh. qarkullimi i stafit, vendet e lira dhe sëmundjet). <i>Udhëzuesi CBC MBNJ, fq.11</i></p> <p>e) Arritja e objektivave në strategji monitorohet çdo vit. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>f) Strategjia shpërndahet tek i gjithë stafi. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>g) Strategjia e burimeve njerëzore rishikohet dhe përditësohet rregullisht, të paktën një herë në pesë vjet. <i>Rrjedh nga Udhëzuesi CBC MBNJ, fq.10-13</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Së paku pesë nga kriteret e mësipërme r plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>Udhëzuesi CBC MBNJ</p> <p>AFROSAI – EICBF</p>
<p>Dimensioni (iii) Funkzioni dhe Rekrutimi i Burimeve Njerëzore</p>	
<p>Procesi i rekrutimit të SAI – t duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:</p> <p>a) Të ketë procedura të shkruajtura për rekrutimin (dhe kërkesat minimale të kualifikimit për stafin e rekrutuar) <i>ISSAI 40. fq.10</i></p> <p>b) Procedurat për rekrutimin bëhen publike <i>CBC Udhëzues për MBNJ fq.19</i></p> <p>c) Procedurat e rekrutimit promovojnë diversitetin <i>CBC Udhëzues për MBNJ fq.19</i></p> <p>d) Në rekrutimet e fundit, procesi i vendimmarrjes përfshin më shumë se një person. <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues për MBNJ fq.19-20</i></p> <p>e) Planet e përgjithshme aktuale të rekrutimit bazohen në analizat e nevojave organizative, duke marrë në konsideratë çështje të tilla si: vendet vakante, nivelin ekzistues të kompetencave dhe aftësive dhe koeficientin</p>	<p>ISSAI 40</p> <p>CBC Udhëzues për MBNJ</p>

<p>e qarkullimit të stafit. <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues për MBNJ fq.10-21, dhe AFROSAI-E ICBF, fq.11</i></p> <p>f) Njoftimet për pozicionet e lira gjatë vitit fundit përfshijnë një përshkrim të aftësive dhe eksperiencës së kërkuar, si dhe janë publikuar <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues për MBNJ fq.19-20,</i></p> <p>g) Burimet e brendshme njerëzore plotësohen nga ekspertiza e jashtme sipas nevojës, si dhe SAI ka procedura për të siguruar cilësinë e rezultateve. <i>ISSAI 40. fq.9-10</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p>	<p>AFROSAI-E ICBF</p>
<p>Dimensioni (iv) Shpërblimet, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit</p>	
<p>SAI duhet të ketë praktika efektive për shpërblimin, promovimin dhe mirëqenien e stafit, të cilat tregohen nëpërmjet:</p> <p>a) Ka krijuar procedura rregullta për të siguruar vlerësimin individual të performancës së paku një herë gjatë vitit. <i>CBC Udhëzues për MBNJ fq.23; Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>b) Vlerësimi më i fundit i performancës vlerëson performancën e punonjësit krahasuar me përshkrimin e punës ose marrëveshjen e performancës të kryer në vitin e mëparshëm. <i>CBC Udhëzues për MBNJ fq.24</i></p> <p>c) Atëherë kur është brenda kompetencave të SAI-t, ka prova se vendimet më të fundit të shpërblimit dhe çdo shpërblim është bërë në përputhje me procedurat e përcaktuara. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>d) Procedura e promovimit merr parasysh vlerësimin e performancës dhe potencialin për të patur rezultate në nivel më të lartë. <i>CBC Udhëzues për MBNJ fq.23-24</i></p> <p>e) Vendimet mbi promovimet e dhëna gjatë vitit të kaluar, ose vendimet për të paktën dy promovimeve të fundit, kanë ndjekur procedurat e përcaktuara. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p>	<p>Udhëzuesi CBC MBNJ</p>

f) Ka një politikë për mirëqenien e stafit (kjo mund të jetë pjesë e strategjisë së burimeve njerëzore). *CBC Udhëzues për MBNJ fq.36*

g) Punonjësit kanë pasur mundësinë të shprehin pikëpamjet e tyre mbi mjedisin e punës në menaxhimin gjatë vitit të fundit. *Rrjedh nga CBC Udhëzues për MBNJ fq.36-38*

h) Drejtimi ka ndërmarrë veprime për problemet që kanë dalë nga diskutimet e shprehura në mjedisin e punës. *Rrjedh nga CBC Udhëzues për MBNJ fq.36-38*

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

SAI-23: Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi

Sipas ISSAI 40, SAI duhet ofrojë një shërbim ekselent dhe cilësor. Si pjesë e menaxhimit të cilësisë "SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për t'i dhënë siguri të arsyeshme se ka burime të mjaftueshme (personel...) me kompetencën, aftësitë dhe angazhimin ndaj parimeve etike të nevojshme për:

- i. kryerjen e punës në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi; dhe
- ii. të mundësuar SAI-n të nxjerrë raporte që janë të përshtatshme për rrethanat "(ISSAI 40, elementi 4).

ISSAI 12 thekson se SAI-et duhet të promovojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional që ndikon në ekselencën individuale, të grupit dhe të gjithë organizatës.

Ky tregues vlerëson sesi SAI, si një organizatë, është e aftë të promovojë dhe sigurojë zhvillimin profesional për përmirësimin dhe mbajtjen e kompetencave të stafit të vet.

Dimensione për tu vlerësuar:

- (i) Planet dhe Proceset për Zhvillim dhe Formimit Profesional dhe Trajnimi;*
- (ii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar;*
- (iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Performancës;*
- (iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Përputhshmërisë.*

(i) Planet dhe Proceset për Zhvillim dhe Formimit Profesional: SAI duhet të krijojë dhe të zbatojë planet e duhura të zhvillimit dhe trajnimit profesional për të siguruar që stafi i tij ka kompetencën dhe aftësitë e duhura për të kryer punën dhe për të mundësuar që SAI të arrijë objektivat e tij. Planet duhet të lidhen me strategjinë e burimeve njerëzore të SAI-t, veçanërisht rekrutimin dhe promovimin. Ato duhet të përfshijnë aftësitë e përgjithshme që kërkohen nga i gjithë stafi, si aftësitë personale, mbikëqyrjen dhe menaxhimin; të jenë të lidhura me identifikimin e nevojave të zhvillimit të sistemit të vlerësimit të stafit; dhe të monitorohen dhe vlerësohen.

Në veçanti, SAI duhet të identifikojë disiplinat përkatëse të auditimit për mandatin dhe qasjen e tij të auditimit, për të zhvilluar 'ekipet profesionale' ose 'personat kryesor' brenda stafit të cilët kanë aftësitë e duhura për të ndërmarrë llojet e ndryshme të auditimeve të kryera nga SAI. P.sh: auditimin financiar, auditimin e përputhshmërisë, auditimin e performancës, ndonjë kombinim të tyre, ose lloje të tjera auditimi. Kjo mund të pasqyrojë mënyrën se si SAI kombinon lloje të ndryshme auditimi, ose SAI

mund të zhvillojë një profesion të vetëm të auditimit, me qëllim që të gjithë audituesit të jenë në gjendje të kryejnë të gjitha llojet e auditimeve.

(ii), (iii), (iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar, Performancës dhe Përputhshmërisë: SAI duhet të krijojë dhe të zbatojë planet e duhura të zhvillimit dhe të trajnimit profesional për secilin nga 'ekipet profesionale' ose 'personat kryesor', dhe të monitorojë dhe vlerësojë rezultatet. Këto tre fusha kanë kriteret për trajnimet dhe zhvillimin për këto tre disiplina auditimi, auditimi financiar, auditimin e performancës dhe atë të përputhshmërisë.

SAI – 23 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensionet (i) Planet dhe Proceset për Zhvillim Profesional dhe Trajnimin	
<p>Praktikat e zhvillimit profesional të SAI-t duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:</p> <p>a) SAI zhvillon dhe zbaton një plan për zhvillim profesional dhe trajnim i cili përmban: <i>Të mësuarit për Impakt i IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.17-18, Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>I. Prezantimi dhe Njohja për stafin e ri.</p> <p>II. Trajnime të brendshme mbi politikat, procedurat dhe proceset e SAI-t.</p> <p>III. Trajnime për aftësitë personale (p.sh. aftësi komunikimi dhe shkrimi, aftësi analitike, aftësi prezantimi, aftësi intervistimi, etikë, mbikëqyrje).</p> <p>IV. Menaxhimi.</p> <p>b) Strategjia e të mësuarit të SAI-t dhe/ose plani vjetor për zhvillimin profesional dhe trajnimin është:</p> <p>I. Në përputhje me strategjinë e burimeve njerëzore. <i>Të mësuarit për Impakt i IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.29-42; AFROSAI-E ICBF. fq.12;</i></p> <p>II. I lidhur me qëllimet/objektivat e përcaktuara në planet strategjike dhe operacionale të SAI-t. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.29-42;</i></p>	<p>ISSAI 40</p> <p>CBC Udhëzues MBNJ</p> <p>Të mësuarit për Impakt i IDI: NJë Udhëzues Praktike për SAI- t</p> <p>AFROSAI-E ICBF</p>

<p>III. Është bazuar në rezultatet e analizës së nevojave për të mësuar. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-55; CBC Udhëzues MBNJ, fq.30.</i></p> <p>c) SAI ka procedura për përzgjedhjen e stafit për të marrë pjesë në trajnime dhe të marrin kualifikime profesionale të përcaktuara, dhe zgjedhja është e bazuar në aplikimet dhe konsideratat e kompetencave të nevojshme. <i>Rrjedh nga ISSAI 40: fq.9-10 dhe IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-59;</i></p> <p>d) Të gjithë punonjësit profesionistë (drejtuesit, menaxherët, audituesit etj) duhet të kenë një plan zhvillimi të bazuar në një vlerësim vjetor dhe zbatimi i planit duhet të monitorohet. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.58-59, 173; CBC Udhëzues MBNJ, fq.39;</i></p> <p>e) SAI ka identifikuar 'ekipet profesionale' ose 'personat kryesor' të auditimit që duhet të zhvillojë për përmbushjen e mandatit të tij. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.45-50;</i></p> <p>f) Një sistem për zhvillimin profesional të stafit jo auditues/kontrollues është i zhvilluar me përgjegjësi të qarta. Kërkesat për kompetencat e duhura dhe një plan për zhvillimin profesional edhe për stafin jo auditues/kontrollues është hartuar në bazë të nevojave të identifikuara dhe zbatohet. <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-19; IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-59;</i></p> <p>e) Ekzistojnë mekanizma për të monitoruar dhe vlerësuar rezultatin e zhvillimit profesional dhe trajnimin e stafit. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.171-178.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme është plotësuar.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar</p>	
<p>Për zhvillimin profesional dhe trajnimin për auditimin financiar, SAI duhet të:</p>	

<p>a) Të caktojë përgjegjësinë për zhvillimin profesional te një person se persona me eksperiencën e duhur dhe autoritet të mjaftueshëm brenda SAI-t. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p> <p>b) Zhvilloi kërkesat për kompetencat e duhura për nivele të ndryshme të stafit në auditimin financiar. <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-19; IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-59,</i></p> <p>c) Zhvilloi dhe implementoi një plan për zhvillimin profesional për stafin e auditimit financiar mbi bazën e një analize të përshtatshme duke adresuar dhe identifikuar nevojat dhe kompetencën e kërkuar për nivele të ndryshme të stafit. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-55; CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-18;</i></p> <p>d) Plani për zhvillimin profesional dhe trajnimin në auditimin financiar duhet të mbulojë sipas rastit:(<i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i>)</p> <p>I. Trajnim i brendshëm mbi standardet e auditimit dhe procedurat e SAI-t.</p> <p>II. Mësimi në punë dhe skemat e mbikëqyrjes/udhëzimit.</p> <p>III. Trajnimi profesional ose akademik/anëtarësimi në organet përkatëse profesionale ose akademike.</p> <p>IV. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>CBC Udhëzuesi MBNJ</p> <p>Të mësuarit për Impakt i IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t</p>
<p>Dimensioni (iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Performancës</p>	
<p>Për zhvillimin profesional dhe trajnimin për auditimin e performancës, SAI duhet të:</p> <p>a) Të caktojë përgjegjësinë për zhvillimin profesional tek një person ose persona me eksperiencën e duhur dhe autoritet të mjaftueshëm brenda SAI-t. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i></p>	<p>Udhëzuesi CBC HRM</p> <p>Impakti i të mësuarit i IDI: Një Guidë</p>

<p>b) Zhvilloi kërkesat për kompetencat e duhura për nivele të ndryshme të stafit në auditimin e performancës <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-19; IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-59</i></p> <p>c) Zhvilloi dhe implementoi një plan të zhvillimit profesional për auditimin e performancës për stafin mbi bazën e një analize të përshtatshme duke adresuar dhe identifikuar nevojat dhe kompetencën për nivele të ndryshme të stafit. <i>IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-55; CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-18;</i></p> <p>d) Plani për zhvillimin profesional dhe trajnimin në auditimin e performancës duhet të mbulojë sipas rastit: (<i>Grupi i Punës KMP i SAI-t</i>)</p> <p>I. Trajnim i brendshëm mbi standardet e auditimit dhe procedurat e SAI-t.</p> <p>II. Mësimi në punë dhe skemat e mbikëqyrjes/udhëzimit.</p> <p>III. Trajnimi profesional ose akademik/anëtarësimi në organet përkatëse profesionale ose akademike.</p> <p>IV. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>praktike për SAI-et</p>
<p>Dimensioni (iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Përputhshmërisë</p>	
<p>Për zhvillimin profesional dhe trajnimin për auditimin e përputhshmërisë, SAI duhet të:</p> <p>a) Të caktojë përgjegjësinë për zhvillimin profesional tek një person ose persona me eksperiencën e duhur dhe autoritet të mjaftueshëm brenda SAI-t. <i>Grupi i Punës KMP i SAI-t;</i></p> <p>b) Zhvilloi kërkesat për kompetencat e duhura për nivele të ndryshme të stafit në auditimin e përputhshmërisë <i>Rrjedh nga CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-19; IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-59</i></p>	<p>Udhëzuesi CBC MBNJ</p> <p>Të mësuarit për Impakt i IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t</p>

c) Zhvilloi dhe implementoi një plan zhvillimi profesional për auditimin e përputhshmërisë për stafin mbi bazën e një analize të përshtatshme duke adresuar dhe identifikuar nevojat dhe kompetencën për nivele të ndryshme të stafit. *IDI: Një Udhëzues Praktike për SAI-t, fq.43-55; CBC Udhëzues MBNJ, fq.15-18;*

d) Plani për zhvillimin profesional dhe trajnimin në auditimin e përputhshmërisë duhet të mbulojë sipas rastit: (*Grupi i Punës KMP i SAI-t*)

I. Trajnim i brendshëm mbi standardet e auditimit dhe procedurat e SAI-t.

II. Mësimi në punë dhe skemat e mbikëqyrjes/udhëzimit.

III. Trajnimi profesional ose akademik/anëtarësimi në organet përkatëse profesionale ose akademike.

IV. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional.

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Së paku tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.

Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.

Fusha G: Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara

ISSAI 12 identifikon një nga objektivat kryesore të SAI-t, demonstrimi i rëndësisë së tij te palët e interesit. SAI duhet të komunikojë me palët e interesit me qëllim që ata të kuptojnë punën audituese dhe rezultatet e saj. Kjo duhet të bëhet me qëllim që të rriten njohuritë e palëve të interesit dhe që të kuptojnë rolin dhe përgjegjësinë e SAI-t, si një auditues i pavarur i sektorit publik. SAI-et duhet të identifikojnë palët e tyre të interesit dhe të zhvillojnë strategjinë e komunikimi. Një kërkesë kryesore lidhur me komunikimin dhe menaxhimin e palëve të interesit është stili, gjuha dhe formati i përdorur për të përfshirë palët e interesit.

Krahas kërkesave të përmendura më sipër, SAI duhet të autorizohet nga ligji kombëtar ose kuadri rregullator që t'i raportojë Legjislativit dhe organeve të tjera publike, dhe të publikojë gjetjet më të rëndësishme të auditimeve. Këto aspekte maten te Fusha A Pavarësia dhe Kuadri Ligjor. (SAI-2 (iii)). Në mënyrë të ngjashme, komunikimi me subjektin e audituar/kontrolluar gjatë punës audituese matet te Fusha C mbi Cilësia e Auditimit dhe Raportimi. Fusha F e konsideron komunikimin me palët e interesit në nivel strategjik. Komunikimi i brendshëm matet te Fusha B Strategjia Organizative, Planifikimi dhe Kontrolli (SAI-6 (ii)). Aktorët e jashtëm (ose "Grupet e synuara për komunikim të jashtëm", siç thuhet në Udhëzuesin e INTOSAI-t "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerës dhe Përfitimeve të SAI-ve", paragrafi 3.2.1) të SAI-t përfshijnë, por nuk mund të kufizohet vetëm tek:

- Legjislativi: veçanërisht komisioni legjislativ përgjegjës për miratimin e buxhetit, si dhe për mbikëqyrjen e funksioneve të qeverisë dhe të financave publike;
- Ekzekutivi: organizatat qeveritare/organet ekzekutive/agjencitë;
- Subjektet e audituara;
- Gjyqësori, Prokuroria dhe agjencitë investiguese;
- Mediat;
- Qytetarët/publiku i përgjithshëm;
- Grupet e interesit, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e zhvillimit, akademikë dhe organizata të politikave publike, dhe
- Organizatat profesionale që përcaktojnë standarde.

Treguesit e Performancës

SAI - 24: Komunikimet me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin;

SAI - 25: Komunikimet me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.

SAI-24: Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin

SAI-24 vlerëson praktikat e komunikimit që SAI vendos me palët institucionale të interesit. SAI duhet të komunikojë efektivisht me këto palë interesi. Për sa i përket modelit të SAI-t, SAI duhet ta mendojë punën e tij në kontakt me këto institucione. SAI duhet të ndërmarrë iniciativën të komunikojë mandatin dhe aktivitetet e tij, në mënyrë të tillë që mos të cenohet pavarësinë. Praktikrat më të mira mund të lehtësojnë komunikimin duke ndihmuar në minimizimin e riskut. Komunikimi efektiv do t'iu lejojë palëve të interesit të shohin raportet e SAI-t, dhe gjithashtu lejon SAI-n të jetë i përgjegjshëm në menaxhimin e riskut.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) Strategjia e Komunikimit;*
- (ii) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Legjislativin;*
- (iii) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Ekzekutivin;*
- (iv) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Gjyqësorin, dhe/ose Prokurorinë dhe agjencitë investiguese.*

(i) Strategjia e komunikimit: Për të komunikuar si duhet vlerat dhe përfitimet që i japin për shoqërinë, SAI-et duhet të krijojnë një strategji komunikimi në linjë me objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik përkatës. Qëllime të tjera të një strategjie të komunikimit mund të përfshijnë marrja e mbështetjes nga vendimmarrësit, mediat dhe qytetarët për rolin e rëndësishëm të SAI-t, ose për të qartësuar rolin e tij ku ka mundësi për konfuzion me institucione e tjera kombëtare. Ky dimension merr në konsideratë vetëm komunikimin e jashtëm (komunikimi i brendshëm është mbuluar në Fushën B, Treguesi SAI-6). Strategjia e komunikimit nuk ka nevojë të përfshihet në një dokument të vetëm - elementet e saj mund të përfshihen në dokumenta të ndryshëm. Megjithatë, strategjia duhet identifikojë palët e interesit dhe audiencat me të cilat SAI duhet të komunikojë për të arritur objektivat organizative dhe për të përmbushur mandatin e tij. Strategjia duhet gjithashtu të deklarojë qartë mesazhet kryesore që SAI dëshiron të komunikojë, si dhe mjetet që do të përdorë për të këtë qëllim, të tilla si burimet e përcaktuara për komunikimin dhe mjete të veçanta analitike si listimi i palëve të interesuara dhe analiza. Treguesit duhet të monitorojnë progresin kundrejt objektivave të strategjisë së komunikimit, me qëllim që të vlerësohet performanca dhe të ndërmerren veprimet korrigjuese të nevojshme. Me qëllim krijimin, zbatimin dhe

monitorimin e strategjisë së komunikimit, SAI duhet të ketë staf të përkushtuar për këtë funksion në proporcion me shkallën e aktiviteteve të tij.

(ii) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Legjislativin: Legjislativi është një nga palët e interesit më të rëndësishme të SAI, pasi luan një rol në mbajtjen përgjegjës të Ekzekutivit për përdorimin e fondeve publike. Është e rëndësishme që Legjislativi ta konsiderojë SAI-n si një partner i rëndësishëm dhe i vlefshëm në mbikëqyrjen e veprimeve dhe vendimeve për shpenzime të Ekzekutivit. Në shumë vende, Legjislativi dhe SAI janë reciprokisht të varura nga njëri tjetri kur ushtrojnë funksionin e mbikëqyrjes. Legjislativi duhet të mbështetet tek SAI për të realizuar shqyrtimin e detajuar të llogarive publike, dhe përdorimin e parave publike; dhe SAI mund të marrin mbështetje të vlefshme nga Legjislativi në mbajtjen përgjegjës të përfaqësuesve të Ekzekutivit. Kapaciteti i Legjislativit për t'u përfshirë dhe për të përdorur produktet e SAI-t është thelbësor për efektivitetin e vetë SAI-t. SAI duhet të hartojë strategji për t'iu përgjigjur çdo kufizimi në kapacitete të identifikuar. SAI me funksione gjyqësore normalisht kanë një marrëdhënie të distancuar me Legjislativin në krahasim me SAI-t me një model Parlamentar, por Legjislativi është gjithashtu një palë interesi e rëndësishme për to.

(iii) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Ekzekutivin: Ky dimension merr në konsideratë komunikim strategjik të SAI-t me organizatat e Ekzekutivit. Një komunikim i tillë strategjik mund të hedhë themelet që puna e SAI-t të jetë me rëndësi për të audituarit, për veprimet e duhura të ndjekjes së rekomandimeve për t'u ndërmarrë nga Ekzekutivi, si dhe bashkëpunim efektiv me të audituarit në procesin e auditimit.

(iv) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Gjyqësorin, dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë investiguese: Komunikimi me Gjyqësorin dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë investiguese, përfshirë agjencitë anti-korrupsion, është i rëndësishëm sepse gjetjet e auditimit, kur është e përshtatshme, mund të hetohen më tej dhe përdoren nga institucionet ligjore për investigim. Disa SAI kanë mandatin për të vendosur sanksione në mënyrë të drejtpërdrejtë, të tjerë nuk e kanë. Në secilin prej rasteve, duhet të vendosen dhe të mbahen në mënyrë të përcaktuar qartë marrëdhëniet e punës me Gjyqësorin, dhe/ose Prokurorinë dhe agjencitë investiguese.

SAI – 24 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioni (i) Strategjia e komunikimit	
<p>SAI duhet të:</p> <p>a) Hartojë një strategji për komunikimet dhe /ose përfshirjen e palëve të interesit. <i>Udhëzues i INTOSAI-t “Mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-t”</i>: fq.4-5</p> <p>b) Identifikojë palët kryesore të interesit me të cilët SAI duhet të komunikojë për të arritur objektivat organizative. <i>AFROSAI-E Manual mbi komunikimin e SAI-t</i>, fq 34-35</p> <p>c) Identifikojë mesazhet kryesore që SAI dëshiron të komunikojë. <i>Udhëzues i INTOSAI-t “Mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-t”</i>: fq.4</p> <p>d) Identifikojë qasjet dhe mjetet e përshtatshme për komunikimin e jashtëm. <i>Udhëzues i INTOSAI-t “Mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-t”</i>: Kapitulli 3.1 (domethënë rolet dhe përgjegjësitë e stafit të përcaktuar për komunikimin).</p> <p>e) Vendosë strategjinë e komunikimit në të njëjtën linjë me planin e tij strategjik. <i>AFROSAI-E Manual mbi komunikimin e SAI-t</i>, fq 43</p> <p>f) Monitorojë në mënyrë periodike implementimin e strategjisë së komunikimit. <i>Udhëzues i INTOSAI-t “Mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-t”</i>: Kapitulli 3.1</p> <p>g) “(...) vlerësojë në mënyrë periodike nëse palët e interesit besojnë se SAI komunikon në mënyrë efektive.” <i>ISSAI 12:6</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri c) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	<p>ISSAI 12</p> <p>Udhëzues i INTOSAI-t “Mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-t”</p> <p>AFROSAI-E</p> <p>Manual mbi komunikimin e SAI-t</p>

<p>Pikëzimi = 3: Kriteri (c) dhe së paku pesë nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Së paku katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Më pak se dy kritere plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (iii) Praktikët e Mira për Komunikimin me Ekzekutivin</p>	
<p>Sa i përket komunikimit me Ekzekutivin, SAI duhet të:</p> <p>a) "mos jetë i përfshirë ose të duket sikur është i përfshirë, në asnjë mënyrë, në menaxhimin e organizatave që ata auditon". <i>ISSAI 20:3</i></p> <p>b) Ofrojë informacion të përgjithshëm subjektit të audituar për çfarë duhet të presin gjatë një auditimi (të tillë si prodhimi dhe shpërndarja e udhëzuesve mbi objektivat e SAI-t dhe parimet që udhëheqin ndërveprimet midis audituesve dhe subjekteve të audituara). <i>Udhëzues i INTOSAI –t Si të rrisim përdorimin dhe impaktin e raporteve të auditimit, faqe 11.</i></p> <p>c) Të ftojë në mënyrë periodike anëtarët e nivelit të lartë të Ekzekutivit në takime për të diskutuar çështje shqetësuese në lidhje me të dy SAI dhe Ekzekutivin, duke përfshirë gjetjet e përbashkëta, trendet dhe origjinën e shkakut që SAI ka identifikuar nëpërmjet analizës së raporteve të auditimit. <i>ISSAI 12:3, Grupi i Punës SAI KMP.</i></p> <p>d) Të marrë reagimet nga Legjislativi mbi cilësinë dhe përshtatshmërinë e raporteve dhe procesit të auditimit. <i>Udhëzues i INTOSAI–t Si të rrisim përdorimin dhe impaktin e raporteve të auditimit, faqe 21. AFROSAI-E Manual mbi komunikimin e SAI-t, fq 69.</i></p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p>	<p>ISSAI 10</p> <p>ISSAI 12</p> <p>Udhëzues INTOSAI mbi si të rrisim përdorimin dhe impaktin e raporteve të auditimit.</p>

<p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (iv) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Gjyqësorin, dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë Investiguese</p>	
<p>SAI-et duhet të:</p> <p>a) Vendosur politika dhe procedura për mënyrën se si komunikohet me Gjyqësorin, dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë investiguese në lidhje me gjetjet e auditimit që janë të rëndësishme për këto agjenci. <i>Grupi i Punës KMP së SAI-t (domethënë nëse gjetjet e auditimit duhet të ndiqen nga këto institucione, ose, në rastin e SAI-ve me funksione gjyqësore, ku gjykimet përmbushin kriteret për t'u ndjekur nga sistemi i drejtësisë penale.)</i></p> <p>b) Realizojë aktivitete të rritjes së ndërgjegjësimit me Gjyqësorin dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë investiguese mbi rolin, mandatin dhe punën e SAI-t. <i>ISSAI 12:6 . Grupi i Punës SAI KMP.</i></p> <p>c) Komunikojë me Gjyqësorin dhe/ose Prokurorinë dhe Agjencitë investiguese për rolin e SAI-t në lidhje me hetimet dhe procedurat ligjore që janë iniciuar në bazë të gjetjeve të auditimit të SAI-t. <i>Grupi i Punës KMP së SAI-t.</i></p> <p><i>(d.m.th. për të zvogëluar rrezikun që SAI aksidentalisht të pengojë procese të tilla përmes punës së tij të auditimit në rastet kur gjetjet e auditimit mund të çojnë në procedurat ligjore).</i></p> <p>d) Vendosë një sistem për ndjekjen e rasteve që SAI i ka transferuar Gjyqësorit dhe/ose Prokurorisë dhe Agjencive investiguese. <i>ISSAI 12:1</i></p> <p>e) Kur është e përshtatshme, SAI duhet të ketë politika dhe procedura për dokumentimin e auditimit që janë të hartuara për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e aplikueshme të evidencave, <i>ISSAI 40, faqe 12, ISSAI 1230 faqe 15 (Kjo është e rëndësishme për disa SAI me funksione gjyqësore ku audituesit janë subjekt i ligjeve dhe rregulloreve që kërkojnë atyre që të kuptojnë dhe të ndjekë procedurat e sakta dokumentacionit në lidhje me administrimin e provave. ISSAI 1230 faqe 15)</i></p>	<p>ISSAI 12</p> <p>ISSAI 40</p>

<p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 3: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet</p> <p>Pikëzimi = 0: Anjë ka kriteret e mësipërme nuk plotësohet</p>	
---	--

SAI-25: Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

SAI duhet të perceptohet si një burim i besueshëm i mendimit të pavarur e objektiv dhe si udhëzues për të mbështetur ndryshime të dobishme në sektorin publik (ISSAI 12:7). Ky tregues vlerëson praktikën e SAI-t për të arritur informimin e shoqërisë dhe publikut në lidhje me rolin, punën dhe rezultatet e tij, si dhe të kontribuojë në rritjen e llogaridhënies në sektorin publik.

Dimensionet për t'u vlerësuar:

- (i) *Praktikat e Mira për Komunikimin me Mediat;*
- (ii) *Praktikat e Mira për Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile.*

(i) Praktikat e Mira për Komunikimin me Mediat: Media është një nga kanalet kryesore të komunikimit me publikun. Prandaj, është e rëndësishme që SAI të mbajë marrëdhënie efektive me organizatat e medias, për të maksimizuar ekspozimin në publik të gjetjeve të rëndësishme të auditimit. Kjo marrëdhënie duhet të jetë në përputhje me strategjinë e komunikimit të SAI-t dhe/ose kornizën ligjore.

Komunikimi me mediat duhet të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme nga SAI. Duhet të caktohet në mënyrë të qartë përgjegjësia për komunikimin dhe menaxhimin të palëve të interesuara. Personat e ngarkuar me këto detyra duhet të kenë aftësitë e duhura, përvojën dhe burimet për të kryer këtë punë. Në varësi të madhësisë së SAI-t, kjo mund të nënkuptojë një person të vetëm të dedikuar për çështje të komunikimit ose departamente të veçanta për komunikimin dhe menaxhimin e palëve të interesuara. Stafi përgjegjës për komunikim dhe menaxhimin e palëve të interesuara duhet të ketë një linjë të drejtpërdrejtë raportimi me drejtuesin e SAI-t, me qëllim që të sigurohet akses në informacion në nivelet më të larta dhe për të lehtësuar komunikimin e brendshëm.

(ii) Praktikat e Mira për Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile: Shoqëria po bëhet gjithnjë e më e vetëdijshme për aftësinë e saj në mbajtjen e qeverive të përgjegjshme. SAI duhet të stimulojë këtë sjellje, duke arritur direkt te qytetarët dhe shoqëria civile, dhe duke zhvilluar marrëdhënie të ngushta me ta. Të gjitha komunikimet duhet të përshtaten për audiencën e tyre, dhe në këto raste gjuha duhet të jetë e qartë dhe e kuptueshme. Mesazhet mund të përfshijnë foto/grafikë, ose mund të përcillen nëpërmjet radios ose mediave të tjera, dhe/ose në gjuhët lokale/dialekte. Krahas

publikimit të gjetjeve të auditimit, SAI duhet gjithashtu të përpqet t'u ofrojë qytetarëve akses në informacion mbi menaxhimin e sektorit publik në përgjithësi, me qëllim që të nxisë transparencën. Ky informacion mund të përfshijë çështje të tilla si prokurimi, borxhi publik, burimet natyrore, ose informacion të përgjithshëm mbi ekzekutimin e buxhetit.

SAI – 25 Dimensionet & Kriteret Minimale për Pikëzim	Referenca Kyçe
Dimensioani (i) Praktikati e Mira për Komunikimin me Mediat	
<p>Sa i përket komunikimit me median:</p> <p>a) Gjatë periudhës në rishikim, SAI ka mbajtur konferenca për shtyp për raportin e tij vjetor dhe duke përfshirë sipas rastit raporte të tjera të rëndësishme dhe raporte të auditimit të performancës. <i>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve": 2.2</i></p> <p>b) Gjatë periudhës në rishikim, SAI ka bërë njoftime për shtyp për raporte të rëndësishme, duke përfshirë sipas rastit edhe raporte të auditimit të performancës. <i>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve": 2.2</i></p> <p>c) Gjatë periudhës në rishikim, SAI ka përdorur mediat e duhura për të shpërndarë raporte të auditimit, duke përfshirë sipas rastit edhe raporte të auditimit të performancës. <i>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve" :2.2</i></p> <p>d) SAI ka vendosur një sistem për monitorimin e prezencës së SAI në media dhe çështje që kanë lidhje me SAI-n. <i>Udhëzues i INTOSAI "Si të rrisim përdorimin dhe ndikimin e raporteve të auditimit":5.1</i></p> <p>e) SAI ka autorizuar një ose disa individë që të komunikojnë me median në emër të SAI-t. <i>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve" :3.1,3.2</i></p> <p>f) SAI ka vendosur procedura për menaxhimin e kërkesave të medias dhe ka një pikë kontakti me mediat. <i>Udhëzim i INTOSAI</i></p>	<p>ISSAI 20</p> <p>ISSAI 300</p> <p>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve";</p> <p>Udhëzues i INTOSAI "Si të rrisim përdorimin dhe ndikimin e raporteve të auditimit"</p>

<p><i>"Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve"</i> :3.2.2.</p> <p>Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen</p> <p>Pikëzimi = 3: Kriteri c) dhe të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 2: Të paktën tre nga kriteret e mësipërme plotësohen.</p> <p>Pikëzimi = 1: Të paktën një nga kriteret e mësipërme plotësohet.</p> <p>Pikëzimi = 0: Asnjë nga kriteret e mësipërme nuk plotësohet.</p>	
<p>Dimensioni (ii) Praktikrat e Mira për Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile</p>	
<p>Për sa i përket komunikimit me qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile, gjatë periudhës së vlerësimit SAI ka:</p> <p>a) "{bërë } publik mandatin e tij (...)" <i>ISSAI 12:8</i></p> <p>b) Publikuar përmbledhjet e raporteve të auditimit, me shkrim ose i ka komunikuar ato në mënyrë që të bëjë të lehtë për qytetarët të kuptojnë gjetjet kryesore të auditimit. <i>ISSAI 12:8, Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve" :2.2</i></p> <p>c) Vendosur kontakte me organizatat e duhura të shoqërisë civile dhe i ka nxitur ato që të lexojnë dhe të përhapin gjetjet e auditimeve tek qytetarët. <i>Udhëzues i INTOSAI "Si të rrisim përdorimin dhe ndikimin e raporteve të auditimit" faqe 78</i></p> <p>d) Stimuluar akses në informacionin mbi auditimin publik, përtëj raporteve të auditimit, nga qytetarët. <i>Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve" :3.1</i></p> <p>e) Ofruar mundësi qytetarëve të japin të dhëna dhe/ose të marrin pjesë në punën e SAI-t pa kompromentuar pavarësinë e SAI-t. (të tilla si duke vendosur mekanizma për marrjen dhe monitorimin e informacionit në lidhje me programet qeveritare dhe sugjerimet për përmirësimin e administratës dhe shërbimeve publike - duke përfshirë sipas rastit edhe kanalet on-line). <i>Udhëzim i INTOSAI</i></p>	<p>INTOSAI Udhëzimi "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve";</p> <p>ISSAI 20, Parimi 8.</p>

"Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve"
:3.2.4

f) Përdorur në mënyrën e duhur mediat online (website institucional, gazetat e-mail, rrjetet sociale, ...), në përputhje me kulturën e vendit (p.sh. ku rrjetet sociale janë të njohura, SAI duhet të zhvillojë praninë e tij në këto rrjete) *Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve"* :3.2.3

g) "SAI-t duhet të kontribuojnë në debate për përmirësimin e sektorit publik pa kompromentuar pavarësinë e tyre." *Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve"* :3.2.3

h) Kërkuar reagime nga organizatat e shoqërisë civile dhe/ose anëtarët e publikut mbi aksesueshmërinë e raporteve të tij, dhe ka përdorur këtë regjim për përmirësime në të ardhmen. *Udhëzim i INTOSAI "Komunikimi dhe Promovimi i Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve"* :3.2.4, IV.

Pikëzimi = 4: Të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 3: Të paktën gjashtë nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 2: Të paktën katër nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 1: Të paktën dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Pikëzimi = 0: Më pak se dy nga kriteret e mësipërme plotësohen.

Aneksi 1: Përkufizimi i termave

<p>Auditim</p>	<p>Në përgjithësi, auditimi i jashtëm në sektorin publik mund të përshkruhet si një proces sistematik, objektiv i marrjes dhe vlerësimit të provave për të përcaktuar nëse informacioni ose kushtet aktuale janë në përputhje me kriteret e vendosura. Auditimi i sektorit publik është thelbësor sepse i jep organeve legjislative dhe mbikëqyrëse, të ngarkuarve me qeverisjen dhe publikut të gjerë, informacion dhe vlerësime të pavarura dhe objektive lidhur me administrimin dhe performancën e politikave programeve ose operacioneve qeveritare. (ISSAI 100: 18).</p> <p>Në përgjithësi, auditimet e sektorit publik mund të kategorizohen në një ose më shumë nga tre lloje kryesore: auditime të pasqyrave financiare, auditimetë përputhshmërisë me kornizën ligjore dhe auditime të performancës. Objektivat e çdo auditimi do të përcaktojnë se cilat standarde do të zbatohen. (ISSAI 100: 21).</p> <p>SAI-t me funksione gjyqësore kryjnë kontrollegjyqësore. Në seksionet e SAI KMPku auditimi përdoret në kuptimin e përgjithshëm, mbulohen gjithashtu aktivitetet e kontrollit të SAI-t me funksione gjyqësore. Treguesit në fushës C lidhen, në mënyrë specifike, me auditimin financiar, auditimin e performancës, auditimit të përputhshmërisë ose kontrollet juridiksional (shih përkufizimet e këtyre termave më poshtë).</p>
<p>Subjekt i audituar/ kontrolluar</p>	<p>Njësi juridike e cila është subjekti auditimit/kontrollit gjyqësor nga SAI.</p>
<p>Auditues</p>	<p>Personat të cilëve u delegohet/ngarohet detyra e auditimit.</p>
<p>Kriteri i auditimit</p>	<p>Kritere që përdoren janë standarde për të vlerësuar çështjen. Çdo auditim duhet të ketë kriteret e përshtatshme për rrethanat e auditimit. Kriteret mund të jenë specifike ose</p>

	shumë të përgjithshme, dhe mund të nxirren nga burime të ndryshme, duke përfshirë ligjet, rregulloret, standardet, parimet e shëndosha dhe praktikat më të mira.
Evadim i raportit të auditimit	Kur vendimmarrësi i SAI-t (domethënë Kryetari i SAI-t) miraton raportin.
Auditimi i Pajtueshmërisë	Përqëndrohet në faktin nëse një çështje e veçantë është në përputhje me kornizën ligjore të aplikueshme të identifikuar si kritere. Auditimi i Përputhshmërisë kryhet duke vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullat që qeverisin subjektin e audituar. Kjo kornizë ligjore mund të përfshojë rregulla, ligje dhe rregullore, rregullat e buxhetit, politikën, kushtet e dakortësuara ose parime të përgjithshme që qeverisin menaxhimin e mire financiar të sektorit publik dhe sjelljen e zyrtarëve publikë. (ISSAI 100:22)
Kontroll	Shih përshkrimin tek termi “auditim”
Kulturë	Mënyra e të menduarit, sjelljes ose e të punuarit që ekziston në një vend ose organizatë.
Dimensioni (në SAI KMP)	Komponentët e një indikatorit. Ekzistojnë deri në katër dimensione për çdo indikator. Pjesa më e madhe e dimensioneve përmbajnë një numër kriteresh. Çdo dimension pikëzohet individualisht përpara se pikëzimi i dimensionit të pëmblihet në indikatorin e përgjithshëm.
Ekonomiciteti, eficaenca, efektiviteti	Parimi i <i>ekonomicitetit</i> do të thotë minimizimi i kostove të burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe me çmimin më të mirë. Parimi i <i>eficencës</i> do të thotë që të marrësh maksimumin nga burimet në dispozicion. Ajo lidhet me marrëdhënien midis burimeve të përdorura dhe rezultatet

	<p>e arritura në terma të sasisë, cilësisë dhe kohës. Parimii efektivitetit ka të bëjë me arritjen e objektivave të vendosura dhe arritjen e rezultateve të synuara.(ISSAI 300:11)</p>
Auditimi financiar	<p>Përqëndrohet në përcaktimin nëse informacioni financiar i njësisë ekonomike është paraqitur në përputhje me raportimin financiar të aplikueshëm dhe kornizën rregullatore. Kjo arrihet duke marrë evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mundësuar audituesin që të shprehë një opinion nëse informacioni financiar është pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi. (ISSAI 100:22)</p>
Pasqyrat financiare	<p>Një praqitje e strukturuar e informacionit historik financiare, përfshirë edhe shënimet përkatëse, të destinuara për të komunikuar burimet ekonomike ose detyrimet e një njësie ekonomike në një moment në kohë ose ndryshimeve në të për një periudhë kohe në përputhje me kornizën e raportimit financiar. Shënimet janë zakonisht një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.</p> <p>Termi - deklaratat financiar zakonisht i referohet grupit të plotë të pasqyrave financiare sikurse përcaktohet nga kërkesat e kornizës së zbatueshme të raportimit financiar, por ai gjithashtu mund t'i referohet një pasqyre të vetme financiare. (ISSAI 1003)</p>
Ndjekje e zbatimit	<p>SAI-t kanë rol në veprim në monitorimin e veprimeve të ndërmarra nga pala përgjegjëse në përgjigje të çështjeve të ngritura në raportin e auditimit. Ndjekja e zbatimit fokusohet në shqyrtimin nëse subjekti i audituar ka adresuar në mënyrë adekuate çështjet e ngritura, duke përfshirë edhe implikimet më të gjera. Veprime të pamjaftueshme ose të pakënaqshme nga subjekti i audituar mund të kërkojë një raport të mëtejshëm nga ana e SAI-t. (ISSAI 100:51)</p>

<p><i>Kryetari i SAI-t</i></p>	<p>Termi "Kryetar i SAI-t" i referohet atyre që janë përgjegjës për vendimmarrjen e SAI-t. Kjo në praktikë varet nga modeli i SAI-t. Për shumë institucione, siç janë SAI-t me funksione gjyqësore, vendimet merren bashkërisht nga një numër anëtarësh. Në këtë kontekst, "anëtarët përcaktohen si personat që marrin vendime për Institucionin Suprem të Auditimit dhe janë përgjegjës për këto vendime ndaj palëve të treta, që janë anëtarët e një organi kolegjal vendimmarrës apo kreu i Institucionit Suprem të Auditimit të organizuar si monokratik."</p>
<p><i>Tregues në KMP e SAI-t</i></p>	<p>KMP e SAI-tpërbëhet nga 25 tregues, ku secili prej tyre ka dy deri në katër dimesione. Pikëzimet e dimensioneve individuale përmbledhet në një pikëzim të përgjithshëm të treguesit.</p>
<p><i>IntoSAINT</i></p>	<p>Vetë-Vlerësimi Integritetit: Një mjet për të vlerësuar cënueshmërinë dhe qëndrueshmërinë ndaj shkeljeve të integritetit të Institucioneve Supreme të Auditimit, zhvilluar nga Gjykata e Auditimit të Mre6tërisë së Hollandës.</p>
<p><i>Kontroll gjyqësor (për SAI-t me funksione gjyqësore)</i></p>	<p>Qëllimi i kontrollit gjyqësor është të marre vendikte në formën e vendimeve specifike: urdhërave, vendimeve ose dekreteve, veçanërisht mbi përgjegjësinë personale dhe financiare të kontabilistëve publik. Në disa raste, qëllimi i kontrollit gjyqësor është të vendosë mbi përgjegjësinë specifike të administratorëve publikë, nëpërmjet vendimeve kolegjiale dhe, mundësisht, të penalizojë ata për çdo parregullsi. Ushtrimi i kontrollit gjyqësor nënkupton përputhshmërinë me standardet e aplikueshme, si dhe zbatimin e një procedure ballafaqese dhe kryesisht tëshkruajtura të përcaktuara në ligj dhe në rregullore. Kontrolli gjyqësor lejon SAI-n të kontrollojë nëse menaxherët publikë, sipas një rregjimi specific detyrimi të vendosur nga ligji dhe rregulloret, përmbushin detyrat që u janë caktuar nga ligji dhe rregulloret. Nëse nuk përmbushin detyrat e tyre, menaxherët publikë janë përgjegjës. Është</p>

	<p>ngushtësisht e kufizuar me përputhshmërinë e detyrave në fjalë. Nuk ka ISSAI hartuar posaçërisht për kontrollin gjyqësor. Prandaj kriteret e futura në indikatorët përkatës në KMP e SAI-t rrjedhin nga praktikat e mira të identifikuara nga një grup referues të SAI-ve gjyqësore.</p>
Mandati	<p>Autoriteti i dhënë SAI-t për të vepruar. SAI do të ushtojë funksionin e tij auditues në sektorin publik të përcaktuar nga kushtetuta dhe nga mandate i vet, i cili i siguron pavarësinë e mjaftueshme dhe fuqinë e diskrecionit në kryerjen e detyrave të tij. Mandati SAI-t mund përcaktojë përgjegjësitë e tij në fushën e auditimit të sektorit publik dhe ofron perceptime shtesë lidhur me auditimet dhe angazhime të tjera për t'u kryer. (ISSAI 100:13)</p> <p>Për SAI-t me funksione gjyqësore, ju lutemi shih "misioni"</p>
Letër Menaxhimi	<p>Gjithashtu referuar si raport auditimi i formës së gjatë. Identifikon çështjet që nuk kërkohet patjetër të jepen shpjegime të mëtejshme në Opinionin e Auditimit dhe jep gjetjet, observacionet dhe rekomandimet e vërejtura gjatë auditimit nga audituesit.</p>
Materialiteti	<p>Materialiteti është i rëndësishëm për të gjitha auditimet. Një çështje mund të gjykohet materiale, nëse njohja e saj ka të ngjarë të ndikojë në vendimet e përdoruesve të synuara. Materialiteti shpesh konsiderohet në aspektin e vlerës, por ajo gjithashtu ka aspekt sasior dhe cilësor. Konsideratat e materialitetit të ndikojnë vendimet në lidhje me natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit dhe vlerësimin e rezultateve të kontrollit. Konsideratat mund të përfshijnë shqetësimet e palëve të interesuara, interesin publik, kërkesat rregullatore dhe pasojat për shoqërinë.</p>

<p>Misioni</p>	<p>Për një SAI me funksione juridiksionale termi mision është më i rëndësishëm se sa mandati. Një SAI juridiksional nuk merr një mandat, ai përmbush misionin që i është besuar.</p>
<p>Auditimi i performancës</p>	<p>Fokusohet nëse ndërhyrjet, programet dhe institucionet janë kryer në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijçencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim. Kjo arrihet duke ekzaminuar performancën kundrejt kriterëve të përshtatshme dhe duke analizuar shkaqet e devijimeve nga kriteret ose problemet. Qëllimi është përgjigja e pyetjeve kyçe të auditimit dhe të japë rekomandime për përmirësim. ISSAI 300 shtjellon më tej këtë. (ISSAI 100:22)</p>
<p>Kontrolli i cilësisë</p>	<p>Përshkruan tërësinë e masave të marra për të siguruar cilësi të lartë të çdo produkt të auditimit. Kryet si pjesë e integruar e procesit të auditimit. Që një sistem kontrolli cilësie të jetë efektiv duhet që kontrolli i cilësisë të jetë pjesë, strategjisë, kulturës dhe procedurave të SAI-t. Në këtë mënyrë , cilësia ndërtohet në performancën e punës së çdo SAI dhe si pjesë e çdo raporti, dhe jo të mbetet një proces shtesë pasi të ketë përfunduar raporti. (ISSAI 40: fq.2)</p>
<p>Sigurimi i cilësisë</p>	<p>Procesi i monitorimit ndërtohet për të dhënë siguri të arsyeshme se politikat dhe procedurat janë të lidhura me sistemin e kontrollit të cilësisë dhe janë të te duhurat dhe të përshtatshmet dhe funksionojnë ne menyrë efektive. Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësime periodike të sistemit të kontrollit të cilësisë së SAI-t, duke përfshirë një kampion nga auditimet e përfunduara të SAI-t. Përgjegjësia e monitorimit të procesit duhet ti ngarkohet një punonjësi me eksperiencën e duhur dhe autoritet brenda SAI-t, i cili duhet të jetë i pavarur, pra të mos ketë marrë pjesë në asnjë punë audituese që ka të bëjë me kontrollin e cilësisë. (ISSAI 40: fq.13)</p>

<p><i>Sigurim i arsyeshëm</i></p>	<p>Siguria mund të jetë e arsyeshme ose e limituar. Siguria e arsyeshme është e lartë por jo absolute. Konkluzioni i auditimit shprehet pozitivisht, duke thënë se opinioni i audituesit është me theksim ose jo të çështjes, është apo jo në përputhje me gjithë aspektet materiale, ose kur është e rëndësishme informacioni tregon një pamje të vërtetë dhe të saktë në përputhje me kriteret e vendosura. (ISSAI 100:46)</p>
<p><i>Vlerësimi i riskut</i></p>	<p>Audituesit duhet të kryejnë vlerësimin e riskut apo analizim të problemeve dhe të rishikojnë atënjë përgjigje të gjetjeve të auditimit. Natyra e risqeve të identifikuar do të ndryshojnë në përputhje me objektivin e auditimit. Audituesi duhet të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë lloje të ndryshme tërisqeve, shmangiet apo gabimeve që mund të ndodhin në lidhje me çështjen. Të dy risqet, të përgjithshme dhe të veçanta, duhet të merren parasysh. Kjo mund të arrihet përmes procedurave që shërbejnë për të njohur subjektin ose programin dhe mjedisin të tij, duke përfshirë kontrollet e brendshme përkatëse. Identifikimi i rreziqeve dhe ndikimi i tyre në auditimin duhet të merret parasysh gjatë procesit të auditimit. (ISSAI 100:46)</p>
<p><i>SAI-t me funksione juridiksionale</i></p>	<p>Në disa vende, SAI është një gjykatë, i përbërë nga gjyqtarë me autoritet mbi përfaqësuesit e shtetit dhe figura të tjera publike që duhet ti japin lloari. Ka një marrëdhënie të rëndësishme midis autoriteteve gjyqësore dhe karakterisitkave të auditimit të sektorit publik. Funksioni gjyqësor kërkon që SAI të japi sigurinë që kushdo që ka të bëjë me fondet publike po vepron me përgjegjshmëri dhe është subjekt i juridiksionit të tij.</p>
<p><i>Evadim i raportit të auditimit</i></p>	<p>Dorëzimi/Dërgimi i një raporti final auditimi autoriteteve që do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e raportit dhe marrjen e masave të duhura.</p>

<p><i>Evidenca të mjaftueshme dhe të duhura</i></p>	<p>Evidencat duhet të jenë të mjaftueshme (nga ana sasiore) që ti krijojnë bindjen një personi që gjetjet janë të arsyeshme dhe të duhura (nga ana cilësore)-domethënë, të rëndësishme, të vlefshme dhe të besueshme.</p>
<p><i>Sistem</i></p>	<p>Një procedurë e vendosur që siguron që praktikat janë të qëndrueshme në të gjithë organizatën dhe gjatë gjithë kohës.</p>

Aneksi 2: Lista e Referencave

Standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)

Referenca Kyçe

Referenca	Titulli i dokumentit	Publikuar nga	Viti i Publikimit
ISSAI 1	Deklarata e Limës	INTOSAI	1977
ISSAI 10	Deklarata e Meksikos mbi pavarësinë	INTOSAI	2007
ISSAI 12	Vlerat dhe dobitë e SAI-ve – të bësh diferencën në jetën e qytetarëve	INTOSAI	2013
ISSAI 20	Parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë	INTOSAI	2010
ISSAI 30	Kodi i Etikës (2016 Verisoni për miratim)	INTOSAI PSC	2016
ISSAI 40	Kontrolli i cilësisë së SAI-t	INTOSAI	2010
ISSAI 100	Parimet bazë të auditimit në sektorin publik	INTOSAI	2013
ISSAI 200	Parimet bazë në auditimin financiar	INTOSAI	2013
ISSAI 300	Parimet bazë në auditimin e performancës	INTOSAI	2013
ISSAI 400	Parimet bazë në auditimin e përputhshmërisë	INTOSAI	2013
Referenca Shtesë			
ISSAI 1210	Dakortësimi mbi Kushtet e Angazhimit të Auditimit	INTOSAI	2010
ISSAI 1800	Dispozita të Veçanta- Auditimi i Pasqyrave Financiare për Qëllime të Veçanta	INTOSAI	2007

ISSAI 1805	Dispozita të Veçanta - Auditimi i Pasqyrave Financiare Individuale dhe Elementët e veçantë, Llogaritë ose Zërat e një Pasqyre Financiare	INTOSAI	2007
ISSAI 1810	Angazhimet për të Raportuar mbi Pasqyrat Financiare Përmbledhëse.	INTOSAI	2007
ISSAI 3000	Standartet e Auditimit të përformancës (Versioni për miratim 2016)	INTOSAI PSC	2016
ISSAI 5600	Udhëzim për Rishikim nga Kolegët (Peer Review)	INTOSAI	2016
INTOSAIGOV 9100	Udhëzues për Kontrollin e Brendshëm në Sektorin Publik	INTOSAI	2004
Burime të tjera			
Titulli i Dokumentit	Publikuar nga	Viti i publikimit	
Ndërtimi i Kapaciteteve në Institucionet Supreme të Auditimit (Udhëzues)	Komiteti INTOSAI Për Ngritjen e Kapaciteteve	2007	
Komunikimi. Manual për Komunikimin në Institucionet Supreme të Auditimit	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedi-së. /AFROSAI-E	2010	
Praktikat e mira në mbështetje të SAI-ve	OECD	2011	
Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë	Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)	2001	

Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t

Udhëzues mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve nga SAI-t	Grupi i Punës së INTOSAI-t mbi Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve nga SAI-t	2013
Si të Risim Përdorimin dhe Impaktin e Raporteve të Auditimit. Një Udhëzues për SAI	Komiteti i INTOSAI-t Për Ngritjen e Kapaciteteve	2010
Menaxhimi Burimeve Njerëzore. Një Udhëzues për SAI	Komiteti i INTOSAI-t Për Ngritjen e Kapaciteteve	2012
Korniza e Ndërtimit të Kapaciteteve Institucionale	AFROSAI-E	2009
(ICBF)		
Standarti Ndërkombëtar mbi Kontrollin e Cilësisë	Bordi Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë	2009
(ISQC1)		
IntoSAINT	Gjykata e Auditimit, Hollandë	2014
Të mësuarit nga Impakti. Një Udhëzues Praktik për SAI-t	Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI)	2009
Korniza e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjshmërisë Financiare	Partnerët e PEFA	2016
(PEFA)		
Planifikimi Strategjik. Një Manual për SAI-t	Iniciativa e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI)	2009
Korniza e Përbashkët e Vlerësimit (CAF)	Rrjeti Evropian i Korrespondentëve Kombëtarë	2013
	CAF	

	Dhe Qendra Burimore Evropiane CAF në EIPA	
Përdorimi Sistemeve Kombëtare të Menaxhimit Financiar Publik. Një Udhëzues për praktikuesit	OECD	2011

Aneksi 3: Përcaktimi i KMP i SAI-t për vlerat dhe dobisë e Institucioneve Supreme të Auditimit

Tabela e mëposhtme paraqet parimet mbi "Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit" sipas Fushave dhe kritereve të SAI.

Forcimi i përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të Qeverisë dhe subjekteve të sektorit publik.

Parimet	Fusha, Treguesi, Fusha
Parimi 1: Ruajtjen e pavarësisë së SAI-t	
1.1. SAI-t duhet të përpiqen të nxisin, të sigurojnë dhe të mbajnë një kuadër të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues, ligjor ose juridik.	Fusha A, SAI-1 (i) Fusha B, SAI-3 (i)
1.2. SAI duhet të kërkojë të ruajë pavarësinë e drejtuesve të tij dhe anëtarëve (të institucioneve kolegjiale), duke përfshirë sigurinë e mandatit dhe imunitetin ligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, e cila rezulton nga shkarkimi normal i detyrave të tyre.	Fusha A, SAI-1 (i) FushaA, SAI-1 (iv)
1.3. SAI-t duhet të përdorin mandatet dhe gjykimin e tyre në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësisë për të përmirësuar administrimin e fondeve publike.	Fusha A, SAI-2 (i)
1.4. SAI-t duhet të kenë të drejta të pakufizuara për qasje në të gjitha informatat e nevojshme, për kryerjen e duhur të përgjegjësisë të tyre ligjore.	Fusha A, SAI-2 (ii)
1.5. SAI-t duhet të përdorin të drejtat dhe detyrimet e tyre për të raportuar në mënyrë të pavarur punën e tyre.	Fusha A, SAI-2 (iii)
1.6. SAI-t duhet të kenë lirinë për të vendosur mbi përmbajtjen dhe kohën e raporteve të tyre.	Fusha A, SAI-2 (iii)
1.7. SAI-t duhet të kenë mekanizma të përshtatshëm për ndjekjen e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit.	Fusha C, SAI-11 (iii), SAI-14(iii),

	SAI-17 (iii), SAI-20 (iii)
1.8. SAI-t duhet të kërkojnë të ruajnë autonominë financiare dhe menaxheriale apo administrative dhe burimet e përshtatshme njerëzore, materiale dhe financiare.	Fusha A, SAI-1 (ii), (iii)
1.9. SAI-t duhet të raportojnë për çdo çështje që mund të ndikojnë aftësinë për të kryer punën e tyre në përputhje me mandatet dhe/ose kuadrit legjislativ.	Fusha A, SAI-2 (i), (iii)
	Fusha B, SAI-3 (iv)
Parimi 2: Kryerja e auditimeve për të siguruar se qeveria dhe subjektet e sektorit publik janë përgjegjës për administrimin mbi dhe përdorimin e, burimeve publike.	
2.1a SAI-t duhet të kryejnë, në përputhje me mandatet e tyre dhe standardet profesionale të zbatueshme, auditime të informacioneve financiare dhe jo-financiare përkatëse.	Fusha C, SAI-8 (i)
	Fusha C, SAI-9 deri SAI-11
	Fusha C, SAI-15 deri SAI-17
2.1b SAI-t duhet të kryejnë, në përputhje me mandatet e tyre dhe standardet profesionale të zbatueshme, auditime performancës.	Fusha C, SAI-8 (ii)
	Fusha C, SAI-12 deri SAI-14
	Fusha C, SAI-8 (iii)
2.1c SAI-t duhet të kryejnë, në përputhje me mandatet e tyre dhe standardet profesionale të zbatueshme, auditime përputhshmërie me autoritetin e zbatueshëm.	Fusha C, SAI-15 deri SAI-17
2.2. SAI-t gjithashtu mund, në përputhje me mandatet e tyre, të kryejnë lloje të tjera të punës, për shembull shqyrtimit gjyqësor apo hetimit në përdorimin e burimeve publike apo çështje ku interesi publik është në rrezik.	Fusha C, SAI-18 deri SAI-20
	Fusha C, SAI-20 (i), (ii), (iii)

2.3 SAI-t duhet t'i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me mandatet e tyre, risqeve të parregullsive financiare, mashtrimit dhe korrupsionit.	Fusha C, SAI-10 (i), (ii)
	Fusha C, SAI-13 (i)
	Fusha C, SAI-16: (i), (ii)
2.4. SAI-t duhet të dorëzojnë raportet e auditimit, në përputhje me mandatet e tyre, për legjislaturën apo ndonjë organ tjetër përgjegjës publik, sipas rastit.	Fusha A, SAI-2 (iii)
	Fusha C, SAI-11 (i)
	Fusha C, SAI-14 (i)
	Fusha C, SAI-17 (i)
Parimi 3: Aftësimi i personave të ngarkuar me qeverisjen e sektorit publik për të përmbytur përgjegjësitë e tyre në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit dhe duke marrë masat e duhura korrigjuese.	
3.1. SAI-t duhet të sigurojnë komunikim të mirë me të audituarit dhe aktorët e tjerë, sipas rastit, dhe ti mbajnë të informuar gjatë procesit të auditimit për çështjet që dalin nga puna e SAI-t.	Fusha C, SAI-10 (i), (ii)
	Fusha C, SAI-11
	Fusha C, SAI-13 deri SAI-14
	Fusha C, SAI-16: (i), (iii)
	Fusha C, SAI-17
	Fusha C, SAI-19: (ii), (iii)
	Fusha F, SAI-24 deri SAI-25

<p>3.2. SAI-t duhet, në përputhje me mandatin e tyre, të sigurojnë legjislativin, komitetet e tij, apo menaxhimit dhe bordet qeverisëse të subjekteve të audituara me informata relevante, objektive dhe në kohën e duhur.</p>	Fusha C, SAI-11
	Fusha C, SAI-14
	Fusha C, SAI-17
	Fusha F, SAI-24 (ii), (iii)
<p>3.3. SAI-t duhet të analizojnë raportet e tyre individuale të auditimit për të identifikuar tema, gjetjet e përbashkëta, tendencat, shkaqet dhe rekomandimet e auditimit dhe për të diskutuar këto me palët kyçe të interesuara.</p>	Fusha F, SAI-24 (ii), (iii)
<p>3.4. SAI-t duhet, pa kompromentuar pavarësinë e tyre, të ofrojnë këshilla se si gjetjet e tyre të auditimit dhe mendimet mund të përdoren për efekt më të madh, për shembull, përmes ofrimit të udhëzimeve të praktikave të mira.</p>	Fusha F, SAI-24 (ii)
<p>3.5. SAI-t duhet të zhvillojnë marrëdhënie profesionale me komisionet përkatëse të mbikëqyrjes legjislative dhe të menaxhimit të subjekteve të audituara dhe bordet drejtuese për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë raportet dhe konkluzionet e auditimit dhe të marrë masat e duhura.</p>	Fusha F, SAI-24 (i), (ii), (iii)
<p>3.6. SAI-t duhet të raportojnë, sipas nevojës, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të tyre.</p>	Fusha C, SAI-11 (iii)
	Fusha C, SAI-14 (iii)
	Fusha C, SAI-17 (iii)
	Fusha C, SAI-20 (iii)

Parimi 4: Raportimi mbi rezultatet e auditimit duke mundësuar publikun të rrisë llogaridhënien e qeverisë dhe të subjekteve të sektorit publik	
4.1. SAI-t duhet të raportojnë informacion objektiv në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë, duke përdorur një gjuhë që kuptohet nga të gjithë aktorët e tyre.	Fusha C, SAI-10 (iii)
	Fusha C, SAI-13 (iii)
	Fusha C, SAI-16 (iii)
	Fusha C, SAI-19 (iii)
	Fusha F, SAI-25
4.2. SAI-t duhet të vënë raportet e tyre në dispozicion të publikut në kohën e duhur.	Fusha B, SAI-3 (iv)
	Fusha C, SAI-11 (ii)
	Fusha C, SAI-14 (ii)
	Fusha C, SAI-17 (ii)
	Fusha C, SAI-20 (ii)
	Fusha F, SAI-25
4.3. SAI-t duhet të lehtësojnë qasjen në raportet e tyre nga të gjitha palët e interesuara, duke përdorur mjetet e duhura të komunikimit.	Fusha F, SAI-25 (i), (ii)

Demonstrimi i rëndësisë së vazhdueshme për qytetarët, parlamentin dhe pjesëmarrësit e tjerë

Parimi 5: Duke qenë të përgjegjshëm për ndryshimin e ambientit dhe risqeve në zhvillim.	
5.1. SAI-t duhet të jenë të vetëdijshëm për pritshmëritë e palëve të interesuara dhe të përgjigjet për këto, sipas rastit, në kohën e duhur dhe pa kompromentuar pavarësinë e tyre.	Fusha B, SAI-3 (i), (iii), (iv)
	Fusha B, SAI-7 (i)
	Fusha F, SAI-24 (ii), (iii)
5.2. SAI-t duhet, në zhvillimin e programit të tyre të punës, të përgjigjen në mënyrë sa më të përshtatshme për çështjet kyçe që prekin shoqërinë.	Fusha B, SAI-3 (i)
	Fusha B, SAI-7 (i)
5.3. SAI-t duhet të vlerësojnë në ndryshim dhe zhvillimin e risqeve në mjedisin e auditimit dhe të përgjigjen për këto në kohën e duhur, për shembull duke nxitur mekanizma për të adresuar keqpërdorimin financiar, mashtrimin dhe korrupsionin.	Fusha B, SAI-7 (i) Fusha C, SAI-10 (i), (ii)
	Fusha C, SAI-13 (i), (ii)
	Fusha C, SAI-16 (i)
	Fusha C, SAI-24 (i), (iii)

5.4. SAI-t duhet të sigurojnë që shpresat e aktorëve dhe risqet e reja janë faktorë në planet strategjike, të biznesit dhe të auditimit, sipas rastit.	Fusha B, SAI-3 (i), (iii)
	Fusha B, SAI-7 (i')
5.5. SAI-t duhet të konsiderojnë çështjet relevante që po debatohen në forum vendore dhe ndërkombëtare dhe të marrin pjesë kur është e përshtatshme.	Fusha F, SAI-25 (ii)
5.6. SAI-t duhet të krijojnë mekanizma për mbledhjen e informacionit, vendimmarrjen dhe matjen e performancës për të rritur rëndësi për palët e interesit	Fusha B, SAI-3
	Fusha B, SAI-7 (i)
	Fusha F, SAI-24 (ii), (iii)
	Fusha F, SAI-25 (ii)
Parimi 6: Komunikimi në mënyrë efektive me palët e interesuara	
6.1. SAI-t duhet të komunikojnë në një mënyrë që rrit njohuritë dhe të kuptuarit e palëve të interesuara në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e SAI-t si një auditues i pavarur i sektorit publik.	Fusha F, SAI-24 (i), (ii), (iii), (iv)
	Fusha F, SAI-25 (ii)
6.2. Komunikimi i SAI-t duhet të kontribuojë për të ndërgjegjësuar palët e interesuara ndaj nevojës për transparencë dhe llogaridhënie në sektorin publik.	Fusha F, SAI-25 (ii)
6.3. SAI-t duhet të komunikojnë me palët e interesuara për të siguruar të kuptuarit e punës së auditimit dhe rezultatet e SAI-t.	Fusha C, SAI-11 (i), (ii)

	Fusha C, SAI-13 (i), (ii)
	Fusha C, SAI-16 (i), (iii)
	Fusha C, SAI-19 (ii)
	Fusha F, SAI-24
	Fusha F, SAI-25
6.4. SAI-t duhet të ndër vepronjë në mënyrë të përshtatshme me mediat, për të lehtësuar komunikimin me qytetarët.	Fusha F, SAI-25 (ii)
6.5. SAI-t duhet të angazhohen me palët e interesuara, duke pranuar rolet e tyre të ndryshme dhe të marrë parasysh pikëpamjet e tyre, pa kompromentuar pavarësinë e SAI-t.	Fusha B, SAI-3 (i), (ii) Fusha B, SAI-7 (i)
	Fusha F, SAI-24
	Fusha F, SAI-25 (ii)
6.6. SAI-t duhet periodikisht të vlerësojnë nëse palët e interesuara besojnë se SAI ka komunikuar në mënyrë efektive.	Fusha F, SAI-24 (i),(ii), (iii)
	Fusha F, SAI-25 (i), (ii)

Parimi 7: Duke qenë një burim i besueshëm për njohuri dhe udhëzime të pavarura dhe objektive për të mbështetur ndryshimin e dobishëm në sektorin publik.	
7.1. Puna e SAI-ve duhet të bazohet në gjykimin e pavarur profesional dhe të shëndoshë dhe analiza të fuqishme.	Fusha C, SAI-9 deri SAI-20
7.2. SAI-t duhet të kontribuojnë në debatin për përmirësime në sektorin publik pa kompromentuar pavarësinë e tyre	Fusha F, SAI-25 (ii)
7.3. SAI-t duhet, si partnerë aktivë në profesionin kombëtar dhe ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik, të përdorin njohuritë dhe njohuri të tyre për të avokuar reformat e sektorit publik, për shembull në fushën e menaxhimit të financave publike.	Fusha F, SAI-25 (ii)
7.4. SAI-t duhet periodikisht të vlerësojnë nëse palët e interesuara të besojnë se ata janë të efektshme dhe për të kontribuar në përmirësimin e sektorit publik.	Fusha F, SAI-24 (ii). (iii)
	Fusha F, SAI-26 (i), (ii)
7.5. SAI-t duhet të bashkëpunojnë ndërkombëtarisht brenda INTOSAI dhe me organizata të tjera përkatëse profesionale në mënyrë që të promovojnë rolin e komunitetit në trajtimin e çështjeve globale që lidhen me Auditimin e Sektorit Publik, kontabilitetin dhe llogaridhënien.	Fusha B, SAI-4 (iv)

Të qenit organizatë model që udhëheq nëpërmjet shembullit

Parimi 8: Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies së duhur të SAI-ve	
8.1. SAI-t duhet të kryejnë detyrat e tyre në një mënyrë që siguron llogaridhënie, transparencë dhe qeverisjen e mirë publike.	Fusha A, SAI-1 (iii)
	Fusha B, SAI-3 dhe SAI-4
	Fusha B, SAI-7 (i)
	Fusha C,
	Fusha D,
	Fusha F,
8.2. SAI-t duhet të bëjnë publikë mandatin e tyre, përgjegjësitë, misionin dhe strategjinë	Fusha A, SAI-3 (iii)
8.3. SAI-t duhet të përdorin, si të përshtatshme për rrethanat e tyre, standardet e auditimit, proceset dhe metodat që janë objektive dhe transparente, dhe të bëjnë të njohur aktorëve çfarë standardesh dhe metoda përdorin.	Fusha B, SAI-3 (iv)
	Fusha C, SAI-9 (i)
	Fusha C, SAI-10 (iii)
	Fusha C, SAI-12 (i)
	Fusha C, SAI-13 (iii)
	Fusha C, SAI-15 (i)
	Fusha C, SAI-16 (iii)
	Fusha C, SAI-18 (i)
	Fusha C, SAI-19 (iv)
	Fusha B, SAI-3 (iv)

8.4. SAI-t duhet të menaxhojnë operacionet e tyre ekonomike, në mënyrë efikase, efektive dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe të raportojnë publikisht për këto çështje.	Fusha B, SAI-4
	Fusha D, SAI-21
8.5. SAI-t duhet të jenë subjekt i shqyrtimit të pavarur të jashtëm, duke përfshirë edhe auditimin e jashtëm të operacioneve të tyre dhe të vendosin në dispozicion të palëve të interesuara këto raporte.	Fusha B, SAI-3 (iv)
	Fusha B, SAI-4 (iv)
	Fusha B, SAI-7 (iii)
	Fusha D, SAI-21 (i)
Parimi 9: Sigurimi i një qeverisje të mirë të SAI-ve	
9.1. SAI-t duhet të miratojnë dhe të jenë në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe të raportojnë në mënyrë të përshtatshme mbi të.	Fusha B, SAI-3 (iv)
	Fusha B, SAI-4
	Fusha B, SAI-21 (i), (ii)
9.2. SAI-t periodikisht duhet të dorëzojnë punën e tyre për rishikim të pavarur, për shqyrtim nga kolegët.	Fusha B, SAI-4 (iv)
9.3. SAI-t duhet të kenë një strukturë organizative të menaxhimit dhe mbështetëse të përshtatshme që të japë efekt në proceset e qeverisjes së mirë dhe të mbështesë praktikatat e shëndosha të kontrollit dhe të drejtimit të brendshëm.	Fusha B, SAI-4 (i), (ii), (iii)
	Fusha B, SAI-6
	Fusha D, SAI-22
	Fusha E, SAI-22, SAI-23 (i)
9.4. SAI-t duhet të vlerësojnë riskun organizativ rregullisht dhe të plotësojnë këtë me iniciativa të menaxhimit të riskut të zbatuara në mënyrë të përshtatshme dhe të monitoruara rregullisht, për shembull	Fusha B, SAI-4 (i),(ii),(iii),(iv)
	Fusha B, SAI-3 (ii)

nëpërmjet një funksionimi në mënyrë të përshtatshme objektive të auditimit të brendshëm.	Fusha B, SAI-7 (ii),(iii)
Parimi 10: Pajtueshmëria me Kodin e Etikës së SAI-t	
10.1. SAI-t duhet të aplikojnë Kodin e Etikës që është në përputhje me mandatin e tyre dhe i përshtatshëm për rrethanat, për shembull Kodi i Etikës INTOSAI.	Fusha B, SAI-4 (i)
10.2. SAI-t duhet të aplikojnë standarde të larta të integritetit dhe etikës siç është shprehur në kodin e sjelljes.	Fusha B, SAI-4 (i)
	Fusha B, SAI-10 (i), SAI-13 (i), SAI-16 (i), SAI-19 (i)
10.3. SAI duhet të themelojë politikat dhe proceset e duhura për të siguruar ndërgjegjësimin dhe respektimin e kërkesave të kodit të sjelljes brenda SAI-t.	Fusha B, SAI-4 (i), (ii), (iii), (iv) Fusha B, SAI-6 (i)
10.4. SAI duhet të publikojë vlerat e tij kryesore dhe angazhimin për etikën profesionale.	Fusha B, SAI-3 (iii), SAI-4 (i)
10.5. SAI duhet të zbatojë vlerat e tij kryesore dhe angazhimin për etikën profesionale në të gjitha aspektet e punës së tij, në mënyrë që të shërbejë si një shembull.	Fusha B, SAI-4 (i), (ii), (iii),(iv) Fusha B, SAI-6 (i)
Parimi 11: Përpjekjet për përsosmëri të shërbimit dhe cilësi	
11.1. SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të hartuara për të nxitur një kulturë të brendshme që pranon se cilësia është thelbësore në kryerjen e të gjitha aspekteve të punës së SAI-t.	Fusha B, SAI-4 Fusha B, SAI-5 (ii),(iii)
	Fusha B, SAI-6 (i)
	Fusha B, SAI-4 (i)
	Fusha B, SAI-5 (i)

11.2. Politikat dhe procedurat e SAI-t duhet të kërkojnë që i gjithë stafi dhe të gjitha palët që punojnë në emër të SAI-t të jenë në përputhje me kërkesat përkatëse etike.	Fusha C, SAI-10 (i)
	Fusha C, SAI-13 (i)
	Fusha C, SAI-16 (i)
	Fusha C, SAI-19 (i)
11.3. Politikat dhe procedurat e SAI-t duhet të parashikojnë se SAI do të ndërmarrë vetëm punën që është kompetent për të kryer.	Fusha C, SAI-9 (ii), SAI-12 (ii), SAI-15 (ii), SAI-18(ii) RP-SAI, seksioni c), 3.3
11.4. SAI duhet të ketë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer punën e tij në përputhje me standardet relevante dhe kërkesat e tjera, duke përfshirë të pasurit qasje në kohën e duhur ndaj këshillimit të jashtëm dhe të pavarur kur është e nevojshme.	Fusha E, SAI-23
	Fusha C, SAI-9 (ii)
	Fusha C, SAI-13 (ii)
	Fusha C, SAI-15 (ii)
	Fusha C, SAI-18 (ii)
11.5. Politikat dhe procedurat e SAI-t duhet të promovojnë qëndrueshmërinë në cilësinë e punës së tyre dhe duhet të përcaktojnë përgjegjësitë për mbikëqyrjen dhe rishikimin.	Fusha B, SAI-4 (iii), SAI-5
	Fusha C, SAI-9 (i), (iii)
	Fusha C, SAI-12 (i), (iii)
	Fusha C, SAI-15 (i), (iii)

	Fusha C, SAI-18 (i), (iii)
11.6. SAI duhet të krijojë një proces monitorimi që siguron që sistemi i kontrollit të cilësisë është i rëndësishme, adekuat dhe që vepron në mënyrë efektive.	Fusha B, SAI-4 (iv)
	Fusha B, SAI-5 (iii)
Parimi 12: Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive	
12.1. SAI-t duhet të promovojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional që kontribuon në përsosmërisë individuale, të grupit dhe organizative.	Fusha E, SAI-23
12.2. SAI duhet të ketë një strategji të zhvillimit profesional, duke përfshirë trajnimin, që është i bazuar në nivelet minimale të kualifikimeve, përvojës dhe kompetencës së nevojshme për të kryer punën e SAI-t.	Fusha E, SAI-23
12.3. SAI-t duhet të përpiqen të sigurojnë që personeli i tyre ka kompetenca profesionale dhe mbështetjen e kolegëve dhe të menaxhimit për të bërë punën e tyre.	Fusha E, SAI-23
12.4. SAI duhet të nxisë shkëmbimin e njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të dorëzimit të rezultateve.	RP-SA seksioni (c)
12.5. SAI duhet të përfitojë nga puna e të tjerëve, duke përfshirë edhe SAI-t kolegë, INTOSAI dhe grupet rajonale përkatëse të punës.	RP-SA seksioni (c)
12.6. SAI-t duhet të përpiqen për të bashkëpunuar me profesionin e auditimit në mënyrë që të rrisin profesionin.	Fusha F, SAI-25 (ii)
12.7. SAI-t duhet të përpiqen të marrin pjesë në aktivitete të INTOSAI-t dhe të ndërtojnë rrjete me institucionet e tjera dhe SAI relevante, për të mbajtur të ngritur vëmendjen ndaj çështjeve të reja dhe për të nxitur shkëmbimin e njohurive për të përfituar nga SAI-t e tjera.	RP-SA seksioni (c)

Lista e Shkurtimeve

AFROSAI-E	<i>Organizata Afrikane e Institucioneve Supreme të Auditimit (anglisht-folëse);</i>
IDI	<i>Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t;</i>
INTOSAI	<i>Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit;</i>
INTOSAINT	<i>Vetëvlerësimi i integritetit: një mjet për vlerësimin e dobësive dhe elasticitetin e shkeljeve të integritetit të Institucioneve Supreme të Auditimit, të zhvilluar nga Gjykata e Auditimit Holandeze;</i>
ISSAI	<i>Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit;</i>
NA	<i>Nuk aplikohet;</i>
NR	<i>Nuk vlerësohet;</i>
PEFA	<i>Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare;</i>
PEFA PI	<i>Kuadri i indikatorëve të Performancës PEFA;</i>
PFM	<i>Menaxhimi i Financave Publike;</i>
QA	<i>Sigurimi i Cilësisë;</i>
QC	<i>Kontrolli i Cilësisë;</i>
SAI	<i>Institucion Suprem Auditimi;</i>
KMP E SAI-T	<i>Kuadri i Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit;</i>
SAI-PR	<i>Raporti i Performancës së Institucioneve të Auditimit;</i>
WGVBS INTOSAI	<i>Grup Pune mbi Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve;</i>

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH.Kontrolli i Lartë i Shtetit

“Korniza e matjes së performancës së SAI-ve”:

Grupi i punës së INTOSAI-t mbi vlerën dhe dobëtë e SAI-ve / RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit. - Tiranë: KLSH, 2017

254 f.; 165 x 235 Bibliogr.

ISBN 978-9928-159-59-5

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit 2.Administrimi publik 3.Kontrolli

4. Vlerësimi 5.Projekte

351.95(496.5) (083.9)

005.962.13 (083.9)

ISBN: 978-9928-159-59-5



Kontrolli i Lartë i Shetit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3
Tiranë Tel/Fax 04/228485, Tel.04/251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail klsh@klsh.org.al

 **print**
CLASSIC
Printing & Publishing Home